UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

POLITIKA PENALE NDAJ KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE DHE METODIKA E ZBULIMIT TË TIJ NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË GJATË PERIUDHËS KOHORE 2006-2015

Kandidat:

Mr. Sc. Blerta AHMEDI ARIFI

Mentor:

Prof. Dr. Besa ARIFI

Qershor 2018

Prindërve të mi, Arsimit, Agronit dhe Triumfit tim.

Falemnderim

Për të realizuar me sukses një sfidë të jetës siç ishte për mua hulumtimi i temës së punimit të doktoratës, fillimisht e falemnderoj Zotin i cili më fali shëndetin, motivimin dhe forcën për të punuar me shumë vullnet me qëllim për ta realizuar këtë sfidë.

Gjatë këtij rrugëtimi kam pasur fatin të bashkëpunoj dhe të gjej mbështetjen e shumë personave, të cilët i falemnderoj dhe i'u jam mirënjohëse për ndihmën që ma kanë ofruar.

Falemnderoj mentoren time Prof. Dr. Besa Arifi për bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë hulumtimit të punimit, për këshillat dhe udhëzimet gjatë ç'do faze të punës hulumtuese. Poashtu, falemnderoj për bashkëpunimin shumë produktiv anëtarët e komisionit për vlerësim të punimit të doktoratës, Prof. Dr. Vllado Kambovski, Prof. Dr. Ejup Sahiti, Prof. Dr. Ismail Zejneli dhe Prof. Dr. Jeton Shasivari për udhëzimet dhe vërejtjet e tyre profesionale.

Falemnderoj profesorët e Fakultetit të Drejtësisë në UEJL, të cilët kanë kontribuar në ngritjen time profesionale si dhe kolegët e studimeve Vedije Ratkoceri dhe Vilard Bytyqi. Dekanen e Fakultetit të Drejtësisë në UEJL Doc. Dr. Emine Zendeli dhe Prof. Dr. Adnan Jashari për mbështetjen e dhënë, si dhe znj. Emsale Murtezani për realizimin efikas të të gjitha çështjeve procedurale në kuadër të Shkollës së Doktoratës në UEJL.

Falemnderoj Prof. Dr. Gentian Zyberi për mbështetjen gjatë qëndrimit tim në Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oslos, me ç'rast realizova hulumtimin ndërkombëtar në këtë Qendër.

Falemnderoj përfaqësuesit e projektit të agjencionit zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim - Civica Mobilitas për vlerësimin e temës dhe ndarjen e Grantit për bursë për krijim dhe shpërndarje të njohurive për shoqërinë civile përmes këtij hulumtimi. Si dhe koordinatoren nga Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar (MCMS) znj. Sara Mustafa për bashkëpunimin e sukseshëm gjatë realizimit të grantit. Falemnderoj znj. Liljana Jakovçevska dhe znj. Lirie Elezi për ndihmën profesionale që ma kanë ofruar.

Në fund, falemnderoj familjen time të shtrenjtë e cila më ka përkrahur në ç'do moment, e veçanërisht nënën Sermijete, vëllaun Arsimin dhe bashkëshortin Agronin, të cilët janë kujdesur për Triumfin sa herë që unë nuk isha aty e më kanë qëndruar pas gjatë tërë këtij rrugëtimi, duke më ndihmuar dhe përkrahur në ç'do aspekt. Ç'do falemnderim për ta është i pamjaftueshëm krahas mbështetjes që ata më japin ç'do ditë, andaj si shenjë të mirënjohjes së përjetshme këtë punim ua dedikoj pikërisht atyre dhe babait tim Ramadan Ahmedi i cili është gjithmonë në zemrën time, si dhe motivit të jetës time Triumfit.

Blerta A.

Qershor, 2018, Tetovë.

Abstrakt

Hulumtimi i pasqyruar në këtë punim të përfshinë fushën e politikës penale për luftimin e kriminalitetit të fëmijëve. Objekti i hulumtimit është fokusuar në analizimin e legjislacionit penal për personat jomadhorë të Republikës së Maqedonisë.

Është analizuar zhvillimit i politikës penale në vend gjatë periudhës kohore 2006-2015. Në këtë drejtim në pjesën e parë të punimit është trajtuar Politika represive ndaj delikuencës/kriminalitetit të fëmijëve, ndërsa në pjesën e dytë është trajtuar Politika preventive e vendit ndaj këtij fenomeni. Është trajtuar poashtu Metodika e sqarimit dhe zbulimit të veprave penale të kryera nga fëmijët, në pjesën e tretë të punimit.

Së këndejmi, lënda e hulumtimit ka të bëjë me analizimin e masave ndëshkimore, parandaluese dhe atyre të cilat kanë për funksion zbulimin e fëmijëve të dyshuar për kryerje të veprave të kundërligjshme. Pra, tri aspekte të ndryshme të trajtimit të kriminalitetit të manifestuar nga fëmijët janë analizuar në tri pjesët e veçanta të punimit. Ndërkaq pjesa e fundit përmbanë analizën e shtrirjes së fenomenit të delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015.

Kriminaliteti i fëmijëve paraqet një pjesë të rëndësishme për studim nga fusha e të drejtës penale, kjo sepse kryerësit e tij dallohen me karakteristika specifike. Ajo që i bën ata të veçantë gjatë trajtimit penalo-juridik është mosha e tyre kritike-jomadhore, e cila sipas legjislacionit pozitiv të vendit tonë përfshinë grupin e moshave 14-18 vjeçare.

Në punim janë trajtuar disa legjislacione të huaja që rregullojnë drejtësinë penale për fëmijë, si ai i Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë, Zvicrës, Holandës, Norvegjisë dhe Anglisë me qëllim që përmes analizimit të ngjashmërive dhe dallimeve të drejtësisë penale për fëmijë të Republikës së Maqedonisë me këto shtete, të mund të nxirren përfundime dhe rekomandime se ku duhet të përmirësohet dhe fokusohet për t'u zhvilluar politika penale e vendit tonë.

Terma kyçë: Fëmijë, fëmijë në konflikt me ligjin, politika represive, parandalimi, zbulimi.

Abstract

The research reflected in this doctoral thesis includes the criminal policy area for fighting agains child criminality. The object of the research is focused on analyzing the criminal legislation of Republic of Macedonia which treats the juveniles.

It is analyzed the development of criminal policy in the country during the period 2006-2015. In this regard, in the first part of the paper, the repressive policy on child delinquency/ criminality is treated, while in the second part the country's preventive policy against this phenomenon. The Methodology of clarification and detection of criminal offenses committed by children is also addressed in the third part of the paper.

Therefore, the subject matter of the research is to analyze the punitive and preventive measures and those that have the function of detecting children suspected of committing the offenses. Thus, three different aspects of the treatment of criminality manifested by children are analyzed in three separate parts of the paper. The last part contains an analysis of the extent of child delinquency phenomenon in the Republic of Macedonia during the period 2006-2015.

Child criminality is an important part of the study in the field of criminal law, because its perpetrators are distinguished by specific characteristics. What makes them special during criminal-judicial treatment is their critical age, which according to our country's legislation includes a group of ages of 14-18 years.

Some foreign legislation regulating criminal justice for children, such as Kosovo, Albania, Croatia, Switzerland, the Netherlands, Norway and England, have been dealt with in this paper in order to analyze the similarities and differences of criminal justice for children of the Republic of Macedonia with these states, which can draw conclusions and recommendations on where to improve and focus on developing our country's criminal policy.

Key terms: Children, children in conflict with law, repressive policies, prevention, detection.

DEKLARATË

Vërtetoj se unë jam autori original i këtij punimi.

Blerta Ahmedi Arifi

_____

PËRMBAJTJA

HYRJE.....6
1. Objekti i studimit... 6
2. Arsyeshmëria e studimit.. 7
3. Metodologjia e hulumtimit.. 9
4. Sistemimi i punimit. 10
5. Hipotezat e hulumtimit... 12

PJESA E PARË

POLITIKA REPRESIVE E SISTEMIT JURIDIKO-PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE : 2006-2015

KAPITULLI I

1. TRAJTIMI JURIDIKO-PENAL I FËMIJËVE NË RREZIK DHE NË KONFLIKT ME LIGJIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....15

1.1. Drejtësia penale për fëmijë nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë deri më sot..15
1.2. Kategorizimi i fëmijëve sipas moshës.....19
1.3. Parimet e drejtësisë penale për fëmijë 25
1.3.1. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Kodit penal.....25
1.3.2. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Ligjit për drejtësinë për të mitur.....26
1.3.3. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Ligjit për drejtësinë për fëmijë.....27
1.4. Sanksionet penale për fëmijë sipas Ligjit për drejtësinë për fëmijë.....31
1.4.1. Kuptimi dhe llojet e sanksioneve penale për fëmijë.....31
1.4.2. Masat edukuese.....33
1.4.2.1. Kuptimi i masave edukuese.....33
1.4.2.2 Llojet e masave edukuese.....34
1.4.2.2 (1) Qortimi dhe Dërgimi në Qendër edukuese.....35
1.4.2.2. (2)Masat e mbikqyrjes së përforcuar.....36
1.4.2.2.(3) Masat e enteve.....39
1.4.3 Dënimet për fëmijë.....40
1.4.3 (1) Burgu për fëmijë.....41
1.4.3(2) Dënimi me para (Gjoba)..,.....43
1.4.3(3) Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi 44
1.4.4 Masat alternative.....45
1.4.4.1. Llojet dhe qëllimi i masave alternative.....45
1.4.5. Masat siguruese.....47
1.5. Sanksionet kundërvajtëse për fëmijë.....48

1.6. Efekti i sanksioneve për fëmijë, rehabilitimi dhe parashkrimi i tyre sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve.....50

KAPITULLI II

2. NORMAT DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË PENALE TË FËMIJËVE.....52

2.1. Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës.....52

2.2. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit") 58

2.3. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të cilëve u është hequr liria ("Rregullat e Havanës") 62

2.4. Rregullat e OKB-së për preventivë të delikuencës së të miturve ("Rregullat e Riadit").....69

KAPITULLI III

3. QASJE KRAHASIMORE NDAJ DREJTËSISË PENALE PËR FËMIJË TË DISA VENDEVE TË RAJONIT DHE ATYRE EVROPJANE 70

3.1. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Shqipërisë.....71

3.2. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Kosovës.....81

3.3. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Kroacisë.....89

3.4. Drejtësia penale për fëmijë e Holandës.....95

3.5. Drejtësia penale për fëmijë e Konfederatës Zvicerane.....103

3.6. Drejtësia penale për fëmijë e Norvegjisë.....112

3.7. Drejtësia penale për fëmijë e Anglisë.....122

PJESA E DYTË:

POLITIKA PARANDALUESE PËR PENGIMIN E KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË: 2006-2015

KAPITULLI IV

4. MASAT PREVENTIVE-JURIDIKE PËR PENGIM TË KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....135

4.1. Strategjia Nacionale për parandalim të delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë (2010-2020) dhe efekti i saj në praktikë.....135

4.1.1. Sfidat kryesore dhe drejtimet strategjike të strategjisë.....139

4.2. Qëllimi i parandalimit special dhe gjeneral i dënimeve për fëmijë.....143

4.3. Efekti parandalues i masave të ndihmës dhe mbrojtjes.....145

4.3.1. Llojet e masave të ndihmës dhe mbrojtjes 147

4.4. Efekti i sanksioneve penale për fëmijë në arritjen e parandalimit special, me vështrim të posaçëm në masat e entit dhe dënimit me burgim për fëmijë.....149
4.4.1. Rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të gjykuar me masë të entit- Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese.....149
4.4.2. Rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të dënuar me burg për fëmijë.....160

KAPITULLI V
5. NDIKIMI I DISA FAKTORËVE SOCIAL NË PARANDALIMIN E KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE.....165
5.1. Familja si faktor mbrojtës dhe roli i saj në parandalimin e delikuencës së fëmijëve.....166
5.2. Edukimi.....167
5.3. Mjedisi jetësor.....168
5.4. Faktorë të tjerë (mbrojtës/të rrezikut).....169
5.5. Anketa me nxënës të shkollave të mesme lidhur me efektin parandalues të shkollës ndaj kriminalitetit 171
5.5.1. Të dhëna të përgjithshme rreth nxënësve të anketuar dhe sigurisë në shkolla.....172
5.5.2. Koha e lirë e fëmijëve.....179
5.5.3. Roli i familjes.....180
5.5.4. Rrethi i personave me të cilët shoqërohen të rinjtë.....182
5.5.5. Aktivitetet e lira jashtashkollore/zbavitëse 183
5.5.6. Qasja në mjetet e komunikimit masiv.....185
5.5.7. Njohuri rreth të drejtës penale për fëmijë.....186
5.6. Intervista me personelin e shkollave të mesme lidhur me ndikimin e shkollave në parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve.....189

KAPITULLI VI
6. ROLI I DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE SUBJEKTEVE TË TJERA JURIDIKE NË PARANDALIMIN E DELIKUENCËS SË FËMIJËVE.....191
6.1. Roli i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.....191
6.2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.....195
6.3. Ministria e Punëve të Brendshme.....196
6.4. Ministria e Punës dhe Politikës sociale.....199
6.4.1. Kompetencat e Qendrave për punë sociale sipas LDF.....202
6.4.2. Veprimi i Qendrës për punë sociale me fëmijët në rrezik sipas LDF.....202
6.4.3. Procedura për ndërmjetësim.....204
6.4.4. Numri i masave të ndihmës dhe mbrojtjes të zbatuara ndaj fëmijëve në rrezik në QPS.....207
6.4.5. Ndihma e dhënë fëmijëve nga ana e Qendrës për punë sociale pas daljes nga enti.....208

6.5. Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë....208
6.6. Organizatat joqeveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve....210
6.7. Ministria për vetëqeverisje lokale....212
6.7.1. Kompetencat e Këshillave komunalë sipas LDF....212

PJESA E TRETË:

METODIKA E ZBULIMIT DHE SQARIMIT TË DISA VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA FËMIJËT

KAPITULLI VII

7. SPECIFIKAT E ZBULIMIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE....215
7.1. Zbulimi i delikuencës së fëmijëve....215
7.2. Karakteristikat e fëmijëve kryes të veprave penale dhe taktika e zbulimit të tyre....215
7.2.1. Koha e kryerjes së veprave penale të kryera nga fëmijët....215
7.2.2. Vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale të fëmiut....217
7.2.3. Taktika e zbulimit të delikteve pronësore....218
7.3. Metodika e sqarimit të disa veprave penale kundër pasurisë....222
7.3.1. Vjedhjet nga xhepat....222
7.3.2. Grabitja (Vjedhja me dhunë dhe vjedhja me armë)....223
7.4. Mjetet më të shpeshta që i përdorin fëmijët për kryerjen e veprave penale....226
7.5. Mbikqyrja e përforcuar dhe kontrolli lokal....227
7.6. Njohja e mjedisit të fëmijëve si kusht për zbulim....228

KAPITULLI VIII

8. AKTIVITETI I POLICISË NË ZBULIMIN DHE TË PROVUARIT E KRIMEVE TË KRYERA NGA FËMIJËT....229
8.1. Shërbimet e specializuara për zbulimin e kriminalitetit të fëmijëve....229
8.2. Taktika e pyetjes së fëmijëve....230
8.3. Kushtet për marrjen në pyetje të fëmijëve....231
8.4. Shfrytëzimi i Informatorit....233
8.5. Intervistë me punonjës të policisë lidhur me aktivitetet policore për zbulimin e fëmijëve të dyshuar për kryerje të veprave penale....235

PJESA E KATËRT:

ANALIZË E SHTRIRJES SË FENOMENIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KAPITULLI IX

9. SHTRIRJA E FENOMENIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË: 2006-2015.....241

9.1.1. Numri i fëmijëve të paraqitur në Republikën e Maqedonisë: 2006-2015.....241

9.1.2. Numri i fëmijëve të gjykuar në Republikën e Maqedonisë: 2006-2015 dhe numri i fëmijëve të gjykuar të gjinisë femrore: 2006-2015.....242

9.1.3. Numri i personave madhorë të gjykuar në raport me fëmijët e gjykuar: 2006-2015.....244

9.1.4. Numri i fëmijëve të paraqitur sipas grupit të veprave penale: 2006-2015.....245

9.1.5. Numri i fëmijëve të akuzuar sipas grupit të veprave penale: 2006-2015.....247

9.1.6. Numri i fëmijëve të gjykuar sipas grupit të veprave penale: 2006-2015.....248

9.1.7. Numri i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar: 2006 - 2015.....250

9.1.8. Numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 14-16 vjeçare: 2006-2015 sipas llojit të sanksionit të shqiptuar.....251

9.1.9. Numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18 vjeçare sipas llojit të sanksionit penal: 2006-2015.....252

9.1.10. Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë vitit 2014 sipas vendit dhe grupit të veprës penale.....254

9.2. Studim i rasteve individuale nga kriminaliteti i fëmijëve, bazuar në Praktikën gjyqësore të gjykatave në Republikën e Maqedonisë.....255

9.2.1. Rasti 1: Vrasje.....256

9.2.2. Rasti 2: Vjedhje e rëndë.....258

9.2.3. Rasti 3: Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve 259

9.2.4. Rasti 4: Rrezikim i sigurisë në komunikacion.....260

9.2.5. Rasti 5: Vjedhje grabitqare.....262

9.2.6. Rasti 6: Lëndim i rëndë trupor dhe Lëndim trupor.....264

9.2.7. Rasti 7: Vrasje 266

PËRFUNDIME.....270

REKOMANDIME.....281

LISTA E SHKURTESAVE.....284

BIBLIOGRAFIA.....285

HYRJE

1. Objekti i studimit

Objekti i studimit të këtij punimi të doktoraturës përfshinë fushën e politikës penale të luftimit të kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015. Ai trajton edhe një pjesë nga shkenca e Kriminalistikës, përkatësisht Metodikën e sqarimit dhe zbulimit të veprave penale të kryera nga fëmijët. Së këndejmi, lënda e hulumtimit ka të bëjë me analizimin e masave ndëshkimore dhe masave parandaluese të parapara për veprat penale të kryera nga fëmijët në Republikën e Maqedonisë dhe sqarimin e karakteristikave të metodikës kriminalistike për zbulimin e tyre.

Kriminaliteti i fëmijëve paraqet një pjesë të rëndësishme për studim nga fusha e të drejtës penale, kjo sepse kryerësit e tij dallohen me karakteristika të veçanta. Ajo që i bën ata të veçantë është mosha e tyre kritike, e cila sipas legjislacionit pozitiv të vendit tonë përfshinë moshën 14 deri 18 vjeçare. Prandaj edhe kryerësit e kësaj grupmoshe (14-18) dallohen gjatë trajtimit penalo-juridik në krahasim me kryerësit madhorë të veprave penale.

Në literaturën shkencore juridike përdoren emërtime të ndryshme si: "*Delikuenca e të miturve*", "*Delikuenca e fëmijëve*", "të mitur/fëmijë delikuentë", me qëllimin të shmangjes termeve si: "*Kriminaliteti i fëmijëve*", apo "të mitur/fëmijë kriminelë". Kjo sepse kryerësit jomadhorë të veprave të kundërligjshme (penale, kundërvajtëse) në të drejtën penale në kuptimin e saj të gjërë (të drejtën penale materiale, procedurale dhe atë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale) trajtohen më butë sesa ata madhorë. Duke marrë parasyshë faktin se fëmijët paraqesin kategori të personave të grupmoshave të reja, konsideroj se ato duhet trajtuar në mënyrë speciale nga shoqëria dhe organet shtetërore për luftimin e kriminalitetit, për të arritur të vetmin qëllim - risocializimin dhe riedukimin e tyre.

Ky fakt vërtetohet edhe gjatë analizimit të formave të manifestimit të veprimeve delikuente nga fëmijët në Republikën e Maqedonisë për periudhën kohore 2006-2015, ku vërejmë se në krye të listës qëndrojnë krimet kundër pasurisë. Të miturit në Republikën e Maqedonisë janë të prirur për të kryer më së shpeshti vjedhje, vjedhje të imta, vjedhje nëpër xhepa, në automobila dhe forma të tjera të vjedhjeve. Më pas vijojnë veprat penale kundër rendit

publik; Veprat penale kudër jetës dhe trupit të kryera nga të miturit, si vrasje, pjesëmarrje në rrahje dhe forma të tjera të dhunës. Të miturit kryejnë edhe vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik, vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, ku dhunimi seksual është një nga format më të shpeshta nga ky grup i veprave penale. Poashtu ndonëse në numër më të vogël, por në të dhënat statistikore të Entit shtetëror statistikor vërejmë edhe një numër të vogël të fëmijëve të gjykuar për vepra penale kundër shëndetit të njerëzve; Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë; Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo pjesë e hulumtimit do të trajtohet më hollësisht në pjesën e katërt, kapitulli i nëntë " *Shtrirja e fenomenit të delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë*" dhe në pjesën e tretë të këtij punimi lidhur me Metodikën e zbulimit dhe sqarimit të disa formave më të shpeshta të krimeve të kryera nga fëmijët në vendin tonë.

Konsideroj se për të luftuar dhe parandaluar delikuencën e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, janë të domosdoshëm hulumtimi, gjetja dhe trajtimi i shkaqeve apo faktorëve që ndikojë në paraqitjen e saj. Pasi që ky fenomen sot paraqet një çështje problematike dhe shqetësuese për shoqërinë tonë, mendojmë se atij i duhet kushtuar një studim më i thellë. Prandaj, shpresoj që ky punim të paraqesë një kontribut shkencor modest në këtë aspekt e të jetë ndihmesë për studimin, kërkimin e mjeteve e metodave më efikase për parandalimin dhe luftimin e formave të ndryshme delikuente të manifestuara nga fëmijët.

2. Arsyeshmëria e studimit

Gjatë analizimit të zhvillimit kronologjik të drejtësisë penale për fëmijë të vendit tonë, shfaqet hipoteza lidhur me natyrën juridike të kësaj dege të së drejtës e cila i rregullon çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijë. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Maqedonisë nga pavarësia e saj (1991) deri më sot ka pësuar shumë ndryshime. Në këtë drejtim, nga viti 2007 në vendin tonë u krijua një sistem i veçantë i drejtësisë për fëmijë, i ndarë nga ai për personat madhorë që deri në atë kohë ishte një tërësi e rregulluar me ligjet penale materiale, procedurale dhe atë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale. Me këtë rast kjo degë e së drejtës u shkëput nga dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë sferën e së drejtës penale në kuptimin e gjërë. Në këtë drejtim paraqitet sfida *e zgjidhjes së dilemës për natyrën juridike të drejtësisë penale për fëmijë, respektivisht gjetja e përgjigjes se a paraqet ajo një degë*

të pavarur pozitive në sistemin juridiko-penal apo është pjesë e së drejtës penale në kuptimin e gjërë, gjegjësisht nëndegë e saj?

Rëndësia dhe arsyeshmëria e temës hulumtuese qëndron në studimin e *politikës penale parandaluese dhe ndëshkimore* ndaj kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë (2006-2015). Duke i analizuar të gjitha aspektet rreth rregullimit të këtij fenomeni brenda legjislacionit penal në vend, konsideroj se është arritur deri në një nivel të caktuar të nxirren në pah anët pozitive dhe të metat e politikës penale për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve.

Përveç politikës represive ndaj kriminalitetit të fëmijëve, të cilës i është kushtuar një pjesë e punimit, janë trajtuar edhe politikat parandaluese ndaj këtij fenomeni, duke u ndalur në të gjitha instrumentat që e përbëjnë atë. Hollësisht janë trajtuar subjektet kompetente, respektivisht kompetencat e tyre për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, rregullativa ligjore dhe standardet tjera mbi parandalimin e saj, faktorët mbrojtës dhe ato të rrezikut etj. Në këtë drejtim janë dhënë rekomandime posaçërisht për përmirësimin e ngecjeve gjatë zbatimit dhe efikasitetit të masave parandaluese ndaj dukurive devijante të fëmijëve.

Hulumtimi prek poashtu edhe një pjesë të shkencës së kriminalistikës, konkretisht *Metodikën e sqarimit dhe zbulimit* të veprave penale të kryera nga fëmijët, me ç'rast janë analizuar mënyrat e zbulimit të krimeve që kryhen më së shpeshti nga fëmijët. Janë pasqyruar aktivitetet e organeve të ndjekjes për zbulimin e këtyre krimeve dhe kryerësve të tyre jomadhorë. Për zbulim të suksesshëm të kriminalitetit të fëmijëve, patjetër duhet të njihen të gjitha veçoritë e këtij fenomeni dhe specifikat që lidhen me zbulimin e tij.

Punimi është gjithpërfshirës për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Janë analizuar vendime gjyqësore të disa gjykatave të niveleve të ndryshme të vendit. Megjithatë, punimi përmban edhe një pjesë krahasimore të disa legjislacioneve të huaja mbi drejtësinë penale për fëmijë. Është analizuar legjislacioni penal pozitiv për fëmijë i shteteve në vijim, si: Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, Republika e Kroacisë, Zvicra, Holanda, Norvegjia dhe Anglia. Duke pasqyruar praktika të ndryshme të vendeve evropjane, si nga ato fqinje dhe rajonale (Kosova, Shqipëria, Kroacia) të cilat deri diku kanë rregullim ligjor të drejtësisë penale për fëmijë të ngjashëm me atë të vendit tonë, mund të marrim edhe

shembuj shumë të mirë nga vendet evropjane, të cilat paraqesin model për botën sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut, e posaçërisht të fëmijëve, me ç'rast është paraqitur diversiteti i masave edukuese e parandaluese, si dhe atyre represive që i parasheh legjislacioni penal i tyre (Norvegjia); Poashtu edhe praktika ku mund të themi se fëmijët kanë trajtim shumë të ndryshëm në krahasim me vendin tonë (Zvicra, Holanda). Duke dashur të nxirret një pasqyrim i drejtësisë penale për fëmijë në sistemin anglosakson, i është kushtuar një pjesë edhe analizimit të legjislacionit penal për fëmijë të Anglisë dhe disa karakteristika të sistemit juridiko-penal të Britanisë së Madhe.

3. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë këtij hulumtimi janë përdorur metoda të ndryshme, si:

- Metodologjia *teorike* (Metoda juridike; Metoda historike; Metoda krahasuese; Metoda sociologjike; Metodat psikologjike dhe logjike), dhe
- Metodologjia *empirike* (Metoda statistikore; Metoda e analizës dhe sintezës; Metoda e anketës dhe intervistës; Metoda e vështrimit dhe metoda përshkruese).

Hulumtimi bazohet në të dhëna nga autorë kompetentë të cilët kanë trajtuar të drejtën penale për fëmijë. Janë respektuar rregullat e shfrytëzimit të njohurive deri tek të cilat është arritur. Poashtu është respektuar rendi shtëpiak në të gjitha institucionet që janë vizituar gjatë hulumtimit shkencor. Materiali faktografik konsiston në sigurimin e rezultateve të nevojshme lidhur me kriminalitetin e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë 2006-2015.

Kërkimet shkencore janë bërë në biblioteka të ndryshme të vendit dhe ato ndërkombëtare, veçanërisht të Bibliotekën e Kriminologjisë dhe atë të Qendrës për të Drejtat e Njeriut të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oslos. Janë shfrytëzuar të dhëna statistikore oficiale nacionale si dhe Vendime gjyqësore. Punimi është pasuruar me referenca nga libra, monografi, revista shkecore, dispozita ligjore nacionale dhe ndërkombëtare nga e drejta penale për fëmijë etj. Gjithashtu punimi përmbanë: Rezultate nga Anketa me fëmijë të gjykuar me sanksione me heqje lirie (me burg, me masa të enteve); Intervista me persona përgjegjës në institucione penitensire për fëmijë dhe nga intervista me punonjës policorë;

Është realizuar edhe anketë me nxënës në shkolla të mesme si dhe intervista me persona përgjegjës në ato institucione edukativo-arsimore.

4. Sistemimi i punimit

Tema e trajtuar "Politika penale ndaj kriminalitetit të fëmijëve dhe metodika e zbulimit të tij në Republikën e Maqedonisë:2006-2015" është e ndarë në katër pjesë, të cilat përbëjnë gjithsej nëntë kapituj. Në pjesën e parë të titulluar "*Politika ndëshkimore e sistemit juridiko-penal ndaj kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015*" janë përpunuar tre kapituj. Kapitulli i parë përmbledh të gjitha çështjet që ndërlidhen me masat represive-juridike për luftimin e kriminalitetit të fëmijëve, ku konkretisht është bërë një vështrim historik i zhvillimit të drejtësisë penale për fëmijë i Republikës të Maqedonisë. Në vazhdim të kapitullit janë analizuar parimet e drejtësisë penale për fëmijë në Republikën e Maqedonisë dhe kategorizimi i fëmijëve sipas të tri ligjeve të cilat e kanë rregulluar këtë sferë të së drejtës nga pavarësimi i vendit e deri sot me ligjin pozitiv, si dhe janë paraqitur dhe analizuar llojet e sanksioneve penale për fëmijë sipas legjislacionit penal pozitiv.

Në kapitullin e dytë janë studiuar normat dhe standardet ndërkombëtare për drejtësinë penale të fëmijëve, gjegjësisht Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve (1989), Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit", 1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të cilëve u është hequr liria ("Rregullat e Havanës, 1990) dhe Rregullat e OKB-së për preventivë të delikuencës së të miturve ("Rregullat e Riadit", 1990).

Kapitulli i tretë, përbëhet nga qasja komparative e hulumtimit të drejtësisë penale për fëmijë të disa vendeve të rajonit dhe atyre europjane, dhe atë: Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës, Republikës së Kroacisë, Holandës, Norvegjisë, Zvicrës dhe Anglisë. Në këtë drejtim janë hulumtuar ligjet pozitive që rregullojnë të drejtën penale për fëmijë në sistemin juridik të këtyre shteteve.

Në pjesën e dytë të punimit të titulluar "*Politika parandaluese për pengimin e kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2006-2015*" e cila është e përbërë

nga tre kapituj, trajtohen tema të karakterit preventiv ndaj fenomenit kriminal të fëmijëve. Në *kapitullin e katërt* janë analizuar masat preventive-juridike për pengim të kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast është studiuar Strategjia nacionale e Republikës së Maqedonisë për parandalim të delikuencës së të miturve (2010-2020) dhe efekti i saj në praktikë; Qëllimi i parandalimit special dhe gjeneral i sanksioneve penale për fëmijë dhe i masave të ndihmës dhe mbrojtjes; Efekt i sanksioneve penale për fëmijë në arritjen e parandalimit special me vështrim të posaçëm në masat e entit dhe dënimin me burgim për fëmijë. Në këtë drejtim janë prezantuar rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të dënuar me burg për fëmijë, si dhe ato nga anketa e realizuar me fëmijë të gjykuar ndaj të cilëve është shqiptuar masa e entit- Dërgimi në Shtëpi edukuese-përmirësuese.

Në këtë pjesë, në kuadër të kapitullit të pestë është analizuar ndikimi i disa faktorëve social në pengimin e kriminalitetit të fëmijëve, si edukimi, mjedisi jetësor, si dhe disa faktorë të tjerë mbrojtës apo të rrezikut. Poashtu kapitulli është pasuruar me rezultate të nxjerruara nga hulumtimi empirik i realizuar në tri shkolla të mesme të vendit. Në këtë drejtim janë paraqitur të dhënat e fituara nga intervistat e realizuara me persona përgjegjës të punësuar në shkolla të mesme, si pedagogë, përgjegjës, arsimtarë si dhe rezulatet nga anketa me nxënës të tri shkollave të mesme lidhur me efektin parandalues të shkollës, që i prek temat në vijim: Koha e lirë e fëmijëve, roli i familjes, niveli ekonomik, rrethi i personave me të cilët shoqërohet fëmiu, aktivitetet e lira zbavitëse, qasja në mjetet e komunikimit masiv etj.

Në kapitullin e gjashtë është trajtuar roli i disa institucioneve shtetërore në parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve, si roli i: Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe Politikës sociale, Qendrave për Punë sociale, Avokatit të Popullit, organizatave joqeveritare, Ministrisë për vetëqeverisje lokale, respektivisht i Këshillave komunalë.

Në pjesën e tretë të titulluar "*Metodika e zbulimit dhe sqarimit të disa veprave penale të kryera nga fëmijët", në kuadër të kapitullit të shtatë* janë trajtuar këto tema: Zbulimi i delikuencës së fëmijëve, karakteristikat e fëmijëve kryes të veprave penale dhe taktika e zbulimit të tyre, koha, vendi, mjetet dhe mënyra e kryerjes së veprave penale nga fëmijët; Metodika e sqarimit

të disa veprave penale kundër pasurisë; masat hetimore dhe operative për zbulimin e fëmijëve të dyshuar etj.

Ndërkaq, në kapitullin e tetë është analizuar aktiviteti i policisë në zbulimin dhe të provuarit e krimeve të kryera nga fëmijët, respektivisht këto tema: Shërbimet e specializuara për zbulimin e kriminalitetit të fëmijëve; Taktika e pyetjes së fëmijëve; Kushtet për marrjen në pyetje të fëmijëve; Shfrytëzimi i Informatorit. Në fund të këtij kapitulli është paraqitur intervista e realizuar me një punonjës të policisë lidhur me aktivitetet policore për zbulimin e fëmijëve të dyshuar për kryerje të veprave penale.

Pjesa e katërt e punimit, kapitulli i nëntë ka të bëjë me analizimin e shtrirjes së *fenomenit të delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë*, ku janë prezantuar dhe analizuar të dhëna statistikore oficiale të publikuara nga Enti shtetëror statistikor i Republikës i Maqedonisë në bazë të kritereve të ndryshme. Konkretisht janë pasqyruar përmes një numri të tabelave të dhëna mbi numrin e fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar, sipas llojit të veprës penale, llojit të sanksionit të shqiptuar gjatë periudhës kohore 2006-2015, gjendja e kriminalitetit të fëmijëve në raport me atë të personave madhorë, gjinia e kryesve fëmijë dhe tregues të tjerë si niveli i arsimimit të fëmijëve, gjendja familjare e tyre etj. Njëkohësisht në kuadër të këtij kapitulli janë analizuar disa raste individuale nga kriminaliteti i fëmijëve, bazuar në vendime gjyqësore të gjykatave të vendit, për të pasqyruar edhe anën e praktikës gjyqësore nga kriminaliteti i fëmijëve në vend- me ç'rast fokusi i përzgjedhjes së disa rasteve të caktuara nga disa gjykata themelore dhe ajo Supreme, ishte shtjellimi i disa veçorive të cilat lidhen me kryesin e gjykuar dhe veprën penale të kryer, si p.sh. moshat e ndryshme të fëmijëve të gjykuar, lloje të ndryshme të veprave penale, mënyrat e kryerjes së veprave penale, llojet e sanksioneve penale të shqiptuara nga gjykatat etj.

5. Hipotezat e hulumtimit

Gjatë përcaktimit për këtë temë hulumtimi, u shtruan disa hipoteza të cilat kanë arritur të zgjidhen deri në nivel të caktuar e të arrihet deri tek përgjigjet e duhura lidhur me to, përmes hulumtimit të aspekteve që ato i prekin. Në pjesën e përfundimit të punimit janë trajtuar të përmbledhura arritjet dhe rezultatet për hipotezat e parashtruara, si vijojnë:

1. Cili është vendi i të drejtës penale për fëmijë në sistemin juridiko-penal në raport me të drejtën penale në kuptimin e gjërë? A paraqet ajo degë të pavarur të së drejtës nga e drejta penale për persona madhorë?
2. Sa është e harmonizuar politika penale e Republikës së Maqedonisë ndaj kriminalitetit të fëmijëve në raport me kërkesat dhe trendet ndërkombëtare në këtë drejtim? *(Mjaftueshëm apo jo mjaftueshëm?)*
3. Sa është arritur qëllimi i parandalimit special i sanksioneve penale tek fëmijët e gjykuar për vepra penale në Republikën e Maqedonisë? *(Mjaftueshëm apo jo mjaftueshëm?)*
4. Sa janë treguar efikase masat parandaluese ndaj kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë? (*Mjaftueshëm apo jo mjaftueshëm?*)
5. A dallon taktika kriminalistike për zbulimin e fëmijëve të dyshuar për vepra penale nga ata të moshës madhore? (*Po, Jo?)*

PJESA E PARË

POLITIKA REPRESIVE E SISTEMIT JURIDIKO-PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE: 2006-2015

KAPITULLI I

1. TRAJTIMI JURIDIKO-PENAL I FËMIJËVE NË RREZIK DHE NË KONFLIKT ME LIGJIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1.1. Drejtësia penale për fëmijë nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë deri më sot

Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Maqedonisë nga pavarësimi i saj (në vitin 1991) deri më sot (2018) ka pësuar disa herë ndryshime të cilat kanë sjellur reforma në të drejtën penale për fëmijë. Historikisht, këto janë ligjet të cilat e kanë rregulluar trajtimin juridiko-penal të fëmijëve në konflikt me ligjin: Ligji penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976)[1] dhe Ligji Penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë (1976)[2]; Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (1996)[3]; Ligji mbi drejtësinë e të miturve (2007)[4] dhe Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve (2013)[5].

Qëllimi i hulumtimit në këtë kapitull është të nxjerrë në pah llojet e sanksioneve penale për fëmijë në Republikën e Maqedonisë nga pavarësia e saj e deri më sot, të cilat mbi të gjitha gjithmonë kanë pasur për qëllim mbrojtjen e interesave të fëmijëve kryes të veprimeve delikuente. Në këtë drejtim, gjithashtu i'u kushtohet rëndësi analizimit të të ashtuquajturave "Masa të ndihmës dhe mbrojtjes", të parashikuara me Ligjin mbi drejtësinë e të miturve (2007) dhe atij të fundit mbi drejtësinë e fëmijëve (2013). Këto masa paraqesin një risi në drejtësinë penale për fëmijë të vendit tonë.

---

[1] Ligji penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, "Gazeta Zyrtare e R.S.F.J." nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90,38,90 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/92 and 32/93.

[2] Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedoisë "Gazeta Zyrtare. e R.S.M." nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89,7/90, 23/91, 24,92,49/93.

[3] Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr: 37/1996.

[4] Ligji mbi drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë." nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008, 145/2010. Nga dita e fillimit me zbatimin e këtij ligji pushojnë të vlejnë dispozitat nga neni 70 deri 96 nga Kodi penal i R.M. ''Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë'',numër 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006 dhe 73/2006 që rregullonin trajtimin juridiko-penal të të miturve.

[5] Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 148/2013. Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji u shfuqizua Ligji mbi drejtësinë e të miturve. Ky ligj filloi të zbatohet nga 1 dhjetori 2013 dhe aktualisht është ligji pozitiv i cili zbatohet për drejtësinë e fëmijëve.

Sistemi i drejtësisë penale i Republikës së Maqedonisë ka funksionuar pesë vjet pas pavarësisë së saj (1991) me Ligjin Penal të Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave dhe me Ligjin penal të Republikës Socialiste të Maqedonisë deri në vitin 1996, kur hyri në fuqi Kodi i ri Penal.

Me këto dy ligje penale (1976) rregullohej veprimtaria e organeve shtetërore kompetente me të miturit delikuentë. Legjislacioni penal i ish-Jugoslavisë i cila vazhdoi të ndiqet si model me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë (1996) në raport me trajtimin penalo-juridik të të miturve, ka kaluar nëpër disa faza:

1. Ligji penal - *Pjesa e përgjithshme* (**1947, 1951**) kryes të mitur i ka trajtuar personat nga mosha katërmbëdhjetë deri tetëmbëdhjetë vjeçare. Kjo kategori pastaj është njohur me ndarje në dy grupe, dhe atë 14 deri 16 vjet si **të mitur të rinjë**, dhe 16 deri 18 vjet si **të mitur të rritur** (Kambovski, 2007, f. 600). Me novelën e LP të vitit **1959** është lënë koncepti i pëgjegjësisë penale si supozim për shqiptimin e masave të sigurisë. Këto masa (të sigurisë) janë sanksione themelore për të dy kategoritë e të miturve, ku gjatë zgjedhjes së tyre gjyqi niset para së gjithash prej personalitetit të të miturit dhe prej nevojës së edukimit të tij. Sipas Prof. Dr. Kambovski ndarja e të miturve në të rinjë (14-16) dhe të rritur (16-18) është në funksion të zbatimit të masave edukuese si rregull, gjegjësisht të dënimit me burg për të mitur si përjashtim: të miturve të rinjë i'u shqiptohej vetëm masë edukuese, kurse të miturve të rritur po ashtu i'u shqiptohej masë edukuese dhe përjashtimisht dënim me burg për të mitur.

Ky koncept është mbajtur edhe në legjislaturën penale të vitit 1977 dhe pastaj edhe në KPM të vitit **1996**. Novela e KPM e vitit **2004** zgjeroi repertoarin e dënimeve – ***Dëbimi i të huajit nga vendi*** dhe ***Ndalesa për të drejtuar automjetin***, si dhe si sanksione të reja janë paraparë masat alternative: ***Ndërprerja me kusht e procedurës penale*** dhe ***Puna në dobi të përgjithshme***.

2. Më 30 qershor 2009 hyri në fuqi Ligji mbi drejtësinë e të miturve, i miratuar më 27 korrik 2007 deri kur Kodi Penal ka qenë efektiv me nenet 70-96 në një kapitull të veçantë kushtuar delikuencës së fëmijëve me titull *"**Masat edukuese dhe dënimet për të miturit**"*. Në këtë kapitull kanë qenë të përcaktuara të gjitha masat edukuese dhe represive të cilat mund të i'u shqiptoheshin të miturve fajtorë nën kushte të përcaktuara me atë kod. Me

miratimin e këtij ligji të veçantë u shfuqizuan dispozitat e lartëpërmendura në Kapitullin e VI-të të Kodit Penal.

Llojet e sanksioneve penale për të mitur sipas Ligjit mbi drejtësinë e të miturve ngelën të njejta me ato që i parashihte edhe Kodi penal, me një plotësim, respektivisht me inkorporimin e dënimit me para në listën e dënimeve për fëmijë. Poashtu risia e këtij ligji ishte përcaktimi i Masave të ndihmës dhe mbrojtjes. Këto janë masa jopenale, të cilat mund të shiptohen nga organe të specializuara dhe të zbatohen ndaj fëmiut dhe prindit/prindërve të tij. Kështu që nga ky moment drejtësia penale për fëmijë fillon të pavarësohet nga Kodi penal apo mund të themi që e drejta penale materiale fillon të zgjerohet në objektin e saj me një ligj të veçantë që trajton vetëm kryerësit jomadhorë dhe kështu ajo fiton një natyrë më autonome.

Edhe pse me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Kodit penal në vitin 2009[6], si pasojë e hyrjes në fuqi të LDM, njëkohësisht u fshinë nenet 70-96 që rregullonin sanksionimin e të miturve, në anën tjetër u shtua një titull dhe nen pas nenit 6, i emërtuar "Zbatimi i Kodit penal ndaj të miturve dhe personave madhorë të rinjë" - neni 6-a. Në këtë nen të ri u përcaktua se KPM nuk do të zbatohet ndaj personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur katërmbëdhjetë vjet (p.1). Poashtu u përcaktua se ndaj të miturve dhe personave madhorë të rinjë, për vepra panale të përcaktuara me ligj apo me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare do të zbatoheshin dispozitat e Kodit penal në pajtim me Kushtetutën e R.M.-së, **nëse me ligj nuk ishte e rregulluar ndryshe (p.2).** Pra, është me rëndësi të potencojmë se ligjvënësi e ka potencuar rëndësinë e KPM si burim i të drejtës penale për fëmijë krahas ekzistimit të LDM, në kushtet e përcaktuara më lartë në paragrafin 2 të nenit 6-a.

Me sjelljen e Ligjit për drejtësinë e të miturve në Republikën e Maqedonisë u krijua sistem i drejtësisë për fëmijë mbi parimet e drejtësisë restorative, në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare dhe evropjane si dhe dhe me praktikat e mira. Me këtë ligj u vendosën reforma në sistemin penalo-juridik që kanë të bëjë me fëmijët, në linjë me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe instumentet e tjera evropjane e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

[6] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.114/09, neni 2

Me këtë ligj është përqafuar qasja e drejtësisë së mosndëshkimit dhe asaj restorative. Ligji solli shumë ndryshime, dhe atë (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.3):

- U themelua Këshilli Shtetëror për parandalimin të delikuencës së të miturve (me këtë ligj ishte i pranuar termi "të mitur", e jo "fëmijë" që do të pasojë me LDF të viti 2013);
- Masat e ndihmës dhe mbrojtjes, me të cilat rastet më të lehta zgjidhen në procedurë jo-gjyqësore;
- Puna në dobi të përgjjithshme si masë alternative;
- Mediacioni mes viktimës dhe kryesit;
- Prezenca e mbrojtësit gjatë kohës së bisedës me fëmiun e dyshuar;
- Kufizimi i kohëzgjatjes së procedurës hetimore dhe gjyqësore;
- Trajnime për gjykatës të specializuar, prokurorë, inspektorë policorë, avokatë dhe mediatorë;
- Formim i departamenteve të specializuara ose ekipeve në qendrat për punë sociale.

3. Ndërkaq ligji i fundit pozitiv që rregullon drejtësinë penale për fëmijë është Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i vitit 2013. Ky ligj rregullon në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve që janë në konflikt me ligjin apo përfaqësojnë viktimat e krimit. Përveç kategorizimit të fëmijëve në ndarje të caktuara sipas moshës dhe cilësive, ky ligj parasheh të gjitha llojet e sanksioneve penale dhe përcakton kushtet nën të cilat mund të shqiptohen ato ndaj fëmijëve kryes të veprave penale dhe kundërvajtëse. Ai rregullon edhe sanksionimin e personave të moshës madhore për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale të cilat i kanë kryer si fëmijë; Sanksionet për fëmijë për vepra kundërvajtëse; Përcakton edhe llojet dhe mënyrën e zbatimit të masave jopenale – Masave të ndihmës dhe mbrojtjes të cilat së bashku me të gjitha llojet e masave represive që i parasheh ligji kanë qëllim edukimin, socializimin, zhvillimin e drejtë dhe mbrojtjen e interesave të fëmiut. Ligji përmban edhe dispozita mbi procedurën penale për fëmijë dhe procedurën e ndërmjetësimit. Poashtu LDF përmban dispozita rreth parandalimit të delikuencës së fëmijëve të cilat janë trajtuar në pjesën e dytë të këtij punimi.

Në vazhdim do të paraqesim burimet e brendshme të së drejtës penale për fëmijë në Republikën e Maqedonisë. Këto burime ndahen në kryesore dhe sekondare/plotësuese. (Buzharovska G. Кривично постапување со деца во ризик и во судир со законот, 2015, f.115):

- ***Burime kryesore të brendshme*** të së drejtës penale për fëmijë janë:

- Kushtetuta e R.M.-së (Gazeta zyrtare e R.M. nr.52 nga data 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese);
- Ligji mbi drejtësinë për fëmijë (Gazeta zyrtare e R.M. nr 148/2013) dhe
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve (Gazeta zyrtare e R.M. nr.02/2006, 57/2010 dhe 170/2013).

- ***Burime plotësuese të brendshme*** të kësaj dege të të drejtës janë:

- Kodi penal i R.M.-së (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014 dhe 199/2014);
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e R.M. nr.150/2010 dhe 100/2012) dhe
- Deklarata për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (e ratifikuar në vitin 2003), si dhe ligje të tjera.

1.2. Kategorizimi i fëmijëve sipas moshës

Edhe pse sistemi i drejtësisë penale për fëmijët ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës, ai nuk ka ndryshuar kufirin e moshës minimale dhe maksimale për fëmijët. Mosha e tillë proklamohet edhe në ligjin pozitiv për drejtësinë e fëmijëve: "***Ndaj fëmiut i cili në kohën e kryerjes së veprës e cila me ligj është parashikuar si vepër penale nuk ka mbushur 14 vjet, nuk mund të aplikohen sanksionet e përcaktuara me këtë ligj***" (neni 20), nga i cili parim përcaktohet kufiri minimal i moshës së fëmijëve lidhur me përgjegjësinë penale. Të gjitha ligjet penale të Republikës të Maqedonisë kanë përcaktuar kufirin e përgjegjësisë penale nga mosha mbi 14 vjeç dhe përfundimin e miturisë me moshën 18 vjet.

Nëse shikojmë historikisht se si janë kategorizuar fëmijët në bazë të moshës, sipas dispozitave të Kodit Penal (1996) ato janë klasifikuar në këto kategori, si në vijim:

- ***Fëmijë*** – të mitur të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i kanë mbushur 14 vjet. Kjo kategori sipas KPM ishte e përjashtuar nga përgjegjësia penale. Sipas Kodit penal ndaj të miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 14 vjet (fëmijë) nuk mund të zbatoheshin sanksione penalo-juridike (Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, neni 71).

Kjo dispozitë nuk i përjashton nga ana tjetër pasojat tjera të mundura nga fakti se është kryer vepër penale: Për veprën e të miturit mund të përgjigjen bashkëpunëtorët e tij, ose prej tij mund të konfiskohet e gjithë dobia pasurore dhe të merren sende që janë krijuar me kryerjen e veprës. Por shumë qartë është i përjashtuar zbatimi i sanksioneve penalo-juridike dhe me të edhe inicimi i procedurës penale, kështu që edhe në rast të kryerjes së veprës më të rëndë (p.sh. vrasje,), kundër të miturit mund të ndërmerren masa të tjera jopenale juridike të edukimit, kujdesit dhe mbikqyrjes nga ana e shërbimeve sociale (Kambovski, 2007, f. 604).

- ***Të mitur të rinjë*** janë ata fëmijë të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale i kanë mbushur 14 vjet por ende nuk i kanë mbushur 16 vjet***.*** Sipas KPM të miturit i cili ka kryer vepër penale në moshë prej 14 deri 16 vjet (i mitur i ri) mund ti shqiptohej vetëm masë edukuese (Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, neni 72, p.2).
- ***Të mitur të rritur*** (16-18 vjet) janë ata fëmijë të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale i kanë mbushur 16 vjet por nuk i kanë mbushur 18 vjet. Sipas KPM ndaj tyre mund të shqiptoheshin masa edukuese, por edhe dënime, si dënimi me burg si dhe dënimi sekondar, Dëbimi i të huajit nga vendi apo Ndalimi i drejtimit të automjetit; Masa alternative si: Ndërprerja me kusht e procedurës penale dhe puna në dobi të përgjithshme. Mund të i'u shqiptohej edhe masë siguruese nën kushtet e parapara ligjore (Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, neni 72.p.2 dhe 4).
- Mund të konstatojmë se dallimi i parë mes Kodit penal dhe ligjeve pasuese Ligji mbi drejtësinë për të mitur dhe Ligji mbi drejtësinë për fëmijë, konsiston pikërisht në emërtimin e këtyre personave nga mosha 14 deri 18 vjeçare. Ligjet e reja pas Kodit penal që kanë rregulluar këtë fushë të së drejtës, në vete inkorporojnë një fjalor më të pasur sesa Kodi

penal. Kështu që Ligji mbi drejtësinë e të miturve i vitit 2007 përveç këtyre dy kategorive (I mitur i ri dhe i mitur i rritur), të cilat i ka trashëguar nga Kodi penal, përcaktonte edhe disa kategori të tjera si në vijim (Ligji për drejtësi për të mitur , 2007, neni 12):

- **Fëmijë në rrezik** - i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur ***shtatë vjet***, e nuk i ka mbushur ***katërmbëdhjetë vjet***; Fëmijë në rrezik konsiderohet edhe i mituri me moshë deri në 14 vjet-i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotropike ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmija - viktimë e dhunës dhe fëmija i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes, ose fëmija nuk është përfshirë në sistemin e arsimit dhe edukimit ose është dhënë pas lypësisë, bredhjes ose prostitucionit, i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin;
- **I mitur i ri** - i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, i ka mbushur ***katërmbëdhjetë vjet***, ndërsa nuk i ka mbushur ***gjashtëmbëdhjetë vjet***;
- **I mitur i ri në rrezik** - personi i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale, për të cilin është paraparë ***dënim me para ose me burg deri në tri vjet ose kundërvajtje***, ka mbushur katërmbëdhjetë vjet, kurse nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet; ose që është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotrope ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmijë i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin;
- **I mitur i rritur** - i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur ***gjashtëmbëdhjetë vjet***, ndërsa nuk i ka mbushur ***tetëmbëdhjetë vjet***;
- **I mitur i rritur në rrezik** - i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale, për të cilën është paraparë ***dënim me para ose me burg deri në tri vjet ose kundërvajtje***, i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, kurse nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet ose që është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotrope ose

alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin.

- Përveç kategorizimit të këtillë të fëmijëve, ajo që u paraqet si risi dhe reformë e drejtësisë për fëmijë me Ligjin mbi drejtësinë e të miturve, ishin të ashtuquajturat ***Masa të Ndihmës dhe mbrojtjes***. Të njejtat janë masa jo penale të cilat mund të shqiptohen në procedurë jo penale dhe ndaj personave ("fëmiut në rrezik") të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur 14 vjet. Këto masa mund të shqiptohen nga organe të tjera të specializuara krahas gjykatës, si Qendrat për punë sociale, Prokuroria publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet për zbatimin e sanksioneve për fëmijë (n.14-17). Këto masa parashiheshin në pjesën e dytë të këtij ligji të titulluar "Veprimi me të miturit", si pasojë e parimit të *përjashtimit të sanksioneve të parapara me ligj ndaj të miturit i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, që nuk i ka mbushur katërmbëdhjetë vjet - fëmijë në rrezik nuk mund të zbatohet sanksioni i paraparë ligj* (Kodi penal e Republikës së Maqedonisë, neni 13).

Këto masa parashihen edhe me ligjin pozitiv mbi drejtësinë e fëmijëve (2013). Sipas dispozitave të këtij ligji, ndaj fëmiut në rrezik deri në moshën 14 vjet dhe fëmiut në rrezik mbi moshën 14 vjet zbatohen masat e parapara për ndihmë dhe mbrojtje, të cilat janë me interes për fëmiun dhe për zhvillimin dhe edukimin e tij (KPM, neni 21). Ndaj fëmiut në rrezik deri në moshën 14 vjet dhe fëmiut në rrezik mbi moshën 14 vjet zbatohen masat për ndihmë dhe mbrojtje vetëm kur qendra për punë sociale do të vlerësojë se gjendja e rrezikut reflektohet mbi personalitetin e fëmiut dhe mbi edukimin e tij të drejtë. Këto masa mund të zbatohen edhe ndaj prindit/ëve ose tutorit/ëve, nëse e kanë lënë pas dore ose e kanë keqpërdorur kryerjen e të drejtave ose të obligimeve të veta lidhur me mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës (KPM, n. 22). (Më gjërësisht për karakterin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes shih kapitullin e IV-të të këtij punimi, pika 4.3.1)

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë, në kapitullin e dytë të pjesës së dytë "Veprimi me fëmijën në rrezik" (nenet 24-32), rregullon çështjet që lidhen me përgjegjësinë penale të fëmijëve në rrezik deri në moshën katërmbëdhjetë vjeçare (7-14 vjet)

dhe atyre mbi katërmbëdhjetë, si përjashtimi i sanksioneve të parapara me këtë ligj për fëmijët në rrezik deri në moshën 14, masat (e ndihmës dhe mbrojtjes) që mund të i'u shqiptohen atyre dhe organet kompetente që i shqiptojnë këto masa si dhe procedurën për shqiptimin dhe zbatimin e tyre. (Më hollësisht të gjitha këto çështje të theksuara janë trajtuar në kapitullin e VI-të të punimit - "Kompetencat e Qendrave për punë sociale sipas LDF", pikat 6.4.1-6.4.5).

Risia tjetër e Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë (2013) nuk konsiston vetëm me ndryshimin e emërtimit të personave jomadhorë nga "të mitur" në "fëmijë", por edhe në plotësimin e kategorizimit e tyre më të detajuar, me dy kategori të tjera të emërtuara si "Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14-16 vjeç" dhe "Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga nga 16-18 vjeç". Neni 19 i këtij ligji i kategorizon fëmijët si vijon:

- **Fëmijë** është ç'do person deri në moshën 18 vjet;
- **Fëmijë në rrezik** është ç'do fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhvillimit mental, viktimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizimi i funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/ëve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve të këtilla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është paraparë si vepër penale;
- **Fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose burg mbi tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet;
- **Fëmijë në rrezik nga 14 deri 18 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet;

- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet;
- **Fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet** është ç'do fëmijë i cili në kohen e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet;
- **Fëmijë viktimë** është ç'do fëmijë i moshës deri 18 vjet i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësim emotiv, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale;
- **Person i ri i moshës madhore** është personi i cili gjatë kohës së gjykimit për veprim të paraparë me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet.

Nga paraqitja taksative më lartë e kategorive të fëmijëve, shihet se Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve rregullon detajisht ndarjen e të gjitha kategorive të fëmijëve. Megjithatë, pavarësisht kësaj ndarjeje nëse analizojmë përmbajtjen e këtyre dispozitave sa i përket pyetjes mbi përcaktimin e kufirit të moshës "së miturisë" për përgjegjësinë penale, ende mbetet i pandryshuar ai kufi. Pra, vetëm kategoria e *fëmijëve që bien ndesh me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare* kanë përgjegjësi penale në rast të kryerjes së ndojë vepre të kundërligjshme (neni 19) dhe vetëm ndaj kësaj kategorie fëmijësh mund të shqiptohen sanksione penale nga një procedurë penale.

Mendoj se Republika e Maqedonisë duhet të vazhdojë t'i përmbahet këtij përcaktimi të kufirit të moshave – minimale dhe maksimale të fëmijëve, sepse kjo gjë është në pajtim me kriteret e kërkuara nga Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës. Veçanërisht konsideroj se nuk duhet të ulet mosha minimale për përgjegjësi penale të fëmijëve (14 vjeçare), duke marrë parasyshë shumë faktorë objektivë të cilët lidhen me kushtet që ofrohen gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale për fëmijë në vendin tonë. Ndaj një fëmiu nën moshën 14 vjeçare mund të zbatohen masa jopenale, siç janë ato të ndihmës dhe mbrojtjes dhe kjo mendoj se është shumë pozitive dhe e mjaftueshme. Një sanksion penal ndaj një kryesi nën moshën 14 vjeçare, konsideroj se do të kishte më tepër efekt negativ ndaj atij fëmiu sesa që do të arrihej efekti i përmirësimit dhe riedukimit të tij. Kjo gjithmonë, duke pasur parasysh faktin lidhur

me kushtet që ofrohen gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale në vendin tonë, të cilat për disa masa edukuese (masat e enteve) dhe dënimin me burg për fëmijë nuk janë në pajtim me standardet minimale ndërkombëtare që përcaktojnë se si duhet të jenë ato kushte ku do të trajtohet fëmiu. Në kapitullin dytë të punimit janë trajtuar këto norma dhe standarde ndërkombëtare për drejtësinë e fëmijëve.

1.3. Parimet e drejtësisë penale për fëmijë

1.3.1. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Kodit Penal

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë përcaktonte parimet themelore mbi të cilat ishte ndërtuar dhe vepronte sistemi parandalues dhe represiv i delikuencës së të miturve. Parimi i ***përjashtimit të sanksioneve penale nga fëmijët nën moshën 14 vjeçe*** ka qëndruar në krye të listës së parimeve të Kodit Penal (neni 71). Parim shumë i rëndësishëm është edhe ***parimi i parandalimit të delikuencës së fëmijëve***. Me këtë parim bëhej proklamimi i karakterit parandalues të sanksioneve penale për fëmijët e dënuar i cili realizohej gjatë zbatimit të masave edukuese, dënimeve apo masave alternative. Krahas kësaj, qëllimi ishte që këto masa represive të sigurojnë ndihmë dhe mbrojtje për të miturit, dhe mbikëqyrje mbi to, për zhvillim profesional dhe përgjegjësinë e tyre, dhe për të arritur qëllimin kryesor i cili është edukimi, rehabilitimi dhe zhvillimi i tyre të drejtë (neni 72). Ky parim vazhdon të jetë i zbatueshëm në drejtësisë penale për fëmijë edhe sot.

Po ashtu në nenin 73 të KPM-së ishte i përcaktuar ***parimi e parandalimit special dhe atij gjeneral*** në kuptim të qëllimit të dënimit me burg për të mitur, i cili megjithatë është një mundësi e fundit për ata fëmijë të cilët kanë arritur moshën 16 vjeçare. Parime të tjera nuk ishin të përcaktuara në Kodin penal në mënyrë specifike vetëm për të miturit, për shkak të parimeve të përgjithshme të përcaktuara që vlejnë edhe për personat e rritur,të tilla si: *Parimi i ligjshmërisë, legjitimitetit, drejtësisë, fajsisë, humanitetit, individualizimit të dënimit etj.*

1.3.2. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Ligjit mbi drejtësinë për të mitur (LDM)

Me Ligjin mbi drejtësinë për të mitur i cili rregullonte sistemin e unifikuar tashmë të drejtësisë për të mitur, u proklamuan disa parime, duke përfshirë edhe ato të përcaktuara më herët me Kodin penal. Parimet e drejtësisë për të mitur sipas këtij ligji ishin:

Parimi i ligjshmërisë, një nga postulatet kryesore të së drejtës penale në kuptimin e gjërë të saj. Sipas këtij parimi, të miturit nuk mund t'i shqiptohej sanksion i paraparë me këtë ligj, për veprim që para se të kryhej nuk ka qenë me ligj i cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe për të cilin nuk ka qenë i përcaktuar sanksion me ligj(n. 3); *Të miturit në* ***procedim joformal*** të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe ***në procedurën gjyqësore, i garantohen të gjitha të drejtat*** *që i kanë personat e mitur* të akuzuar në procedurën penale, respektivisht për kundërvajtje si dhe të drejtat e veçanta, të pranuara me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin dhe zbatimin e cilitdo sanksion ose masë të përcaktuar me ligj (n. 4); Zbatimi i masave dhe sanksioneve të përcaktuara me LDM dhe veprimi me të miturin ishin subordinuar në ***interes të tij për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë*** (n. 5). Gjatë zbatimit të masave dhe sanksioneve edhe në procedurat e përcaktuara me LDM të miturit mund ***t'i merreshin ose t'i kufizoheshin të drejtat*** *e caktuara* vetëm në masë që përgjigjet me *shkallën* ***e arritur të zhvillimit të personalitetit të tij*** dhe të *nevojës së tij për mënjanimin e gjendjeve që ndikojnë që ai* të bëjë vepra penale ose kundërvajtje (n. 6). Parim tjetër i rëndësishëm që proklamohej me këtë këtë ligj ishte ***dhënia përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese*** kundrejt sanksioneve të parashikuara në këtë ligj (n. 7). Gjithashtu, parashiheshin parimet në vijim:

Parimi i ***individualizimit të sanksioneve penale*** për kryes të miturit të vepër penale; ***Sanksionet që përbëjnë privim nga liria*** të të miturit, do të zbatohen në raste të veçanta, si ***mjet i fundit***, nëse ndryshe nuk mund të arrihet qëllimi i zbatimit të masave dhe sanksioneve për veprën e kryer penale (neni 8). Edhe këtu parashihej parimi ***i shmangies së të miturit në procedurë penale***, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me LDM me qëllimit të mënjanimit të ndikimit të dëmshëm ndaj të miturit, përveç nëse cilësitë personale të tij dhe rrethanat në të cilat është kryer veprimi nuk tregonin për nevojën e mbajtjes së procedurës

gjyqësore; Procedura gjyqësore sipas rregullit, do të zbatohej vetëm në rastet kur i mituri ka kryer vepër që me ligj është përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënim me ***burg prej tre vjet*** *ose dënim më i rëndë*, ose në rast kur ***qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me LDM nuk mund të arrihej pa procedurën e tillë*** (n. 9); I mituri kishte ***të drejtën e mbrojtjes*** në gjykatën kompetente kundër aktvendimeve të marra në procedurën administrative (n. 10); E drejtë themelore e të miturit ishte që procedurën ndaj tij ta mbajë dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj t'i shqiptojë vetëm ***gjykata kompetente*** për kriminalitetin e të miturve. Masat e tjera të përcaktuara me LDM mund t'i shqiptonin edhe ***organet tjera të specializuara*** (n. 11).

1.3.3. Parimet e drejtësisë për fëmijë sipas Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë (LDF)

Ligji pozitiv për drejtësinë e fëmijëve përcakton parimet themelore në të cilat bazohet funksionimi i drejtësisë penale për fëmijë. Në përmbajtjen e tyre ato parime paraqesin proklamimin e të drejtave themelore të fëmijëve në njërën anë dhe obligime për organet dhe subjektet tjerë të cilët janë kompetentë për të vepruar në procedura ndaj fëmijëve (kryes dhe viktima të veprave penale dhe atyre kudërvajtëse) në anën tjetër. Ato rregulla janë (nenet 3-18):

E drejta e përdorimit të gjuhës, e drejta për t'u informuar në çdo fazë të procedurës penale; Ndalimi i diskriminimit mbi çfarëdo baze; Parimi i ligjshmërisë; Ndalimi i trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues; Privimi nga liria i të miturve vetëm si mjet i fundit në procedurë, duke mbrojtur interesin e fëmijës për edukim; E drejta e ankesës; Prioriteti i masave parandaluese, edukuese dhe të mbrojtjes; Parimi i individualizimit të dënimit etj.

- ***E drejta e përdorimit të gjuhës*** parashihet si e drejtë që e ka fëmiu në procedurë në nenin 3 të këtij ligji, i cili përcakton se në procedurë, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Më tej theksohet se dispozitat e *Ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve* në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëadministrimit lokal në mënyrë adekuate zbatohen në procedurë ndaj fëmijëve. Fëmiu shtetas i huaj i privuar nga liria ose në paraburgim, parashtresat në procedurë mund t'i parashtrojë në gjuhën e vet, ndërsa në raste të tjera në kushte të reciprocitetit (n. 3);
- Fëmiu ka të drejtë të ***informohet*** nga të gjitha institucionet, që janë në lidhje me të,

për të drejtat e tij, të cilat përfshijnë obligime dhe përgjegjësi me Konventën për të drejtat e fëmiut dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmiut me këtë ligj dhe me ligje tjera. Fëmiu ka të drejtë ***të merret në pyetje, të dëgjohet dhe të këshillohet për të drejtat në atë procedurë dhe për vetë procedurën.*** Në ç'do procedurë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në të cilën merr pjesë, fëmiu ka të drejtë në mënyrë ***aktive*** të marrë pjesë ***në marrjen e vendimeve*** për jetën e tij dhe ta japë mendimin e vet (n. 4);

- Fëmiut mbi moshën 14 vjet ***nuk mund*** t'i shqiptohet ***sanksion për veprën*** e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e paraparë ***me ligj*** si vepër penale ose si kundërvajtje dhe për të cilën nuk është përcaktuar sanksion me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare (n. 5);
- Fëmijët ***viktima*** të veprave që me ligj janë paraparë si vepra penale i kanë të drejtat e njëjta që i kanë edhe personat viktima të moshës madhore, para, gjatë kohës dhe pas përfundimit të procedurës penale, si dhe të drejtat e veçanta të pranuara me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara. Fëmijët viktima të veprave, të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe fëmijët dëshmitarë gëzojnë mbrojte të përforcuar dhe përkrahje nga të gjitha institucionet, organet dhe individët në sistemin për drejtësi për fëmijë, me qëllim që të zvogëlohen pasojat negative mbi ta nga vepra penale dhe të pengohet ndikimi negativ i veprimit të institucioneve mbi zhvillimin e drejtë të fëmijës dhe të nxiten të kërkojnë mbrojtje para gjykatës kompetente(n. 6);
- Fëmiut mbi moshën 14 vjet në veprimin joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe në procedurën gjyqësore, i ***garantohen të drejtat*** e njëjta që i kanë personat e moshës madhore të akuzuar në procedurë penale ose kundërvajtëse, si dhe të drejtat e veçanta të pranuara me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet tjera të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin e cilitdo sanksioni ose mase të paraparë me ligj. Nuk mund të konsiderohet se fëmija bie ndesh me ligjin derisa kjo nuk përcaktohet me ***vendim të plotfuqishëm gjyqësor***. Gjatë veprimit gjykatat dhe institucionet tjera në zbatimin e dispozitave të LDF, qëllim kryesor e kanë realizimin e ***interesave më të mira*** për fëmiun (n. 7);
- ***Gjykata dhe institucionet tjera*** në zbatimin e LDF i respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e fëmijës ***pa asnjë diskriminim***, pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës,

përkatësisë së grupit të margjinalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve tjera të besimit, shkollimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesave mentale dhe trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose çfarë do qoftë tjetër përveç asaj që është paraparë me ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, të prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose të anëtarëve të familjes së fëmijës. Gjykata dhe institucionet tjera gjatë zbatimit të këtij ligji i ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së fëmiut nga të gjitha llojet e diskriminimit ose sanksionit ose kufizimeve tjera të të drejtave në bazat e parapara në parag.1 të këtij neni (n. 8);

- Asnjë fëmijë ***nuk guxon*** t'i ekspozohet ***mundimit, veprimeve ose sanksioneve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese***. Fëmiu ç'do herë ka të drejtë për mbrojte të përforcuar nga mundimi dhe veprimet ose sanksionet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (n. 9);
- ***Privimi i fëmiut nga liria*** zbatohet vetëm si **mjet i fundit** në procedurë, dhe vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me LDF (n. 10);
- Ç'do ***veprim*** në gjykatë dhe në institucione tjera me fëmijë në zbatimin e dispozitave të LDF duhet të zgjasë dhe të përfundojë në ***afat të arsyeshëm***, që nuk do t'i dëmtojë interesat e tij(n. 11);
- Fëmiu, ose përfaqësuesi ligjor i tij ka të drejtë ***informimi*** për rrjedhën e veprimit dhe të drejtën e ***ankesës*** dhe ***parashtresës*** për mbrojtjen e të drejtave te Avokati i Popullit dhe organet e institucionet tjera të cilat kanë kompetencë që të kujdesen për të drejtat e fëmiut (n. 12);
- Zbatimi i ***masave dhe sanksioneve*** të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me fëmijën janë paraparë në ***interes të tij për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë***(n. 13);
- Veprimi në gjykatë dhe në institucione tjera gjatë shqiprimit dhe ekzekutimit së sanksioneve dhe masave tjera duhet t'i përshtatet ***moshës, personalitetit, nevojave*** dhe ***interesave*** të fëmiut. Gjatë zbatimit të masave në procedurat e përcaktuara me këtë ligj fëmiut mbi 14 vjet mund t'i merren ose kufizohen të drejta të caktuara vetëm në masë që i përgjigjet shkallës së arritur të zhvillimit dhe të personalitetit të tij dhe të nevojës së tij për mënjanimin e gjendjeve që ndikojnë tek ai të kryejë veprime që me ligj janë paraparë si vepra

penale ose kundërvajtje(n. 14);

- Gjatë vendosjes për zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me LDF, ç'do herë u jepet **përparësi** masave ***preventive, mbrojtëse dhe edukuese*** (n. 15);
- ***Masa*** ose ***sanksioni*** që i shqiptohet fëmiut mbi 14 vjet duhet t'i përgjigjet ***personalitetit*** të tij, ***peshës së veprimit*** që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje dhe ***pasojave*** të saj, *nevojës për edukimin, riedukimin, arsimimin dhe zhvillimin e tij,* për shkak të sigurimit të mbrojtjes së interesit që është më i volitshëm për fëmijën. (n. 16);
- ***Procedura*** gjyqësore sipas rregullës ***inicohet*** vetëm për rastet e parapara si vepër penale me këtë ligj, nëse fëmija mbi 14 vjet ka kryer vepër që është paraparë si ***vepër*** penale për të cilën shqiptohet dënim me ***burg prej tri vitesh*** ose dënim ***më i rëndë***, ose në rastet kur ***qëllimi*** i masave ose sanksioneve të përcaktuara me LDF nuk mund të arrihet pa procedurë të tillë (n. 17);
- Procedurën ndaj fëmiut e zhvillon dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj i shqipton vetëm ***gjykata kompetente***. Masa tjera të parapara me këtë ligj mund të shqiptojnë edhe ***organet tjera të specializuara*** (n. 18).

Ndonëse drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Maqedonisë, është e pavarësuar me ligj të veçantë me të cilin rregullohen institutet, parimet, sanksionet penale dhe masat e tjera jo-penale, procedurat e ndryshme që zbatohen ndaj fëmijëve kryes të veprave penale dhe kundërvajtëse etj., mund të konstatohet se kjo degë e së drejtës ende mbetet në varësi me të drejtën penale në kuptimin e gjërë. Në këtë drejtim, ajo paraqitet si nëndegë e të drejtës penale në kuptimin e gjerë, sa i përket raportit të lidhshmërisë që ka me parimet e përgjithshme dhe institutet juridiko-penale, të cilat nuk përcaktohen shprehimisht me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve, e të cilëve paktika i'u referohet për t'i zbatuar ndaj fëmijëve në raste kur paraqiten dhe përmbushen kushtet e përcaktuara ligjore në Kod penal si psh. Instituti i përjashtimit të kundërligjshmërisë- Mbrojtja e nevojshme; Nevoja ektreme e shumë të tjerë. Krahas parimeve të cilat u trajtuan më lartë, ndaj fëmijëve në kontakt me ligjin (kryes, viktima) zbatohen edhe parime të tjera nga e drejta penale në kuptimin e gjërë (e drejta materiale, procedurale dhe ajo mbi ekzekutimin e sanksioneve penale).

1.4. Sanksionet penale për fëmijë sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve

1.4.1. Kuptimi dhe llojet e sanksioneve penale për fëmijë

Sanksionet penale për fëmijët kryes të veprave penale, paraqesin tërësinë e masave represive të cilat përbëhen me privimin e ndonjë të drejte, lirie apo të mire të caktuar të fëmiut të përgjegjshëm penalisht. Këto sanksione penale parashihen në Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve dhe të njejtit mund të shqiptohen vetëm nga ana e gjykatave kompetente në procedurë gjyqësore në pajtim me këtë ligj dhe ligje të tjera që rregullojnë çështje mbi zhvillimin e procedurës penale ndaj fëmiut (si LPP, Ligji mbi gjykatat etj.). Sanksionet penale për fëmijë mund të i'u shqiptohen fëmijëve të grupmoshave prej 14 deri 18 vjet, të shpallur fajtorë për kryerje të veprës penale.

Qëllimi i sanksioneve penale për fëmijë është në radhë të parë edukimi i fëmijëve, risocializimi dhe mbrojtja e interesave të tyre, respektivisht preventiva e delikuencës së fëmijëve (speciale dhe gjenerale). Sanksionet penale (në përgjithësi, për fëmijë edhe madhorë) në sistemin bashkëkohor të ndëshkimit kanë *karakter dualist*. Kjo do të thotë se ndaj kryersve të veprave penale mund të shqiptohen dhe ekzekutohen edhe dënimet dhe zëvendësimet e tyre p.sh. dënimi me ose sanksionet e tjera të tipit të mbrojtjes të cilat kanë karakter preventiv. Ky karakter dualist shifet edhe në mundësinë e aplikimit dhe seleksionimit të masave të ndryshme, si dënimeve plotësuese ose masave edukuese korrektuese (Halili, Penologjia, 2010, f. 69).

Para se të trajtohen llojet e sanksioneve penale për fëmijë, vlenë të theksohet relevanca e drejtësisë restorative karshi asaj retributive në sistemin juridiko-penal për fëmijë, ku kjo e para (e drejta restorative) është pranuar në modelin e ri të drejtësisë penale për fëmijë në vendin tonë. Sipas këtij modeli të drejtësisë, qëllimi i sanksionimit të fëmiut ka të bëjë me prevencionin dhe resocializimin special të fëmiut, poashtu satisfaksionin e të dëmtuarit në formë të kompenzimit të dëmit dhe plotësim të nevojave të bashkësisë për ndërprerjen e veprave penale.

- Kapitulli i katërt i pjesës së tretë të Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë (2013) i emërtuar ***Sanksione për vepra penale dhe kundërvajtje*** përcakton kushtet për shqiptimin e këtyre

masave represive ndaj fëmijëve, qëllimin si dhe llojet e tyre.

Fëmiut prej moshës **14 deri në 16** vjet për veprime të cilat me ligj parashihen si vepra penale mund t'i shqiptohen vetëm ***masa edukuese*** (n. 34, p.1). Ndërkaq, fëmiut prej moshës **16 deri në 18** vjet për veprime të cilat me ligj parashihen si vepra penale mund t'i shqiptohen masa edukuese, e me përjashtim mund t'i shqiptohet ***dënim*** ose ***masë alternative*** (n. 34, p.2). Qëllimi i masave edukuese, dënimeve, masave alternative dhe i sanksioneve kundërvajtëse është që përmes dhënies së mbrojtjes dhe ndihmës fëmijëve, me kryerjen e mbikëqyrjes mbi ta, me aftësimin e tyre profesional, me zhvillimin e tyre personal të përgjegjësisë, të sigurohet edukimi, riedukimi dhe zhvillimi i drejtë i tyre (n. 35).

Sanksioni që i shqiptohet fëmiut duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojave të saj, nevojës së edukimit, riedukimit, arsimimit dhe zhvillimit të tij, për sigurimin dhe mbrojtjen e interesit të domosdoshëm për fëmiun. Kur janë plotësuar kushtet ligjore, gjykata kompetente shqipton dënim vetëm nëse nuk është e arsyeshme shqiptimi i masës edukuese ose alternative (n. 36.p.1 dhe 2).

Ndaj fëmijëve në ndeshje me ligjin mund të shqiptohen këto lloje të sanksioneve penale (n. 34):

- Masa edukuese;
- Dënime;
- Masa alternative dhe
- Masa siguruese.

Prof. Dr. Kambovski gjatë trajtimit *të* ***kufijve të moshës së miturisë*** në librin e tij "E drejta penale-Pjesa e përgjithshme", vlerëson se ato paraqiten si themel për statusin e ndryshueshëm penalo-juridik të të miturve. Pyetja që ai ngrit është nëse ***ky është kriteriumi më i mirë?***, e që e paraqet me përgjigje të dyshimtë, kjo sepse: ***E para***, zhvillimi i personalitetit të të miturve është proces evolutiv në të cilin kalojnë prej një moshe në tjetrën dhe nuk shprehet si kalim i kapërcyeshëm, por si pjekuri e vazhdueshme në kuptimin psikologjik, të karakterit emocional. Ai shton se ndryshimi radikal i statusit me mbushjen e moshës së caktuar p.sh. prej përjashtimit absolut të ç'do lloj sanksioni deri në plotësimin e moshës 14 vjeçare deri në ndjekje dhe mundësi për sanksione me mbushjen e moshës 14

vjeçare paraqet zgjedhje shumë jonatyrore. Kështu p.sh. nëse fëmiu i moshës deri 13 vjet e 11 muaj dhe 29 ditë ka kryer vrasje- kundër tij nuk do të zbatohet asnjë masë penale dhe nëse pas dy, tre ditëve kryen ndonjë vjedhje të vogël do të gjendet para gjyqit dhe mund të shqiptohet masë edukuese! ***Aspekti i dytë*** sipas Prof. Dr. Kambovski, e hap pyetjen për përqindjen të cilën e imponon vendosja lineare e kufijve për moshën, kjo sepse nuk zhvillohen të gjithë të miturit në mënyrë të njejtë dhe të drejtë, por përkundrazi egzistojnë dallime të mëdha në zhvillimin e personalitetit, kështu që disa të mitur piqen dhe aftësohen për jetë më herët prej përqindjes të cilën e imponon mosha, ndërsa të tjerët vonohen në zhvillimin e tillë (Kambovski, 2007, f. 605). Krahas këtij sqarimi mbi arsyeshmërinë e përcaktimit të kufirit të moshës së fëmijëve i cili kushtëzon përcaktimin e përgjegjësisë penale të fëmijëve, e përkrah qëndrimin e Prof. Dr. Kambovski, sipas të cilit ky përcaktim lidhur me kufirin e moshës duhet respektuar pakushtëzueshëm, në cilësi të prioritetit që nuk duhet lëshuar assesi. Kjo sepse, sipas tij, pa klasifikimin e tillë prej këtij sistemi do të duhet që më parë të largoheshin dënimet dhe nga ana tjetër zbatimi i tyre do të mund të rritej në subjektivitet të skajshëm dhe arbitraritet! (Kambovski, 2007, f. 605).

1.4.2. Masat edukuese

1.4.2.1. Kuptimi i masave edukuese

Masat edukuese janë lloj i sanksioneve penale, të parapara me Ligjin mbi Drejtësinë e fëmijëve, të cilat i'u shqiptohen fëmijëve në ndjeshje me ligjin nga mosha 14-18 vjeçare. Këto paraqesin lloj të posaçëm të sanksioneve penale të cilat mund të i'u shqiptohen ekskluzivisht vetëm fëmijëve kryerës të veprave penale. Këto masa përbëhen në *mbrojtjen, mbikqyrjen, aftësimin profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë personale* të të miturit dhe kanë për qëllim edukimin e tij, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë. Bëhet fjalë për sanksione të udhëhequra ekskluzivisht prej ***idesë së preventivës.*** (Kambovski, 2007, f. 607).

Masat edukuese janë disa llojesh dhe për nga karakteri janë sanksione më të lehta penale në krahasim me sanksionet tjera, respektivisht nga dënimet, masat alternative apo masat siguruese. Qëllimi i këtyre masave mund të vërehet edhe nga vetë emërtimi i tyre, i cili konsiston në edukimin apo riedukimin e fëmiut delikuent, parandalimin e veprimeve

delikuente e asociale nga fëmijët, socializimin e fëmiut në shoqëri, e assesi dënimin apo shpagimin për të keqen që e ka shkaktuar. Qëllimi i hakmarrjes nuk është prezent as tek sanksionet e tjera bashkëkohore edhe për persona madhorë! Pra, qëllimi i politikës penale represive dhe preventive është përmirësimi i fëmijëve delikuentë, që në të ardhmen të mos e përsërisin veprimin e njejtë apo të ndryshëm kundërligjor (Qëllimi i parandalimit special).

Gjatë zgjedhjes së masës edukuese gjykata merr parasysh këto rrethana: Moshën e fëmiut, shkallën e zhvillimit të tij shpirtëror, cilësitë e tij psikike, prirjet, nxitjet nga të cilat e ka kryer veprimin, edukimin e deritanishëm, mesin dhe rrethanat në të cilat ka jetuar, peshën e veprimit të kryer, nëse ndaj tij më parë është shqiptuar masë edukuese ose dënim me burg për fëmijë dhe të gjitha rrethanat tjera që ndikojnë mbi caktimin e llojit të masave për arritjen e qëllimit të tij të përcaktuar me ligj (Ligji për drejtësi për të mitur , 2007, neni 38).

1.4.2.2 Llojet e masave edukuese

Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë njeh tri kategori të masave edukuese që mund t'i shqiptohen fëmiut që ka arritur moshën 14 vjeçare deri 18 vjeçare, për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale (neni 37). Ato janë:

1. Qortimi ose Dërgimi në qendrën për fëmijë,
2. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve, familjes përkujdesëse ose Qendrës dhe
3. Masat e entit - Dërgim në institucion edukues ose Dërgim në Shtëpi edukuese-përmirësuese.

Masa Qortim ose dërgim në qendrën për fëmijë i shqiptohet fëmiut kur nuk ekziston nevoja për masa më të gjata të edukimit, e në veçanti nëse ka kryer veprim me të cilat me ligj është paraparë si vepër penale nga pamaturia ose mendjelehtësia. ***Masat e mbikëqyrjes së përforcuar*** i shqiptohen fëmiut kur ekziston nevoja për masa më të gjata të edukimit, riedukimit ose mjekimit me mbikëqyrje përkatëse, e nuk nevojitet ndarje e plotë e tij nga mjedisi i deritanishëm. ***Masat e entit*** i shqiptohen fëmiut kur ekziston nevoja për masa të

gjata të edukimit, riedukimit ose mjekimit dhe veçim të plotë nga mjedisi i deritanishëm (deri në momentin kur e ka kryer veprën penale). Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet, por më së shumti mund të zbatohet deri më mbushjen e 23 viteve të fëmiut (n. 37). Duhet të theksohet se ndarja e këtillë e masave edukuese nuk ka pësuar asnjë ndryshim me ligjin pozitiv të drejtësisë për fëmijë(2013), pasi që ky kategorizim ka egzistuar edhe në KPM edhe në LDM (2007).

Sipas Prof. Dr. Kambovski, gradimi i tyre prej masave më të lehta, masa të lirisë deri te masat më të rënda, masa që përbëhen në heqjen e lirisë, nuk ka për qëllim përcaktimin e ndonjë proporcionaliteti aprior mes llojit dhe rëndësisë së veprës së kryer dhe masës që duhet të shqiptohet, funksion që e kanë p.sh. parimi i shkallëzimit të veprave të rënda dhe të lehta. Edhe pse është më se e saktë se edhe këtu përzgjedhja e këtyre masave niset prej kërkesës së proporcionalitetit, por e kuptuar si zgjidhje e masës edukuese që i përgjigjet personalitetit të të miturit (fëmiut) dhe nevojës së edukimit dhe zhvillimit të tij (Kambovski, 2007, f. 607). Ky koncept mund të kuptohet më së miri nga përcaktimi i kushteve për zbatimin e këtyre masave sipas n.37 të këtij ligji. Megjithatë kjo nuk e obligon gjykatën që gjithmonë të shkojë sipas këtij rendi, pra nga masat më të lehta edukuese tek ato më të rënda dhe nëse është e përjashtuar në raport me interesin e fëmiut, në rastin konkret gjykata mund të vendosë për zbatimin e masës së entit pa eksperimentuar me trajtimin e mëparshëm të lirisë! (Kambovski, 2007, f. 607). Parimi i oportunitetit dhe i arsyeshmërisë në vendimmarrje në bazë të bindjes së lirë të gjykatësit, duke i'u përshtatur rastit individual ka relevancën e vet për ç'do çështje penale që duhet zgjidhur nga ana e gjykatës kompetente.

1.4.2.2 (1) Qortimi dhe Dërgimi në qendër edukuese

Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë njeh dy lloje të *masave disiplinore për fëmijë*:

- Qortimi;
- Dërgimi në Qendër për fëmijë.

Emërtimi "Masa disiplinore" në LDF nuk përdoret për këto dy masa. Ky term egzistonte në Kodin penal dhe në Ligjin mbi drejtësinë për të mitur.

a. ***Qortimi*** shqiptohet nëse mjafton vetëm qortimi i fëmiut për veprimin e kryer. Gjatë shqiptimit të qortimit fëmiut do t'i tregohen dëmet nga veprimi i tij dhe do të paralajmërohet

se në rast të përsëritjes, ndaj tij mund të shqiptohet sanksion tjetër (n.39).

b. Masën ***Dërgim në Qendër për fëmijë*** (n.40) gjykata do ta shqiptojë për fëmiun kur nevojitet që me masa afatshkurtra të realizohet ndikim mbi personalitetin dhe sjelljen e tij. Fëmiun të cilit i është shqiptuar kjo masë, gjykata mund ta dërgojë në qendrën për fëmijë në numër të caktuar të orëve gjatë ditës në ditët e festave, e më së shumti në katër ditë të festave të njëpasnjëshme, në numër të caktuar të orëve gjatë ditës, por më së shumti një muaj ose në qëndrim të pandërprerë në numër të caktuar të ditëve, por jo më shumë se 20 ditë. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata do të mbajë llogari për atë se me zbatimin e saj fëmiu të mos mungojë nga mësimi i rregullt ose nga puna. Në qendrën për fëmijë, fëmiu do të kryejë punë që i përgjigjen gjendjes së tij psikofizike. Kur do të shqiptohet dërgimi në qendër për fëmijë, gjykata mund të përcaktojë që gjatë dhe pas mbarimit të kësaj mase fëmiu të vihet nën mbikëqyrje të përforcuar të qendrës, për periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj.

Realizimi i masës është i rregulluar me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, por në praktikë varet prej organizimit, ekipit kadrovik dhe programeve për punë me fëmijë të tillë! (Kambovski, 2007, f. 608). Kjo masë është e mundur si kufizim afatshkurtër i lirisë i llogaritur me veprim frikësues mbi të miturin (shok terapia). Prej këtu shqiptimi i saj paraqet diagnozë të mirë të personit dhe prognozë për veprimet e terapisë së tillë (Kambovski, 2007). Nga të dhënat e publikuara të Entit shtetëror statistikor shihet se nga viti 2007 deri 2015 është shqiptuar vetëm një herë një masë e këtillë në vitin 2014 për vepër penale Vjedhje e rëndë! (Më hollësisht rreth numrit të masave edukuese të shqiptuara ndaj fëmijëve gjatë periudhës 2006-2015 elaborimi në kapitullin IX të punimit).

1.4.2.2. (2)Masat e mbikqyrjes së përforcuar

Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i Maqedonisë njeh tre lloje të masave të mbikqyrjes së përforcuar, dhe atë:

a. **Mbikqyrja e përforcuar nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve;**
b. **Mbikqyrje e përforcuar nga ana e familjes tjetër përkujdesëse;**
c. **Mbikqyrja e përforcuar nga ana e qendrës.**

a. ***Mbikqyrja e përforcuar nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve***(n.41) shqiptohet në rastet kur prindi/ërit, ose tutori/ët, kanë bërë lëshim, kurse kanë pasur mundësi të kryejnë

mbikëqyrje mbi fëmiun. Kur gjykata do të shqiptojë këtë masë do t'u urdhërojë prindërve ose tutorëve obligime të caktuara në pikëpamje të masave që duhet të ndërmerren për edukimin e fëmiut, për mjekimin e tij dhe për largimin e ndikimeve të dëmshme mbi të, e mund t'iu japë edhe udhëzime të nevojshme. Gjykata në mënyrë plotësuese vendosë për ndërprerjen e kësaj mase ashtu që ajo nuk mund të zgjasë më pak se një vit dhe as më gjatë se tri vite. Masa së pari i është adresuar jo të të miturit (fëmiut) por personave që janë të obliguar ta edukojnë atë (prindërit, adoptuesit ose kujdestarit). Shqiptimi i saj duhet të mbështetet në pritjen se personat e tillë do të munden me mbikqyrje të fortë ta korrigjojnë sjelljen e fëmiut dhe me këtë sipas nevojës ti ndihmojnë organit social (Qendra për punë sociale) me kontrollin e realizimit të masës dhe me dhënien e këshillave, urdhëresave se si ti realizojnë detyrat e dhëna prej gjyqit.

b. Mbikqyrje e përforcuar nga ana e familjes tjetër (n.42) shqiptohet nëse prindi/ët ose tutori/ët e fëmijës nuk kanë mundësi të kryejnë mbikqyrje mbi të ose kjo me arsye nuk mund të pritet nga ata, fëmiu do të dorëzohet në familje përkujdesëse e cila do ta pranojë dhe ka mundësi të kryejë mbikqyrje të përforcuar mbi të. Realizimi i kësaj mase do të ndërpritet kur prindi/ët, ose tutori/ët e fëmijës do të kenë mundësi të kryejnë mbikqyrje të përforcuar mbi të ose kur sipas rezultateve të edukimit dhe riedukimit do të pushojë nevoja e mbikqyrjes së përforcuar.

Kjo masë shqiptohet në rastet kut fëmiu ka mbetur pa familje ose familja për arsye të ndryshme nuk mund ta kryejë funksionin prindëror të edukimit. I mituri mund ti besohet për edukim familjes së shëndoshë (zakonisht ato janë familje të afërmit e tij) për të cilat gjyqi do të konstatojë se ka dëshirë të ndihmojë në edukimin e atij fëmiu (Kambovski, 2007, f. 609). Por është shumë interesant fakti se sa kjo masë është shqiptuar nga gjykatat në vendin tonë, kur nga të dhënat e publikuara nga Enti shtetëror statistikor në Publikimet vjetore për numrin e kriminalitetit në vend, respektivisht nga analiza e nëntë publikimeve për vitet 2007 deri 2015 vërehet se nuk është shqiptuar të paktën as një masë e këtillë ndaj fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare e asaj ndaj atyre të moshës 16-18 vjeçare!(Shih në kapitullin IX tabelat *Fëmijë të gjykuar nga mosha 14-16, 16-18 vjeçare sipas sanksionit penal 2006-2015). Nga k*y fakt lind dilema se pse asnjë familje nuk është e gatshme të ndihmojë fëmijë që gjenden në rrethana të këtilla familjare, që e parasheh si mundësi neni 42 i LDF?! Sidoqoftë, mund të konstatohet se nëse për së paku dhjetë vitet e fundit të drejtësisë penale për fëmijë nuk ka

gjetur zbatueshmëri në praktikë kjo masë, ajo rezulton të paraqitet si joefikase për realitetin tonë, me ç'rast paraqitet nevoja që ligjvënësi të ndërmerr masa për modifikimin e kësaj mase me qëllim të zbatimit ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin.

c. ***Mbikqyrja e përforcuar nga ana e qendrës*** (n.43) shqiptohet nëse prindi/ët, ose tutori/ët nuk kanë mundësi të kryejnë mbikëqyrje të përforcuar mbi fëmijën e nuk ekzistojnë kushte për dorëzim të fëmijës në familje përkujdesëse për kryerje të mbikqyrjes së këtillë, fëmiu do të vendoset në mbikëqyrjen e qendrës. Gjykata në mënyrë plotësuese do të vendosë që masa të pushojë, me atë që zgjatja e saj nuk mund të jetë më e shkurtër se një as më e gjatë se tri vite. Gjatë kohëzgjatjes së masës fëmiu edhe më tej mbetet të jetojë te prindi/ët ose te persona tjerë që e mbajnë, kurse mbikëqyrjen e përforcuar mbi të e kryen qendra. Nëse fëmiu nuk mund të mbetet në familjen ku ka jetuar, qendra do ta vendosë në institucion edukues dhe do të kujdeset për shkollimin ose punësimin e tij, për ndarje nga mjedisi që ndikon dëmshëm mbi të, për mjekimin e nevojshëm dhe përmirësimin e rrethanave ku jeton.

- ***Obligime të veçanta ndaj masës mbikëqyrje e përforcuar*** (n.44)

Gjatë shqiptimit të ndonjë mase edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar, gjykata mundet fëmijës t'i caktojë një ose më shumë obligime të veçanta nëse kjo është e nevojshme për zbatim më të suksesshëm të masës të shqiptuar. Gjykata mundet fëmiut t'ia caktojë këto obligime në veçanti:

- T'i kërkojë falje personalisht personit të dëmtuar,
- Ta përmirësojë ose kompensojë dëmin e shkaktuar me veprimin e kryer,
- Të shkojë rregullisht në shkollë;
- Të mos mungojë nga vendi i punës për fëmijë mbi 15 vjet;
- Të aftësohet për punë që i përgjigjet aftësive, prirjeve dhe forcës fizike të tij për fëmijë mbi 15 vjet;
- Të pranojë punë për fëmijë mbi 15 vjet;
- T'ia ndalojë përdorimin e pijeve alkoolike, drogës dhe substancave tjera psikotropike;
- Të dërgohet në institucion përkatës shëndetësor ose këshillimore;
- Në mënyrë të dobishme ta shfrytëzojë kohën e lirë;
- Të mos kontaktojë me persona të cilët ndikojnë negativisht mbi personalitetin e tij;
- Të profesionalizohet dhe rikualifikohet për mbajtjen e vendit të punës që e zë ose për

krijimin e parakushteve për punësim të fëmijëve mbi 15 vjet;
- Të mundësojë kontroll dhe të pranojë këshilla lidhur me sistemimin dhe shpenzimin e rrogës dhe të hyrave tjera që i realizon;
- Të përfshihet në punë të organizatave humanitare, komunale, ekologjike ose organizatave joqeveritare;
- Të përfshihet në organizatë ose shoqatë të caktuar sportive, kulturore zbavitëse me obligimin që rregullisht të prezantojë në prova dhe trajnime dhe
- T'i ndalohet lëvizja pa shoqërimin e prindit/ëve, ose tutorit/ëve të tij prej orës 22 deri në orën 5.

Gjykata mundet me propozim të qendrës, t'i ndryshojë ose heqë obligimet e veçanta që i ka caktuar. Gjatë caktimit të obligimeve nga paragrafi (2) i këtij neni, gjykata në veçanti do t'i sugjerojë fëmijës dhe prindit/ëve, ose tutorit/ëve të tij që në rast se ai nuk i plotëson obligimet, masa mund t'i zëvendësohet me dërgim në qendër për fëmijë ose me masa të entit. Qendra kryen mbikëqyrje të përhershme dhe i ndihmon fëmiut në plotësimin e obligimeve të caktuara, bashkëpunon me prindin/ët, ose tutorin/ët dhe e njofton gjykatën së paku një herë në gjashtë muaj për suksesin e arritur në zbatimin e obligimeve të veçanta.

Në kombinim me mbikqyrjen e intensifikuar caktimi i masave të tilla do të thotë modelim i më pak ose më shumë i trajnimit intenziv, i cili nënkupton interaksion mes anëve të involvuara: të miturit dhe familjes, gjegjësisht organit social. Suksesi i tij varet në radhë të parë prej mbikqyrjes së plotësimit të obligimeve. Kjo është e mundur si pjesë përbërëse e mbikqyrjes që e kryen familja, gjegjësisht organi social, por duke e ditur se obligimet i cakton gjyqi, ai poashtu duhet të kryej mbikqyrje mbi angazhimin e tyre në plotësimin e obligimeve nga ana e të miturit (Kambovski, 2007, f. 610).

1.4.2.2.(3) Masat e enteve

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve parasheh dy masa të enteve: Dërgim në institucionin edukues dhe Dërgim në shtëpi edukuese përmirësuese.

a. *Masën* ***Dërgimi në institucion edukues*** (n.45) gjykata i'a shqipton fëmiut ndaj të cilit duhet të sigurohet mbikqyrje e përhershme dhe e përforcuar nga persona profesionalë (me përgatitje profesionale dhe shkollore për edukatorë) për edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë. Në institucionin edukues fëmiu mbetet së paku gjashtë muaj, e më së shumti tri vite.

Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton zgjatjen e saj por për këtë në mënyrë plotësuese vendos sipas rregullave të përcaktuara në n. 47 p.(2) të këtij ligji: Realizimi i masës së entit, duke pasur parasysh suksesin e arritur në edukim dhe riedukim, mund të ndërpritet, e mund të zëvendësohet me masë tjetër të tillë me kufizimet në vijim:

- Masa dërgim në institucion edukues nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para kalimit të afatit prej gjashtë muajsh, e deri në kalimin e këtij afati mund të zëvendësohet vetëm me dërgim të fëmiut në shtëpi edukuese-përmirësuese kurse,
- Masa dërgim në shtëpi edukuese përmirësuese nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para kalimit të afatit prej një viti.

Kjo masë shqiptohet kur i mituri duhet të largohet prej rrethit të tij të ngushtë dhe të përcaktohet për proces intenziv edukues, por këtu nuk bëhet fjalë për shkallë të tillë të edukimit të lënë dhe sjellje devijante, që do të imponoonte shqiptim i referimit në shtëpi edukativo-përmirësuese. Enti edukues është ent i llojit të përgjithshëm edukues me kushte për qëndrim ditor të të miturit (Kambovski, 2007, f. 610).

c. ***Dërgimi në shtëpi edukuese përmirësuese*** (n.46) *shqiptohet ndaj fëmiut* ndaj të cilit duhet të zbatohen masa të përhershme dhe të përforcuara për edukim dhe riedukim dhe ndarje të plotë të tij nga mjedisi i deritanishëm. Gjatë vendimmarrjes nëse do ta shqiptojë këtë masë, gjykata në veçanti do ta marrë parasysh peshën dhe natyrën e veprimit të kryer dhe rrethanat nëse ndaj fëmijës më herët janë shqiptuar masa edukuese ose dënim me burg për fëmijë. Në shtëpinë edukuese përmirësuese fëmiu mbetet së paku një vit, e më së shumti pesë vite, ose deri më mbushjen e 23 viteve. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj por për këtë vendos në mënyrë plotësuese. Gjykata e rishqyrton nevojën për qëndrim në shtëpi edukuese-përmirësuese ç'do vit, me detyrë zyrtare, me propozim të prokurorit publik ose me propozim të shtëpisë edukuese-përmirësuese.

Zgjidhja e këtillë ligjore lidhur me afatet e masave të enteve të cilat paraqesin minimumin dhe maksimumin absolut të kohëzgjatjes së masës, de lege lata nuk është në rregull. Kjo sepse, gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen strikte të masës, por për këtë vendosë më vonë. Prandaj, de lege ferenda gjykata do të duhej të caktojë kohëzgjatjen konkrete të masës me mundësi që me vendim plotësues të shkurtoj afatin e caktuar.

1.4.3 Dënimet për fëmijë

Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve (n.50) mund të dënohet një fëmijë mbi moshën e përgjegjësisë penale, respektivisht nëse ka arritur atë 16 vjeçare, përveç rasteve kur për shkak të pasojave të rënda të veprës penale të kryer dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme për shqiptimin e masës edukuese. Për këtë rast Prof. Dr. Kambovski thekson se kushtet ligjore për shqiptimin e dënimeve janë të përcaktuara në frymën e konceptit retributiv (Kambovski, 2007, f. 612). Sipas tij, ligji (mos)arsyetimin për shqiptimin e masës edukuese nuk e lidh për personalitetin e fëmiut dhe qëllimin e masës edukuese, por për pasojat e rënda të veprës dhe shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, e kjo në fakt nuk nënkupton gjë tjetër pos pranimit të parimit të dënimit proporcional dhe adekuat në zgjidhje që inklinon nga natyra e masave edukuese si sanksione themelore e që mund të mbrohet vetëm prej pozicionit të vetëm: Ekzistimi i shkallës së lartë të përgjegjësisë penale tek i mituri! (Kambovski, 2007, f. 612). Me të drejtë ai vlerëson se shqiptimi i dënimit mund të paraqitet si sanksion jashtëzakonisht i dobishëm për arritjen e qëllimit të (ri)edukimit të fëmiut. (Kambovski, 2007, f. 612).

Sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve, fëmiut mbi moshën 16 vjeçare mund t'i shqiptohen dënimet e mëposhtme(n.50)**:**

- Burg për fëmijë;
- Dënim me para;
- Ndalim i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë së caktuar dhe
- Dëbim i të huajit nga vendi.

1.4.3 (1) Burgu për fëmijë

Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve dënimi me burg për fëmijë(n.51) mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor. Burgu për fëmijë mund t'i shqiptohet fëmiut me përgjegjësi penale mbi moshën 16 vjet që ka kryer veprim që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej pesë vitesh ose dënim më i rëndë, nëse vepra është kryer në rrethana rënduese dhe në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit e me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masë edukuese.

Burgu për fëmijë nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit dhe as më i gjatë se dhjetë vite, kurse shqiptohet në vite të plota ose gjysmë viti (n.51, p.3). Vlen të theksohet se në përcaktimin e qëllimit të dënimit, në n. 73 të KPM-së përcaktohej si qëllim i posaçëm edhe parandalimi special dhe gjeneral si dhe në Ligjin mbi drejtësinë e të miturve të vitit 2007 (n.29), qëllim i cili nuk është përcaktuar si i tillë edhe në ligjin pozitiv mbi drejtësinë e fëmijëve, ku si qëllim i vetëm i masave edukuese, dënimeve, masave alternative dhe të sanksioneve kundërvajtëse është që përmes dhënies së mbrojtjes dhe ndihmës fëmijëve, me kryerjen e mbikqyrjes mbi ta, me aftësimin e tyre profesional me zhvillimin e tyre personal të përgjegjësisë, të sigurohet edukimi, riedukimi dhe zhvillimi i drejtë i tyre (n.35), por megjithatë edhe në këtë rast konsideroj se përsëri i njejti qëllim i lartëpërmendur, edhe pse nuk është i proklamuar shprehimisht në ligj është shumë i rëndësishëm dhe i zbatueshëm njëkohësisht.

Gjatë caktimit të dënimit, gjykata nuk mund të shqiptojë burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë nga dënimi i përcaktuar për atë vepër, por gjykata nuk është e lidhur për masën më të vogël të përcaktuar të atij dënimi. Kështu p.sh. kur si maksimum i posaçëm për veprën e kryer është i përcaktuar dënim me burg deri 8 vjet, gjyqi nuk mund të shqiptojë dënim mbi atë maksimum, por gjithmonë mund të ulet nën minimumin e përgjithshëm të dënimit me burg deri në një vit kohëzgjatje (Kambovski, 2007, f. 612).

Gjatë matjes së dënimit burg për fëmijë, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, të përcaktuara në Kodin penal, duke mbajtur llogari të veçantë për shkallën e zhvillimit shpirtëror të fëmijës dhe për kohën e nevojshme për edukimin, riedukimin dhe përsosjen profesionale të tij (LDM, n. 52).

Fëmiu që është në vuajtjen e dënimit me burg për fëmijë mund të lëshohet në lirim me kusht nëse e ka vuajtur së paku një të tretën, por jo para se të vuajë një vit nga dënimi i shqiptuar nëse riedukimi është i suksesshëm. Nëse fëmiut i është shqiptuar dënim me burg për fëmijë deri në dy vite e gjashtë muaj, mund të lëshohet në lirim me kusht në një të tretën e dënimit të shqiptuar. Gjatë kohës së lirimit me kusht gjykata i cakton masë të mbikqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës në kohëzgjatje të caktuar, e cila mund të jetë edhe më e shkurtër se pjesa e pavuajtur e dënimit.

Gjykata mund ta vazhdojë zgjatjen e mbikqyrjes së përforcuar deri në një vit pas kohëzgjatjes së dënimit, por më së shumti deri në mbushjen e 21 viteve të të dënuarit. Gjykata do ta

revokojë lirimin me kusht nëse fëmiu i dënuar nuk i plotëson obligimet e parapara me mbikqyrjen e përforcuar ose nëse derisa është në lirim me kusht kryen një ose më shumë veprime të parapara me ligj si vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burg për fëmijë mbi dy vite. Nëse fëmiu ka kryer veprim me ligj të paraparë si vepër penale për të cilin i është shqiptuar dënim prej dy vitesh me burg për fëmijë ose dënim me para, gjykata mund ta revokojë lirimin me kusht, duke i pasur parasysh ngjashmërinë e veprave të kryera, rëndësinë e tyre, nxitjet nga të cilat janë kryer dhe rrethanat tjera që sugjerojnë në arsyeshmërinë për revokimin e lirimit me kusht. Kur gjykata do ta revokojë lirimin me kusht, do të shqiptohet një dënim me zbatimin e dispozitave nga neni 58 të këtij ligji, duke e marrë dënimin e shqiptuar paraprakisht si tanimë të përcaktuar. Kur gjykata nuk do ta revokojë lirimin me kusht, ai vazhdohet për kohën që fëmiu i dënuar e ka kaluar në vuajtjen e dënimit me burg për fëmijë të shqiptuar për veprën e re (LDF, n.53, p.1-6).

Sa i përket temës lidhur me efektin pozitiv dhe negativ të shqiptimit të dënimit me burg për fëmijë, ajo është trajtuar në kapitullin e katërt të këtij punimi, ku analizohet efektiviteti i sanksioneve penale për fëmijë në arritjen e parandalimit special me vështrim të posaçëm në masat e entit dhe dënimin me burgim për fëmijë. Konkretisht efektet e dënimit me burgim ndaj fëmiut të privuar nga liria, mund të konkludohen nga rezultatet e nxjerrura nga Anketa e realizuar me fëmijët e burgosur, rezultate dhe konkluzione të cilat janë paraqitur në kapitullin e katërt dhe në pjesën e Përfundimeve dhe Rekomandimeve të punimit.

1.4.3.(2) Dënimi me para (Gjoba)

Dënimi me para për fëmijë për herë të parë është paraparë me Ligjin mbi drejtësinë e të miturve (nenet 47, 48), pra, nuk parashihej si dënim për fëmijë në KPM. Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve dënimi me para mund të shqiptohet si dënim kryesor (n.54). Për veprat e kryera nga lakmia e përfitimit, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për fëmijë ose dënimin me kusht me mbikqyrje të përforcuar. Dënimi me para shqiptohet në gjoba ditore. Numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se një as më i madh se 120 gjoba ditore. Lidhur me matjen dhe zbatimin e dënimit me para në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Kodit penal.

Dënimin e papaguar me para gjykata mund ta zëvendësojë me masën alternative Punë me dobi të përgjithshme. Një gjobë ditore zëvendësohet me tri orë pune me interes të

përgjithshëm, me ç'rast numri i përgjithshëm i orëve të punës punë me dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më i madh se 100 orë. Dënimin e papaguar me para ose punën me dobi të përgjithshme të pakryer ose pjesërisht të kryer si zëvendësim të saj, gjykata mund ta zëvendësojë edhe me masën Dërgim në qendrën për fëmijë, ose me masën Mbikëqyrje e përforcuar (LDM, n.55).

1.4.3.(3) Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi

Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve, dënimet **ndalim i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar** dhe **dëbimi i të huajit nga vendi** (n.56) mund të shqiptohen si dënime kryesore ose si dënime dytësore së bashku me dënimin me para. Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të llojit ose kategorisë të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi shqiptohen me kushte për shqiptimin e tyre të parapara në Kodin penal.

Shqiptimi i dënimeve dhe masave edukuese për veprime të parapara me ligj si vepra penale recidive (n.58): Për veprime të parapara me ligj si vepër penale recidive gjykata i shqipton fëmiut vetëm një masë edukuese ose vetëm dënim me burg për fëmijë ose dënim me para, kur ekzistojnë kushte ligjore për shqiptim të atij dënimi dhe kur gjykata konstaton se duhet të shqiptohet. Gjykata do të veprojë si më lartë, edhe kur pas shqiptimit të masës edukuese, ose burgut për fëmijë ose dënimit me para do të konstatojë se fëmiu para ose pas shqiptimit të tyre ka kryer ndonjë veprim që me ligj është paraparë si vepër penale. Nëse fëmiu mbi moshën 16 vjet ka kryer më shumë veprime që me ligj janë paraparë si vepër penale recidive, kurse gjykata konstaton se për ç'do veprim në veçanti duhet të shqiptohet dënim me burg për fëmijë ose dënim me para, dënimin do ta caktojë me vlerësim të lirë në suaza të masës së tij më të madhe ligjore. Poashtu gjykata do të veprojë njejtë sikur në rastin e lartëpërmendur, në rast se pas dënimit të shqiptuar konstaton se fëmija para ose pas shqiptimit të tij ka kryer ndonjë veprim që me ligj është paraparë si vepër penale. Nëse në kohëzgjatjen e masës edukuese gjykata shqipton dënim me burg për fëmijë, masa edukuese pushon me fillimin e vuajtjes së këtij dënimi.

Nëse në kohëzgjatjen e masës edukuese gjykata i shqipton personit të moshës së re madhore dënim me burg për fëmijë ose burg prej së paku një viti, masa edukuese pushon me fillimin e

vuajtjes së dënimit. Pas vuajtjes së dënimit më së voni në afat prej 30 ditësh, gjykata në mënyrë plotësuese do të vendosë nëse do të vazhdojë realizimi i masës edukuese (LDM, n.59).

1.4.4 Masat alternative

1.4.4.1. Llojet dhe qëllimi i masave alternative

Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve (n.60), fëmiut me përgjegjësi penale mbi moshën 16 vjet për veprim të kryer që me ligj parashihet si vepër penale, mund t'i shqiptohen masat alternative si në vijim:

- ***Dënim me kusht me mbikëqyrje të përforcuar,***
- ***Ndërprerje me kusht të mbajtjes së procedurës ndaj fëmiut dhe***
- ***Punë me dobi të përgjithshme***.

Dispozitat e Kodit penal për masa alternative vlejnë edhe me shqiptimin e tyre ndaj fëmijëve mbi moshën 16 vjet, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Qëllimi i masave alternative është që për përgjegjësi penale ndaj fëmiut mbi moshën 16 vjet të mos zbatohet dënimi kur kjo nuk është e detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritet se paralajmërimi me kërcënim të dënimit dhe zbatimi i masave të ndihmës, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikojë në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij (n.61).

Kushtet e veçanta për shqiptimin e masave alternative (n. 62):

- Masat alternative gjykata mund t'i shqiptojë vetëm kur ekziston vullnet i lirë i shprehur dhe i prerë i fëmiut, në procedurë në të cilën respektohen të drejtat e tij;
- Dënimi me kusht me mbikëqyrjen e përforcuar mund të shqiptohet kur fëmiut i është caktuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej tre vitesh ose dënim me para;
- Nëse fëmijës i është caktuar edhe dënimi me burg për fëmijë dhe dënim me para, gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht për të dyja dënimet ose vetëm për dënimin me burg për fëmijë;
- Kohën e kontrollit gjykata e cakton në kohëzgjatje që nuk mund të jetë më e shkurtër se një as më gjatë se tre vite;

- Mbikëqyrja e përforcuar përmbahet në një ose më shumë obligime të parapara në nenin 44 të këtij ligji në të cilat fëmija është i obliguar të përmbahet gjatë kohës së kontrollit;
- Ndihmë dhe përkujdesje, mbikëqyrje dhe mbrojtje në plotësimin e obligimeve nga ana e fëmijës kryen qendra, e cila është e obliguar që me këshillat praktike ta nxisin dhe t'i ndihmojnë në plotësimin e tyre, të bashkëpunojë me prindin/ët, ose tutorin/ët dhe herë pas here e së paku një herë në tre muaj, ta njoftojë gjykatën për gjendjet me plotësimin e obligimeve të caktuara;

Gjykata do ta revokojë dënimin me kusht me mbikëqyrje të përforcuar, nëse fëmiu në kohën e kontrollit nuk i plotëson obligimet e përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose kryen një ose më shumë veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë se tre vite, ose nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur konstaton se fëmiu ka kryer veprim që me ligj është paraparë si vepër penale para se të shqiptohet dënimi me kusht me mbikëqyrje të përforcuar dhe se është i domosdoshëm dënimi për veprime të kryera paraprakisht që me ligj janë paraparë si vepra penale.

1.4.4.1 (a) Ndërprerja me kusht e procedurës penale (n.63) - Gjykata mund të vendosë që ***me kusht ta ndërpresë procedurën*** ndaj fëmiut mbi moshën 16 vjet për vepër që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në pesë vite, nëse fëmiu ka shprehur pendim për veprën e kryer, nëse i ka evituar pasojat e veprës, nëse e ka kompensuar dëmin ose janë pajtuar me të dëmtuarin, i cili pajtohet me ndërprerjen e procedurës, me kusht që në afat prej dy vitesh fëmiu të mos kryejë veprim tjetër që me ligj është paraparë si vepër penale.

1.4.4.2 (b) Puna në dobi të përgjithshme (n.64) **-** Gjykata mundet fëmiut me përgjegjësi penale në moshën mbi 16 vjet i cili ka kryer veprim që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është caktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite, t'i shqiptojë masa të punës me dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 5 deri në 100 orë kur është e nevojshme që me këtë masë të kryejë ndikim edukues mbi personalitetin dhe sjelljen e fëmiut. Mbikqyrje mbi plotësimin e detyrave punuese të fëmiut kryen qendra e cila është e

obliguar që herë pas here e së paku një herë në muaj, ta njoftojë gjykatën për zbatimin e masës. Nëse fëmiu nuk i plotëson ose jorregullisht i plotëson obligimet e dhëna të punës, gjykata do ta zëvendësojë këtë masë me masën Dërgim në qendrën për fëmijë ose me masën e mbikëqyrjes së përforcuar, nën kushtet e parapara për shqiptimin e tyre, duke e marrë parasysh pjesën e obligimeve që tanimë janë plotësuar.

Këto dy masa alternative janë të paramenduara si sanksione të mesme mes masave disiplinore dhe masave edukuese të entit dhe kanë për qëllim ikjen nga zbatimi i masave të entit të cilat përbëhen me heqje lirie (Kambovski, 2007, f. 613). Për shqiptimin e tyre është me rëndësi vlerësimi se vetë paralajmërimi ose me masat e ndihmës dhe mbikqyrjes në liri mund të realizohet qëllimi ri(edukues) i sanksioneve për të mitur (Kambovski, 2007, f. 614). Sipas Prof. Kambovski, nuk do të kishin asnjëfarë kuptimi sanksionet e tilla t'i shqiptohen fëmiut i cili nuk ka qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprës së tij, sepse efektet e tij janë llogaritur në ndikimin edukues nëpërmjet forcimit të përgjegjësisë së tij personale (Kambovski, 2007).

1.4.5. Masat siguruese

Sipas Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, nën kushtet e përcaktuara me Kodin penal ndaj fëmiut të gjukuar me masën edukuese ose dënimin me burg për fëmijë mund të shqiptohet masa e sigurisë(n.65). Ndaj fëmiut të papërgjegjshëm nën kushtet e përcaktuara me Kodin penal mund të shqiptohen këto masa siguruese:

1.4.5(1)Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor;

1.4.5(2) Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri.

1.4.5(3) Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve nga Kodi penal, si masë e mjekimit të detyrueshëm të fëmiut nga varshmëritë, mund të shqiptohet dhe pa shqiptim e masës edukuese ose dënimit. Kur masa *Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve* shqiptohet me masën edukuese ose dënimin, ajo zbatohet në seksion të specializuar të institucionit. Koha e kaluar në institucion për zbatimin e masës së sigurisë llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg për fëmijë ose masës së entit. Pas zbatimit të masës së sigurisë, gjykata do të vendosë nëse do të vazhdojë realizimi i dënimit me burg për fëmijë apo masa e entit.

1.5. Sanksionet kundërvajtëse për fëmijë

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve përcakton edhe sanksionet për fëmijë për veprime që me ligj janë paraparë si kundërvajtje, në kapitullin e tetë:

- Fëmiut të moshës prej **14 deri në 16 vjet** për veprim që me ligj është paraparë si kundërvajtje mund t'i shqiptohen:
  - ***Masa qortim ose***
  - ***Masa mbikqyrje e përforcuara nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve ose***
  - ***Masa të mbikqyrjes së përforcuar nga qendra.***

Tek masat edukuese të shqiptuara për veprime që me ligj janë paraparë si kundërvajtje, zbatohen dispozitat për masat edukuese nga Ligji mbi drejtësinë për fëmijë. Masa e mbikëqyrjes së përforcuar nuk mund t'i shqiptohet në kohëzgjatje më të shkurtër se 30 ditë as më të gjatë se një vit, kurse me mbikëqyrje të përforcuar gjykata mund të caktojë mjekim të detyrueshëm nga varshmëritë dhe obligime tjera të parapara në nenet 44 dhe 65 paragrafi (3) të LDF.

- Fëmiut **mbi moshën 16 vjet**, për veprim që me ligj është paraparë si kundërvajtje, mund t'i shqiptohen ndonjëra nga masat edukuese që iu shqiptohen fëmijëve të moshës 14-vjeçare, e me përjashtim fëmiut me përgjegjësi kundërvajtëse mbi moshën 16 vjet **gjobë** dhe **dëbim i të huajit nga vendi** (n.65).

- **Gjoba (n. 67):** Fëmiut mbi moshën 16 vjet, me përjashtim mund t'i shqiptohet gjobë për vepër që me ligj është paraparë si kundërvajtje nën kushtet e përcaktuara në Ligjin për kundërvajtje. Gjoba për veprim që me ligj është paraparë si kundërvajtje, shqiptohet në shumë të caktuar që nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë as më e madhe se 800 euro në kundërvlerë me denarë. Për veprime që me ligj janë paraparë si kundërvajtje të kryera nga lakmia për përfitim, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në shumë të dyfishtë ose në përpjesëtim me dobinë e përfituar, por më së shumti deri në shumë të dhjetëfishtë të gjobës së përcaktuar të lartëpërmendur (15-800 euro). Nëse fëmiu nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata mund ta zëvendësojë me punë me dobi të përgjithshme, në mënyrë që shuma prej 15 eurosh në kundërvlerë me denarë do të zëvendësohet me tri orë pune me dobi të përgjithshme, por numri i përgjithshëm i orëve të punës me dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë 40 orë, ose të shqiptojë masë

edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar.

Si sanksion dytësor, së bashku me gjobën, gjykata mund t'i shqiptojë fëmiut që është i huaj edhe dëbim nga shteti, nën kushtet për shqiptimin e këtij sanksioni të përcaktuar me Ligjin për kundërvajtje.

Fëmiut që për veprimin e kryer që me ligj është paraparë si kundërvajtje i është shqiptuar masë edukuese ose gjobë, mund t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje ***mjekim i detyrueshëm nga varshmëritë*** me kushtet e parapara në Ligjin për kundërvajtje (n.68, p.1).

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve në kapitullin e nëntë të titulluar "***Shqiptimi i sanksionit personave të moshës madhore për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale që i kanë kryer si fëmijë***" përcakton rastet kur gjykata mundet t'i shqiptojë masë edukuese personit madhor për vepra penale që i ka kryer si fëmijë (n.69):

- Personi në moshën madhore që i ka mbushur 21 vjet nuk mund të gjykohet për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale që e ka kryer si fëmijë në moshë prej 14 deri në 16 vjet.
- Personi i moshës madhore i cili në kohën e gjykimit nuk i ka mbushur 21 vjet mund të gjykohet vetëm për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale që i ka kryer si fëmijë në moshën prej 14 deri në 16 vjet për të cilat është caktuar dënim më i rëndë se pesë vjet. Personit të këtillë, gjykata mund t'i shqiptojë masë përkatëse të mbikëqyrjes së përforcuar ose masë edukuese të entit. Gjatë vlerësimit nëse do ta shqiptojë këtë masë, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e në veçanti peshën e veprës së kryer, kohën që ka kaluar nga kryerja e saj, sjelljen e kryerësit dhe qëllimin e kësaj mase edukuese.
- Personit të moshës madhore për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale që e ka kryer si fëmijë mbi moshën 16 vjet, mund t'i shqiptohet masë përkatëse e mbikëqyrjes së përforcuar ose masa edukuese e entit, dënimi ose masa alternative. Gjatë vlerësimit nëse edhe cila nga këto sanksione do të shqiptohet, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e në veçanti peshën e veprës së kryer, kohën që ka kaluar nga kryerja e saj, sjelljen e kryerësit, si dhe qëllimin që duhet të arrihet me këto sanksione. Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, personit të moshës madhore që në kohën e gjykimit i ka mbushur 21 vjet, gjykata mundet në vend të burgut për fëmijë, t'i shqiptojë burgim ose dënim me kusht. Dënimi me burg i shqiptuar në këtë rast lidhur me rehabilitimin, shlyerjen e dënimit

dhe pasojat juridike nga dënimi, kanë veprim të njëjtë juridik si dhe dënimi me burg për fëmijë.

Ligji mbi drejtësinë për fëmijë poashtu rregullon rastet për ***shqiptimin e masave edukuese ndaj madhorëve të rinj*** (n.70): Kryerësit që si person më i ri i moshës madhore ka kryer veprim që me ligj është paraparë si vepër penale, e në kohën e gjykimit nuk i ka mbushur 21 vjet, gjykata mund t'i shqiptojë këto masa edukuese nëse duke pasur parasysh personalitetin e tij dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, mund të pritet se edhe me masën edukuese do të arrihet qëllimi që do të ishte realizuar me shqiptimin e dënimit.:

- Masë përkatëse të ***mbikëqyrjes së përforcuar*** ose
- *Masë të* ***entit***.

Personit madhor të ri të cilit i është shqiptuar masa edukuese, gjykata nën kushte të parapara me LDF, mund t'i shqiptojë edhe ***masë të sigurisë***. Masa edukuese e shqiptuar mund të zgjasë më së shumti deri në mbushjen e moshës 23 vjeçare të kryerësit. Me këtë zgjidhje ligjore jam e të njejtit mendim me Prof. Dr. Kambovski, i cili konstaton se ligji në këtë rast shkon në përmbushjen e njoftimeve të verifikuara shkencore për procedimin dhe mosbaraspeshimin e zhvillimit të personave, gjë që nuk mund të futet në proceset e vendosura ligjore – kjo sepse nuk e arrijnë pjekurinë të gjithë personat me mbushjen fikse të moshës 18 vjeçare (Kambovski, 2007, f. 615).

1.6. Efekti i sanksioneve për fëmijë, rehabilitimi dhe parashkrimi i tyre sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve

Sanksionet e shqiptuara ***ndaj personave të moshës madhore për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale që i kanë kryer si fëmijë*** dhe ***masat edukuese personave më të rinj të moshës madhore*** nuk tërheqin pasoja juridike që përbëhen në ndalimin e fitimit të të drejtave të caktuara (n.71). **Evidencë të sanksioneve të shqiptuara** fëmiut dhe personit më të ri të moshës madhore mban gjykata kompetente sipas vendlindjes (n.72, p.1). Gjykata kompetente është e obliguar që më së voni deri në ditën e pestë të muajit të dorëzojë evidencë të sanksioneve të shqiptuara për muajin paraprak, fëmiut dhe personit më të ri të moshës madhore për veprime që me ligj janë paraparë si vepër penale dhe sanksione kundërvajtëse në Gjykatën Themelore Shkupi I Shkup, që mban Regjistër unik për Republikën

e Maqedonisë. Në Regjistrin unik futen edhe të dhëna të marra nga gjykata kompetente sipas vendlindjes, për sanksione të shqiptuara për veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe sanksione kundërvajtëse për fëmijë dhe persona më të ri të moshës madhore të lindur jashtë vendit ose me vendlindje të panjohur. Të dhëna për sanksionet e shqiptuara mund t'i jepen vetëm gjykatës, prokurorit publik dhe institucioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve, lidhur me procedurën e re që udhëhiqet ndaj fëmiut ose personit më të ri të moshës madhore për veprim të kryer që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje. **Fshirja e të dhënave nga evidencat** (n.73) bëhet për masat e shqiptuara *Qortim* ose *Dërgim në qendër të fëmijëve*, masat e *Mbikëqyrjes së përforcuar* dhe *sanksionet kundërvajtëse* fshihen nga evidenca kur do të kalojë **një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre**, nëse fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen veprim të ri që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje. Të dhënat për *Dënim me kusht me mbikëqyrje të përforcuar* fshihen nga evidenca pas **një viti nga kalimi i kohës për kontroll**, nëse fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen vepër të re që është e paraparë me ligj si vepër penale. Të dhënat për masat e shqiptuara nga *enti, dënimi në para si dhe masat alternative* fshihen nga evidenca kur do të kalojë **një vit nga zbatimi ose parashkrimi i tyre**, nëse fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore në atë afat nuk kryen veprim të ri që është paraparë me ligj si vepër penale ose kundërvajtje. Të dhënat për dënimin e shqiptuar me *burg për fëmijë* fshihen nga evidenca kur do të kalojnë **pesë vite nga dita e dënimit të mbajtur, të parashkruar ose të falur**, nëse në atë afat fëmiu ose personi më i ri i moshës madhore nuk kryen vepër tjetër që me ligj është paraparë si vepër penale.

Konsederoj se Republika e Maqedonisë ka të rregulluar një sistem të sanksioneve penale për fëmijë me karakter pluralist. Diversiteti i sanksioneve penale për fëmijë të cilat parashihen me Ligjin për drejtësinë për fëmijë i'u jap hapsirë gjykatave që të përcaktojnë sanksionin e duhur në raport me nevojat e fëmiut të cilin e gjykojnë dhe kjo gjithsesi se kontribuon në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmiut. Masat edukuese si sanksione penale ekskluzivisht për fëmijët gjithmonë kanë përparësi për tu shqiptuar ndaj fëmijëve krahas dënimeve e sanksioneve të tjera. Në legjislacionin penal për fëmijë. Republika e Maqedonisë nuk ka inkorporuar ndonjë masë edukuese të re për fëmijë. Ndjekja e modeleve të vendeve të rajonit apo atyre evropjane, do të kishte efekt pozitiv në këtë aspekt, duke marrë si model ndonjë masë të re edukuese e cila do të gjente zbatueshmëri në mjedisin tonë.

KAPITULLI II

2. NORMAT DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË PENALE TË FËMIJËVE

Në këtë kapitull janë trajtuar normat dhe standardet ndërkombëtare të cilat rregullojnë drejtësinë penale për fëmijë: Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës (1989), Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Rijadit);

2.1. Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës[7]

Konventa është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 2 Dhjetor 1993[8]. Ajo është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, kurse ka hyrë në fuqi më 2 Shtator 1990.

Sipas konventës, fëmijë është ç'do qenie njerëzore që nuk i ka mbushur 18 vjet me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet (n.1). Definicioni i tillë i jep shpirt të posaçëm gjithë kompleksit të të drejtave të fëmiut dhe ka reperkusione të rëndësishme në raport me sistemin e të drejtave të të miturve (Kambovski, 2007, f. 620). Konventa para së gjithash përmban sistem të të drejtave të fëmijëve dhe e thekson interesin e tyre si primar në të gjitha aktivitetet që i ndërmarrin institucionet private dhe shtetërore, gjyqet, ose organet tjera. Shteti ka obligim për mbrojtje dhe kujdes për të miturit që është e domosdoshme për zhvillimin e tij, duke i pranuar të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe personave të tjerë që janë juridikisht përgjegjës për të miturin (Kambovski, 2007, f. 620). Shtetet anëtare të Konventës

[7] Emri origjinal i Konventës: Convention on the Rights of the Child-(CRC)

[8] http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=173&Lang=EN

angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato ç'do fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose ç'do opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo ç'do gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij (n.2). Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese (n.3). Sipas prof. Kambovski, kjo dispozitë ka karakter parimor dhe ka konsekuenca të rëndësishme në raport me modelin e të drejtës penale për të mitur. Në fushën e luftimit të krimit, prioriteti i interesit të të miturit duhet të vendoset në raport të pranimit të metodave dhe mjeteve të reaksionit të inspiruar me nevojën e ndihmës së të miturit dhe mbrojtjen e tij prej recidivizmit (Kambovski, 2007, f. 620).

Sipas Konventës, parimet më të përgjithshme për realizimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve janë: Mosdiskriminimi i fëmijëve, respektimi i interesit më të mirë të fëmijës dhe pjesëmarrja e fëmijës në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën. Këto parime udhëzuese quhen **trekëndëshi** i të drejtave të fëmijëve, nga i cili krijohet një listë e të drejtave individuale që mund të grupohen në pesë grupet themelore si në vijim:

a) Të drejtat ekonomike, që nënkupton një standard të përshtatshëm jetese, siguri sociale dhe kujdes shëndetësor;

b) Të drejtat sociale dhe kulturore, duke përfshirë kujdesin dhe edukimin e duhur;

c) të drejtat politike dhe civile në të cilat merren parasysh edhe të drejtat për lirinë e shprehjes dhe mosdiskriminimit;

d) Të drejtën e gjyqësorit për të mitur - drejtësinë për të mitur, ose të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe kur procedurat penale janë ngritur kundër tyre, si dhe ndalimin e shqiptimit të llojeve të caktuara të sanksioneve dhe

e) Të drejtat humanitare që përfshijnë të drejtat e fëmijëve në rajonet e përfshira nga konfliktet ushtarake (Golomeova, 2013, f. 47).

Të gjitha këto të drejta të definuara në mënyrë precise janë lëndë (objekt) e të drejtës familjare, mjekësore, të drejtës së punës dhe degëve tjera të së drejtës. Implementimi i tyre ka rëndësi për të drejtën penale si *ultima ratio* në raport me degët tjera të përmendura të drejtësisë (nenet 4-36 të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës). Konventa insiston në intervenim të posaçëm dhe të përforcuar penalo-juridik në raste të shkeljeve të rënda të të drejtave të fëmijës: Mbrojta e fëmijëve prej përdorimit jolegal të drogave dhe substancave psikotrope prej të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe keqpërdorimit seksual, eksploatimi i fëmijëve në prostitucion dhe pornografi, ndërprerja e marrjes me dhunë, shitja dhe tregtia e fëmijëve për çfarëdo qëllimi dhe në çfarëdo forme, mbrojtja prej të gjitha formave të eksploatimit të dëmshëm të fëmijëve (Kambovski, 2007, f. 620). Të rëndësishme për temën tone janë **obligimet** që konventa i parasheh për shtetet anëtare, si në vijim:

Shtetet Palë duhet të sigurojnë që:

(a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burigimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;

(b) Asnjë fëmije të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

(c) Ç'do fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë, që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, ç'do fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;

(d) Ç'do fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose ç'do ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin

për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për ç'do rast të tillë (n.37).

Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijët. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake. Shtetet Palë nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet Palë duhet të përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur (n.38). Shtetet anëtare marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të ç'do fëmije që është viktimë e: Ç'do forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose ç'do forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhet në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës (n.39).

Shtetet anëtare duhet t'i njohin ç'do fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (n.40, p.1). Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, shtetet duhet të kujdesen në veçanti që:

(a)Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

(b) Ç'do fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

(i) Të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose ç'do ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

(iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

(iv)Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

(v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.

(vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës (n.40, p.2).

Me thirrjen eksplicite të parimit të ligjshmërisë zgjidhet pyetja e nocionit të delikuencës së të miturve: përkundër qasjes më të gjërë sociologjike, pedagogjike të nocionit (i zbatuar p.sh. në të drejtën anglo-saksonike), ajo insiston në nocionon penalo-juridik sipas të cilit vepër penale e të miturit mund të paraqitet vetëm sjellja që para kryerjes së veprës ka qenë e ndaluar me ligjet nacionale ose ndërkombëtare (normat në konventat ndërkombëtare që kanë karakter *ius cogens*) (Kambovski, 2007, f. 621). Poashtu Konventa i obligon shtetet anëtare të përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të

posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti të: Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal; Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa i'u drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore. Të parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit (n.40,p.3).

Konventën për të drejtat e fëmijëve e kanë ratifikuar shumica e vendeve në botë, më shumë se ç'do konventë tjetër ndërkombëtare. Si përpunim apo operacionalizim të të drejtave të drejtësisë për të mitur, janë miratuar disa rregullore ndërkombëtare lidhur me gjyqësinë për të mitur, siç janë Standardet minimale ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (Rregullat e Havanës), për zbatimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe parandalimin e delikuencës së të miturve (Rregullat e Rijadit) (Golomeova, 2013, f. 47).

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e vitit 1950 gjithashtu rregullon çështjet e privimit të paligjshëm nga liria të të miturve (neni 5 paragrafi 1 pika 10), si dhe çështjet lidhur me shpalljen e aktgjykimit ndaj të miturit (neni 6 paragrafi 1). Ndër të tjera, kjo Konventë gjithashtu përcakton se: Gjithkush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë; Askush nuk mund të privohet nga liria përveç rasteve dhe procedurave në pajtim me ligjin; Ç'do kush ka të drejtë për një seancë të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme dhe përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar në përputhje me ligjin; Ç'do ksuh ka të drejtën e respektimit të privatësisë personale dhe familjare të të miturit (Golomeova, 2013, f. 48).

2.2. Rregullat Standarde Minimale të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit") [9]

Këto Rregulla janë miratuar në vitin 1985. Në parimet e përgjithshme (1.5), posaçërisht janë të theksuar se drejtësia për delikuencën e të miturve duhet kuptuar si pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit nacional të ç'do shteti dhe njëkohësisht në këtë mënyrë të kontribuojë në mbrojtjen e të rinjve dhe mbajtjen e qetësisë në rendin shoqëror. Rregullat kanë të bëjnë me fëmijët dhe personat e ri. Si shkelje është definuar ç'do sjellje që është e dënueshme me ligj, kurse si kryes i mitur – fëmijë ose person i ri për të cilin supozohet ose konstatohet se ka kryer vepër penale (2.2.). Insistimi i qasjes së unifikuar siç duket nuk mund ti tejkalojë dallimet e ndjeshme mes disa legjislaturave penale në të cilat nocioni i të miturit zgjatet prej kufirit të poshtëm prej 7-të dhe më shumë deri në kufirin e lartë (epërm) prej 18 vjet e më shumë. Përveç kësaj, zbatimi i rregullave është i zgjeruar edhe për personat madhorë të rinjë (3.3) që edhe më shumë e rëndon problemin e tërheqjes së kufijve të vjetërsisë dhe dallimet në trajtimin e kategorive të ndryshme të të miturve dhe personave madhorë të rinjë. Rregullat udhëzojnë edhe në zbatimin e principeve dhe procedurave tjera kundër të miturve kur shkas për procedurë të tillë është sjellja që nuk paraqet vepër penale në rastin kur është kryer nga të rriturit(rregullat kanë të bëjnë edhe me nocionin më të gjërë të delikuencës së të miturve në të drejtën Anglo-saksone), si dhe në trajtimin e të miturve si raste sociale (3.2). Në raport me tërheqjen e kufirit të poshtëm të moshës është e theksuar kërkesa ajo mos mund të përcaktohet shumë ulët dhe në përcaktimin e saj të merren parasyshë pjekuria emotive, mentale dhe intelektuale (4.1.) (Kambovski, 2007, f. 623)

Rregullat që kanë të bëjnë me sistemin e të drejtës penale (rregulli 5-9) si prioritet e përcaktojnë mirëqenien e të miturit dhe parimin e proporcionalitetit sipas të cilit gjithmonë duhet me siguri të konstatohet se masa e ndërmarrë kundër delikuentit të mitur do të jetë në raport me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe me gjendjen e kryerësit. Përcaktimi i qëllimeve të këtij sistemi është me rëndësi të posaçme sepse nuk është baza për konsiderata të numërta kriminalo-politike. Në këtë mënyrë decide janë theksuar parimet e

[9] Titulli original: United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)

individualietit, socializimit dhe reintegrimit të delikuentit të mitur, si dhe ndalesa për masa më të rrepta të inspiruara me qëllime tjera (preventiva gjenerale etj.) (Kambovski, 2007, f. 624). Principi i proporcionalitetit për dallim prej të rriturve nuk nënkupton dënim të merituar që i përgjigjet rëndësisë së veprës së kryer , por masa e individualizuar për të cilën rëndësia e veprës ka funksion të moskalueshmërisë së kufirit të epërm, por nën të cilën pyetje zgjidhja e masës varet ekskluzivisht nga gjendja e personalitetit të të miturit (Kambovski, 2007, f. 624). Nga ana tjetër, kjo rregull ka rëndësi të parimit udhëheqës shumë të rëndësishëm për procedurën penale, qëllimi i së cilës nuk është konstatimi i ekzistimit të veprës penale, por edhe konstatim i të gjithave rrethanave relevante për gjendjen e personit dhe zgjedhjen e masës më adekuate. Kjo më tej nënkupton autorizime më të mëdha diskrecionesh të gjyqit dhe pjesëmarrësve tjerë në të gjitha fazat e procedurës, që njëkohësisht paraqet aftësim të tyre special dhe edukim, si dhe kontroll mbi kryerjen e autorizimeve diskrecionale për shkak të ndërprerjes së keqpërdorimit të mundshëm (rregulla 6) (Kambovski, 2007, f. 624).

Në vazhdim të këtyre rregullave potencohen të drejtat procedurale të fëmijëve, si e drejta e prezumimit të pafajsisë, e drejta për informimin për arsyet e akuzës, e drejta e heshtjes, e drejta e përfaqësuesit ligjor, e drejta e pranisë së prindërve ose kujdestarit, e drejta e ballafaqimit dhe parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara dëshmitarëve dhe e drejta e ankesës deri tek gjykata më e lartë të cilat duhen të jenë të garantuara në çdo fazë të procedurës (rregulla 7). Rregull tjetër i rreferohet mbrojtjes së privatësisë së të miturit në të gjitha fazat, me qëllim të shmangjes së dëmtimit të tij nga publikimi i panevojshëm apo etiketimi. Në parim, asnjë informacion që do të shpiente në identifikimin e krerësit të ri të veprës penale, nuk duhet të publikohet (rregulla 8).

Sipas rregullit pasues proklamohet që asgjë në këto Rregulla nuk do të interpretohet si ndalesë e zbatimit të Rregullave Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe instrumentet dhe standardet e tjera të të drejtave të njeriut të njohura nga bashkësia ndërkombëtare që lidhen me kujdesin dhe mbrojtjen e të rinjve (rregulla 9). Për arrestimin e të miturit, prindërit ose kujdestari i tij / saj duhet të njoftohen menjëherë për një arrestim të tillë, e kur njoftimi i tillë nuk është i mundur, prindërit ose kujdestari duhet të njoftohen në kohën më të shkurtër të mundshme. Gjyqtari

ose zyrtari ose organi tjetër kompetent, pa vonesë, duhet të shqyrtojë çështjen e lirimit të të riut. Kontakte ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe kryesit të ri duhet të menaxhohen në mënyrë të tillë që të respektojnë statusin ligjor të të ritut, të promovojnë mirëqenien e tij dhe të shmangin dëmtimin e tij, duke pasur parasysh rrethanat e rastit (rregulla 10:1,2,3).

Rregulli pasues i rreferohet diversitetit, respektivisht drejtimit të organeve shtetërore kompentente si policia, prokuroria e të tjera, që të kenë konsideratë në ato raste me të mitur ku kushtet janë të përshtatshme, ti trajtojnë ato në procedurë joformale, pa përdorur një gjykim formal nga autoriteti kompetent. Për ç'do tërheqje që përfshin referim për shërbim përkatës duhet të kërkohet pëlqimi i të miturit, ose i prindit/ kujdestarit të tij. Për të lehtësuar zgjidhjen diskrete të rasteve të të miturve, duhet të bëhen përpjekje për të siguruar programe nga shoqëria siç janë: Mbikëqyrja dhe këshillimi i përkohshëm, kthimi në komunitet dhe kompensimi i viktimave (rregulla 11). Sipas prof. Kambovski, statuimi i parimit të oprtunitetit dhe alternativave të procedurës formale gjyqësore (medijimi, pajtimi, kompenzimi i demit, zbatimi i masave alternative, posaçërisht puna me dobi shoqërore, si dhe zbatimi i masave tjera nga ana e shërbimeve për mbrojtjen e të miturve), e vërtetuar në legjislaturat bashkëkohore, është zgjidhje për të dhënë rezultate në realizimin e qëllimeve primare të këtij sistemi; socializimi, reintegrimi, dhe pengimi (ndalimi) i recidivitetit. Por tërheqja nga procedura formale gjyqësore, e rekomanduar posaçërisht kur bëhet fjalë për kryerjen e veprave të lehta, supozon shërbime mirë të organizuara për ndihmë dhe kujdes të të miturve, si dhe gatishmërinë e familjes, shkollës dhe institucioneve tjera joformale për masa adekuate pedagogjike dhe të ngjashme. Për të përmbushur më së miri funksionet e tyre, oficerët e policisë të cilët shpesh ose ekskluzivisht merren me të mitur ose që janë të angazhuar kryesisht në parandalimin e kriminalitetit të të miturve duhet të udhëzohen dhe trajnohen në mënyrë specifike. Në qytete të mëdha, njësi speciale të policisë duhet të krijohen për këtë qëllim (rregulla 12).

Rregull tjetër i referohet masës së paraburgimit të të miturit, sipas së cilës paraburgimi në pritje të gjykimit duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për periudhën më të shkurtër të mundshme. Kurdoherë që është e mundur, paraburgimi në pritje të gjykimit duhet të zëvendësohet me masa alternative, të tilla si mbikëqyrja e ngushtë, kujdesi intensiv ose vendosja në një familje ose në një mjedis arsimor ose në shtëpi. Të miturit nën paraburgim

në pritje të gjykimit kanë të drejtë për të gjitha të drejtat dhe garancitë nga Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve të miratuara nga Kombet e Bashkuara. Të miturit nën paraburgim në pritje të gjykimit do të mbahen të ndarë nga të rriturit apo të mbahen në një institucion të veçantë ose në një pjesë të veçantë të institucionit ku qëndrojnë edhe të rriturit. Derisa gjenden në paraburgim, të miturit duhet të pranojnë kujdes, mbrojtje dhe të gjithë ndihmesën e nevojshme individuale -sociale, arsimore, profesionale, psikologjike, mjekësore dhe fizike, që ata të mund të kërkojnë në varësi të moshës, gjinisë dhe personalitetit (rregulla 13: 1-5).

Pjesa e tretë e këtyre rregullave i rreferohet procesit të gjykimit dhe vendosjes së fëmijëve, respektivisht autoriteteve kompetente për të gjykuar; Përfaqësuesit ligjor, prindërve dhe kujdestarëve; Raportet për hetimet sociale; Parimet udhëzuese gjatë gjykimit dhe vendosjes; Masat e ndryshme për trajtimin e rasteve; Përdorimi sa më i pakët i mundshëm i institucionalizimit; Shmangia e vonesave të panevojshme; Regjistrimi i të dhënave; Nevoja për profesionalizëm dhe trajnim (rregullat 14-22). Pjesa e katërt i trajton Masat joinstitucionale, respektivisht tretmanin jo-institucional të të miturve shkelës të ligjit (rregullat 23-26). Pjesa e pestë përmbanë rregulla lidhur me tretmanin institucional të të miturve delikuentë, si cilat janë qëllimet e trajtimit të institucionalizuar të të miturit; Zbatimin e këtyre Rregullave Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve miratuar nga Kombet e Bashkuara; Rregulla për kushtet e shpeshta dhe të hershme për lirim me kusht të të miturit si dhe Marrëveshjet gjysmë-institucionale (rregullat 26-29). Pjesa e fundit e këtyre Rregullave (6-të) përmbanë rregulla për hulumtimin, planifikimin, formulimin dhe vlerësimin e politikave për përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale për të miturit.

2.3. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjëve të privuar nga liria ("Rregullat e Havanës") [10]

Këto Rregulla të miratuara nga Asambleja e përgjithshme me rezolutën 45/113, më datë 14 dhjetor 1990 nisen nga parimi i zbatimit të kufizuar ekskluziv të paraburgimit dhe dënimit që kanë të bëjë me heqjen e lirisë. Në rastet e heqjes së lirisë të të miturit, poashtu parimisht zbatohen normat dhe standardet e OKB-së për veprim me persona të cilëve i'u është hequr liria. Po këto rregulla përmbajnë edhe standard të posaçme dhe të larta që duhet të përpunohen me rregullat nacionale për zbatimin e sanksioneve (Kambovski, 2007, f. 625). Sistemi i drejtësisë për të miturit duhet të mbrojë të drejtat dhe sigurinë e të miturve, si dhe mirëqënien e tyre fizike dhe mendore. Burgimi duhet përdorur si masë e fundit (rr.1). Këto Rregulla kanë për qëllim të vendosin standarde minimale të pranuara nga Kombet e Bashkuara për mbrojtjen e të miturve, të cilëve u është hequr liria në të gjitha format, në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (3). Këto Rregulla duhen zbatuar në mënyrë të paanshme, pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, gjuhës, besimit fetar, kombësisë, bindjes politike apo rasteve të tjera, besimeve apo praktikave kulturore, pronës, statusit të lindjes apo atij familjar, origjinës etnike apo shoqërore dhe aftësisë së kufizuar. Besimet fetare apo kulturore, praktikat dhe konceptet morale të të miturve duhen respektuar (4). Këto Rregulla duhet t'u jepen të gatshme personelit të drejtësisë për të mitur në gjuhën e tyre amtare. Të miturit që nuk e zotërojnë gjuhën e folur nga personeli i mjediseve të paraburgimit duhet të kenë të drejtën e shërbimeve falas të një përkthyesi kurdoherë që të jetë e nevojshme.

Qëllimi dhe zbatimi i këtyre rregullave: I mitur është ç'do person nën moshën 18 vjeç. Kufiri i moshës, nën të cilin nuk duhet lejuar heqja e lirisë një fëmije, duhet përcaktuar me ligj; Heqje lirie do të thotë çdo lloj ndalimi ose burgimi apo vendosja e një personi në një institucion publik ose privat, nga i cili ky person nuk lejohet të largohet me dëshirën e tij, me urdhër të ndonjë autoriteti gjyqësor, administrativ apo ndonjë autoriteti tjetër publik (11). Heqja e lirisë duhet të bëhet në kushte dhe rrethana që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut të të miturve (12).

[10] Titulli original: United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)

Të miturit nën arrest ose në pritje të gjykimit: Sipas këtyre rregullave të miturit që mbahen të ndaluar nën arrest apo që presin gjykimin prezumohen të pafajshëm dhe trajtohen si të tillë. Arrestimi/ndalimi para gjyqit shmanget aq sa është e mundur dhe kufizohet në rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të zbatuar masa alternative. Megjithatë, kur përdoret paraburgimi, gjykatat e të miturve dhe organet hetuese i japin përparësi më të madhe procedimit të përshpejtuar të këtyre rasteve për të siguruar kohëzgjatjen më të shkurtër të mundshme të paraburgimit. Të ndaluarit, që nuk kanë dalë akoma para gjyqit, duhet të veçohen nga të miturit të cilët janë dënimin (17).

Kushtet, në të cilat ndalohet një i mitur, duhet të jenë në përputhje këto rregulla të përcaktuara: (a) Të miturit duhet të kenë të drejtën e këshillimit ligjor dhe t'iu krijohet mundësia për të kërkuar ndihmë ligjore falas, aty ku një ndihmë e tillë është e disponueshme, si dhe të komunikimit sistematik me këshilltarët e tyre ligjorë. Jeta private dhe konfidencialiteti duhet të garantohen për një komunikim të tillë; (b) Të miturve duhet t'u sigurohen, aty ku është e mundur, mundësitë për të punuar, me shpërblim, dhe për të vazhduar shkollën ose trajnimin, por nuk u duhet vënë kusht që ta bëjnë një gjë të tillë. Puna, arsimi apo trajnimi nuk duhet të bëhen shkak për vazhdimin e ndalimit; (c) Të miturve duhet t'u jepen dhe të kenë mundësi të ruajnë materiale për kohën e tyre të lirë në përputhje me interesat e vënies të drejtësisë (18).

A. Të dhënat e gjendjes gjyqësore: Të gjithë raportet, përfshirë të dhënat ligjore, të dhënat mjekësore dhe ato të proceseve disiplinore, si dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë lidhje me formën, përmbajtjen apo hollësi të trajtimit, duhen vendosur në dosje individuale konfidenciale, të cilat duhet të rifreskohen, të mund të shihen vetëm nga persona të autorizuar dhe të klasifikohen në mënyrë të tillë që të kuptohen me lehtësi. Kurdo që është e mundur, ç'do i mitur duhet të ketë të drejtë të kontestojë ç'do fakt apo opinion, që përmban dosja e tij/saj në mënyrë që të lejohet korrigjimi i deklarimeve të pasakta, të pabazuara apo të padrejta. Për ta ushtruar këtë të drejtë, duhet të ekzistojnë procedura, që të lejojnë një palë të tretë të përshtatshme të ketë akses e të mund të shohë dosjet e kërkuara. Me lirimin e të miturve, të dhënat e tyre gjyqësore do të vulosen, dhe, në një kohë të përshtatshme, do të fshihen (19).

B. Pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi: Në ç'do vend ku mbahen të mitur, duhet të mbahen të dhëna të hollësishme, të plota dhe të sigurta të informacionit të mëposhtëm për ç'do të mitur të pranuar atje:

Informacion mbi identitetin e të miturit; Faktin dhe arsyet e angazhimit dhe autoritetin që e ka marrë atë; Ditën dhe orën e pranimit, transferimit dhe lëshimit; Hollësi për njoftimin e prindërve apo kujdestarëve për ç'do pranim, transferim apo lënie të lirë të të miturit në kujdesin e tyre në kohën e angazhimit; Hollësi për problemet e njohura fizike dhe mendore, përfshirë abuzimin me drogë apo alkool (21).

Informacioni për pranimin, vendin, transferimin dhe lënien të lirë u duhet siguruar pa vonesë prindërve dhe kujdestarëve ose njërëzve më të afërt të të miturit në fjalë (22). Sa më shpejt që të jetë e mundur pas pritjes, duhet të përgatiten raporte të plota dhe informacioni i duhur për situatën personale dhe rrethanat e ç'do të mituri dhe t'i dorëzohen administratës (23). Në momentin e pranimit, të gjithë të miturve u jepet një kopje e rregullave të ambienteve të paraburgimit dhe një përshkrim me shkrim i të drejtave dhe detyrimeve të tyre në një gjuhë që ata e kuptojnë, së bashku me adresën e autoriteteve kompetente, të cilave mund t'iu drejtohen ankesat, si dhe adresën e agjencive dhe organizatave publike ose private që japin ndihmë ligjore. Për ata të mitur, që janë analfabetë ose që nuk mund ta kuptojnë gjuhën në formularin e shkruar, informacioni u duhet transmetuar në mënyrë të tillë që të sigurohet se ata e kuptojnë plotësisht atë (24).

C. Klasifikimi dhe vendosja: Në të gjitha ambientet e paraburgimit, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit, përveç rasteve kur ata janë anëtarë të së njëjtës familje. Në kushte të kontrolluara, të miturit mund të vihen bashkë me të rritur të zgjedhur me kujdes si pjesë e një programi të veçantë që ka treguar se i'u sjell përfitime të miturve në fjalë (29). Duhet të ngrihen ambiente paraburgimi të hapura për të miturit. Ambientet e hapura të paraburgimit janë pa masa sigurie ose me masa sigurie minimale. Numri i të ndaluarve në këto ambiente paraburgimi duhet të jetë sa më i vogël që të jetë e mundur. Numri i të miturve në ambiente paraburgimi të mbyllura duhet të jetë aq i vogël, sa të mundësojë trajtimin individual. Ambientet e paraburgimit për të mitur duhet të decentralizohen dhe duhet të kenë madhësi të tillë që të lehtësojë aksesin dhe kontaktet mes të miturve dhe familjeve të tyre. Duhet të

ngrihen ambiente të vogla paraburgimi e të integrohen në mjedisin social, ekonomik dhe kulturor të shoqërisë (30).

D. Mjedisi fizik dhe sistemimi: Të miturit, të cilëve u është hequr liria, kanë të drejtën e lehtësirave dhe shërbimeve që plotësojnë të gjitha kërkesat e dinjitetit shëndetësor dhe njerëzor (31). Normalisht, vendet e fjetjes duhet të përbëhen nga fjetina për grupe të vogla ose dhoma individuale, duke pasur parasysh standardet vendase. Gjatë orëve të gjumit, e të gjitha zonat e fjetjes, përfshirë dhomat individuale dhe fjetinat e grupeve/kolektive duhet të mbikqyren sistematikisht, pa shkaktuar bezdi, për të siguruar sigurinë e ç'do të mituri (33). Instalimet sanitare duhet të vendosen në vende të tilla dhe të jenë të standardeve të mjaftueshme për t'i mundësuar ç'do të mituri të përmbushë, siç kërkohet, nevojat e veta fizike në intimitet dhe në një mënyrë të pastër dhe të hijshme (34). Zotërimi i sendeve personale është një element bazë i të drejtës për intimitet dhe thelbësor për mirëqënien psikologjike të të miturit (35). Brenda mundësive, të miturit duhet të kenë të drejtë të veshin rrobat e veta. Ambientet e paraburgimit duhet të sigurojnë që ç'do i mitur të ketë veshje personale të përshtatshme për klimën dhe të mjaftueshme për të siguruar shëndet të mirë, dhe që në asnjë mënyrë të mos jenë degraduese apo poshtëruese. Të miturit që hiqen ose largohen nga një ambient paraburgimi për çfarëdo lloj qëllimi, duhet të lejohen të veshin rrobat e veta (36). Ç'do ambient paraburgimi duhet të garantojë që ç'do i mitur të marrë ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme dhe të paraqitur në vaktet normale të ushqimit (37).

E. Arsimimi, trajnimi profesional dhe puna: Çdo i mitur në moshën e shkollës së detyrueshme ka të drejtën e arsimimit të përshtatur me nevojat dhe aftësitë e tij / saj dhe të planifikuar në mënyrë të tillë që ta përgatisë atë për t'u kthyer në shoqëri. Ky arsimim duhet siguruar jashtë ambienteve të paraburgimit, në shkollat e komunitetit, kudo që të jetë e mundur dhe në ç'do rast, nga mësues të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendit, në mënyrë që pas daljes në liri, të miturit të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre pa vështirësi (38). Të miturit mbi moshën e shkollës së detyrueshme, që dëshirojnë të vazhdojnë arsimimin e tyre duhet të lejohen e të inkurajohen që të veprojnë kështu, dhe duhet bërë ç'do përpjekje për tu dhënë atyre mundësi për të ndjekur programe të përshtatshme arsimore (39). Diplomat apo çertifikatat arsimore (dëftesat shkollore) që i'u

jepen të miturve gjatë kohës që ata janë në paraburgim nuk duhet të përmendin/tregojnë në asnjë lloj mënyre se i mituri ka qënë i institucionalizuar(40). Ç'do ambient paraburgimi duhet të sigurojë mundësi hyrjeje/akses në një bibliotekë të pajisur mjaftueshëm si me libra udhëzues ashtu edhe rikrijues të përshtatshëm për të mitur, që duhen inkurajuar dhe mundësuar që t'i përdorin plotësisht ato(41). Ç'do i mitur duhet të ketë të drejtën e trajnimit profesional në profesione/zanate që kanë mundësi ta përgatisin atë për punësim të ardhshëm (42). Kudo që është e mundur, të miturve u duhet dhënë mundësia që të punojnë me pagesë, nëse është e mundur brenda komunitetit vendas, si një plotësim për trajnimin profesional që u sigurohet, me qëllim që të rritet mundësia që të gjejnë punësim të përshtatshëm kur të kthehen në komunitetet e tyre (45). Ç'do i mitur që bën një punë duhet të ketë të drejtën e një shpërbimi/pagese të drejtë. Interesat e të miturve dhe ato të trajnimit të tyre profesional nuk duhet t'i shërbejnë qëllimit të përfitimit për ambientet e paraburgimit apo për një palë të tretë (46).

F. Aktivitetet zbavitëse: Ç'do i mitur ka të drejtën e një sasie të përshtatshme kohe për ushtrime të lira të përditshme në mjedis të hapur, kurdo që e lejon moti, gjatë së cilës duhet siguruar normalisht trajnim i përshtatshëm zbavitës dhe fizik (47).

G. Feja: Ç'do i mitur duhet të lejohet të përmbushë nevojat e jetës së vet fetare dhe shpirtërore, në veçanti duke ndjekur shërbesat apo takimet e siguruara në mjediset ku mbahet i ndaluar ose duke kryer vetë shërbesat fetare, si dhe të zotërojë librat e nevojshëm ose artikuj në lidhje me praktikimin e riteve fetare dhe udhëzimet për përkatësinë fetare të tij. Nëse një mjedis paraburgimi ka një numër të mjaftueshëm të miturish të një feje të caktuar, një ose më shumë përfaqësues të asaj feje duhet të caktohen ose miratohen dhe të lejohen të kryejnë shërbesa rregullisht, si dhe të kushtojnë vizita pastorale vetëm për vetëm me të miturit me kërkesë të tyre. Ç'do i mitur duhet të ketë të drejtën të presë vizita nga një përfaqësues i kualifikuar i një feje sipas zgjedhjes së tij, si dhe të drejtën të mos marrë pjesë në shërbesa fetare dhe të heqë dorë lirisht nga edukimi, këshillimi, apo indoktrinimi fetar (48).

H. Kujdesi shëndetësor: Ç'do i mitur duhet të marrë kujdes të mjaftueshëm shëndetësor, si parandalues ashtu edhe kurues, duke përfshirë, kujdes shëndetësor dentar, kujdes

oftalmologjik të syve, mendor, si dhe produkte farmaceutike dhe dieta speciale sipas përshkrimit të mjekut (49).

I. Njoftimi për sëmundje, dëmtim, dhe vdekje: Familja ose kujdestari i një të mituri, si dhe ndonjë person tjetër i përcaktuar nga i mituri, kanë të drejtën të informohen mbi gjendjen e shëndetit të të miturit me kërkesën e tij dhe në rast ndryshimesh të rëndësishme të shëndetit të të miturit. Drejtori i qendrës ku mbahen të ndaluar të miturit duhet të njoftojë menjëherë familjen ose kujdestarin e të miturit në fjalë, ose ndonjë person tjetër të përcaktuar në rast të vdekjes, sëmundjes, që kërkon transferim të të miturit në një mjedis mjekësor të jashtëm, ose të një gjendjeje që kërkon kujdes klinik brenda mjediseve ku mbahet i ndaluar për më shumë se 48 orë. Gjithashtu, duhen njoftuar autoritetet konsullore të shtetit, shtetas i të cilit është i mituri i huaj (56).

J. *Kontakte me një komunitet më të gjerë*: Duhet siguruar ç'do mënyrë e mjet për të siguruar komunikim të mjaftueshëm të të miturit me botën e jashtme, që është pjesë integrale e të drejtës për trajtim të drejtë dhe human dhe është thelbësore në përgatitjen e të miturve për rikthimin e tyre në shoqëri. Të miturit duhet të lejohen të komunikojnë me familjen, miqtë e tyre dhe persona të tjerë ose përfaqësues të organizatave të tjera të jashtme me emër/reputacion të mirë, të lënë mjediset e kryerjes së dënimit për një vizitë pranë shtëpisë dhe familjes dhe të marrin leje të lënë vendin ku mbahen të ndaluar për arsimim, formim profesional ose arsye të tjera të rëndësishme. Koha e kaluar jashtë mjedisit ku mbahet i ndaluar duhet të llogaritet si periudhë e dënimit (59). Ç'do i mitur duhet të ketë të drejtën të komunikojë me shkrim ose me telefon të paktën dy herë në javë me një person sipas zgjedhjes së tij, përveç se kur është i kufizuar ligjërisht, dhe duhet të asistohet sipas nevojës me qëllim që të gëzojë të drejtën e tij në mënyrë efektive. Ç'do i mitur duhet të ketë të drejtën për letërkëmbim (61). Të miturit duhet të kenë mundësinë të informohen rregullisht në lidhje me të rejat duke lexuar gazetat, botimet periodike dhe botime të tjera, me anë të aksesit në programe radio-televizive dhe filmave, dhe nëpërmjet vizitave të përfaqësuesve të klubeve të ndryshme dhe organizatave të ligjshme në të cilat i mituri është i interesuar (62).

K. Kufizime të shtrëngimit fizik dhe përdorimit të forcës: Instrumentet e shtrëngimit dhe detyrimit mund të përdoren vetëm në raste përjashtimore/të jashtëzakonshme, ku të gjitha metodat e tjera të kontrollit janë përdorur dhe kanë dështuar, dhe vetëm sipas autorizimit të qartë dhe specifik nga ligji dhe rregullorja (64). Mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli duhet ndaluar në ç'do mjedis, ku mbahen të ndaluar të mitur (65).

L. Proceset disiplinore: Të gjitha masat disiplinore që përmbajnë trajtim mizor, çnjerëzor, apo degradues duhet të ndalohen rreptësisht, duke përfshirë ndëshkimin fizik, vendosjen në një qeli të errët, kufizimin me mbyllje ose në vetmi, apo ndonjë ndëshkim që mund të kompromentojë shëndetin fizik apo mendor të të miturit në fjalë. Reduktimi i dietës dhe kufizimi ose mohimi i kontaktit me pjesëtarë të familjes duhet të ndalohet për çfarëdo lloj qëllimi. Puna duhet të shihet gjithmonë si mjet edukimi dhe promovimi i respektit për veten nga ana e të miturit në përgatitjen e tij për rikthim në komunitet dhe nuk duhet të imponohet si një masë disiplinore. Ndaj asnjë të mituri nuk duhen marrë masa më shumë se një herë për të njëjtën shkelje disiplinore. Masat kolektive duhen ndaluar (67). Pjesë tjera të fundit të këtyre Rregullave trajtojnë çështjet lidhur me *Inspektimin e ankimimeve; Rikthimin e fëmiut në komunitet; Personeli i institucionit penitensiar ku fëmiu e vuan dënimin me heqje lirie, respektivisht masën e paraburgimit.*

2.4. Rregullat e OKB-së për preventivë të delikuencës së të miturve ("Rregullat e Riadit")[11]

Rregullat e OKB-së për preventive të delikuencës së të miturve janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1990. Rregullat e Riadit e mbulojnë fazën para-konfliktuoze dhe përmbajnë strandarde dhe masa për mbrojtjen e të miturve në situate të rrezikut social, që përbëhen në modalitete të preventivës së hershme dhe intervenimit mbrojtës drejtuar kah familja, shkollimi, bashkësia dhe mjetet e informimit publik. Rregullat përmbajnë standard për pengim të delikuencës së të miturve që kanë funksion të ndihmës, vendeve anëtare në formulimin dhe zbatimin e programeve speciale dhe politike, me theks të ndihmës, kujdesit dhe kyçjes në bashkësi (Kambovski, 2007, f. 625).

[11] Titulli original: UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Deliquency (Riyadh Guidelines)

Të gjitha Rregullat ndërkombëtare të përpunuara më lartë në këtë kapitull, duhet të jenë synimi kryesor i organeve përkatëse kompetente të vendit tonë të cilat punojnë në sferën e drejtësisë për fëmijë me qëllim të implementimit maksimal të tyre. Maqedonia në këtë aspekt ka punuar dhe me sjelljen e Ligjit për drejtësinë e të miturve në vitin 2007, dhe Ligjit për drejtësinë e fëmijëve në vitin 2013, me ç'rast u bënë reforma në sistemin e drejtësisë penale për fëmijë në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijës. Konventa përcakton se drejtësia penale për fëmijë duhet të unifikohet me ligj të veçantë. Poashtu vendi ynë është para shteteve fqinje apo atyre të rajonit, nëse shohim obligimin tjetër për shtetet palë të Konventës rreth termit "fëmijë" për personat deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Të gjitha shtetet fqinje ende e përdorin në legjislacionin e tyre penal termin "i mitur" për personat e moshës 14-18 vjeçare, kurse termin "fëmijë" për ato nën moshën 14 vjeçare. Gjithashtu obligimi që rrjedh nga Konventa lidhur me përcaktimin e kufirit të moshës minimale dhe maksimale është respektuar nga vendi ynë.

Sa i'u përket Rregullave të OKB-së për preventivë të delikuencës së të miturve ("Rregullave të Riadit"), është bërë një përparim i madh në drejtim të tretmanit të fëmijëve në rrezik duke e përcaktuar procedurën e masave të ndihmës dhe mbrojtjes, të rregulluar me LDF, me ç'ka për herë të parë janë jetësuar në praktikë këto Rregulla (Buzharovska G.,Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, f.198). Vlenë të theksojmë se reforma në fjalë për të parën herë u soll me Ligjin për drejtësinë e të miturve, ku kjo procedurë rregullohej me nenet 18-26 në pjesën "Veprimi me fëmijë dhe të mitur në rrezik". LDF vetëm e ka vazhduar jetësimin e kësaj reforme të rëndësishme për drejtësinë penale për fëmijë në Republikën e Maqedonisë. Ngecja e Republikës së Maqedonisë qëndron tek kushtet që i'u ofrohen fëmijëve gjatë zbatimit të sanksioneve penale që kanë për pasojë privimin e tyre nga liria, siç janë masat e enteve dhe dënimi me burg për fëmijë. Në këtë aspekt nuk ofrohen kushte të mjaftueshme që fëmijët të përmirësohen dhe që ndaj tyre të arrihet efekti i duhur i sanksioneve penale, p.sh. nuk mundësohet ndjekja e rregullt e procesit arsimor për fëmijët e privuar nga liria. Duhet të punohet më tepër në zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar, respektivisht në zbatimin e Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria dhe Rregullave Standarde Minimale të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur.

KAPITULLI III

3. QASJE KRAHASIMORE NDAJ DREJTËSISË PENALE PËR FËMIJË TË DISA VENDEVE TË RAJONIT DHE ATYRE EVROPJANE

Në këtë kapitull janë paraqitur dhe analizuar legjislacionet penale për fëmijë të disa shteteve, me qëllim të njoftimit me sistemet e tyre të drejtësisë penale. Me këtë rast, janë përzgjedhur dy shtetet fqinje- Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, nga shtetet e rajonit – Republika e Kroacisë, nga shtetet evropjane - Zvicra dhe Holanda, një shtet skandinavik - Norvegjia si dhe një shtet me sistem anglo-saksion të së drejtës- Anglia. Qëllimi i përpunimit të legjislacioneve penale të cilat rregullojnë drejtësinë për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, është të nxirren në pah modele të tjera të drejtësisë penale për fëmijë, të ndryshme nga ajo e vendit tonë. Poashtu të vërehen pikat e përbashkëta, respektivisht të ngjashme dhe ato të ndryshme mes legjislacioneve të hulumtuara dhe atij të vendit tonë. Meqenëse legjislacioni i Republikës së Maqedonisë u trajtua hollësisht në kapitullin e parë të punimit, më poshtë janë paraqitur legjislacionet e huaja penale për fëmijë.

Mosha minimale e përgjegjësisë penale, mosha minimale për shqiptimin e dënimit me burg dhe mosha e arritjes së pjekurisë sipas shtetit përkatës

SHTETI	Minimumi i moshës për përgjegjësi penale (MIPP)	Mosha min. për shqiptimin e burgut	Arritja e moshës madhore
Maqedonia	**14**	**16**	**18**
Shqipëria	**14**	**16**	**18**
Kosova	**14**	**16**	**18**
Kroacia	**14**	**16**	**18**
Zvicra	**10**	**15**	**18**
Holanda	**12**	**16**	**18**
Norvegjia	**15**	**15**	**18**
Anglia dhe Welsi	**10**	**12/15**	**18**

Tabela1: Qasje krahasimore mes shteteve të përzgjedhura për hulumtim, sa i përket këtyre elementeve: Minimumi i moshës për përgjegjësi penale; Mosha minimale për shqiptimin e dënimit me burg dhe arritja e moshës madhore.

3.1. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Shqipërisë

Momentet më të rëndësishme të cilat përbëjnë pikënisjen e reformave të drejtësisë për të mitur në Republikën e Shqipërisë janë dy. Ato janë miratimi i dipozitave kushtetuese dhe paketës mbi liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve dhe ratifikimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989 nga data 27 shkurt 1992 dhe Protokolin shtesë të saj më 18 janar 2002 lidhur me Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë e fëmijëve. Drejtimet kryesore të reformave kanë qenë krijimi i kornizës ligjore dhe praktikave proceduriale në përputhje me standardet nërkombëtare, përmirësimi i infrastrukturës për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajnimi i profesionistëve që lidhen me sistemin e drejtësisë për të mitur (SUFAJ, 2011, f. 66). Krahas zbatimit të shumë reformave në drejtësi, si miratimi i disa ligjeve që kompletonin kornizën ligjore të sistemit të drejtësisë për të mitur (Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale, Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, Ligjet për policinë e shtetit, policinë e burgjeve dhe një sërë aktesh nënligjore) Republika e Shqipërisë në krahasim me Republikën e Maqedonisë si duket kishte ngelur pas në aspekt të krijimit të një sistemi të veçantë të drejtësisë për të mitur. Kjo pasi që deri në vitin 2017 në Shqipëri çështjet që kishin të bëjnë me drejtësinë penale për fëmijë, nga e drejta materiale, procedurale dhe ajo mbi ekzekutimin e sanksioneve penale rregulloheshin me ligje të veçanta, si Kodi penal, Kodi i procedurës penale etj, pra mungonte një ligj i vetëm i cili do ta kishte grumbulluar tërë këtë materie në një ligj të vetëm!

Poashtu nga hapat për përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të mitur në Republikën e Shqipërisë, vlenë të përmenden:

- Stategjitë pesë vjeçare si: Strategjia për Fëmijët dhe Plani i veprimit për periudha pesëvjeçare duke filluar nga viti 2001 e këndej; Strategjia Kombëtare për Rininë nga viti 2007 e këndej, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Punës për Luftën kundër Trafikut të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve viktima të trafikut.
- Janë krijuar seksione të gjykatave për të mitur në gjashtë rrethe gjyqësore, ku janë vendosur edhe gjykatat e apelit.

- Sistemi i paraburgimit ka kaluar nën përgjegjësinë dhe administrimin e Ministrisë së Drejtësisë që nga viti 2007.
- Është ndërtuar një institucion modern për të miturit në Kavajë, i cili i plotëson të gjitha parametrat e sigurisë dhe të riintegrimit të të miturve.
- Poashtu janë ndërtuar pesë institucione të reja për ekzekutimin e vendimeve penale sipas standardeve ndërkombëtare.
- Janë krijuar seksione për të miturit në prokuroritë e rretheve gjyqësore, të policisë së shtetit.
- Zhvillohet trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të institucioneve për të mitur.

Një tjetër risi e sitemit të drejtësisë për fëmijë është edhe ngritja e Shërbimit të Provës, e cila ka mundësuar zbatimin e dënimeve alternative duke shmangur dënimin me burg (SUFAJ, 2011, f. 67). Ndonëse, UNICEF shpreh shqetësimin se ky shërbim i provës nuk ofrohet njësoj për të miturit në të gjithë vendin dhe është pak i financuar dhe varet së tepërmi nga mbështetja e donatorëve (https://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.html).

Edhe pse në Shqipëri është bërë progres në fushën e administrimit të drejtësisë për të miturit për ta bërë sistemin sa më njerëzor duke ofruar garanci ligjore dhe proceduriale, dhe duke kaluar nga një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe ri-integron fëmijët përmes masave të ndryshme si, pajtimi midis viktimës dhe shkelësit të ligjit, praktikave dëmshpërblyese dhe dënimet alternative për të miturit që janë zbatuar së fundmi, të cilat kanë kontribuar në alternativa ndaj masës me burg për të miturit që kanë shkelur ligjin, hasen edhe disa mangësi në zbatimin e plotë të tyre të praktikë.

Kësisoj, sipas UNICEF situata në rajonet e policisë është shqetësuese. Ka akoma raste kur të miturit mbahen në të njëjtën qeli me të rriturit. Ashtu siç raportohet në Raportin e fundit mbi parandalimin e Torturës së Komitetit Evropjan, trajtimi i tyre nuk përputhet me standardet ndërkombëtare. Në burgim, fëmijët nuk marrin shërbimet e duhura. Ka vetëm 5 qendra paraburgimi për të miturit (në Tiranë, Vlorë, Korçë, Lezhë dhe Kavajë), dhe një institucion për integrimin e të miturve në Kavajë ku gjenden të mitur të dënuar. Ky institut, i ndërtuar nga BE dhe mbështetur nga UNICEF, “Save the Children”, dhe OJQ-të vendore, ofron një

model për trajtimin e të miturve të dënuar. Të dënuarve u ofrohen aktivitete edukuese, trajnuese, ndërmjetësimi, asistencë ligjore falas, dhe aktivitete ri-integruese. (https://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.html)

- **Kodi i drejtësisë penale për të mitur i Republikës së Shqipërisë**

Si rezultat i kërkesave ndaj Shqipërisë për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, (si vend kandidat për antarësim në BE), si dhe nga fryma e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare si Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët UNICEF, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe Bashkimi Europian të cilët mbështetnin fortë hartimin e një kodi drejtësie për të miturit, më 30.03.2017 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Kodin e drejtësisë penale për të mitur i cili hyri në fuqi më 1 janar 2018.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban dispozita të natyrës materiale dhe procedurale, si:

Përgjegjësia penale e të miturve; Rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit me dënim penal, rehabilitimin ose të ç'do mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Ky Kod përmban poashtu dispozita që ndërlidhen me të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç.

Siç shihet nga vetë emërtimi i këtij ligji, Republika e Shqipërisë nuk e ka unifikuar emërtimin e personave më të rinjë se 14 vjet me ato prej 14 deri në 18 vjet me termin "fëmijë", siç kërkohet nga Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, por përsëri ka ruajtur termin "i mitur". Mendoj se ajo duhet ta ndërmarrë këtë reformë në legjislacionin e saj penal, konform dispozitave të Konventës.

Qëllimi i Kodit penal për të mitur i Republikës së Shqipërisë (KPMSH) është (neni 2): Garantimi i një kornize ligjore mbi drejtësinë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e OKB-së për te drejtat e fëmijës dhe standardet dhe normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit; Të promovojë riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm; Të garantojë rishoqërizimin

dhe rehabilitimin e të miturit që ka kryer vepër penale; Të mbrojë të drejtat e të miturit si dëshmitar ose viktimë e veprës penale; Të parandalojë riviktimizimin dhe viktimizimin e dytë të të miturit; Të parandalojë recidivizmin e të miturve; Të mbrojë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale të të miturit; Të garantojë masa edukative dhe parandaluese për të miturin kryes të veprave penale dhe sigurimin e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre.

Sipas Kodit:

"***I mitur***" është ç'do person nën moshën 18 vjeçare;

"***I mitur në konflikt me ligjin***" është ç'do person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeçare) deri në moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale(n.3, p.3,4).

Moshë minimale e përgjegjësisë penale është mosha 14 vjeçare në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal (n.3, al.11).

Disa përkufizime nga Kodi i drejtësisë penale për të mitur i Republikës së Shqipërisë (2017) (neni 3):

"***Masë e drejtësisë restauruese***" - ç'do masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një vepre penale, të kompensojë dëmet dh e/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra pen ale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mën yrë aktive për të zgjidhur pasojat e një vepre penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tret ë të pavarur (p.12).

"Stimul" janë disa përfitime shtesë, përveç atyre që i mituri i gëzon rregullisht, të cilat jepen për shkak të sjelljes së mirë dhe të respektimit të programit të rehabilitimit dhe riintegrimit (p.22).

"Shmangie" janë masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin (p.23). Këto masa në Ligjin për Drejtësinë e fëmijëve të Republikës së Maqedonisë emërtohen "Masa të ndihmës dhe mbrojtjes", kurse në legjislacionin e Republikës së Kosovës emërtohen "Masa të diversitetit".

Mosha minimale e përgjegjësisë kundërvajtëse për të miturit është ajo 16 vjeçare, ndërsa maksimalja ngelet e njejtë me atë të përgjegjësisë penale. (18 vjet)(n7.al2). Në Republikën e Maqedonisë, mosha minimale për përgjegjësinë kundërvajtëse është e njejtë me atë penale.

Kodi i drejtësisë penale për të mitur i Republikës së Shqipërisë në mënyrë taksative i
përcakton parimet e drejtësisë penale për të miturit (n.8-18):

- Parimi i prezumimit të pafajsisë;
- Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës;
- Mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi;
- E drejta për zhvillim harmonik të të miturit;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Përparësia e masave alternative të shmangies;
- Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit;
- Pjesëmarrja e të miturit në procedurën penale;
- Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut.

Vlenë të theksohet se sipas parimit të fundit në ç'do fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme. Të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin janë (n.19):

1. I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara me Kodin e Drejtësisë për të mitur;

2. I mituri ka të drejtë për mbrojtje dhe procedura të veçanta në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur.

3. Në ç'do fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtat e mëposhtme: a) të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose ç'do ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij; b) Të drejtën të informohet menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit individual të tij; c) Të drejtën për një përkthyes falas/interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave; ç) Të drejtën që të ketë prindin të pranishëm dhe/ose të drejtën të shoqërohet nga një person i besuar; d) Të drejtën të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë; dh) Të drejtën që, në kushte të barabarta, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij; e) Të drejtën për ndihmë nga shërbimi konsullor; ë) Të drejtën për ankim, në ç'do fazë të procedimit penal apo gjatë ekzekutimit të vendimit penal.

Në kreun VI (n.46-54) të Kodit janë të rregulluara çështjet që kanë të bëjnë me procesin e drejtësisë penale për të mitur. Kurse kreu VII rregullon rastet e mundshme të shmangjes nga ndjekja penale dhe nga dënimi permes masave alternative (n.55-72). Shumica e dispozitave ligjore për kushtet e zbatimit të "shmangjes", ("masave të ndihmës dhe mbrojtjes") janë të njejta me ato të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë. Vlenë të theksojmë se në mënyrë të veçantë masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim maksimum deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë (n.55, al.3.). Zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset, sipas rastit, edhe nga gjykata. Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social ose psikologut, mund të vendosë kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies. Para marrjes së këtij vendimi, gjykata dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij. Gjykata mund të zbatojë masën e shmangies në fazën e gjykimit deri para marrjes së vendimit përfundimtar (n.57). Rastet e kushtëzimit të vendimit të zbatimit të masës së shmangies(n. 61): 1. Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:

a) Riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit; b) Përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; c) Përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit; d) Trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera. Në rast se i

mituri përmbush detyrimet, sipas pikës 1, të këtij neni, prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj tij.

Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë (n.62): Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; Këshillimin për të miturin dhe familjen; Paralajmërimin me gojë; Paralajmërimin me shkrim; Masat detyruese dhe Vendosjen nën kujdes. Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këto masa përcaktohen mbështetur në raportin e vlerësimit individual të të miturit, sipas rregullave të parashikuara në nenin 47 të Kodit. Masat e shmangies duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose/dhe mendor. Ndalohet vendosja e një mase shmangieje më të ashpër sesa sanksioni minimal ligjor i parashikuar për veprën penale të kryer.

Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale nuk përbën vepër penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit. Edhe në këtë rast, heqja e lirisë, konsiderohet nga organet kompetente si masa e fundit (n.71). Në këtë rast prokurori mund të japë një vendim për ndryshimin ose revokimin e pjesshëm ose të plotë të masës së shmangies pasi ka bërë një shqyrtim të detajuar të fakteve të raportuara. Prokurori pasi e rishqyrton këtë masë, si edhe masa të tjera, kontakton të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe dëgjon mendimin e punonjësit të Shërbimit të Provës mund të vendosë revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale; Ndryshimin e llojit të masës së shmangies; Zgjatjen e kohës së marrëveshjes (n.72). Nenet 73-92 të Kodit përbajnë elemente nga procedura e hetimit dhe atë të gjykimit të të miturve.

Dënimet për të mitur: Pjesa XI e Kodit përcakton qëllimin dhe llojet e dënimeve për të mitur, ku si qëllim i dënimit të të miturit është risocializimin, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i kryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje (n.93).

Dënimet ndahen në dënime **jo me burgim** dhe dënimi **me burgim.**

Në dënimet jo me burgim bëjnë pjesë (n.95):

- Kufizimi i lirisë;
- Qëndrimi në shtëpi;
- Gjoba;
- Kryerja e një pune me interes publik;
- Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- Përmbushja e detyrimeve të caktuara.

Kodi poashtu parasheh edhe një klasifikim tjetër të dënimeve nga ai i lartëpërmenduri dhe atë në: Dënime **kryesore** dhe **plotësuese**;

Dënime kryesore: a) Burgimi; b) Kufizimi i lirisë; c) Gjoba.

Dënime plotësuese: a) Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; b) Kryerja e një pune me interes publik; c) Përmbushja e detyrimeve të caktuara; ç) Qëndrimi në shtëpi. Ndaj të miturit mund të shqiptohet vetëm një dënim kryesor. Dënimi kryesor mund të shqiptohet së bashku me jo më shumë se një dënim plotësues. Bashkë me dënimin mund të jepen një ose disa masa të parashikuara nga kreu VII i Kodit për drejtësinë e të miturve (n.96).

Dënimi me burg për të mitur (neni 97): Ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.

Gjoba (n.99): Gjoba mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm. Në rastet kur gjoba i shqiptohet një të mituri, masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie (n.100): I mituri mund të ndalohet të kryejë një veprimtari të caktuar për një periudhë kohore nga një deri në tre vjet, nëse kjo çmohet si e

papërshtatshme nga gjykata për rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes prej saj të veprave penale të tjera.

Kryerja e një pune me interes publik (n.101): Puna me interes publik për të miturit mund të jetë nga 40 deri në 300 orë. Kohëzgjatja ditore e punës me interes publik nuk mund të jetë më shumë se 4 orë në ditë.

Qëndrimi në shtëpi (n. 103): Ky dënim përmban detyrimin e të miturit të mos largohet, për një periudhe të caktuar, nga banesa e tij e përhershme ose e përkohshme ose një vend i caktuar, ku ai qëndron ose kurohet përkohësisht. Dënimi mund të jepet për një periudhe nga 6 muaj deri në 1 vit dhe zbatohet në rastin e veprave penale që dënohen jo më shumë se me 5 vjet burgim.

Masat detyruese (n.105): Kur jep dënimin jo me burgim, gjykata mundet që ndaj të miturit, të vendosë një ose disa prej masave detyruese, sipas parashikimeve të nenit 68 të këtij Kodi. Në këto raste ndaj të miturit nuk mund të vendosen masa detyruese, të cilat janë të pamundura të përmbushen prej tij ose tejkalojnë aftësitë mendore dhe fizike të të miturit.

I pandehuri i mitur, ndaj të cilit caktohet paraburgimi si masë sigurimi, duhet të vendoset vetëm në seksionin për të mitur në mjediset e paraburgimit, ndërsa i mituri i dënuar me burgim vendoset në institucion të posaçëm për ekzekutimin e vendimeve penale për të miturit (n.110). Për realizimin e të drejtave në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale, të miturit i caktohet mbrojtës kryesisht sipas dispozitave të Kodit penal për të mitur dhe legjislacionit në fuqi (n. 112). Të gjitha kushtet dhe rregullat për të miturit në mjediset e paraburgimit dhe burgimit janë të përcaktuara në nenet 113 të Kodit, siç janë dispozitat që kanë të bëjnë me Vendet e veçanta për të pandehurit/të dënuarit e miturit; Kontrolli mjeksor, psikologjik dhe vendosja e përshtatshme në mjedise; Kujdesi dhe trajtimi shëndetësor i të miturve; Kushtet e jetesës dhe të ushqimit për të mitur.

Vlen të vendosim theksin në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë organizimin e programeve edukuese dhe rehabilituese për të miturit, sipas të cilave (n.117):

1. Të pandehurve/të dënuarve të mitur/të rinj u sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe, sipas rastit, edhe arsimi i mesëm ose i lartë.

2. Procesi arsimor në mjediset e paraburgimit dhe burgimit për të mitur duhet të jetë në përputhje me standardet e arsimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Gjatë paraburgimit dhe burgimit organizohet procesi mësimor dhe i rehabilitimit, me qëllim që të pandehurve/të dënuarve të mitur t'u sigurohet arsim i përgjithshëm dhe/ose arsim profesional mundësisht jashtë mjediseve të paraburgimit dhe burgimit. Vetëm në raste të veçanta, procesi mësimor duhet të sigurohet që i mituri të ndjekë arsimin profesional/trajnimin në mjediset e paraburgimit dhe burgimit.

4. Të burgosurve të mitur/të rinj u krijohen mundësi për trajnim profesional, sipas interesave dhe prirjeve të tyre dhe që do të ndihmojë në punësimin e tyre pas largimit nga institucioni.

5. Dokumentet që vërtetojnë shkollimin e realizuar nga të pandehurit/të dënuarit e mitur/të rinj në periudhën kur ata kanë qenë të pandehur ose kur vuanin dënimin nuk duhet të përmbajnë informacion që bën të mundur identifikimin e të miturit si një ish i dënuar ose identifikimin e një dënimi të mëparshëm.

Ligji poashtu siguron mundësitë për punë e banim të të miturve të dënuar, realizimin e aktiviteteve sportive dhe ripërtërirjes. Kurse si forma për motivimin nxitës për të miturin e dënuar parashihen në këto raste kur i mituri tregon sjellje shembullore dhe të denjë, përfshirje në programet edukative dhe aktivitetet e zhvilluara në mjedisin e vuajtjes së dënimit për të mitur, organi kompetent zbaton format e mëposhtme të motivimit nxitës ndaj tij si: Dhënien e një deklarate mirënjohjeje; heqjen para kohe të një mase disiplinore; dhënien e së drejtës për një vizitë shtesë; dhënien e së drejtës për një bisedë me videokonference shtesë; dhënie e së drejtës për një telefonatë shtesë; pranimin e sendeve, të cilat nuk janë të ndaluara për t'u marrë nga të dënuarit në vendin e vuajtjes së dënimit për të mitur; dhënien e së drejtës për të përdorur kompjuter; plotësimin e një dëshire që çmohet e mundshme dhe proporcionale (n.124). Kodi më tej përmban dispozita lidhur me llojet dhe kushtet e zbatimit të masave displinore si pasojë e shkeljeve disiplinore në entet penitensiare gjatë vuajtjes së dënimit të të miturit. Poashtu Kodi rregullon edhe mundësinë e zbatimit të institutit Lirimit me kusht nga dënimi.

3.2. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Kosovës

Në legjislacionin penal të Kosovës trajtimit të fëmijëve të cilët bien në konflikt me ligjin u është kushtuar kujdes i veçantë, me ç'rast është miratuar Kodi i drejtësisë për të mitur në vitin 2010, dispozitat e të cilit rregullojnë të gjitha çështjet e drejtësisë për të mitur. Kodi rregullon të gjitha çështjet që lidhen me të miturit si kryerës të veprave penale, fëmijës dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë e cila bazohet në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke marrë parasysh interesat më të mira të të miturve, duke marrë parasysh pjekurinë e tyre, nivelin e zhvillimit, aftësive dhe veçorive personale, si dhe peshën e veprës, me qëllim të rehabilitimi dhe riintegrimi i të tyre shoqëror (BAJRAMI, 2017, f. 291). Ndonëse është miratuar Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur[12], i hartuar dhe finalizuar nga Ministria e Drejtësisë, përmes të cilit janë adresuar pengesat e hasura gjatë zbatimit të kodit ekzistues si dhe janë paraparë disa dispozita të reja, të cilat legjislacionin e kësaj fushe e avancojnë në masë të konsiderueshme, i njejti ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, prandaj në vazhdim do t'i referohemi Kodit në fuqi mbi drejtësinë penale për të mitur të vitit 2010.

Disa nga çështjet më të rëndësishme të Projekt Kodit të drejtësisë për të mitur të Republikës së Kosovës janë: Zgjerimi i numrit të parimeve garantuese dhe mbrojtëse të të drejtave të fëmijëve si dhe është paraparë një kapitull i veçantë i cili i rregullon masat e ndihmës dhe të mbrojtjes për fëmijët si kryes të veprave penale, respektivisht për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Finalizimi i këtij drafti është bërë në koordinim dhe bashkëpunim me akterët relevantë vendorë dhe ndërkombëtar, me theks të veçantë me përkrahjen e UNICEF-it, Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së. [13]

- **Kodi i drejtësisë për të mitur (2010)**

Sipas Kodit të drejtësisë për të mitur të Republikës së Kosovës (2010) (n.2), ***fëmijë*** është personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet; ***I mitur*** është personi

[12] Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur, është miratuar në mbledhjen e 121 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.02/121, datë 21.12.2016

[13] Lajm i publikuar në: http://www.kosovapress.com/sq/lajme/miratohet-ne-parim-projekt-kodi-i-drejtesise-per-te-mitur-105042/

ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet; ***I mitur i ri*** - personi ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet; ***I mitur i rritur*** - personi ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet; ***Madhor i ri*** - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetenjë (21) vjet; ***I ri*** - fëmijë apo madhor i ri; ***Madhor*** - personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet. Pra, siç mund të vërehet legjislacioni aktual i Kosovës i kategorizon të miturit në dy ndarje kryesore, njejtë sikur Ligji i më hershëm i Maqedonisë (i vitit 2007).

Parimet udhëzuese të drejtësisë penale për të mitur sipas Kodit për drejtësinë e të miturve të Kosovës (n.3):

- Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale;
- Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës.
- Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjate kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.
- Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.
- Ç'do i mitur i privuar nga liria trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, ç'do i mitur i privuar nga liria ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.
- Ç'do i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.

- Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

- **Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve** (n. 7):

Masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë:

1. Masat e diversitetit dhe masat educative;

2. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: Gjoba, Urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe Burgimi për të mitur;

3. Dënimi nuk mund t'i shqiptohet të miturit i cili ka qene nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në kohën e kryerjes se veprës penale;

4. Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me këtë Kod.

5. Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy (2) vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy (2) vjet, mund të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme(n.8):

1. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: Llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.
2. Shërbimi sprovues përgatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose gjykatës ashtu siç është paraparë në këtë Kod. Anketa sociale përfshin të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe rrethanat nën të cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën

edukative dhe çfarëdo të dhëne tjetër relevante. 3. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.

Ndërmjetësimi (n.14): Është procedurë jashtëgjyqësore e cila zhvillohet nga personi i tretë, ndërmjetësuesi në pajtim me dispozitat e Kodit penal për të mitur dhe ligjit për ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi vjen në shprehje vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e të dy palëve. Kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar. Prokurori, gjyqtari për të mitur apo kolegji për të mitur mund të propozoj ndërmjetësimin nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme duke pas parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimi i tij në shoqëri. 3. Palëve në procedurë mund tu propozohet ndërmjetësimi në rast se ato kanë shprehur pëlqimin për ndërmjetësim.

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh se të miturve të cilët kryejnë vepra penale, mund t'i shqiptohen: ***Masat dhe dënimet***. Mirëpo përveç këtyre ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe ***masat për trajtim të detyrueshëm***. Si kriter kryesor në përcaktimin se cili sanksion do të shqiptohet merret për bazë mosha e personit të mitur i cili ka kryer vepër penale. Sipas këtij kriteri nëse i mituri kryen vepër penale në moshën mes 14 dhe 16 vjeçare ndaj tij mund të shqiptohet vetëm ndonjë nga llojet e masave të parapara, ndërkaq për shqiptimin e dënimit si sanksion penale si kriter kryesor merret mosha minimale e përgjegjësisë penal për shqiptimin e këtij sanksioni e cila është 16 vjeçare. Pra, sipas këtyre dispozitave personave të mitur nën moshën 16 vite në asnjë rast nuk mund t'iu shqiptohet dënimi. Mirëpo si masa të veçanta me karakter mjekësor kodi i drejtësisë për të mitur i parasheh edhe masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat si të tilla janë të ndara nga llojet e sanksioneve penale (BAJRAMI, 2017, fq. 292-293).

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh dy lloje të masave të cilat mund të shqiptohen ndaj të miturit, dhe atë : ***Masat e diversitetit*** dhe ***masat edukuese***.

- **Masat e diversitetit** për herë të parë në legjislacionin penal të Kosovës janë paraparë me Ligjin penal për të mitur Rregullorja e UNMIK-ut nr.8/2004. Ato poashtu i parasheh Kodi i

drejtësisë për të mitur i vitit 2010. Këto masa përfaqësojnë llojin e masave më të lehta të cilat janë të parapara me kodin penal dhe të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Sa i përket kohëzgjatjes së tyre kodi nuk e ka rregulluar në mënyrë shprehimore këtë aspekt, por e ka lënë në diskrecion të gjykatësit, në mënyrë që në varësi nga rrethanat e rastit konkret të vendosë vetë gjykatësi për gjatësinë e shqiptimit të njërës nga këto masa. Mirëpo gjykatësi me rastin e shqiptimit të kohëzgjatjes së tyre duhet të ketë parasysh interesin më të mirë të të miturve, dhe duhen të përcaktohen në kohëzgjatje sa më të shkurtër të mundshme. Ndaj kryerësit të mitur të veprës penale varësisht nga rrethanat e rastit konkret mund të shqiptohen një ose më shumë masa të diversitetit (BAJRAMI, 2017, f. 293).

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste (n.16). Nga ky nen dalin disa qëllime kryesore për të cilat shqiptohen këto masa: Që ndaj te miturve te mos zhvillohet procedura penale; Të shmanget shqiptimi i sanksionit penal; Të ndikoj ne rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve dhe të shmang stigmatizimin e të miturve; Pengimin e recidivizmit tek të miturit (Hajdari, 2010, f. 47).

Kushtet për shqiptimin e masës së diversitetit janë(n.17): Pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri; Shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe Pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit. Prokurori kompetent njoftohet menjëherë për moskryerjen e detyrimeve të masës së diversitetit nga i mituri i cili mund të vendosë për rifillimin e ndjekjes së rastit. Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.

Llojet e masave të diversitetit janë:

- Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;

- Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
- Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit , të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- Vijimi i rregullt në shkollë;
- Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. (Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej 10-60 orë;
- Edukimi në rregullat e trafikut dhe
- Këshillimi psikologjik. (n.18).

Masat e diversitetit në legjislacionin penal të Maqedonisë njihen me emërtimin "Masa të ndihmës dhe mbrojtjes" dhe janë paraparë së pari me Ligjin e drejtësisë për të mitur të vitit 2007, por edhe me ligjin pozitiv të vitit 2013. Mirëpo të njejtat nuk janë të përcaktuara në mënyrë taksative, kështu siç ka vepruar ligjvënësi kosovar, por i është lënë hapsirë organit procedures (Zakonisht Qendrave për punë sociale, gjykatave në disa raste) që të zgjedhë masën më të përshtatshme për mbrojtjen e interesit të fëmiut nga sferat e ndryshme shoqërore.

- **Llojet dhe kohëzgjatja e masave edukuese**: Llojet e masave edukuese që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë(n.20): Masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale.

1. ***Masat disiplinore*** janë Qortimi gjyqësor dhe Dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa shqiptohen ndaj kryerësit të mitur, interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.
2. ***Masat e mbikëqyrjes së shtuar*** janë Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit

interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.

3. ***Masat institucionale*** janë Dërgimi i të miturit në institucion edukues, Dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe Dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e masës institucionale nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale.

Dënimet për të mitur:

Gjoba: Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëzetepesë (25) Euro ose më shumë se pesëmijë (5.000) Euro (n.30).

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme : Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqindenjëzet (120) orëve. Shërbimi sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda periudhës së caktuar nga gjykata, e cila nuk mund të zgjat më shumë se një (1) vit (n.31).

Dënimi me burgim: Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin. Gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili e ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale. Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më e ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale. 2. Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj as më shume se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet (n. 32-34).

Masat e trajtimit të detyrueshëm (n.38): Qëllimi i masës së trajtimit të detyrueshëm është që të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit dhe të parandalojë rrezikun nga recidivizmi. Trajtimi i detyrueshëm shqiptohet në pajtim me dispozitat e Kodit penal të Kosovës. Gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturit në pajtim me kapitullin XXXIII të Kodit të procedures penale. Gjykata mund të shqiptojë masën për trajtim të detyrueshëm të rehabilitimit ndaj të miturit në pajtim me kapitullin V të Kodit Penal të Kosovës . Masa për trajtim të detyrueshëm shqiptohet vetëm pas konsultimit me shërbimin sprovues, organin e kujdestarisë dhe ekspertët përkatës. Masa e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të shqiptohet në të njëjtën kohë me masën disiplinore. Ndërsa, kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim më nenet 54-62 të Kodit Penal të Kosovës (n.39). Ligji në vazhdim të tekstit të tij përmbanë dispozita me karakter procedural, me të cilat rregullon zhvillimin e procesit penal ndaj të miturit si edhe dispozita të karakter penologjik lidhur me ekzekutimin e masave dhe dënimeve për të mitur (n.40-152).

3.3. Drejtësia penale për fëmijë e Republikës së Kroacisë

Kroacia ka ratifikuar një numër traktatesh ndërkombëtare që përcaktojnë nevojat dhe të drejtat specifike të fëmijëve. Këto dokumente përmbajnë standarde universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe gjatë 20 viteve të kaluara, Kroacia ka inkorporuar ndryshime të ndryshme legjislative në mënyrë që të zbatojë dispozitat e tyre. Më e rëndësishmja në mesin e tyre është Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë nënshkroi dhe ratifikoi KDF-në më 26 janar 1990 dhe 3 janar 1991, me një rezervë, e cila më vonë u tërhoq nga Kroacia. Bazuar në njoftimin e trashëgimisë së shtetit të mëparshëm, Kroacia u bë shtet palë e KDF më 8 tetor 1991 (Maršavelski).

Dispozita të përgjithshme ligjore, të zbatueshme për të gjithë kryerësit e veprave penale (jo vetëm të miturit) mund të gjenden në Kodin Penal dhe në Ligjin e Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë, mirëpo ekziston edhe një ligj i veçantë që e rregullon drejtësinë e të miturve: Ligji mbi Gjykatat e të miturve.[14]

Vlenë të përmendet se një fushë e veçantë e së drejtës në lidhje me kriminalitetin e të miturve dhe një sistem i veçantë i drejtësisë për të mitur ka ekzistuar në Kroaci për më shumë se 50 vjet. Trendet e reja u përfshinë në Ligjin e Gjykatave për të Mitur të miratuar në 1997 (1997, 1998 dhe 2002). Ligji përmban dispozita të së drejtës penale materiale, dispozita për gjykatat dhe procedurat penale dhe dispozitat për ekzekutimin e sanksioneve për të miturit. I njejti shtë i zbatueshëm për dy grupe të kryesve të rinj të veprave penale (neni 2) (Zizak, 2010), (Maršavelski):

- Të miturit (personat, mosha e të cilëve në kohën kur është kryer vepra penale, ka qenë mes katërmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet) dhe
- Të rriturit e rinj (personat, mosha e të cilëve në kohën kur është kryer vepra penale ka qenë mes tetëmbëshjetë dhe njëzet e një).

Rregulla mbi mbrojtjen penale të fëmijëve dhe të miturve poashtu sigurohen përbrenda këtij ligji të lartëpërmendur. Kështu, termi "të mitur" përfshin personat që janë të paktën 14 vjeç

[14] (Zakon o sudovima za mladež) “Narodne novine”No. 84/11, 143/12, 148/13, 56/15

dhe e shtrin fushën e tij tek individët të cilët kanë mbushur moshën madhore, por janë më të rinjë se 21 vjeç. Parime kryesore të sistemit kroat të drejtësisë për të mitur janë: Parimi i urgjencës, Parimi i trajtimit në kohë të arsyeshme; Parimi i sanksionimit gradual dhe parimi i ndryshueshmërisë së sanksioneve (Sabina Mandić, 2017).

Neni 4 i Ligjit të lartëpërmendur përcakton parimin e Shpejtësisë/urgjencës së veprimit, sipas të cilit procedura penale ndaj të miturit, ndaj madhorit të ri, si dhe lëndët që kanë të bëjnë me mbrojtjen penalo-juridike të fëmijëve duhet të jenë urgjente. Pjesa e parë e këtij ligji përmbanë dispozita penalo-juridike të natyrës materiale, dhe atë i përcakton llojet e sanksioneve penale që mund ti shqiptohen një të mituri. Ekzistojnë tri lloje të sanksioneve për të mitur(n.5 (1)):

1. Masa edukuese (korrigjuese),
2. Burgu për të mitur, dhe
3. Masat siguruese.

Më poshtë pikat vijuese të po këtij neni bëjnë diferencën e kategorive të të miturve në bazë të moshës, duke përcaktuar edhe llojet e dënimeve që mund të i'u shqiptohen atyre, si vijon:

(1) Të miturit të ri - i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur katërmbëdhjetë vjet por nuk i ka mbushr gjashtëmbëdhjetë, mund ti shqiptohen vetëm këto sanksione penale – Masat edukuese dhe ato siguruese;

(2) Të miturit të vjetër - i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë, mund ti shqiptohen sanksionet penale – Masat edukuese dhe ato siguruese, e nën kushte të paraprara me ligj edhe burgu për të mitur.

Qëllimi i dënimit të të miturve në Kroaci konsiderohet të jetë rehabilitimi dhe risocializimi i tyre, i cili ndryshon nga qëllimi i ndëshkimit të shkelësve të rritur. Theksi në gjykimin dhe dënimin e të miturve është në mbrojtjen e të miturve, duke siguruar kujdes, ndihmë dhe mbikëqyrje, si dhe edukim për të ndikuar në rritjen e tyre, zhvillimin e personalitetit të tyre dhe forcimin e përgjegjësisë së tyre personale në mënyrë që ata të abstenojnë nga përsëritja e veprave penale dhe për të i'u lehtësuar rikthimin e tyre në shoqëri (Božičević-Grbić M. & Roksandić Vidlička S., 2011).

Në këtë drejtim, qëllimi i sanksioneve penale për të mitur përcaktohet në nenin 6 të Ligjit mbi gjykatat për të rinjtë, ku vaçmas i jepet rëndësi qëllimit të masave korrektuese për të mitur dhe qëllimit mbi dënimin me burgim për të mitur. Së këndejmi, qëllimi i masave korrektuese është të sigurojë mbrojtje, kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje, duke i ofruar edukim kryerësit, për të ndikuar në zhvillimin e personalitetit të tij dhe për të forcuar përgjegjësinë e tij personale që në të ardhmen të mos kryej veprime të kundërligjshme;

Ndërkaq, qëllimi i burgimit për të mitur është të zbatohen masa pedagogjike dhe edukative mbi kryerësin, në mënyrë që të ndikohet në zhvillimin e personalitetit të tij dhe të forcojë përgjegjësia e tij personale për të mos kryer veprime të kundërligjshme, si dhe për të ndikuar tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale (n.6, al.1,2). Ekzistojnë tri lloje të masave edukuese dhe korrektuese: Paralajmërim (vërejtje gjyqësore, detyrime të veçanta dhe referim në një qendër edukative), Mbikëqyrje intensive (prova) dhe Referim në lloje të ndryshme të institucioneve edukative ose korrektuese (Zizak, 2010).

Meqenëse qëllimi i proklamuar i këtyre masave edukuese është parandalimi special, përmbajtja e tyre është kryesisht me karakter pedagogjik (Maršavelski). Llojet e tyre janë të caktuara në mënyrë taksative, dhe ato janë (n.7):

(1) Qortimi gjyqësor;

(2) Detyrime të veçanta;

(3) Kujdes dhe mbikëqyrje e intensifikuar;

(4) Kujdes i shtuar dhe mbikëqyrje me qëndrim ditor në institucion korrektues;

(5) Referim në një qendër disiplinore;

(6) Referimi në një institucion korrektues;

(7) Referimi në shtëpi edukuese-përmirësuese dhe

(8) Referimi në një institucion të posaçëm korrektues.

Ligjvënësi ka përcaktuar kushtet për shqiptimin e këtyre masave, kohëzgjatjen e tyre, rrethanat të cilat duhet ti ketë parasyshë gjykata gjatë zgjedhjes së këtyre masave dhe përshtatjen e tyre të miturit (n.8-17).

Veçantia e burgut për të mitur: Përcaktohet në ligj në mënyrë shprehimore, duke e cilësuar atë të veçantë si nga mënyra e shqiptimit, kohëzgjatjes, qëllimit dhe përmbajtjes së vetë sanksionit (n.24, al.1). Ky dënim mund ti shqiptohet vetëm të miturit të vjetër (16-18 vjeç) për vepër penale e cila në Kod penal ndëshkohet me tre vite burgim ose më të rëndë, duke marrë parasysh natyrën dhe peshën e veprës penale dhe shkallën e lartë të fajit, nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet një masë edukuese (n.24, al.2).

Matja e dënimit me burgim për të mitur: Burgu për të mitur nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj, e as më i gjatë se pesë vite, dhe shqiptohet në vite dhe muaj të plotë. Nëse bëhet fjalë për vepër penele për të cilën parashihet burgim i përjetshëm ose për bashkim të së paku dy veprave penale për të cilat është paraparë burgim mbi dhjetë vite, burgu për të mitur mund të zgjasë deri në dhjetë vite (n.25, p.1). Pra, burgimi për të mitur është sanksioni më i ashpër për të miturit, që përfshinë heqje më të gjatë të lirisë (maksimumi 10 vjet burg) dhe kështu është i rezervuar për vepra të rënda penale (dënim me burgim prej 3 vjet ose më shumë). Kështu, me përjashtim të arsyetimit të parandalimit special, burgimi për të mitur justifikohet gjithashtu me arsyetimin e parandalimit gjeneral. Sidoqoftë, në krahasim me qëllimet e përgjithshme të dënimit të miratuara në Kodin penal të Kroacisë[15], arsyet e retribucionit janë qartësisht të përjashtuara. Dënimi me burgim për të mitur zbatohet në një institucion penal për të mitur ose në divizione të veçanta të institucioneve penale për të dënuarit e rritur. Profesionistët që ofrojnë shërbime trajtimi në këto institucione ose ndarje të veçanta kërkohet të kenë njohuri nga pedagogjia dhe psikologjia (Maršavelski).

Ligji mbi gjykatat për të mitur në nenin 31 përcakton zbatimin e **masave siguruese** ndaj të miturit, sipas të cilit gjykata mundet t'i shqiptojë të miturit masë siguruese së bashku me një masë korrigjuese apo burgun për të mitur në pajtim me dispozitat e Kodit penal. Këto masa janë: Trajtimi i detyrueshëm psikosocial, dhe Ndalimi i ofrimit personit të caktuar – mund të shqiptohen vetëm me masat edukuese të entit;

[15] "Qëllimi i dënimit është të shprehë dënimin publik të krimit të kryer, të ngrisë besimin e qytetarëve në rendin ligjor të bazuar në sundimin e ligjit, të ushtrojë ndikim mbi kryerësin dhe të gjithë të tjerët në mënyrë që të mos kryejnë vepra penale duke rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e kryerjes së veprave penale dhe të drejtësisë së dënimit dhe të lejojë ripranimin e shkelësve të ligjit në shoqëri " (Neni 41 i Kodit Penal të Kroacisë).

- Ndalimi i drejtimit të automjetit- mund ti shqiptohet vetëm të miturit të vjetër (n.31, p.1).
- Masat mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe mjekimi nga varësia, mund të zgjasin deri në mbarimin e shkakut për të cilën ato janë shqiptuar, por në të gjitha rastet deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit me burg, e jo më gjatë se tre vite (n.31,p.2).

Ligji mbi gjykatat për të rinjtë zbatohet vetëm për dy kategori të rasteve penale: (1) Kur një i mitur është kryerës i një vepre penale dhe (2) Kur një fëmijë është viktimë e një krimi të rëndë; Por nuk zbatohet për forma të tjera të sjelljeve antisociale. Kur sjellja antisociale e të miturit përbën kundërvajtje, një rast i tillë administrohet nga një gjykatë kompetente kundërvajtëse në përputhje me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje. Meqenëse fëmijët mund të mbahen penalisht përgjegjës vetëm nëse janë më të moshuar se 14 vjeç (neni 7 (1) i Kodit Penal), sistemi i drejtësisë për të mitur nuk zbatohet për kryerësit e moshës nën 14 vjeç. Vetëm prindërit të tyre dhe personat të cilëve i'u është besuar (p.sh. shërbimet e kujdesit social) mund të aplikojnë sanksione joformale për të vendosur sjelljen e tyre në rregull (p.sh paralajmërimet verbale, zvogëlimin ose sekuestrimin e parave të xhepit etj.). Për më tepër, kjo nuk parandalon procedimet penale ndaj prindërve të fëmijës ose personave të tjerë që janë përgjegjës për fëmijën nëse kanë pasur gjendjen mentale të kërkuar (me qëllim ose në neglizhencë) lidhur me sjelljen e paligjshme të fëmijës! (Maršavelski).

Parimi i oportunitetit është një nga parimet më të rëndësishme në procedurën penale kundër të miturve në Kroaci (Maršavelski, f. 6). Sipas n. 71 të Ligjit të gjykatave për të miturit, për vepra penale më pak të rënda (të dënueshme me dënim me burg deri në 5 vjet ose me gjobë), prokurori publik mund të vendosë për të mos kërkuar që procedura penale të fillojë, nëse ai konsideron se nuk do të ishte e arsyeshme që të zhvillohet procedimi kundër të miturit, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, jetën e mëparshme të të miturit si dhe karakteristikat e tij personale. Në pajtim me n. 72 të ligjit në fjalë, mund të vendosen kushte të ndryshme ndaj të miturve për t'u rehabilituar dhe parandaluar ata nga përsëritja e veprës penale (Maršavelski, f. 15).

Sistemi i kujdestarisë nuk konsiderohet të jetë i lidhur drejtpërdrejt me sistemin kroat të drejtësisë për të miturit, por më tepër përbën një masë brenda Ligjit kroat të familjes dhe

Ligjit të sigurimit social. Kështu, nuk mund të caktohet si një alternativë për paraburgim ose ndalim policor. Kujdesi alternativ i familjes sigurohet sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Social dhe Ligjit mbi Kujdestarinë (Zakon o udomiteljstvu, "Narodne novine" (Official Gazette) No. 90/11, 78/12.). Ekzistojnë dy lloje të kujdesit alternativ familjar:

(1) Shërbimi i strehimit (strehim i përkohshëm në shtëpinë e ofruesit të kujdesit social) dhe

(2) Strehim në një shtëpi të familjes së huaj.

Të dyja masat janë përgjithësisht të dizajnuara për fëmijët pa prindër, fëmijët e lënë pas dore ose të abuzuar, fëmijët me sjellje antisociale dhe në raste të tjera kur ky strehim është në interes të fëmijës. Shërbimet e strehimit në një shtëpi të ofruesit të kujdesit social aplikohen tek fëmijët që presin të vendosen në një familje kujdestare (Maršavelski). Rëndësia e parimit të privatësisë së çështjeve penale të të miturve, poashtu proklamohet shprehimisht në Ligjin mbi gjykatat për të mitur, sipas të cilit në nenin e emërtuar "Shpallja e aktgjykimeve", përcaktohet se dispozitat e Kodit penal mbi shpalljen publike të aktgjykimeve, nuk vlejnë (zbatohen) për kryerësit e mitur të veprave penale (n.34). Ligji një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së tij, në pjesën e dytë ua kushton dispozitave me karakter procedural, në të cilat rregullohen çështje konkrete nga procedura ndaj të miturve, si: Parime të përgjithshme procedural.

Fazat e procedurës ndaj të miturve; Procedura para gjykatave nëpër instancat e ndryshme si dhe ajo sipas mjeteve juridike (n.35-93). Ndërsa pjesa e tretë e ligjit përbanë dispozita lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale për të miturit, mënyrën, kushtet dhe organizimin e institucioneve penitensiare për ekzekutimin e sanksioneve penale për të mitur (n.94-103). Dy pjesët e fundit të ligjit rregullojnë çështje lidhur me aplikimin e dispozitave të këtij ligji ndaj personave madhorë të rinjë (18-21 vjet), si dhe çështje lidhur me mbrojtjen penalo-juridike të fëmijëve (n.104-121). Është interesant fakti, se legjislacioni penal për fëmijë i Kroacisë, nuk e parasheh Dënimin me gjobë për kryesit jomadhorë të veprave penale. Gjoba parashihet si dënim kryesor për fëmijët e dënuar për vepra penale në të gjitha sestemet juridiko-penale të shteteve të tjera të cilat janë marrë për tu analizuar në këtë punim, me përjashtimin e vetëm të atij të Republikës kroate.

3.4. Drejtësia penale për fëmijë e Holandës

E drejta penale për fëmijë në Holandë rregullohet me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale. Rregulla të veçanta zbatohen kur fëmiu dënohet dhe qëndron në një institucion të kujdestarisë (ruajtjes) për të rinjë sipas Ligjit për Institucionet Kujdestare për të Rinjtë (2000). Ministria e Sigurisë dhe Drejtësisë është përgjegjëse për ruajtjen e sundimit të ligjit në Holandë dhe për këtë arsye është gjithashtu përgjegjëse për sistemin e drejtësisë për të miturit (M. Berger, J. Brummelman, 2015).

Në vitin 1991 Parlamenti Holandez miratoi një Ligj mbi Kujdesin e fëmijëve, që rregullonte çështjet lidhur me kujdesin dhe mbrojtjen e tyre, si dhe një ligj penal për fëmijë i cili rregullote një sistem specifik të procedimit dhe sanksionimit të delikunetëve të mitur (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)). Në vitin 1921 u prezantua një sistem i gjyqtarëve profesional, të specializuar për të mitur me kompetenca në të dy llojet e çështjeve-penale dhe civile (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)). Gjyqtarët për të mitur kërkohej të kenë aftësi edukative dhe ligjore (Muncie, Goldson and contrib., 2006).

Deri në vitin 1980 në Holandë aplikohej versioni i filozofisë së "intervenimit minimal" ndaj të miturve delikuentë. Policia kishte autorizime të gjëra lidhur me çështjet penale të fëmijëve, ku ajo mundej të largonte fëmiun nga gjykata drejtë një procedure joformale apo vetëm me një vërejtje, apo thjeshtë duke mos ndërmarrë asnjë veprim të mëtejmë. Si pasojë e mekanizmave të ndryshëm të diversitetit, rezultoi se vetëm 15% nga fëmijët të cilët kishin rrënë në kontakt me policinë eventualisht kishin dalur para gjykatës (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)). Pas vitit 1980 u implementuan politika të modelit të "diversionit të kushtëzuar", i cili përmbante programe të ndryshme alternative, me ç'rast nga kryerësit e mitur të veprave penale kërkohej të paguanin shumën e kompenzimit (zhdëmtimit) të viktimës, apo të ndiqnin një program të diversionit ("Diversion programme") të ashtuquajtur HALT (*"Het ALTternatief").* Kjo e fundit mund të përfshinte kërkim falje viktimës, punë riparuese (maksimum deri në njëzet orë) të realizuar gjatë ditëve të lira të shtuna, ose dëmshpërblimin e viktimës. Kjo masë aplikohej për krime të lehta, zakonisht për krime të imta kundër pasurisë dhe dëmtime kriminale. Edhe pse së pari u prezantua në Rotterdam në vitin 1982, sot aktualisht ky sistem është i shpërndarë në tërë vendin me afërsisht

gjashtëdhjetë e pesë qendra të financuara nga Ministria e Drejtësisë dhe komunat lokale (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)).

Një version i rishikuar i ligjit të vitit 1989, përfundimisht u miratua në vitin 1995 dhe jo vetëm që e kufizoi fuqinë e gjyqtarëve për të rinjtë dhe përmirësoi mundësitë e procesit gjyqësor për kryesit jomadhorë, por edhe ashpërsoi sistemin e drejtësisë për fëmijë në drejtimin e të drejtës penale për të rriturit. Për grupmoshat 16- 17 vjeçe, mundësia e gjykimit sipas ligjit për të rriturit u rrit gjithashtu (Muncie, Goldson and contrib., 2006).

Së këndejmi, me ndryshimet e drejtësisë penale për të mitur në vitin 1995, u zgjat maksimumi i kohëzgjatjes së dënimit me burgim për të mitur dhe atë, për grupmoshat 12-16 vjet nga gjashtë në dymbëdhjetë muaj, kurse për ato 16-18 vjet nga gjashtë në njëzet e katër muaj, ndonëse këto maksimume të reja janë konsiderueshëm më të shkurta sesa ato të zbatueshmet në shumicën e shteteve evropjane! Ky legjislacion (1995) poashtu bëri të mundshëm burgimin e dhunuesve seriozë dhe atyre seksualë deri në gjashtë vite, duke u administruar forma të duhura të trajtimit korrigjues (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)).

Gjatë arrestimit, dispozitat e zbatueshme për fëmijët janë të ngjashme me ato për të rriturit. Vetëm një pjesë e vogël e Kodit penal përmban rregulla të posaçme për fëmijët. Për shkak të futjes së të drejtës penale për adoleshentët në prill 2014, prokuroria rinovoi rregullat e procedurës penale për të miturit dhe adoleshentët.[16] Në këto rregulla përcaktohet metoda ZSM (ZSM = si selektive, e shpejtë, e përbashkët, e zgjuar dhe e bazuar në komunitet), që do të thotë se policia, Prokuroria dhe Bordi për Mbrojtjen e Fëmijëve punojnë së bashku në baza ditore dhe bashkërisht koordinojnë, diskutojnë dhe gjykojnë rastet e të miturve. Zyra e Prokurorit Publik (Openbaar Ministerie) është kompetente për të vendosur lidhur me rastet dhe për të vendosur fëmijët para një gjykate penale. Holanda bëri një rezervë për nenin 37 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Kështu që, sipas nenit 77b dhe c të Kodit të Procedurës Penale, të miturit e moshës 16 dhe 17 vjeç mund të dënohen në raste të caktuara si të rritur. Në të njëjtën kohë, të rinjtë nga mosha 18 deri në 23 vjeç mund të dënohen sipas të drejtës penale për të mitur (M. Berger, J. Brummelman, 2015). Për të miturit që qëndrojnë

[16] Richtlijn en kader voor strafvordering jeugd en adolescenten, inclusief strafmaten Halt (2014R005). (Guidelines and Framework for Criminal Justice and Youth Adolescents, including penalties Halt)

në një institucion të kujdestarisë zbatohet një ligj i veçantë, Ligji mbi Institucionet Kujdestare për të Rinjtë. Ky ligj përshkruan gjerësisht kushtet për institucionet e të rinjve, siç janë edukimi, sporti, stafi i specializuar, kujdesi për përdorimin e masave disiplinore etj.

Dënimet për të miturit: Në Holandë janë në dispozicion një shumëllojshmëri dënimesh për të rinjtë dhe ato janë:

- Gjoba,
- Shërbimi në komunitet,[17]
- Burgimi.[18]

Masat për të rinjtë përfshijnë:

- Konfiskimin e mallrave të marra në mënyrë të paligjshme;
- Masat korrektuese / ri-edukative të sjelljes (gedragsbeïnvloedende maatregel); dhe
- Masat e trajtimit të kujdestarisë (pijmaatregel).

Në Holandë fëmijët mund të arrestohen dhe të merren në pyetje nga policia në ç'do moshë. ***Mosha minimale e përgjegjësisë penale është ajo 12 vjeçare.*** Prokuroria dhe kujdestaria policore mund të veprojnë vetëm nga ajo moshë. Fëmijët e dyshuar për një vepër të rëndë të moshës 12-18 vjeç mund të mbahen në paraburgim deri në 3 ditë dhe 15 orë para se të dalin para një gjyqtari. Gjyqtari hetues i fëmijëve vlerëson nëse fëmija mund të lirohet. Nëse privimi i lirisë zgjatet, fëmijët 12-15 vjeç mund të mbahen ligjërisht për një maksimum prej 9 ditësh dhe 15 orësh në një qeli policore (kujdestari policore dhe paraburgim). Fëmijët e moshës 16 ose 17 vjeç mund të mbahen në qelitë e policisë për një maksimum prej 16 ditësh dhe 15 orësh për shkak të problemeve të kapacitetit ose problemeve që kanë të bëjnë me transportin (M. Berger, J. Brummelman, 2015).

Në Holandë për vitin 2013 normat e krimit të fëmijëve dhe numri i fëmijëve në institucionet e ruajtjes së të rinjve pësoi një rrënie me shpejtësi. Midis viteve 2005 dhe 2012, totali i të

[17] Shërbimi në komunitet për fëmijët përbëhet nga një dënim - punë pa pagesë; një dënim në të cilin fëmija duhet të ndjekë një trajnim që lidhet me veprën, ose një kombinim i të dyjave.

[18] Fëmijët e dënuar me burgim janë të privuar nga liria e tyre në institucione penitensiare për të mitur. Në këtë moment janë në përdorim gjithsej tetë institucione, por kapaciteti i tyre nuk përdoret plotësisht.

fëmijëve të dyshuar për krime u zvogëlua për afër 53%. Mes viteve 2010 dhe 2013, numri i fëmijëve në institucionet e ruajtjes së të rinjve ishte ulur për 25%. Megjithatë, statistikat e vetë-raportimit të fëmijëve tregonin shifra më të larta të kryerjes së krimeve. Në vitin 2010, gati 38% e të miturve të moshës 12 deri 18 vjeç paten raportuar kryerjen e një krimi (delikti)[19] (M. Berger, J. Brummelman, 2015).

Në vitin 2010 për 31 shtete në botë, përfshirë ato 25 evropjane dhe 6 amerikane, u publikuan rezultatet nga "Studimi i dytë ndërkombëtar mbi vetë-raportimin e delikuencës"[20] për periudhën 2005-2007, mes tyre edhe për Holandën (The Dutch ISRD-2[21]). Këto janë disa nga rezultatet e arritura nga ky hulumtim mjaftë serioz: Fëmijët e intervistuar ishin të moshës 12-15 vjeçare, nxënës të klasave të shtatë, tetë dhe nëntë, nga qytete të ndryshme – gjithsej në numër 2,295. 45% e të anketuarve pranuan se të paktën njëherë kanë kryer një nga 15 krimet e paraqitura në pyetësor, dhe atë 29.5% i kanë kryer vitin e kaluar nga viti kur është realizuar kjo anketë. Shumica e fëmijëve raportuan se kanë kryer krime jo shumë të rënda, kurse ata që kanë kryer krime të rënda, poashtu kanë kryer edhe shumë krime të lehta. Veprimet penale më të shpeshta të raportuara ishin: Pjesëmarrja në rrahje, mbajtja e armës, vandalizëm dhe vjedhje në shitore. Poashtu ajo që paraqet një karakteristikë të këtij fenomeni, është se të miturit më së shpeshti i kryejnë këto veprime në grup, ku nga rezultatet e kësaj ankete doli se vetëm 8% e raportuesve i kishin kryer vetë ato krime! (J.Junger-Tas, M.Steketee, M.Moll, 2010).

• Sanksionet penale sipas Kodit penal të Holandës

Sipas **Kodit penal** të Holandës ***dënimet kryesore për fëmijë*** janë (Kodi penal i Holandës, (1881, me ndyshime 1994, neni 77h):

- Për vepra të rënda: ***Burgim për të mitur ose gjobë*****,** kurse për vepra të lehta: ***Gjobë*****.**

[19] WODC, Jeugdcriminaliteit in de periode 1996-2010, Van der Laan en Blom, 2011.
[20] Në volumin e Publikimit të ISRD-2 janë të paraqitura rezultatet për 28 shtete, kurse për 3 shtete të tjera pason Volumi II. Poashtu Studimi ISRD-3 është në përpunim për më shumë shtete të përfshira, të dhëna më të detajuara rreth këtij studimi mund të shihen në: https://web.northeastern.edu/isrd/isrd3/ ku mes tjerash është pjesëmarrëse dhe në përpunimin e të dhënave edhe Maqedonia.
[21] https://web.northeastern.edu/isrd/the-netherlands/

Një ose më shumë nga ***sanksionet alternative*** mund të shqiptohen në vend të një dënimi kryesor (p.2):

- *Shërbimi në komunitet;*
- *Puna që kontribuon në riparimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale dhe*
- *Pjesëmarrja në një projekt trajnimi.*

Dënimet plotësuese përfshijnë: *Konfiskimin dhe Marrjen e lejes për vozitje të automjeteve motorike.*

4. ***Masat për të mitur*** janë (p.4):

a. Dërgimi në një institucion për të rinjtë;

b.Konfiskimi;

c. Marrja e fitimeve të fituara në mënyrë të paligjshme;

D. Kompenzimi i dëmit.

Kohëzgjatja e dënimit me burg për fëmijë është e rregulluar si vijon (neni 77 i):

a) Për një minimum prej një dite dhe një maksimum prej dymbëdhjetë muajsh në rastin e një personi i cili ende nuk ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së veprës së rëndë dhe

b) Për një periudhë maksimale prej njëzet e katër muajsh për raste të tjera nga ato nën a. (për grupmoshat mbi gjashtëmbëdhjetë vjet).

Burgimi për të mitur caktohet në ditë, javë ose muaj.

Gjoba: (n.77 k. p.1,2,7) Shuma e parave të shqiptuara si gjobë nuk duhet të jetë më pak se pesë guilderë dhe jo më shumë se pesë mijë guilderë. Kur për gjobën e shqiptuar në aktgjykim nuk është bërë pagesa e plotë, gjyqtari mund të urdhërojë burgimin e të miturit si dënim zëvendësues. Periudha e burgimit të të miturve si dënim zëvendësues nuk duhet të jetë më pak se një ditë dhe jo më shumë se tre muaj. Një ditë është e barabartë me pesëdhjetë euro të shumës së mbetur të gjobës së papaguar.

- ***Masa Dërgimi në Institucion për të Rinjtë*** (neni 77s, p.1,2,3,6,7): Gjyqtari mund të shqiptojë masën Dërgimi në institucion për të rinjtë:

a) Kur ka të bëjë me një shkelje të rëndë për të cilën lejohet kujdestaria gjyqësore;

b) Kur siguria e të tjerëve ose siguria e përgjithshme e personave ose e pronës kërkon që masa e tillë të shqiptohet dhe

c) Kur masa është në interes të zhvillimit më të favorshëm të të akuzuarit për të ardhmen.

Gjyqtari do të shqiptojë masën vetëm pas paraqitjes së një mendimi të arsyetuar, të datuar dhe të nënshkruar nga jo më pak se dy ekspertë të sjelljes të disiplinave të ndryshme. Mendimi duhet të jepet bashkërisht nga ekspertët e sjelljes ose nga secili prej tyre veç e veç. Në zbatimin e paragrafit 1, ku i akuzuari ka vuajtur nga çrregullimi mendor ose sëmundje mendore në kohën kur vepra është kryer, një nga ekspertët e sjelljes duhet të jetë psikiatër. Masa zgjat për një periudhë prej dy vjetësh.

Kohëzgjatja fillon pasi aktgjykimi është bërë i formës së prerë. Pas këshillimit me Bordin e Kujdesit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, Ministri i Drejtësisë në ç'do kohë mund ta ndërpresë masën, me kusht ose absolutisht.

- ***Diversiteti dhe alternativat e ndalimit nga policia / burgimit***

Kodi Penal i Holandës dhe Kodi i Procedurës Penale përmbajnë rregulla dhe sanksione që garantojnë se fëmijët do të privohen nga liria vetëm atëherë kur nuk ka mundësi të tjera dhe se alternativat janë zbatuar së pari. Policia dhe prokuroria kanë mundësi të ndryshme për të zgjidhur rastet e të miturve jashtë gjykatës. Policia mund të hedhë poshtë një rast duke dhënë një paralajmërim ose vërejtje dhe duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër. Kur ka shqetësime për fëmiun, për shembull për situatën e tij në shtëpi, policia mund t'iu referohet Shërbimeve për kujdesin e të të rinjve (zorgmelding) (M. Berger, J. Brummelman, 2015).

Një sërë organizatash që punojnë me të rinjtë mund të paraqesin ndërhyrje të reja për sjelljen e të miturive dhe ato ti paraqesin para Komitetit për akreditim (përmes së cilit bëhen shpallje publike të Intervenimeve lidhur me sjelljen e fëmijëve, të cilat cilësohen nga ky Komitet si "'Një program sistematik dhe i strukturuar i procedurave metodologjike që synojnë të ndikojnë në sjelljen ose rrethanat e dikujt", si:

- Agjencitë për Kujdesin Rinor (Bureau Jeugdzorg); Bordi i Leger des Heils / i Kujdesit dhe Provës; HALT; Bordi për Mbrojtjen e Fëmijëve (Byroja Kombëtare); Institucionet kujdestare të të rinjve; Kujdesi për të rinjtë në Holandë dhe Bordi i seksionit të Politikës mbi Drejtësinë për të Rinjtë i Ministrisë së Sigurisë dhe Drejtësisë (DJI) (M. Berger, J. Brummelman, 2015).

Kur rasti arrin deri në një aktgjykim të formës së prerë, gjyqtari ka disa zgjidhje për alternativat e burgimit të fëmijëve, si në vijim:

Llojet e alternativave të privimit nga liria të fëmijëve (M. Berger, J. Brummelman, 2015)**:**

1. **Dërgimi në HALT ("The Alternative")** - Kryesit primar (12-18 vjeç) që pranojnë një shkelje të lehtë mund të drejtohen nga ana e policisë në organizatën e ashtuquajtur HALT, për këto vepra: Vandalizëm, mungesa nga shkolla ose vepra të lehta kundër pasurisë, si vjedhja nëpër shitore apo përdorimi i fishekzjarreve ilegale në javën para Vitit të Ri. HALT përballet me sjelljen e të miturve dhe pasojat e saj duke i bërë ata të kërkojnë falje, kompensim dëmi dhe detyra specifike të mësimnxënies.
   Fëmija duhet të pranojë fajin dhe prindërit janë të përfshirë në mënyrë aktive. Përparësia e HALT është se, ndryshe nga shumica e alternativave, ndërhyrja nuk është e regjistruar në dokumentacionin gjyqësor kombëtar dhe nuk ka pasoja (negative) për të ardhmen e të miturit.
2. **Drejtësia restorative -** Përmendet në nenin 51h të Kodit të Procedurës Penale. Ajo mund të përdoret si pjesë e ndërhyrjes të HALT, por edhe pasi një i mitur është dënuar nga një prokuror ose gjyqtar ose është vendosur në një institucion të kujdestarisë për të mitur.
3. **Metoda ZSM -** Prokuroria mund të merret vetë me rastet me anë të metodës ZSM (metodë e thjeshtë, selektive, e zgjuar dhe e bazuar në shoqëri). Kjo metodë u prezantua në mars të vitit 2011. Në "Tryezën-ZSM", prokuroria bashkëpunon ngushtë me policinë, oficerët e provës, organizata për mbrojtjen e viktimave dhe Bordin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Këta palë të interesuara vendosin drejtpërsëdrejti mbi hapat e ardhshëm, si të merren me rastin dhe, nëse është e mundur, si ta mbyllin atë.
4. **Burgu shtëpiak me mbikqyrje (Elektronik):** Sipas Kodit të Procedurës Penale të Holandës (neni 493 paragrafi 3), privimi nga lira mund të realizohet në "ç'do vend që gjykatësit i duket më i përshtatshëm''. Arrestimi në shtëpi përdoret rregullisht. Një i ri i

dyshuar për një krim qëndron në shtëpi dhe mund të shkojë në shkollë, por do të mbikëqyret nga shërbimi i sprovës së të rinjve ose nga një zyrtar i lagjes.

Arrestimi elektronik është gjithashtu i mundur dhe ekzekutimi i tij duhet të vlerësohet ç'do vit, për të cilin prokuroria duhet të marrë iniciativën.

5. **Burgimi gjatë natës:** Në raste të caktuara gjyqtari mund të vendosë që të miturit në burgim mund të vazhdojnë të shkojnë në shkollë, zanat ose punë. Pas shkollës ose punës, i mituri kthehet në institucionin penitensiar për të mitur.
6. **Shërbimi i komunitetit / Urdhëri për trajnim** [22]: Pezullimi me kusht mund të përfshijë një urdhër të komunitetit në të cilin i mituri duhet të punojë falas ose duhet të marrë pjesë në trajnimin kundër agresionit ose në trajnimin e aftësive sociale.
7. **Marrëveshja për edukim:** Një vendim i ri përgatitet nga qeveria, por ende nuk është në praktikë. Marrëveshja për edukim (arsimim) nënkupton që i mituri i dënuar ka për detyrë të shkojë në shkollë dhe të marrë një kualifikim fillestar. Nëse nuk arrinë sukses, privimi nga liria mund të vendoset.

- **Dënimi (me burg) me kusht:** Burgimi i të rinjve mund të shqiptohet me kusht (neni 77 i Kodit Penal). Kjo do të thotë se i mituri duhet të pranojë kushte që nuk mund të shkelen gjatë një periudhe të caktuar kohore.

  Përfshirja e programeve të trajnimit ose të komunitetit, ndalimi për të vizituar vende të caktuara ose për të takuar njerëz të caktuar, udhëzime intensive nga provimi i të rinjve, programet kundër drogës, masat e sjelljes dhe / ose ndërmjetësimi me viktimën.
- **Poashtu masa "Dërgimi në shtëpi nën mbikëqyrje":** Mund të vendosen disa kushte dhe programe, siç janë raportimi i përditshëm, urdhëri i ndalimit të kontaktit me persona të caktuar ose i vizitës së vendeve të caktura.

[22] *"taakstraf: werk- leerstraf"*

3.5. Drejtësia penale për fëmijë e Konfederatës Zvicerane

Në Zvicër funksionon sistemi i veçantë i drejtësisë penale për fëmijë nga viti 2007, i rregulluar me Ligjin mbi drejtësinë e të miturve dhe Kodin e procedurës penale për të mitur. Bazuar në të dhënat Informative nga Raporti periodik i 2 dhe 4 i Zvicrës i parashtruar në sesionin e 68-të të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, në lidhje me çështjet që ndërlidhen me drejtësinë e të miturve, në vazhdim do të analizojmë pikat kyçe të drejtësisë penale për fëmijë të shtetit zviceran.

Legjislacioni penal zviceran:

Në Zvicër kompetencat në lidhje me fëmijët dhe adoleshentët bien në kantonet. Secili ka politika të ndryshme në këtë drejtim. Qeveria Federale mund të veprojë vetëm në baza plotësuese. Më 20 qershor 2003, Parlamenti miratoi një ligj të ri federal mbi të drejtën penale që zbatohet për të miturit (*Ligji për të Mitur*), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2007. Me këtë akt drejtësia penale për të mitur u veçua nga Kodi Penal i zbatueshëm për të rriturit.

Ligji penal për të mitur i Zvicrës përqendrohet tek autori i veprës dhe jo tek akti; Qëllimi i tij kryesor nuk është dënimi, por reformimi dhe edukimi i të miturit. Poashtu ***Kodi i procedurës penale për të mitur*** ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011. ***Akti i Avancimit të Fëmijëve dhe të Rinjve***, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013, së bashku me Konferencën e Ministrave Kantonal (CDAS) po punojnë në përpjekje të përbashkëta për respektimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijës. Në nivel nacional, Komisioni Federal për Çështjet e Fëmijëve dhe Rinisë monitoron gjendjen e fëmijëve dhe të rinjve në Zvicër (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Ligji federal mbi të drejtën penale që zbatohet për të mitur (JCLA) hyri në fuqi më 1 janar 2007 në të njëjtën kohë me Kodin e ri Penal. Në dispozitat e tij parimi udhëheqës mbetet edukimi. (Swiss Juvenile Criminal Law Act (JCLA) 2007 , 2010)

a. ***Parimet dhe fushëveprimi i Ligjit penal për të mitur (2007)***:

Rëndësi vendimtare gjatë ndjekjes penale të kriminalitetit të të miturve i jepet mbrojtjes dhe edukimit të të rinjve, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë kushteve të jetesës dhe

raporteve familjare së bashku me zhvillimin personal (neni 2 paragrafi 1). Ligji penal i zbatueshëm për të mitur bazohet në supozimin se personaliteti i një kryesi të ri nuk është plotësisht i zhvilluar.

Mosha minimale e përgjegjësisë penale: Një nga risitë kryesore të paraqitura nga ligji i ri federal për të miturit është rritja e moshës minimale të përgjegjësisë penale nga 7 në 10 vjet! Zvicra nuk ka ndërmend të rritë moshën minimale prej 10 vjetësh, edhe pse qëllimi parësor i ligjit penal zviceran nuk është të hakmerret, por të mbrojë dhe edukojë fëmijët dhe adoleshentët. Megjithatë, deri në moshën 15 vjeçe, Ligji penal për të Mitur përcakton vetëm masa mbrojtëse ose dënime të lehta (Qortim/vërejtje ose periudhë deri në 10 ditë të shërbimit të komunitetit), pra, dënimi me burg nuk mund t'u shqiptohet të miturve që nuk kanë mbushur moshën 15 vjeçare (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Kodi penal i zbatueshëm për të miturit zbatohet për personat që në kohën e kryerjes së veprës penale janë ndërmjet moshave 10 dhe 18 vjet (neni 3 paragrafi 1). Këto kufizime moshe janë të fiksuara dhe të pandryshueshme. Nëse disa vepra penale kryhen para dhe pas arritjes së moshës madhore, zbatohet ligji penal i zbatueshëm për të rriturit, përveç nëse procedura të veçanta penale për të miturit tashmë janë inicuar.

II. ***Autoritetet përgjegjëse***: Ligji penal pozitiv për të mitur përcakton autoritetet vijuese kompetente për çështjet penale që lidhen me të mitur: Autoriteti hetues, Autoriteti gjykues dhe Autoriteti ekzekutiv. Procedura dhe autoritetet kompetente ndryshojnë nga kantoni në kanton. Më të zakonshmet janë dy modelet e mëposhtme (Swiss Juvenile Criminal Law Act (JCLA) 2007 , 2010):

- Modeli i gjyqtarit të gjykatës për të mitur- është mbizotërues në të gjitha kantonet frëngjisht-folëse: hetimi, gjykimi dhe ekzekutimi i dënimit i nënshtrohen autoritetit të një gjyqtari të vetëm.
- Modeli i prokurorit për të mitur është gjetur në kantonet gjermano-folëse: Zyrtari përgjegjës për hetimin e rasteve dhe ekzekutimin e dënimeve dhe gjyqtari që vendos për lëndët nuk janë i njëjti person.

III. ***Llojet e sanksioneve: Masat mbrojtëse dhe dënimet***

Ligji pozitiv për të miturit përcakton dy forma të sanksioneve: ***Masat mbrojtëse dhe dënimet***. Nëse personi i ri që ka kryer një vepër penale ka vepruar me qëllimin e kërkuar penal, gjykata do të shqiptojë dënim krahas masës mbrojtëse (neni 11, paragrafi 1).

1. **Masat e mbrojtjes**: Ligji penal i Zvicrës parashikon katër lloje të masave mbrojtëse të dizajnuara për t'iu përshtatur nevojave të ndryshme të të rinjve:

- Mbikëqyrja;
- Kujdesi personal;
- Kujdesi medicinal në liri ("out-patient care") dhe
- Vendosja e të miturit tek një person fizik ose në një institucion edukues.

Në të gjitha rastet, autoriteti kompetent mund të urdhërojë ndryshimin e masës. Masat mbrojtëse përfundojnë më së voni, kur i mituri arrin moshën 22 vjeç. Në ç'do rast, autoriteti ekzekutiv duhet të bëjë një shqyrtim vjetor nëse dhe kur masa mund të ndërpritet.

1.1 ***Mbikëqyrja dhe kujdesi personal*** (nenet 12 dhe 13): Me këtë masë, shteti ka të drejtë të ndërhyjë në jetën familjare të kryesit (kryesisht në autoritetin prindëror) me qëllim që të sigurohet zhvillimi normal, edukimi dhe arsimimi i të rinjve në fjalë. Kujdesi personal konsiderohet si një formë më e rreptë e mbikëqyrjes për rastet kur mbikëqyrja e thjeshtë nuk është e mjaftueshme. Qëllimi i masës është kryesisht edukimi i të rinjve, më shumë se që të ofrojë ndonjë formë terapie për to.

1.2 ***Trajtimi medicinal në liri*** (neni 14): Kjo masë zbatohet ndaj të miturit në konflikt me ligjin që vuajnë nga çrregullime psikike, kanë probleme në zhvillimin e personalitetit ose që janë të varur nga lëndë narkotike ose kanë varësi të tjera. Qëllimi është të i'u ofrohet trajtim të rinjve, pa pasur nevojë të monitorohen ato vazhdimisht. Trajtimi medicinal mund të kombinohet me ndonjë nga tre masat e tjera mbrojtëse.

1.3 ***Vendosja në një ent edukues*** (neni 15): Kjo masë shqiptohet nëse kujdesi i të rinjve kërkon mbikëqyrje dhe kontroll afatgjatë. Kjo masë përfshin vendosjen e kufizimeve të mëdha në lirinë e të miturit në fjalë dhe imponohet vetëm nëse një vlerësim mjekësor ose

psikologjik tregon se është e nevojshme. I riu vendoset në një institucion të hapur, ose nëse është thelbësore për trajtimin dhe mbrojtjen e tij ose për mbrojtjen e sigurisë publike, në një institucion të sigurtë.

Autoriteti ekzekutiv rregullon kontaktin personal që prindërit dhe personat e tjerë kanë me të miturin për kohëzgjatjen e vendosjes. Përveç kësaj, i mituri nuk mund të ndahet nga të rinjtë e tjerë për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se shtatë ditë. Nëse kryesi është mbi moshën 17 vjeç, masa mund të ekzekutohet në një institucion për të rriturit e rinjë siç përcaktohet në n.61 të Kodit penal Zviceran.

2. *Dënimet për të mitur*

Ligji penal për të miturit përcakton katër lloje të dënimeve:

- Qortimi,
- Urdhëri për punë personale,
- Gjoba dhe
- Burgimi.

Këto dënime shqiptohen vetëm nëse i mituri ka vepruar me qëllimin e kërkuar penal (neni 11, paragrafi 1). Shqiptimi i dënimeve ka qenë i mundur vetëm pasi që Ligji penal për të mitur hyri në fuqi (2007). Më parë gjykata shqiptonte vetëm masa mbrojtëse, pavarësisht nga shkalla e fajsisë së sjelljes së të miturit (Swiss Juvenile Criminal Law Act (JCLA) 2007 , 2010).

Çdo dënim është me kohëzgjatje të kufizuar dhe zbatohet deri sa është duke u ekzekutuar. Në ç'do rast dënimi përfundon më së voni kur i mituri i dënuar mbush moshën 25 vjeçare (Parashkrimi absolut, neni 37, paragrafi 2). Gjykata mund të heqë dorë nga shqiptimi i një dënimi (n.21).

2.1 ***Qortimi/ Vërejtja*** (neni 22): Qortimi është dënimi më i butë. Një qortim është një tërheqje e vërretjes formale ndaj sjelljes së të miturit dhe duhet t'i mundësojë atij të kuptojë fajin e tij dhe të konsiderojë sjelljen e tij të ardhshme.

2.2 ***Urdhri për punë personale*** (neni 23): Urdhëri për punë personale është i ngjashëm me dënimin Shërbimin ndaj komunitetit sipas ligjit penal të zbatueshëm për të rriturit. Kjo është një alternativë e mirëfilltë e dënimit me burgim dhe jo vetëm që luan një rol në edukimin e kryerësit, por përfshin edhe riparimin e sjelljes së tij.

2.3 ***Gjoba*** (neni 24): Karakteristika specifike e gjobës është se ajo mund të shqiptohet vetëm për të miturit të moshës 15 vjeç e lartë. Në krahasim me dënimin Punë personale, aspekti edukativ i gjobës është minimal.

2.4 ***Burgimi*** – Format e dënimit me burgim (neni 25): Dënimi me burg është masa e fundit represive që zbatohet për të miturit dhe njejtë sikurse edhe gjoba, mund të shqiptohet vetëm për të miturit që kanë mbushur moshën 15 vjeçe.

- Dënimi maksimal i burgimit për një të mitur 15 vjeç është *një vit*, kurse për ata të moshës 16 ose më shumë është deri *katër vjet*.
- Dënimi i burgimit ofrohet në institucione për të mitur, në të cilin ç'do të riu i jepet kujdesi edukativ i përshtatshëm për personalitetin e tij duke e përgatitur për rikthimin e tij në shoqëri.
- Një dënim i pacaktuar i burgimit *deri në një vit* mund të jepet në formë të ***gjysmë-burgimit***;
- Dënimi me burg deri në ***një muaj*** mund të ekzekutohet ose ditë pas dite ose në formën e gjysmë burgimit.
- Dënimi me burg deri në ***tre muaj*** mund të shndërrohet në një urdhër pune personale. Nga ky nen mund të përfundojmë kohëzgjatjen maksimale të dënimit me burgim për të mitur, sipas të cilit deri në një vit për të miturit 15 vjeçar deri në katër vjet për ata që kanë qenë 16 vjeçar në kohën e kryerjes së veprës dhe kur vepra penale është shumë e rëndë.

Gjatë periudhës Janar 2008 - Dhjetor 2011, kohëzgjatja mesatare e burgimit ishte 29 ditë për të rriturit dhe 43 ditë për të miturit. Megjithatë, prej 367 të miturve të burgosur, 204 ishin në burgim për jo më shumë se katër ditë! (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Veçimi i fëmijëve nga të rriturit: Edhe pse Ligji i ri federal i Procedurës Penale për të mitur siguron që të miturit duhet të ndahen nga të rriturit gjatë paraburgimit dhe gjithashtu në burgje, Zvicra ka një rezervë lidhur me nenin 37 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve mbi ndarjen e të miturit dhe të rriturit në paraburgim! Një rezervë që shteti pohon se nuk mund të tërhiqet për momentin, sepse ekziston një periudhë kalimtare prej 10 vjetësh (e themeluar në vitin 2007 me reformën e Ligjit penal për të mitur) për krijimin e institucioneve të nevojshme dhe të përshtatshme për heqjen e lirisë së të miturit, një periudhë kohore që nuk ka kaluar ende.

Disa nga kantonet kanë krijuar tashmë këto institucione, por sipas nenit 48 të Ligjit penal për të mitur, kantonet kishin obligim deri në fund të vitit 2017 të krijojnë institucionet e nevojshme për vendosjen e të miturve dhe për burgimin e të miturve dhe deri në atë periudhë kohore, ndarja e të rinjve të privuar nga liria nga të rriturit do të duhej të jetë e plotë (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Kushtet e gjykimit: Në Kantonin e Solothurn, Departamenti i Policisë lëshoi një direktivë të re për trajtimin e të miturve pasi një numër i prindërve parashtruan një ankesë pasi nuk ishin informuar kur fëmijët e tyre u mbajtën në një stacion policor gjatë natës për verifikim ose identifikim. Direktiva e re thekson shprehimisht që kujdestaria policore duhet të urdhërohet vetëm si "Resor i fundit" dhe kjo paraqet një rregull që të rinjtë se nuk duhet të shoqërohen me pranga. Gjithashtu përcakton se nëse një i mitur duhet të merret në një stacion policor, kujdestari i tij ligjor duhet të informohet menjëherë. Sipas Kodit të Procedurës Penale për të mitur, i pandehuri i mitur ose kujdestari i të miturve ka të drejtë të caktojë mbrojtës në ç'do kohë, por nuk ka asnjë garanci se një ndihmë e tillë do të jetë pa pagesë (lidhur me këtë dispozitë, Këshilli Federal nuk ka ndërmend ta ndryshojë atë). Nenet 10, 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit Federal për të mitur përfshijnë mundësinë që një i mitur i cili ka kryer një vepër penale, pavarësisht nëse ka qenë fajtor ose jo, ti shqiptohet masë mbrojtëse (Ndihmë personale ose trajtim mjekësor ose Vendosje në një institucion) në varësi të nevojave të fëmijës. Kodi i ri i Procedurës Penale për të Mitur u jep të drejtë të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor të përdorë shërbimet e avokatit mbrojtës në ç'do kohë gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Masat alternative: Autoritetet mund të përmbahen nga inicimi i procedurës penale ose ta pezullojnë atë, nëse arrihet një marrëveshje ndërmjet palës së dëmtuar dhe kryerësit të mitur nëpërmjet ndërmjetësimit. Autoriteti kompetent gjithashtu mund të përmbahet nga inicimi i procedurës penale ose shqiptimi i një dënimi nëse plotësohen disa kushte të tjera ligjore (neni 5 i Kodit të Procedurës Penale për të mitur dhe neni 2 i Ligjit Penal për të Mitur). Aktualisht, ***Ndërmjetësimi*** është në fillimet e tij në shumicën e kantoneve zvicerane, duke ndjekur shembullin e praktikave më të mira të Urdhrit të Ndërmjetësimit në kantonin e Fribourg-ut. Sipas nenit 4 (2) të Ligjit të ri të Procedurës Penale për të Mitur, shprehimisht proklamohen të drejtat themelore të fëmijës, veçanërisht e drejta për t'u dëgjuar, e cila duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurës (Summary of Juvenile Justice related issues, 2015).

Rezultate nga Studimi i dytë ndërkombëtar mbi vetë-raportimin e delikuencës në Zvicër për vitin 2006[23]:

ISRD-2 zvicerane përfshin një mostër kombëtare të rastit prej më shumë se 3,000 të miturve që ndiqnin klasën e shtatë, të tetë dhe të nëntë, që korrespondon përafërsisht me moshën 13 deri në 16 vjeç. (M Killias, M F. Aebi, L.Herrmann, C. Dilitz, S. Lucia, 2010).

Një krahasim mes veprimeve delikuente të vetë-raportuara në vitit 1992 dhe atyre në studimin e dytë të vitit 2006 tregohet një rritje në këto akte: Mungesa e paarsyetuar nga shkolla, vjedhjet e automjeteve, grabitje/plaçkitje, vjedhje dhe shitje të drogës. Vjedhja nëpër shitore ka rënë ndjeshëm, mesiguri sepse është bërë shumë më e ndërlikuar gjatë 15 viteve të fundit për shkak të përmirësimit të teknologjive të sigurisë. Ekziston gjithashtu një reduktim i lehtë në normat e mbajtjes së një arme. Kjo mund të shpjegohet me një ndryshim të legjislacionit në vitin 1999, i cili bëri të paligjshëm aktin e nxjerrjes e armëve në publik. Sulmi është rritur, edhe pse jo në mënyrë të konsiderueshme.

[23] Studimi ISRD-2 "International Self-Report Delinquency" i publikuar në vitin 2010, i realizuar në 32 shtete në botë, mes tyre edhe në Zvicër.

Kur kantoni i Zyrihut (zona më urbanistike e Zvicrës) krahasohet me pjesën tjetër të vendit, nuk ka dallim në përdorimin e substancave (alkool, marihuanë / hashash dhe droga të forta), ndërsa normat për vandalizëm dhe veprat e rralla të dhunshme ishin dukshëm më të larta. Në kantonin e Cyrihut të rinjtë urbanë janë gjithashtu më shpesh viktima se ato në pjesën tjetër të Zvicrës, veçanërisht në vjedhje dhe grabitje (M Killias, M F. Aebi, L.Herrmann, C. Dilitz, S. Lucia, 2010).

Sipas analizave të këtij studimi, kryesi "tipik" i ri është një mashkull, ka vetëkontroll të ulët, shpesh nuk arrin të ndjekë shkollën, i përket një grupi prej të paktën tre miqsh dhe jeton në një lagje problematike. Shpesh, ai ka përjetuar ngjarje traumatike të jetës dhe mbikëqyrje të dobët prindërore. Angazhimi i tij në kriminalitetin e dhunës dhe asaj të pronës, si dhe përdorimi i drogës do të rritet me moshën.

Për disa vepra penale, një përkushtim i dobët ndaj shkollës dhe një marrëdhënie e dobët me prindërit gjithashtu luajnë një rol të madh. Variablat e tjerë, siç janë statusi i emigrantëve, pasuria familjare, përbërja e familjes, dështimi i shkollës, lagja dhe papunësia e prindërve, nuk lidhen me delikuencën nëse mund të kontrollohen variablat e tjerë. Delikuenca është e lidhur qartë me mundësitë delikuente në mjedis, si dhe shkallën e kontrollit prindëror. Prandaj, nuk është e çuditshme të gjesh problemet e mungesës së shkollës dhe të lagjes për t'u lidhur ngushtë me delikuencën. Kjo sugjeron që problemet e lagjes janë shumë më të rëndësishme se lidhjet emocionale me zonën lokale. Si përfundim, delikuenca duket të jetë së pari në lidhje me strukturat e mundësive në mjedisin fizik dhe social (M Killias, M F. Aebi, L.Herrmann, C. Dilitz, S. Lucia, 2010).

Në vazhdim, do të paraqiten disa komente (shqetësime) kyçe lidhur me administrimin e drejtësisë zviceriane për të mitur nga publikimi zyrtar "Observime përfundimtare nga Raporti i dytë dhe i katërt i Raporteve periodike të Zvicrës" i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (pika 72) (në mbledhjet e mbajtura më 21, 22 dhe 30 janar 2015)[24]:

[24] UN Committee on the Rights of the Child (CRC), *Concluding observations on the combined second to fourth periodic reports of Switzerland*, 26 February 2015, CRC/C/CHE/CO/2-4, available at: http://www.refworld.org/docid/566e80214.html [accessed 10 August 2017]

- Mosha minimale e përgjegjësisë penale ende mbetet nën Standardet e pranueshme ndërkombëtare, prandaj shprehet kërkesa për ngritjen e moshës minimale për përgjegjësi penale, të paktën në 12 vjet, si standard ndërkombëtar.

- Përdorimi i terminologjive të ndryshme kur flitet për interesin më të mirë të fëmijës dhe atë që përdoret në legjislacionin zviceran në baza normale. Kjo çon në koncepte të gabuara.

- Mungesa e harmonizimit ndërmjet legjislacionit të kantoneve të ndryshme lidhur me të drejtat e fëmijës.

- Ndihma juridike falas për fëmijët nuk është gjithmonë e garantuar, prandaj Komiteti kërkon që të sigurohet për të gjithë fëmijët të kenë qasje në të drejta të disponueshme ose të përshtatshme për ndihmë.

- Pasi që vetëm disa avokatë mbrojtës janë të specializuar në të drejtën penale të të miturve dhe në procedurat, nga Komiteti kërkohet që të sigurojë që të gjithë personat e përfshirë në administrimin e drejtësisë për të mitur, përfshirë avokatët mbrojtës të marrin trajnime të përshtatshme.

- Fëmijët ende nuk janë të ndarë nga të rriturit në qendrat e paraburgimit, prandaj Komiteti kërkon nga Zvicra që të përshpejtojë procesin e krijimit të objekteve adekuate të paraburgimit për të siguruar që fëmijët nuk janë të ndaluar me të rriturit.

3.6. Drejtësia penale për fëmijë e Norvegjisë

Norvegjia nuk ka një sistem të veçantë penal që e rregullon drejtësinë për fëmijë veçmas nga ajo për kryesit madhorë të veprave penale, pra nuk ka një ligj të veçantë që do të rregullonte drejtësinë për fëmijë ndaras nga Kodi penal. Çështjet si: Mosha e pëgjegjësisë penale; Llojet e sanksioneve penale që mund të i'u shqiptohen kryesve jomadhorë dhe kushtet për shqiptimin e tyre; procedura penale për fëmijë si dhe procedura të veçanta që lidhen me drejtësinë restorative, ekzekutimi i sanksioneve penale ndaj fëmijëve të gjykuar - rregullohen me disa ligje penale të vendit. Në këtë drejtim, për të pasqyruar më qartë të gjitha këto tema të lartëpërmendura dhe si rregullohen ato, do të analizohen dispozitat ligjore pozitive të shtetit norvegjez, respektivisht Kodi penal, Ligji për zgjidhjen e konflikteve (Ligji mbi Mediacionin) dhe Ligji i procedurës penale.

a. Historia e legjislacionit penal norvegjez

Më 1 tetor të vitit 2015 hyri në fuqi Kodi penal i ri norvegjez - Lov om straff[25]. Në fakt, kodi u miratua në vitin 2005, por ai ishte vënë në pritje deri në vitin 2015. Në Norvegji, ky është kodi i tretë penal "modern" që kur sistemi ligjor norvegjez kishte marrë bazën e tij kushtetuese në vitin 1814. Kodi i ri reflekton sfondin kontinental të së drejtës penale norvegjeze. Shumë nga idetë, konceptet dhe parimet bazë kanë ngjashmëri me ato të vendeve të tjera nordike, si dhe të së drejtës penale gjermane. Në të njëjtën kohë, sistemi juridik norvegjez ka veçoritë e tij, të cilat gjithashtu pasqyrohen në kodin e ri penal. Kodi mbulon mbi 400 nene. Kodi penal i vitit 1842 ishte një kod penal 'klasik'. Ai u ndikua kryesisht nga kodet bashkëkohore penale në kontinent, ndër të cilat ishte Kodi Penal francez i vitit 1810. Më vonë, kodi i vitit 1842 u zëvendësua me kodin penal të vitit 1902. Ky i fundit ishte pjesë e një projekti më të madh të modernizimit në sistemin e drejtësisë penale norvegjeze. Një kod i ri i procedurës penale u miratua në 1887, i cili gjithashtu prezantoi sistemin e jurisë në Norvegji (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015).

Historia legjislative e kodit penal norvegjez të vitit 2005 filloi në shtator 1980, kur Komisioni Legjislativ i kodit penal u caktua për të kryer një rishikim të plotë të të drejtës penale

[25] Kodi penal i Norvegjisë 2005-05-20-28 (Lov om Straff).

norvegjeze, si dhe për të hartuar një kod krejtësisht të ri penal. Shqyrtimet e Komisionit çuan në propozimin për një kod të ri penal, të sugjeruar nga Ministria e Drejtësisë (2003-2004). Kjo çështje u shqyrtua më tej nga Komiteti i Përhershëm i Parlamentit Norvegjez për Drejtësi (2004-2005). Rezoluta u miratua nga Parlamenti norvegjez në prill 2004 (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015).

Megjithatë, akti që do të fuqizonte kodin e ri penal nuk u miratua deri më 19 qershor 2015. Ky akt çoi në hyrjen në fuqi të kodit penal në 1 tetor 2015. Periudha jashtëzakonisht e gjatë kohore mes miratimit të kodit dhe hyrjes së tij në fuqi ishte për shkak të arsyeve pragmatike. Pretendohet se sistemet kompjuterike të aplikuara nga autoritetet policore nuk ishin në gjendje të trajtonin kodin e ri sepse kishte nevojë për zgjidhjen e sfidave teknike. Meqenëse kodi i ri penal është tashmë dhjetë vjeç, disa ndryshime dhe shtesa janë bërë që nga miratimi i kodit në 2005. Kodi ende po zhvillohet, me sugjerime për disa ndryshime (2015-2016), të cilat mund të çojnë në zgjerimin e përgjegjësisë penale për rrëmbimin e fëmijëve (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015). Deri në një farë mase Kodi sjell shenja të një ndikimi më të fortë të ideve retributive. Sipas ligjvënësit ekziston një nevojë sociale për reagime ndaj krimit, një nevojë që duhet të plotësohet për të shmangur trazirat sociale. Veçanërisht në lidhje me dhunën dhe krimet seksuale, ligjvënësi ka kërkuar një rritje të dënimit në mënyrë që këto të plotësohen me një reagim proporcional (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015).

Struktura e kodit penal të vitit 1902 është zgjeruar në masë të madhe me kodin e vitit 2005: Ajo ndahet në pjesën I-rë me dispozitat e përgjithshme të Kodit dhe pjesa II-të ku janë përcaktuara veprat penale. Në nenin 20 përcaktohet se kryerësi duhet të jetë psiqikisht i shëndoshë në kohën e veprës penale. Kryesi shfajësohet nga përgjegjësia penale nëse ai është nën moshën 15 vjeçe, psikotik, me aftësi të kufizuara mendore ose pa vetëdije në kohën e veprimit. Në veçanti, alternativa e psikozës është debatuar së fundmi pas rastit të Breivik! (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015).

b. **Format e ndëshkimit dhe dënimit:**

Sipas parimit të ligjshmërisë, është detyrë e ligjvënësit të përcaktojë në ligj llojin dhe masën e sanksionit që duhet të zbatohet në reagimin ndaj shkeljeve me veprën penale të përshkruar.

Pra, me ligj përcaktohet vepra penale dhe nëse ajo mund të sanksionohet me gjobë ose me burgim, ose të dyja. Megjithatë, një sërë sanksionesh të tjera janë gjithashtu në dispozicion sipas dispozitave të përgjithshme të Kodit penal.

Llojet e dënimeve në Kodin penal janë (n.29):

- Dënimi me burg;
- Sigurimi i mbikëqyrjes së përforcuar;
- Puna në dobi të përgjithshme(për komunitetin);
- Dënimet për të mitur;
- Gjoba dhe,
- Humbja e të drejtës për ushtrim të pozitës, profesionit apo biznesit .

Reagime të tjera ndaj krimeve janë (n. 30 a -f): *Shtyerja e dënimit; Pezullimi i dënimit; Dërgimi në trajtimin e detyrueshëm psikiatrik; Dërgimi në përkujdesje të detyrueshme; Konfiskimi i të ardhurave të fituara nga vepra penale; Pushimi i procedurës penale.*

Përveç kësaj si masa të veçanta parashihen: *Procedura e pajtimit në Bordin e zgjidhjes së konflikteve; Urdhëri për ndjekje nga Bordi i zgjidhjes së konflikteve; Mbikëqyrja e të miturve në Bordin e zgjidhjes së konflikteve; Humbjen e të drejtës për të vozitur dhe humbjen e të drejtës për të vozitur udhëtarët për kompensim (n. 30 g -h).*

Kapitulli 6 i Kodit rregullon dënimin me burg. Dënimi me burg mund të shqiptohet kur përcaktohet në dispozitat përkatëse penale. Dënimi me burgim shqiptohet për një periudhë të caktuar kohe, (n.31). Dënimi minimal është 14 ditë, përveç nëse specifikohet ndryshe. *Dënimi me burgim mund të shqiptohet për kryesit e moshës nën 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës, nëse kërkohet për atë vepër penale veçanërisht dënimi me burgim. Në këto raste kohëzgjatja e burgimit nuk mund të kalojë 15 vjet* (n. 33).

Puna në dobi të përgjithshme (e komunitetit), dënimi me gjobë dhe humbja e të drejtave civile mund të shqiptohen së bashku me dënimin me burg, (n. 32). Dënimi mund të pezullohet për një kohë të provës, e cila zakonisht është dy vjet (n.34). Pezullimi i ekzekutimit të dënimit jepet vetëm me kushtin themelor që kryerësi mos të kryejë vepra të reja në periudhën e provës.

Në kapitullin 8 të Kodit janë të përcaktuara dispozita mbi dënimet që kanë të bëjnë me punën për komunitetin. Kjo formë e dënimit zëvendësoi shërbimin e komunitetit në Maj të vitit 2002. Puna në interes të komunitetit mund të shqiptohet vetëm kur zëvendësohet dënimi me burgim jo për më shumë se një vit. Ajo mund të imponohet edhe në disa situata të tjera, siç është kur autori i veprës penale është nën moshën 18 vjeç ose kur ka arsye të tjera bindëse për shqiptimin e këtij dënimi. Dënimi Puna në interes të komunitetit mund të zgjasë nga 30 deri në 420 orë, dhe duhet të përcaktohet një dënim me burg shtesë. Koha e përfundimit zakonisht korrespondon me dënimin me burg shtesë. Kushtet e mëtejshme, si ndalimi i kontaktit me njerëz të caktuar, mund t'i shqiptohen kryerësit si pjesë e këtij dënimi (punës për komunitetin) (n. 50).

- ***Ndëshkimi i të miturve (ungdomsstraff) rregullohet në kapitullin 8a të Kodit penal***.

Ndëshkimi i të miturve është një novelë në të drejtën penale norvegjeze. Është rezultat i një theksimi më të madh në kujdesin ndaj fëmijëve dhe efektet e dëmshme që mund të vijnë pas burgimit. Tendencat janë që të zbatohen idetë ***e drejtësisë restorative*** në një masë shumë më të madhe se më parë, për shembull përmes dënimit të lartpërmendur – Puna për komunitetin.

Dënimi me burg i të miturve mund të shqiptohet për kryerësit e moshës nën 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale dhe që kanë kryer krime të përsëritura ose serioze (n. 52a). Kryerësi duhet të pajtohet me të (dënimin) dhe të banojë në Norvegji. Kështu, për të respektuar në mënyrë të duhur qëllimin e drejtësisë penale, nuk duhet me forcë të kërkohet burgimi për të miturit. Përmbajtja e dënimit për të mitur është përpunuar më tej në Ligjin mbi ekzekutimin e dënimeve të vitit 2014[26], në kapitullin e 4-të (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015).

Puna e Komisionit për pajtim (Mediacion) në Bordin e zgjidhjes së konflikteve, i shoqëruar nga Bordi i zgjidhjes së konflikteve dhe mbikëqyrësit e të miturve në Bordin e zgjidhjes së konflikteve, rregullohet në nenin 71a të Kodit të Procedurës Penale. Këto reagime mund të vendosen vetëm nëse trajtimi i tillë konsiderohet i përshtatshëm në këtë rast, dhe viktima, i

[26] Act 2001-05-18-21 on the execution of punishment (straffegjennomføringsloven)

pandehuri dhe përfaqësuesit e tij ligjor pajtohen me atë. Mbikëqyrja për të mitur mund të caktohet kur kryerësi ka qenë në moshën 15 deri në 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale dhe kohëzgjatja e mbikëqyrjes së tillë është deri në një vit (JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK, 2015). Nga viti 2012 legjislacioni norvegjez ka pësuar ndryshime në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin. Dënimet e reja për të mitur kanë pasur për qëllim zvogëlimin e numrit të të burgosurve të rinjë në moshë ndërmjet 15 dhe 18 vjeç. Një tjetër synim është t'u jepet një kuptim më i mirë dënimeve për të mitur për pasojat e veprimeve të tyre. Një lloj i ri i "burgut për të mitur", i cili fuksionon në dy njësi të posaçme për të miturit e vjetër nga mosha 15-18 në Oslo dhe Bergen, është planifikuar sipas nevojave të të rinjve. Janë miratuar gjithashtu një numër ndryshimesh të tjera legjislative në lidhje me shkelësit e ligjit të moshës ndërmjet 15 dhe 18 vjetësh, veçanërisht ato ndryshime që synojnë forcimin e të drejtave të të rinjve pas arrestimit. Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi në janar 2012.

Në të njëjtën kohë, autoritetet penale e kanë vendosur ***drejtësinë restorative*** si një pikë kyçe në të gjitha angazhimet e vëzhgimit të fëmiut në burg (2013). Përveç kësaj, legjislacioni i ripërtërirë lidhur me Shërbimin Norvegjez të Mediacionit dhe drejtësisë restorative çon drejtë një organizimi të ri tek të gjitha çështjet penale që kanë të bëjnë me të mitur (2014) (Hydle, 2014).

c.Ligji për zgjidhjen e konflikteve (Ligji mbi Mediaconin)[27]

Përmbajtja dhe implementimi i dënimeve për të mitur dhe vëzhgimi i të rinjëve rregullohen me kapitullin e 4-të të Ligjit për zgjidhjen e konflikteve. Reagimet ndaj dënimit të të rinjve dhe ndjekja e të rinjve përbëhen nga zbatimi i një takimi të të rinjëve, përgatitja e një plani individual të përshtatur dhe ndjekja e atij plani(n.22).

Në rastin e dënimit të të miturit, gjykata do të përcaktojë periudhën e ekzekutimit (Kodi Penal n. 52a - 52c). Periudha e ekzekutimit mund të jetë nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

[27] Ligji mbi Mediacionin, 2014 (Lov om konfliktrådsbehandling-konfliktrådsloven)

(Law on conflict management (the Conflict Act), Short title Mediation Act, LOV-1902-05-22-10 , LOV-1980-06-13-24 , LOV-1981-05-22-25 , LOV-1991-03-15-3 , LOV-1999-03-26-14 , LOV-1999-07-02-64 , LOV-2001-05-18-21 , LOV-2005-05-20-28 , LOV-2009-06-19-58 , LOV-2010-05-28-16

Nëse dënimi me burgim që do të ishte shqiptuar më gjatë se dy vjet, mund të caktohet një periudhë përfundimi deri në tre vjet (n.23).

"Takimi i të rinjëve": Këshilli për zgjidhjen e konflikteve fillon përgatitjen e një takimi mes të rinjëve sapo çështja të jetë transferuar nga gjykata. Takimi i të rinjve kryesohet nga një koordinator i cili do të sigurojë që aktorët relevantë të përfaqësohen. Këto mund të përfshijnë përfaqësues nga shërbimet korrektuese, shkolla, shërbimet mbi mirëqenien e fëmijës, shëndetësisë dhe shërbimeve të kujdesit ose të tjerët të cilët kanë lidhje me të dënuarin, viktimën apo me rastin. Gjatë ekzekutimit të dënimit për të mitur, në mbledhjen e të rinjve duhet të jenë të pranishëm oficerë të caktuar, përfaqësues të prokurorisë dhe policisë. Kujdestarët e palëve kanë të drejtë të jenë të pranishëm. E njëjta vlen edhe për avokatin e emëruar.

Gjatë realizimit të ndjekjes së të rinjve, personi i dënuar dhe viktima duhet të jenë të pranishëm në mbledhjen e të rinjve. Kujdestarët e palëve kanë të drejtë të jenë të pranishëm. Përfaqësuesit e policisë do të marrin pjesë në qoftë se Këshilli i Mediacionit e sheh të përshtatshme. Nëse viktimat dhe i dënuari nuk janë në gjendje ose nuk duan të jetë të pranishëm, koordinatori i të rinjëve do të vlerësojë nëse mund të emërohet një përfaqësues i përkohshëm në përputhje me kushtet ligjore. Takimi i të rinjve mund të ndahet në disa takime nëse është e nevojshme (n.24).

Plani për "takimin e të rinjëve" (n.25):

Në "takimin e të rinjve" duhet të hartohet një plan. Plani duhet të miratohet nga koordinatori i të rinjve, i dënuari dhe nga viktima. Plani mund të përfshijë dënimin ose kufizimet si më poshtë:

A) Mundësimi i kompensimit (zhdëmtimit) jofinanciar personit i cili ka pësuar një dëmtim, humbje ose kundërvajtje tjetër;

B) Merrja pjesë në programet e parandalimit të krimit ose masa të tjera të ngjashme;

C) Kryerja e detyrave të dobishme shoqërore;

D) Respektimi i dispozitave për vendbanimin, punën ose trajnimin;

E) Takimi me policinë ose shërbimin e prokurorisë;

F) Largimi nga përdorimi i alkoolit dhe drogave të tjera dehëse ose anestezike dhe sigurimi i testeve të nevojshme;

H) Shmangja e kontaktit me njerëz të caktuar etj.;

Në rastin e dënimit të të miturit, plani mund të përfshijë edhe personin e dënuar që qëndron në një institucion ose që i nënshtrohet ndonjë trajtimi tjetër. Koordinatori i të rinjve është përgjegjës për zbatimin e planit.

Ekipi i ndjekjes (përcjelljes) (n. 26):

Ekipi i përcjelljes është përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara me planin për të rinjtë. Ekipi i përcjelljes udhëhiqet nga koordinatori i të rinjve dhe përbëhet nga gardianë, të dënuar ose të dëmtuar dhe të tjerë që kanë detyra në lidhje me zbatimin e planit të të rinjve. Koordinatori i të rinjve mund të kërkojë edhe përfshirjen e personave të tjerë të lidhur me personin e dënuar, viktimën ose me çështjen penale. Në rastin e dënimit të të mitur, përfaqësuesit e policisë janë pjesëmarrës të detyrueshëm në ekipin pasues.

Urdhrat e përgjithshëm ndaj personave të dënuar:

I dënuari ose viktima duhet të marrë pjesë në takimin e të rinjve, në bashkëpunim me ekipin përcjellës dhe në takimet apo marrëveshjet e tjera, siç përcaktohet në Plan: Takimi në kohën dhe vendin e caktuar; Të mos jetë i ndikuar nga alkooli ose pijet alkoolike ose anestetikë; Nuk duhet të tregojnë një sjellje që mund të kërcënojë sigurinë e personave që marrin pjesë në zbatimin e planit ose që ndikojnë negativisht në mjedis; Të mos kryen vepra penale të reja gjatë periudhës së ekzekutimit të dënimit; Të mos qëndrojë jashtë vendit gjatë periudhës së ekzekutimit, përveç nëse koordinatori i të rinjve i jep leje (neni 27).

Ndalimi i përdorimit të alkoolit ose substancave të tjera dehëse ose anestetike:

Nëse është e nevojshme për të luftuar një vepër penale të re kundër jetës, shëndetit ose lirisë së dikujt, në ç'do kohë gjatë periudhës së ekzekutimit, koordinatori i të rinjve mund të ndalojë të dënuarit ose të akuzuarit për përdorimin e alkoolit ose agjentëve të tjerë të

dehidrimit ose anestezisë. Koordinatori i të rinjve do të heqë ndalimin kur nuk është më i nevojshëm(neni 28).

Kufizimet: Nëse plani i takimit të të rinjve i është nënshtruar nenit 25 (f) i cili u trajtua më lartë, ose koordinatori i të rinjve i ka ndaluar të dënuarit ose të akuzuarit përdorimin e alkoolit ose substancave dehëse ose anestezike sipas nenit 28 (të trajtuar më lartë), koordinatori i të rinjve do të shqyrtojë nëse kushti ose ndalimi është plotësuar. Përcjellja mund të përfshijë vizita të panjoftuara në shtëpi. Kur vendoset një ndalim, koordinatori i të rinjve mund të urdhërojë të dënuarin ose viktimën që të japë një test të urinës, të nxjerrë provën ose testin e gjakut ose të kontribuojë në një ekzaminim tjetër që mund të ndodhë pa rrezik ose shqetësim të veçantë (neni 29).

Shtyerja e ekzekutimit të dënimit: Koordinatori i të rinjve mund të shtyjë zbatimin e dënimit ndaj të riut ose ndjekjen e të miturit nëse gjendja e personit të dënuar ose të akuzuar këtë e kërkon ose përndryshe ka arsye veçanërisht të vështira që e bëjnë të vështirë realizimin e ekzekutimit. Në rast të dënimit të të miturit, koordinatori i të rinjve, kur ta sheh të nevojshme që ndërprerja të jetë e sigurtë dhe me pëlqimin e pjesëmarrësve të detyrueshëm në takimin e të rinjve dhe ekipin përcjellës, mund të përcaktojë kushtet e përmendura në nenin 31 që është trajtuar në vazhdim (neni 30).

Shkeljet gjatë ekzekutimit të dënimit për të rinjët (n. 31): Nëse personi i dënuar, me dashje ose me neglizhencë shkel dispozitat, respektivisht obligimet e përcaktuara të nenit 25, paragrafët 1,2, n. 27 ose 28, paragrafi 1 (të paraqitura më lartë), koordinatori i të rinjve mund të urdhërojë personat e dënuar të ndjekin një bisedë për të diskutuar lidhur me shkeljet e reja. Gjatë bisedës, personi i dënuar duhet të njoftohet për pasojat e shkeljeve të përsëritura. Nëse duket e nevojshme për të luftuar shkeljet e reja, koordinatori i të rinjve, me pëlqimin e pjesëmarrësve të detyrueshëm në mbledhjen e të rinjve dhe ekipin përcjellës, përcakton detyrime ndaj personit të dënuar, si:

a. Të sillet në pajtim me rregulloret e qëndrimit;
b. Mos kontakti me njerëz të caktuar;
c. Mos të përdorë alkool ose substance të tjera;
d. Takimi me policinë ose shërbimin e prokurorisë.

Nëse përsëri pasojnë shkelje të reja, koordinatori bën thirrje për një mbledhje të re të të rinjve, ose transferon rastin në nivelin rajonal të gjykatës korrektuese me qëllim që çështja të sillet në gjykatë me kërkesë që dënimi me kusht të ekzekutohet në tërësi ose pjesërisht.

Vepra e re penale gjatë ekzekutimit të burgimit për të mitur (n.32): Nëse personi i dënuar kryen një vepër të re të dënueshme para skadimit të afatit të ekzekutimit të dënimit me burg, prokurori mund ta ngrejë çështjen në gjykatë me kërkesën që dënimi me burgim të ekzekutohet plotësisht ose pjesërisht sipas Kodit Penal. Është interesant fakti që ndërmjetësimi bashkëkohor ndërmjet viktimave dhe viktimizuesve (VOM – Victim-Offender Mediation) në Norvegji filloi me ligjëratën e Nils Christie, botuar më vonë si një artikull reviste, "Konfliktet si pronë" (Christie, 1978). Thelbi i artikullit të tij rrotullohet rreth krimeve që ripërcaktohen si konflikte midis viktimave dhe viktimizuesve. Këto konflikte, sipas tij, janë vjedhur prej pronarëve të tyre të ligjshëm nga profesionistë si avokatë, psikologë etj., për të mos përmendur vetë shtetin. Christie propozoi të krijohet një alternativë ndaj sistemit penal kur palët në konflikt (p.sh. viktima dhe vetë fajtori) të marrin pjesë aktive në procesin e gjetjes së një zgjidhjeje për problemin e tyre (domethënë pasojat e krimit) (Kemény, 2005).

Nga kjo ide filluan edhe aktivitete institucionale, si miratimi i një Platforme formale nga ana e Parlametit për gjetjen e alternativave për zgjidhje të konflikteve, siç është ***Mediacioni (Ndërmjetësimi)***. Poashtu edhe Qeveria miratoi projekte pesëveçare "Alternativa të burgut për të miturit" e kështu me rradhë. Pra, kjo alternativë fillloi të zbatohet si një pilot projekt fillimisht në disa komuna e pastaj edhe u formalizua me akte legjislative. Qëllimi ishte i dyfishtë: 1) Fuqizimi i komunitetit lokal në trajtimin e llojeve të ndryshme të konflikteve dhe krimeve të vogla dhe 2) Parandalimin e konflikteve që kanë rezultuar me vepra penale duke i tajtuar konfliktet në një fazë të hershme.

Mediacioni Viktimë-Viktimizues në fazën eksperimentale ishte një opcion vetëm për të miturit, d.m.th. për kryesit ndërmjet moshave 14 dhe 18 vjet. Kjo sepse deri në vitin 1991 mosha e përgjegjësisë penale ishte 14, kurse nga ky vit ajo u ngrit në 15 vjet.. Që nga viti 2004 shërbimet e ndërmjetësimit janë bërë përgjegjësi e qeverisë në të gjitha aspektet. Sot

Mediacioni i ofrohet ç'do qytetari norvegjez si pjesë e shërbimit të ndërmjetësimit të administruar (Kemény, 2005).

Meqenëse nuk ka një sistem të veçantë të drejtësisë për të mitur në Norvegji, Mediacioni Viktimë-Viktimizues mund të ofrohet për të gjithë kryesit e veprave penale, pavarësisht nga mosha. Megjithatë, shumica e kryesve në rastet penale janë adoleshentë ose të rritur të rinj. Kur një krim i raportohet policisë, vendimi në lidhje me çështjen nëse do të ndiqet penalisht varet nga fakti se sa i rëndë është krimi dhe nëse nga prokuroria konsiderohet që ndjekja do të jetë me interes publik (Kemény, 2005).

Mediacioni rregullohet me ligj të veçantë mbi Mediacionin (nga viti 1991) dhe aplikohet në bazë të kushteve të përcaktuara me Ligjin e procedurës penale(1998) si dhe në rastet e parapara me Kodin penal (2005), të cilat u shtjelluan më lartë gjatë interpretimit të dispozitave penalo-juridike pozitive në Norvegji, si Kodi penal dhe Ligji për zgjidhjen e konflikteve. Si përfundim, mund të theksojmë se Norvegjia paraqet model: Kur është në pyetje shëndetësia, përkujdesi ndaj fëmijëve, barazia shoqërore - Norvegjia udhëheq në botë. Kur është në pyetje drejtësia penale për të miturit - shumica e botës e ndjekin Norvegjinë. Ky shtet ka një shkallë të lartë të stabilitetit social dhe familjar dhe ofron një model për shëndetin, kujdesin e fëmijëve dhe barazinë sociale (Wormer, 1990).

3.7. Drejtësia penale për fëmijë e Anglisë

3.7.1. Korniza ligjore dhe mosha e përgjegjësisë penale:

Mbretëria e Bashkuar është palë e një numri të konventave ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe në përgjithësi për të drejtat e njeriut, dhe atë e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) me dy protokollet e saj dhe e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në këtë drejtim, drejtësia e Britanisë së Madhe është një çështje e transferuar, pasi që ç'do juridiksion brenda saj ka kompetencat e veta administrative. Kjo çon në sisteme ndërlidhëse me nivele të ndryshme të përputhjes drejt detyrimeve ndërkombëtare të Mbretërisë së Bashkuar dhe mungesës së mekanizmave të brendshëm për krijimin e niveleve uniforme të mbrojtjes, gjë e cila është kritikuar në mënyrë të përsëritur nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës. Në vend të sistemeve të decentralizuara aktualisht në vend, Britania e Madhe mund të përfitojë më shumë nëse brenda territorit të saj krijon një mekanizëm ose trup të vetëm mbi sistemet e transferuara, për të siguruar një nivel uniform të të drejtave minimale të drejtësisë për të rinjtë. Sistemi Skocez i cili deri tani duket të jetë relativisht stabil dhe dukshëm i sigurtë, i themeluar mbi bazën e orientimit të mirëqenies, por me një qasje që plotëson të dyja rastet - për kujdesin e të rinjëve dhe ato të shkeljeve ligjore. Në anën tjetër, sistemi Anglez (dhe i Uellsit) është shumë i paqëndrushëm dhe vazhdimisht i kontestuar, me përqëndrim tek çështjet e shkeljeve ligjore (Lisle, 2014; Cavadino & Dignan, 2006 (2010)).

Një sërë ligjesh, që datojnë nga viti 1933, rregullojnë sistemin e drejtësisë për të mitur në Angli dhe përpiqen të sigurojnë që një gjykim dhe trajtim i drejtë t'u jepet fëmijëve të akuzuar për vepra penale. Mosha minimale e përgjegjësisë penale në Angli është aktualisht dhjetë vjet.[28] Fëmijë nën këtë moshë konsiderohen *doli incapax* dhe të paaftë për të formuar qëllimin kriminal (Feikert, 2007 (2015)).

Sistemi i drejtësisë për të rinjë në Angli dhe Uells udhëhiqet nga Akti mbi Krimet dhe Parregullsitë ("Crime and Disorder Act") i vitit 1998 dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtësisë për të Rinjtë. Funksionet e Bordit fokusohen në monitorimin dhe ofrimin e shërbimeve të

[28] Children and Young Persons Act 1933, 23 24 Geo. 5, c. 12, 60

drejtësisë për të rinjtë në Angli dhe Uells dhe përfshijnë përgjegjësinë për krijimin dhe mbajtjen e niveleve të larta të përputhjes me detyrimet ndërkombëtare të Mbretërisë së Bashkuar, kryesisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (Lisle, 2014).

Mosha minimale e përgjegjësisë penale:

Konventa për të Drejtat e Fëmijës krijon detyrim për shtetet që të sigurojnë "vendosjen e një moshe minimale nën të cilën do të supozohet se fëmijët nuk kanë aftësi për të shkelur ligjin penal" [29], një detyrim i cili synon të veprojë si mbrojtje ligjore për fëmijët në sistemin e drejtësisë penale. Në Komentin e Përgjithshëm të Komitetit për të drejtat e fëmijëve nr. 10 ky obligim është zgjeruar[30] për t'u dhënë shteteve më shumë udhëzime për vendosjen e niveleve të pranueshme, me parimet në të cilat është vendosur në përputhje me Rregullën 4 të Pekinit, e cila thotë se mosha minimale e përgjegjësisë penale të mos jetë i fiksuar në nivel shumë të ulët, duke pasur parasysh faktet e pjekurisë emocionale, mendore dhe intelektuale" (Lisle, 2014).

Komiteti deklaroi se një moshë minimale e përgjegjësisë penale nën atë 12 vjeçare nuk konsiderohet ndërkombëtarisht e pranueshme dhe kështu shtetet duhet ta rrisin atë në 12 duke vazhduar ta ngrisin ende më lartë (Komenti Gjeneral n.32), me një moshë të lavdërueshme të identifikuar si 14 deri në 16 vjet (Komenti Gjeneral n.30). Në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut mosha minimale e përgjegjësisë penale është e rregulluar me një sërë aktesh legjislative dhe është vendosur në moshën dhjetë. Ky nivel menjëherë njihet si më i ulët se mosha e treguar si e pranueshme dhe është, së bashku me atë të Skocisë dhe Zvicrës, midis moshave minimale më të ulëta të përgjegjësisë penale në Evropë. Në Skoci, mosha minimale e ndjekjes penale u vendos në 12 vjet në 2011! (Criminal Procedure (Scotland) Act, n. 16, s 41A).

Pra, mosha minimale e përgjegjësisë penale në Britani të Madhe është 10 vjeç dhe qeveria e saj duket se nuk ka plane për ta rritur këtë përkundër rekomandimeve të Komitetit. (Lisle, 2014). Në bazë të nenit 50 të Ligjit mbi Fëmijët dhe të Rinjtë të Anglisë (Children and Young

[29] KDF (n 2) n. 40(3)(a).
[30] Komenti Gjeneral Nr. 10 (n 30) [30] deri [39].

Persons Act of England, 1933): "Supozohet përfundimisht se asnjë fëmijë nën moshën dhjetë vjeç nuk mund të jetë fajtor për ndonjë vepër penale" (Blakeman, 2008).

Në sistemin e drejtësisë penale të Anglisë, "fëmijë" konsiderohet një person nën moshën 14 vjeçare, kurse "person i ri" konsiderohet ai i cili ka mbushur moshën 14 vjet dhe është nën moshën 18 vjeç.are. (Crime and Disorder Act, 1988)(neni 117). Me Ligjin për Krime dhe Parregullsi përcaktohet se qëllimi kryesor i sistemit të drejtësisë për të rinjtë është "të parandalojë kriminalitetin e fëmijëve dhe të rinjëve" (Crime and Disorder Act, 1988, n. 37, 1). Pasi që qëllimi kryesor i sistemit të drejtësisë për të mitur është "të parandalojë kriminalitetin e fëmijëve dhe të rinjve", për të arritur këtë qëllim, ky sistem në Angli përparon përmes një sërë hapash. Dy hapat e parë, të cilat zbatohen vetëm për krime më pak serioze, kanë për qëllim parandalimin e përfshirjes së fëmijës në sistemin e drejtësisë për të mitur përmes një sërë kontratash të marrëveshjes për sjelljen dhe metoda të tjera të dizajnuara për të korrigjuar sjelljen e fëmijës dhe për ta parandaluar atë që të mos kryejë shkelje të rënda. Për shembull, një sistem këshillimi është zhvilluar për të miturit me anë të qortimeve dhe paralajmërimeve që u jepen atyre që pranojnë fajësinë në polici për krimet e tyre dhe për të cilët ka prova të mjaftueshme që ç'do ndjekje penale për veprën penale do të jetë e suksesshme. (Crime and Disorder Act, 1988) (c.54,65). Pas marrjes së vërejtjes ose paralajmërimit, kryesi i ri i referohet Bordit të Drejtësisë për të Rinjtë, i cili përcakton pjesëmarrjen e të riut në një program rehabilitimi (Feikert, 2007 (2015)).

Sistemi gjyqësor dhe masat/dënimet për të rinjtë në Angli:

Pas vitit 1990 u themelua një juridiksion i ndarë i gjykatave angleze për të miturit nga ai i mëparshmi që kishte të bëjë me procedimin e përbashkët të çështjeve të kujdesit dhe të ndëshkimit të të miturve, duke u riemëruar pastaj si Gjykata "për të rinjtë" të cilat procedonin ekskluzivisht vetëm çështje me karakter penal (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)).

"Personat e rinjtë", respektivisht kryerësit e veprave të moshës nën 18 vjeç, ose në disa raste të moshës 18 vjeç, të cilët trajtohen si persona nën 18 vjeç, mbahen në Shtëpinë Siguruese për Fëmijë (Secure CHildrens Home - SCH); Qendrën Siguruese Trajnuese (Secure Training Centre - STC) ose në një Ent për kryerësit e rinjë (Youth Offened Institution - YOI).

Bordi i Drejtësisë për të Rinjtë është përgjegjës për vendosjen e të rinjve në burg dhe zakonisht ata të moshës nën 15 vjeç mbahen në Shtëpinë Siguruese për Fëmijë, kurse ata mbi 15 mbahen në një Qendër apo Ent vetëm të rinjtë. Të rinjtë mund të dënohen me Urdhërin për Paraburgim dhe Trajnim (Detention Training Order), me dënimin me burgim të përcaktuar sipas nenit 90 ose 91 të Aktit mbi dënimet Penale të vitit 2000 ose me burgim sipas nenit 226 ose 228 të Kodit penal të vitit 2003.[31] Për fëmijët për të cilët metodat parandaluese të lartëpërmendura nuk mund të zbatohen, për shembull, për shkak të seriozitetit të veprës, ose janë zbatuar ndaj tyre ato masa veçse, sistemi i drejtësisë për të mitur funksionon me formën e një Gjykate për të rinjtë, e cila procedon raste për të mitur prej dhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeçarë. (Criminal Justice Act, 2003)c.53, 68.

Kur një i ri akuzohet për një vepër penale, ai do të paraqitet para Gjykatës për të Rinjtë ("The Youth Court") (Blakeman, 2008). Kjo gjykatë e të rinjve u krijua për të parandaluar fëmijët dhe të rinjtë të hyjnë në kontakt apo shoqërim me të rritur të dyshuar gjatë ç'do faze të një gjykimi. Publiku përjashtohet nga gjykimet dhe egzistojnë ligje që mbrojnë anonimitetin e fëmijëve që paraqiten para gjykatës. (Children and Young Persons Act, 1933)(23,24 Geo.5, c.12, 39). Gjykata e të Rinjve është një gjykatë e specializuar e magjistratëve, me tre magjistratë të pranishëm rregullisht për secilin rast (Feikert, 2007 (2015)). Gjykata disponon me një sërë dënimesh të ndryshme për kryesit e rinjë, për shembull: Urdhërat e mbikëqyrjes (Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000) (c. 6, 64-67), që mund të kenë një sërë kushtesh të bashkangjitura ose me një Urdhër në Planin e Veprimit- një program intensiv, tre mujor i bazuar në komunitet. Më serioze janë dënimi me burgim dhe urdhërat për stërvitje (Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000)(c.6, 69-72). Këto urdhëra u shqiptohen zakonisht fëmijëve që përfaqësojnë një "nivel të lartë rreziku (për publikun), kanë një histori të konsiderueshme kriminale ose janë përsëritës dhe kur asnjë dënim tjetër nuk do t'i menaxhojë rreziqet e tyre në mënyrë efektive". Ato aplikohen për një periudhë minimale nga katër muaj deri në një periudhë maksimale prej dy vjetësh, me gjysmën e dënimit duke kaluar në burgim dhe pjesa tjetër në liri, të mbikëqyrur nga një ekip i specializuar për të rinjtë (Detention and Training Order, 2008).

[31] https://www.justice.gov.uk/offenders/types-of-offender/juveniles

Vetëm ata kryes të moshës mbi pesëmbëdhjetë vjet mund të dënohen me burgim në institucion të veçantë për të rinjë, ndonëse ky kufizim i fundit nuk zbatohet për fëmijët e moshës dhjetë vjeç e më shumë, të dënuar për vrasje (Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000)(c.6, 90).

- ***Heqja e ndalesave për Raportim (Përjashtimi nga parimi i ndalimit të publicitetit)***

Pas dënimit të fëmiut, mbrojtja nga publiciteti mund të hiqet nëse kjo konsiderohet të jetë në interes të drejtësisë. Ideja prapa kësaj është të inkurajojë kryesit e rinjë që të përballen me pasojat e sjelljes së tyre fyese dhe kështu të pengojë shkeljet e mëtejshme. E ashtuquajtura "Emërtimi (etiketimi) dhe turpërimi" ("Naming and shaming"), si mundësi relativisht e re, është e diskutueshme sepse është në kundërshtim me nenin 40 (2b) të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës –me të cilin mbrohet e drejta për privatësi për kryesit nën moshën 18 vjeçare gjatë procedurave penale, si dhe me rregullat e Pekinit. (Rregulla 8 rekomandon që informacioni që shpie në identifikimin e një kryesi nën moshën 18 vjeç nuk duhet të publikohet). Megjithatë udhëzimet zyrtare u japin këshilla gjykatave në rastet kur heqja e kufizimeve mund të jetë ose nuk mund të jetë në interes të drejtësisë.

Gjykatat e magjistratëve për të rriturit mund të gjykojnë dhe të dënojnë vetëm persona për vepra penale për të cilat dënimi maksimal është gjashtë muaj burg. Gjykatat e magjistratëve merren kryesisht me raste që përfshijnë persona mbi moshën 18 vjeç. Ata mund të merren me të rinjtë, por vetëm nëse ato gjykohen njëkohësisht me me një të akuzuar të rritur (Blakeman, 2008).

Gjykata e të rinjve është një seksion i gjykatës së magjistratëve dhe është e vendosur në të njëjtin objekt me të parën. Ajo procedon pothuajse të gjitha rastet që përfshijnë të rinjtë nën moshën 18 vjeç. Ky seksion i gjykatës shërbehet nga magjistratët e paneleve të të rinjve dhe gjykatësit e rrethit. Ata kanë fuqinë të shqiptojnë Urdhër të Burgimit dhe Trajnimit deri në 24 muaj, si dhe një sërë dënimesh në liri (komunitet). Gjykatat e të rinjve janë më pak formale se gjykatat e magjistratëve, janë më shumë të hapura dhe të angazhuara me të riun që shfaqet në gjykatë dhe me familjen e tij. Gjykatat e të rinjve janë kryesisht hapsira të mbyllura dhe pjesëmarrës nga publiku nuk lejojnë. Viktima (t) e krimit, megjithatë, ka /kanë mundësinë të marrin pjesë në seancat e gjykatës nëse dëshiron/jnë, me një kërkesë

paraprake drejtuar gjykatës (Blakeman, 2008). Kur të rinjtë për herë të parë kryejnë veprime delikuente, sillen në mënyrë asociale ose kryejnë kundërvajtje, zakonisht mund të trajtohen nga policia dhe autoritetet lokale jashtë sistemit gjyqësor, duke zbatuar një sërë masash dhe marrëveshjesh. Kjo me qëllim për të ndaluar të rinjtë të kyçen në sistemin e drejtësisë për të rinjë, kurse në anën tjetër duke i'u ofruar atyre ndihmën dhe mbështetjen për të cilën ata kanë nevojë, me qëllim të pengimit të kriminalitetit (Blakeman, 2008).

Masat dhe dënimet për të rinjtë:

a. Zgjidhjet pa privim nga liria për të rinjë, janë këto në vijim:

Shqiptimi dhe zbatimi i sanksioneve jo-me burgim/ndalim tani dominon shumë nga përpjekjet për të zvogëluar përsëritjen e kryerjes së veprave penale, siç përcaktohet me Ligjin mbi Krimet dhe Parregullsitë (1998). Megjithëse, programe të tilla të reja alternative të burgimit si "***Mbikqyrje dhe monitorim intensiv***" nuk e përjashtojnë domosdoshmërisht privimin nga liria. Programet e mbikëqyrjes dhe monitorimit intensiv (të cilave u është dhënë një bazë ligjore nga Akti i Drejtësisë Penale dhe Imigracionit 2008) janë të dizajnuara për të trajtuar "kryesit e mitur "të ashpër", "të vështirë' dhe seriozë (Sevdiren, 2011).

Këto programe mund të jenë pjesë e një urdhri të burgimit dhe trajnimit, si dhe si një kusht i lirimit me kusht, ose si alternativë e një dënimi të komunitetit. Ato janë në dispozicion për ata kryes të mitur që paraqiten në gjykatë ose të akuzuar ose të dënuar për një vepër penale dhe të cilët janë akuzuar ose paralajmëruar për një vepër burgimi në katër ose më shumë raste të veçanta brenda 12 muajve të fundit ose kanë pranuar më së paku një dënim në komunitet ose dënim me burg, ose janë në rrezik të paraburgimit, duke pasur parasysh faktin se akuza aktuale është aq serioze, për të cilën një i rritur mund të dënohet me 14 vjet burgim ose më shumë. Një program mbikqyrës dhe monitorues intensiv, siç sugjerohet edhe nga vetë emërtimi i programit, përmban mbikëqyrjen e të miturit duke përfshirë etiketimin elektronik ose përcjelljen, dhe pjesëmarrjen në trajnime edukative dhe profesionale, programet e sjelljes së shkelësve të ligjit dhe në aktivitete të tjera rekreative (Sevdiren, 2011).

Në grupin e masave të cilat paraqiten si zgjidhje pa privim nga liria të kryesve të rinjë janë edhe ***masat paragjyqësore*** si dhe ***paralajmërimi përfundimtar***.

b. **Masat e tjera**: Mbikëqyrja lokale e fëmijëve (Blakeman, 2008);
c. **Dënimet në Komunitet janë** (Blakeman, 2008): Urdhëri për Mbikëqyrje; Urdhri për Rehabilitim; Urdhri për punë në komunitet; Urdhri i Planit të veprimit; Urdhëri për Pjesëmarrje në Qendër; Urdhëri mbi referimin; Urdhëri për riparim; Gjoba; Lirimi me kusht, dhe Lirimi Absolut.

Përsa i përket kryesve të mitur, policia ka kompeteca (përmes Ligjit mbi Krimet dhe Parregullsitë, 1998) për të lëshuar një paralajmërim ose vërejtje përfundimtare. Një vërejtje mund të lëshohet kur vepra (faji) është pranuar dhe i mituri nuk ka qenë i dënuar më parë, i qortuar ose 'paralajmëruar'. Një paralajmërim përfundimtar është një mundësi më e vështirë për policinë, në anën tjetër, dhe mund të jepet kur kryesi i mitur nuk ka marrë paralajmërim brenda dy viteve të mëparshme dhe përfshin një referim të kryesit të mitur në ekipin lokal të të të rinjve të dënuar (Sevdiren, 2011).

d. **Dënimet me burgim:** Në Angli dhe Uells dënimet me burg për të rinjtë rregullohen me Ligjin Mbi Gjykatat Penale (Ligji mbi Dënimet) të vitit 2000, i cili u jep gjykatësve udhëzime strikte mbi atë se kur mund dhe duhet të shqiptohet burgimi ndaj një të riu. Për shembull, dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet përveç nëse shkalla e shkeljes është e lartë, fëmija është një kryes përsëritës dhe burgimi është mënyra e vetme e përshtatshme për të mbrojtur publikun nga fëmija që vazhdimisht kryen vepra të kundërligjshme. Burgimi varet gjithashtu nga mosha e fëmijës kur ato kanë kryer veprën penale - nën pesëmbëdhjetë vjet mund të privohen nga liria vetëm nëse janë kryes përsëritës dhe nën moshën 12 vjeç mund të privohen nga liria vetëm nëse Sekretari i Shtetit merr një vendim të veçantë dhe se kjo do të ishte e vetmja mënyrë për të parandaluar delikuencën e mëtejme (Lisle, 2014) .[32]

e.**Urdhri i Burgimit dhe Trajnimit:** Legjislacioni i ri penal anglez krijoi një dënim të ri të *ashtuquajtur* ***Dënimi i burgimit dhe Trajnimit*** (Detention and Traning Order) për të rinjtë e

[32] http://www.westminsterlawreview.org/Volume3/Issue2/wlr28.php

moshës nën 18 vjeç.[33] Dënimi i ri u krijua për të racionalizuar dënimet që ekzistonin për personat nën moshën 18 vjeç dhe për ta bërë më efektive kujdestarinë ndaj tyre (Blakeman, 2008). Ky dënim u prezantua duke u ekzekutuar në atë mënyrë që gjatë gjysmës së kohëzgjatjes së tij personat e dënuar mbahen nën kujdestari(të privuar nga liria), kurse gjysmën tjetër nën mbikqyrje në liri. Gjatë vitit të parë të aplikimit të këtij dënimi, numri i dënimeve të shqiptuara me burgim rezultoi të rritej në 10 përqind (Cavadino & Dignan, 2006 (2010)).

Të vetmet dënime të burgimit dhe trajnimit në dispozicion të gjykatave janë ato me 4, 6, 8, 10, 12, 18 dhe 24 muaj. Gjysma e dënimit ekzekutohet në burgim dhe gjysma tjetër nën mbikëqyrje në komunitet (liri). Dënimet e njëpasnjëshme janë gjithashtu në dispozicion të gjykatave, por vetëm deri në maksimum të 24 muajve (12 muaj në burgim).

Ky dënim mund ekzekutohet në një Shtëpi siguruese për fëmijë, në një Qendër Siguruese të Trajnimit (STC), në Ent pët të Rinjë si dhe në ç'do vend tjetër që e përcakton Sekretari i Shtetit (Blakeman, 2008).

f. Dënimet për vepra penale të rënda:

Për vepra penale shumë serioze, fëmijët gjykohen penalisht në Gjykatën e Kurorës (The Crown Court). Një direktivë praktike e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbretërisë së Bashkuar të Anglisë dhe Uellsit për ndjekjet penale të fëmijëve kërkon që "procesi i gjykimit të mos e ekspozojë të pandehurin e ri para frikësimit, poshtërimit apo shqetësimit të shmangshëm. Të gjitha hapat e mundshëm duhet të ndërmerren për të ndihmuar të pandehurin e ri për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në procedurë. Procesi i zakonshëm i gjykimit duhet të përshtatet për aq kohë sa është e nevojshme."[34] Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë (1933) përcakton që mirëqenia e të pandehurit duhet të kihet në konsideratë gjatë ç'do procedure penale dhe direktiva e praktikës kërkon- të bëhen më shpeshë pauza, veshjet formale dhe paruket të mos vishen dhe që të mos jetë e dukshme prania e policisë në gjykatë pa ndonjë shkak të mirë. Gjykata e Kurorës është gjykata e vetme të cilës i lejohet të zbatojë këto rregulla për dënimin e fëmijëve të moshave mes dhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç që kanë kryer vepër penale për të cilën parashihet dënim prej katërmbëdhjetë ose më

[33] Powers od Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000, n.100 (Crime and Disorder Act 1998, c. 73)

[34] Practice Direction, *Trial of Children and Young Persons in the Crown Court*, Feb. 2000, ¶ 3, http://www.hmcourts-service.gov.uk/cms/926.htm

shumë vjet burgim për kryesit e rritur; Fëmijët që kanë kryer vrasje ose krime seksuale mund të dënohen me maksimumin e dënimit për të rritur, për të njëjtën vepër penale (Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000) (c.6, 90-91).

Megjithatë, pas gjykimit për vrasjen e dy vjeçarit James Bulger në vitin 1993 nga dy djemtë 10-vjeçarë, u shfaqën shqetësime lidhur me atë se nëse Gjykata e Kurorës është një vend i përshtatshëm për gjykimin e të miturve! Së këndejmi, në vitin 1999, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi që Mbretëria e Bashkuar vepronte në kundërshtim me nenet 3 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 3: Ndalimi i torturës - duke përfshirë trajtimin ç'njerëzor dhe degradues dhe neni 6: E drejta për gjykim të drejtë). (John Graham and Colleen Moore, 2006). Atë kohë privimi nga liria i të rinjëve u promovua si mjeti kryesor për të parandaluar përsëritjen e krimit, nëpërmjet sloganeve konservatore ministrore si "Burgu funksionon" dhe "Të dënojmë më shumë, të kuptojmë më pak"!(Haydon dhe Scraton, 2000). (J. Muncie & B. Goldson, 2006).

Në këtë drejtim, GJEDNJ vendosi që Gjykata e Kurorës së Mbretërisë së Bashkuar, një gjykatë penale për të rritur, nuk ishte një vend i përshtatshëm për gjykimet publike që përfshijnë të miturit dhe se duhet të përshtatet duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e tyre. Duke vepruar kështu, ajo duhet të respektojë të drejtën e tyre për privatësi, të promovojë mirëqenien e tyre dhe t'u mundësojë atyre të kuptojnë dhe të marrin pjesë plotësisht në procedurë. Me gjithë modifikimet në procedurat gjyqësore, Gjykata Evropiane vlerësoi se procedurat ishin në kundërshtim me nenin 6 dhe nxorrën një Udhëzim Praktik që rregullonte gjykimin e të miturve. Që atëherë, është propozuar një trajnim i posaçëm për gjyqtarët dhe avokatët që merren me të mitur në Gjykatën e Kurorës (John Graham and Colleen Moore, 2006).

Kryesit e rinjë nuk vendosen në burgje së bashku me të rriturit, por mund të vendosen në qendra të sigurta të trajnimit, në shtëpi të sigurta të fëmijëve ose në institucionet për delikuentë të rinjë. (Youth Justice Board for England and Wales, Custody, 2008).[35]

Fëmijët dhe të rinjtë e dënuar për disa vepra të caktuara "të rënda" përveç vrasjes, të cilat në rastin e një të rrituri dënohen me 14 vite burgim ose më shumë, e në rast se nuk konsiderohen të përshtatshme metodat e tjera të ndëshkimit, duhet të dënohen me

[35], http://www.yjb.gov.uk/en-gb/yjs/Custody/

maksimumin e të rriturve për veprën, i cili mund të jetë edhe dënimi i përjetshëm! (Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act, 2000)(neni 90). Dënimet e përcaktuara me nenet 90/91 janë miratuar jo vetëm për të përmbushur kërkesat e ndëshkimit dhe parandalimit, por edhe për të pasqyruar faktin që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rehabilitimit të të dënuarit të mitur. Dënimet e tilla ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në gjatësinë dhe rrjedhën e tyre në aspektin se si dhe ku të dënuarit e kalojnë kohën e tyre në burgim. Një person i ri i dënuar do të marrë në shumicën e rasteve lirimin automatik me kusht pas gjysmës së vuajtjes së dënimit. Poashtu Burgu shtëpiak do të jetë në dispozicion. Periudha e dënimit me kusht në liri zgjat deri në datën e skadimit të dënimit (Blakeman, 2008).

g. ***Dënimet për veprat penale kundër Sigurisë Publike dhe për disa vepra të dhunës ose krime seksuale*** poashtu parashin për të rinjtë. Për këto vepra penale mund të shqiptohet një dënim maksimal prej 10 vjet ose më shumë (Criminal Justice Act, 2003) (neni 226).

Në këto raste, fëmijët e arrestuar në Angli dhe të mbajtur në paraburgim duhet të ndahen nga të rriturit. Kujdestarët e tyre njoftohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe duhet të informohen për akuzat e ngritura kundër fëmijës dhe për vendqëndrimin e fëmijës. (Children and Young Persons Act, 1933) (23 & 24 Geo. 5, c. 12: 34).

Gjatë ç'do procedure gjyqësore që përfshin fëmijën nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, ligji kërkon pjesëmarrjen e kujdestarit të fëmijës gjatë të gjitha fazave të procedurës, përveç nëse kjo është e paarsyeshme në rrethanat e rastit. Rregull e përgjithshme është se fëmijët e akuzuar nuk duhet të mbahen në paraburgim policor, por në vend të kësaj të merren në përkujdesje nga shërbimet sociale në objekte strehuese të autoriteteve lokale (Feikert, 2007 (2015)). Kjo rregull konsiderohet të jetë aq e rëndësishme sa që oficerët e policisë së ndalimit e kanë detyrë statutore vendosjen e të miturve në strehimin e autoriteteve vendore, përveç nëse ata mund të vërtetojnë se rrethanat e veçanta e bëjnë të pamundur që kjo të ndodhë ose kur për fëmijët e moshës 12 vjeçare ose më të vjetër nuk ka asnjë strehim të sigurtë në dispozicion, dhe asnjë strehim tjetër i autoriteteve vendore nuk është adekuat për të mbrojtur publikun nga dëmi serioz që paraqet fëmija (Police and Criminal Evidence Act, 1984) (c. 60: 38(6)).

Si përfundim, mund të shihet se Britania e Madhe i zbaton dhe interpreton të drejtat e drejtësisë për të rinjtë të mbrojtura ndërkombëtarisht në nivele të ndryshme të përputhjes me detyrimet ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, por nuk i përmbush detyrimet sipas kërkesës së Komitetit të Kombeve të Bashkura për të Drejtat e Fëmiut. Ç'do ndryshim në përputhje me Mbretërinë e Bashkuar reflekton mbi të gjithë shtetin dhe rrjedhimisht dështimi i një juridiksioni të vetëm për të përmbushur detyrimet e imponuara në Mbretërinë e Bashkuar rezulton në mungesë të pajtueshmërisë për të gjithë shtetin. Ky efekt mund të shihet në të gjithë spektrin e të drejtave të drejtësisë për të rinjtë, dhe veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me moshën minimale për pëgjegjësi penale dhe ndalimin e të rinjve në secilin prej juridiksioneve.

Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së një trupi apo mekanizmi që do të mbikëqyrte sistemet e ndara dhe të siguronte zbatimin e standardeve korrekte brenda territorit të Mbretërisë së Bashkuar. Prandaj për të ngritur me sukses dhe në mënyrë konsistente standardet e drejtësisë së të rinjve aktualisht të zbatuara, për Mbretërinë e Bashkuar është e nevojshme të krijohet një organ ose mekanizëm mbikëqyrës me fuqi për të siguruar pajtueshmëri të plotë me të paktën standardet minimale të pritura, pa të cilat, të drejtat nga drejtësia për të rinjtë nuk do të bëhen një realitet për fëmijët e Britanisë së Madhe (Lisle, 2014).

Megjithatë, është argumentuar se nivelet e tanishme janë jo-njerëzore, nuk marrin plotësisht parasysh nivelin e pjekurisë së fëmijës dhe se qeveritë e ndryshme nuk i kanë marrë plotësisht parasysh këto çështje përballë presionit publik për të ruajtur minimumet e vjetra e moshës së përgjegjësisë penale (Garside, 2009).[36] Në drejtim të këtyre argumenteve, Britania e Madhe ka dështuar në të dy detyrimet e KDF dhe KEDNJ (Lisle, 2014).

Poashtu, heqja e prezumimit, "doli in capax" është kritikuar shumë nga Komiteti, sepse zvogëlon efektivisht moshën në të cilën përgjegjësia penale mund t'i atribuohet një fëmije nga 14 në 10, me rezultatin që fëmijët e moshave mes 10 dhe 14 vjeç janë duke u privuar nga liria. Pavarësisht nga rekomandimet e përsëritura për të ngritur minimumin e moshës për

[36] Richard Garside, 'Too young to be a criminal' (2009): [http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2009/feb/05/uk-age-of-criminal-responsibility] [accessed 15 August 2017];

përgjegjësi penale dhe rishikimin e heqjes së prezumimit të doli incapax, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ende nuk e ka bërë këtë dhe thotë se nuk ka ndërmend të rrisë këtë minimum në Angli dhe Uells,[37] që çon në mungesën e zbatimit të drejtë të parimeve të drejtësisë për të rinjtë në KDF të nenit 40 (Lisle, 2014).[38]

Vlen të theksohet se Anglia dhe Uellsi tani kanë më shumë të rinj të burgosur se ç'do vend tjetër në Evropë: katër herë më shumë se në Francë, 12 herë më shumë se në Holandë dhe 160 herë më shumë se në Norvegji, Suedi dhe Finlandë (Muncie, 2004a) dhe shpesh në kushte 'krejtësisht të papërshtatshme' për ç'do vend që pretendon të quhet i civilizuar. Me normat e larta të ish të burgosurve deri në 88% dhe rritjen e dëshmive për regjimet e papërshtatshme dhe brutalizuese të karakterizuara nga ngacmimet dhe vetëvrasjet, është e qartë se burgosja e fëmijëve është një dështim i shtrenjtë (J. Muncie & B. Goldson, 2006). Sipas të dhënave zyrtare të vendit, në vitin 1992 rreth 100 fëmijë nën moshën 15 vjeç u dënuan me burgim, kurse në vitin 2001, 800 fëmijë nën moshën 15 vjeç u dënuan në mënyrë të ngjashme, pra, paraqitet një rritje prej 800%. Edhe më shumë vajza po dënohen me burgim dhe shkalla e rritjes është proporcionalisht më e lartë se ajo që lidhet me djemtë. Megjithëse baza përbën numër relativisht të vogël, shiptimi i burgut ndaj vajzave të mitura gjatë dekadës së fundit është rritur me 400%! (J. Muncie & B. Goldson, 2006).

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës përcakton që fëmijët duhet të mbrohen nga burgimi sa herë që të jetë e mundur dhe kur të privohen nga liria duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe me respekt. Konventa thekson në nenin 37 se burgimi i një fëmije "do të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për periudhën më të shkurtër të përshtatshme". Kurse, në Angli reduktimet e moshës për ndalimin e të rinjve (nga 14 në 10) së bashku me rritjen e gjatësisë së dënimit shfaqen direkt në kundërshtim me dispozitat e tilla. Për më tepër, meqë ka institucione të kufizuara për shkelësit e rinjë të gjinisë femrore, ato mbahen në burgjet e të rriturve dhe shpesh ndajnë të njëjtat hapsira me të rriturit. Ky fakt paraqet kundërshtim të KDF-në e OKB-së që thotë se " Ç'do fëmijë i privuar nga liria do të ndahet nga të rriturit nëse nuk konsiderohet në interesin më të mirë të fëmijës për të mos vepruar kështu" (J. Muncie & B. Goldson, 2006).

[37] (Cit. Tim Bateman, 'Youth Justice News' (2013) 13(1) Youth Justice 85, 87)
[38] http://www.westminsterlawreview.org/Volume3/Issue2/wlr28.php

PJESA E DYTË

POLITIKA PARANDALUESE PËR PENGIMIN E KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË: 2006-2015

KAPITULLI IV

4. MASAT PREVENTIVE-JURIDIKE PËR PENGIM TË KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

4.1. Strategjia Nacionale për parandalim të delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë[39](2010-2020) dhe efekti i saj në praktikë

"Nuk ekziston besim më i shenjtë sesa ai tek fëmijët.
Nuk ekziston obligim më i vlefshëm se respektimi i të drejtave të tyre, i mbrojtjes së mirëqenies së tyre, në garantimin se jetët e tyre do të jenë të lira nga frika dhe varfëria dhe se do të jetojnë në qetësi" - Kofi Anan. (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 7)

Strategjia Nacionale për Parandalim të Delikuencës së të Miturve[40] (2010-2020) është strategjia e parë në Republikën e Maqedonisë që synon përcaktimin e udhëzimeve strategjike dhe prioriteteve në parandalimin e delikuencës së fëmijëve, e cila është miratuar nga Këshilli shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 9). Kjo Strategji Nacionale është rezultat nga Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë (2007) dhe nga detyrimi që ajo të sillet nga Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së të miturve, sipas n. 145,p.1 të këtij ligji.

Në këtë drejtim, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2009 miratoi vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Këshilli mbajti seancë konstituive më 27 nëntor 2009. (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.3) Këshilli i Shtetit përbëhet nga 15 anëtarë, përbërja e të cilëve është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, të cilat do të trajtohen në vazhdim më gjërësisht në pjesën mbi rolin parandalues të Këshillit shtetëror.

[39] Titulli origjinal i Strategjisë: "Национална стратегија за превенција на малолетничко престапништво во Република Македонија (2010-2010 година)"
[40] Strategjia nuk i përmbahet termit "fëmijë" sipas LDF të 2013, por e përmban termin "i mitur" sepse është miratuar në bazë të LDM të 2007. Gjatë elaborimit të Strategjisë në punim do të përdorim termin "fëmijë", me qëllim të shmangjes së shumësisë së terminologjisë për të njejtin nocion (i mitur- fëmijë).

Duke zbatuar kompetencat e tij nga Ligji për Drejtësinë e të Miturve, Këshilli Shtetëror miratoi Programin e tij Pesëvjeçar (2010-2014), dhe miratoi plane veprimi vjetore për operacionet e tij. Më 7 dhjetor 2010, Këshilli i Shtetit miratoi Strategjinë Nacionale për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Strategjia i referohet periudhës 2011-2020 dhe synon të përcaktojë udhëzimet strategjike dhe prioritetet për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Pjesë përbërëse të kësaj Strategjie janë:

- Parimet udhëzuese; Qëllimet e Strategjisë; Parandalimi i delikuencës së fëmijëve: Faktorët e rrezikut dhe mbrojtës; Sfidat kryesore dhe drejtimet strategjike: Preventiva primare, sekondare dhe ajo terciare; Ndjekja dhe mbledhja e informacioneve; Korniza normative; Resurset për realizim të Strategjisë; Aneksi 1 – Analizë e situatës së gjendjes së delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë; Aneksi 2 – Terminologjia e përdorur.

Sfidat kryesore dhe udhëzimet strategjike të identifikuara në këtë Strategji i referohen Parandalimit primar, sekondar dhe terciar. Në fakt, objektivat e kësaj Strategjie janë vendosja e programeve për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, koordinimi, organizimi dhe qasja multidisiplinare ndaj kësaj problematike, vlerësimin dhe llogarritjen e faktorëve që e rrisin delikuencën e fëmijëve, si dhe bashkëpunimi intensiv ndërkombëtar në fushën e parandalimit të delikuencës së fëmijëve (Golomeova, 2013, f. 46)

Gjatë hartimit të kësaj Strategjie, veçanërisht i'u është kushtuar rëndësi katër parimeve themelore të cilat burojnë nga Konventa për të drejtat e fëmijëve:

- Me këtë Strategji parashihen masa për të siguruar se të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin apo ata në rrezik do të trajtohen në mënyrë të barabartë, pra, në këtë rast garantohet parimi i mosdiskriminimit si dhe promovohet barazia;
- Rëndësi primare ka interesi më i mirë i fëmiut;
- E drejta e jetës dhe zhvillimi duhet të merren parasyshë me qëllim të zhvillimit të politikave efikase dhe programeve preventive për delikuencën e fëmijëve;
- E drejta e fëmiut për shprehje të lirë të mendimit për të gjitha pyetjet të cilat ndikojnë tek fëmiu.

- Poashtu Strategjia është bazuar në Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikuencës së të miturve, të njohura si Udhëzimet e Riadit. Kështu që, në pajtim me këto Udhëzime, parandalimi i sukseshëm i delikuencës së fëmijëve kërkon përkushtim nga ana e tërë shoqërisë. Kjo nënkupton se, Stategjia parasheh politika preventive dhe masa në zhvillim dhe realizim të të cilave duhet të përfshihen të gjithë: familja, shkolla, shoqëria, mediumet, legjislacioni dhe të gjithë ata që punojnë me fëmijë në rrezik. Komponentë e rëndësishme, të cilën kjo Strategji e ka parasyshë, është se për preventivë të suksesshme të delikuencë së fëmijëve patjetër të zgjidhen edhe shkaqet themelore të cilat e kanë nxitur atë, si varfëria, lënia pas dore, keqpërdorimi apo izolimi social (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 10).

Strategjia përcakton se:

- Parandalimi i delikuencës së fëmijëve është pjesë thelbësore e pengimit të kriminalitetit në shoqëri;
- Parandalimi i suksesshëm i delikuencës së fëmijëve kërkon angazhim nga ana e tërë shoqërisë që të sigurohet zhvillim i duhur i adoleshentëve, duke respektuar dhe përparuar personalitetin e tyre që nga fëmijëria e tyre e hershme;
- Personat e rinjë duhet të kenë rol aktiv në shoqëri dhe duhet të konsiderohen si subjekte e jo si objekte pasive të kontrollit;
- Fokusi i cilitdo program preventiv duhet të jetë mirëqenia e të rinjëve nga fëmijëria e tyre e hershme;
- Politikat dhe masat për parandalim duhet të shmangin stigmatizimin dhe ndëshkimin e fëmijëve, të cilët me veprimet e tyre nuk paraqesin dëme serioze për zhvillimin e tyre apo të tjerëve, por të këmbëngulin që fëmiu ta kuptojë problemin dhe ta pranojë përgjegjësinë për veten;
- Shërbime dhe programe për preventivë duhet të zhvillohen në nivel lokal dhe të jenë të pranuara nga shoqëria (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 10).

Ligji për drejtësinë e të miturve (2007) i Republikës së Maqedonisë i kushtonte rëndësi të veçantë parandalimit, sikurse Ligji pozitiv mbi drejtësinë e fëmijëve (2013). Siç kemi theksuar në punim, në këtë ligj Parandalimit i kushtohet pjesë e veçantë, në të cilën organi i pavarur shtetëror- Këshilli për Parandalim të Delikuencës së të miturve është i autorizuar

që të miratojë këtë Strategji. Poashtu në bazë të dispozitave të ligjit të vjetër e poashtu edhe të këtij në fuqi, parashihet formimi i këshillave lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Në këtë Strategji janë prezantuar drejtimet strategjike kyçe për prandalim të kësaj dukurie. Në të nuk përpunohen aktivitete të detajuara në korniza kohore, por sipas saj, secila Ministri relevante duhet të zhvillojë plane operative të cilat duhet të përfshijnë këto aktivitete, si në vijim (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 10):

- Analizë e thellë e problemit dhe përshkrim i programeve konkrete ekzistuese, shërbimeve dhe resurseve;
- Përgjegjësi qartë të definuara të të gjitha institucioneve të cilat janë të përfshira në realizim të aktiviteteve;
- Përshkrim të mekanizmave adekuate për koordinimin mes organizatave qeveritare dhe joqeveritare;
- Sistem për ndjekje dhe evaluim të vazhdueshëm se si zhvillohen aktivitetet;
- Mekanizma për bashkëpunim interdisiplinar mes pushteteve lokale dhe qendrore, me kyçjen e bashkësisë lokale gjatë zhvillimit të programeve dhe shërbimeve të duhura;
- Pjesëmarrje e të rinjëve gjatë hartimit të politikave preventive dhe programeve;
- Kuadër i specializuar në të gjitha nivelet.

Parimet kryesore apo drejtuese të Strategjisë, përveç asaj se janë të bazuara në instrumentet ndërkombëtare, si Komentit Gjeneral nr.10; Të drejtat e fëmijëve sipas drejtësisë së të mituve të Komitetit për të drejtat e fëmijëve; Udhëzimet e Riadit dhe në dispozitat e Ligjit për drejtësinë e të miturve të R.M. (2007), bazohen edhe në këto parime si në vijim (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 11-12):

- Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut – Strategjia mundohet të i'u sigurojë kushte fëmijëve, të cilat do të i'u mundësojnë gëzimin e plotë të lirive dhe të drejtave të cilat iu takojnë të gjithëve, e veçanërisht ato të cilat kanë të bëjnë me këto të drejta, si: E drejta për mbijetesë; E drejta për zhvillim; E drejta për pjesëmarrje .
- Parimi i barazisë – si e drejtë e të gjithëve. Të qenit i barabartë në dinjitet dhe i trajtuar me respekt, si dhe pejsëmarrja e barabartë në cilëndo fushë të jetës shoqërore është

baza e këcaj qasjeje. Ky parim nënkupton edhe qasje të barabartë në arsimim dhe informim, duke i përfshirë edhe programet për trajnim të fëmijëve, prindërve dhe arsimtarëve, si dhe të gjitha segmentet e tjera kyçe në shoqëri, të cilat janë të rëndësishme që të rinjtë të ndihen të sigurtë, të kuptuar dhe të respektuar.

- Parimi i përshtatshmërisë sipas kërkesave të grupeve të ndryshme të synuara – zhvillimi i programeve efikase në fushën e parandalimit, socializimit dhe riintegrimit, në mjekësi, rehabilitim, kyçja sociale e grupeve të ndryshme të synuara, të definuara sipas moshës, gjinisë, kulturës, nacionalitetit dhe karakteristikave të tjera.
- Parimi i ndarjes së përgjegjësisë dhe qajes së koordinuar – kyçja e më shumë akterëve nga sfera e punëve të brendshme, financave, gjyqësorit, shëndetësisë, ndihmës sociale si dhe nga pjesë të ndryshme të shoqërisë civile dhe publikut të gjërë.
- Parimi i qasjes dhe ekonomicitetit - Rritja e përfshirjes dhe qasjes ndaj shërbimeve efikase, ekonomike dhe programeve të drejtuara drejtë parandalimit të delikuencës së të miturve.

Qëllimi i kësaj Strategjie është të japë drejtime gjenerale për krijimin e politikave dhe programeve për preventivë të delikuencës së fëmijëve. Qëllimi i përgjithshëm është që Republika e Maqedonisë të zhvillojë një politikë efektive për zvogëlimin e delikuencës së fëmijëve. Politikat për parandalim të delikuencës së fëmijëve në Maqedoni duhet të bazohen në informacione të besueshme dhe të kuptueshme të cilat janë në pajtim me standardet evropjane dhe ndërkombëtare për kualitet. Politika e tillë do të ndikojë drejtë uljes së rreziqeve të cilat shpiejnë kah delikuenca e fëmijëve, kështu që do të sigurohen kushte për zhvillim të shëndoshë të fëmijëve (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 12). Ndërkaq, si qëllime të posaçme, ajo paraqet: Inicimin e sistemeve për zhvillim të programeve për preventivë; Koordinimin dhe organizimin e mekanizmave të duhura në nivel lokal, nacional, regjional dhe ndërkombëtar; Hulumtimin e faktorëve të rrezikut, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

4.1.1. Sfidat kryesore dhe drejtimet strategjike të Strategjisë

Rrjedhat shoqëroro-ekonomike në Republikën e Maqedonisë të cilat vazhdimisht emërtohen si efekte të tranzicionit padyshim se gjatë po zgjasin dhe ndikojnë tek jeta e njerëzve, e veçanërisht tek fëmijët. Nevoja për të siguruar ambiente "normale" apo stabile

deri në një shkallë të caktuar për një zhvillim të mirë të fëmijëve është poashtu prezente gjatë tërë kohës. Preventiva paraqitet si një nga modelet i cili në afat të gjatë do të trajtonte apo do t'i neutralizonte efektet negative të këtyre proceseve (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 16). Në Republikën e Maqedonisë edhe pse nuk mund të thuhet se deri para se të miratohej kjo Strategji nuk kishte ekzistuar preventiva e delikuencës së fëmijëve, përsëri programe strategjike të cilat do të analizonin faktorët e rrezikut dhe mekanizmat mbrojtës, resurset dhe kapacitetet që ato të adresohen në të tre nivelet e preventivës, nuk kanë qenë mjaftueshëm të zhvilluara.

Sfidat kryesore dhe drejtimet strategjike të cilat janë identifikuar me këtë Strategji kanë të bëjnë me preventivën primare, sekondare dhe atë terciere. Dy fusha plotësuese të cilat janë identifikuar si sfidë dhe për të cilat janë paraparë drejtime të duhura janë koordinimi dhe mbledhja e të dhënave. Këto dy sfera kanë të bëjnë me të tri nivelet e preventivës (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 17).

1. **Preventiva primare**- ka për qëllim të trajtojë kushtet e përgjithshme në të cilat jetojnë fëmijët dhe familjet. Përmes kësaj preventive targetohen shkaqet apo faktorët ende para se fëmijët të bëhen pjesë e delikuencës. Qëllimi i kësaj forme të preventivës është të krijojë mjedis të sigurtë për të gjithë fëmijët, me ç'ka nënkupton qasje sitematike për të siguruar përkrahje institucionale, ndërtim të kapaciteteve, reforma ligjore, ndjekje dhe njoftime për shkelje të të drejtave të fëmijëve, ndryshim të qëndrimeve të shoqërisë në përgjithësi dhe personave profesionistë të cilët punojnë me fëmijët etj. Preventiva primare ka për qëllim të ndikojë ndaj sferave të ndryshme të jetës së fëmijëve dhe familjeve të tyre, me ç'ka do të sigurohen kushte për zvogëlim të faktorëve të rrezikut.

Në kuadër të preventivës primare, janë të identifikuara këto sfida (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 18):

- Nevoja për rritjen e numrit të fëmijëve në aktivitetet arsimore parashkollore;
- Nevoja për identifikimin dhe zhvillimin e programeve punuese me prindër, veçanërisht familje nga mjedise ekonomike të varfëra;
- Nevoja për trupa aktiv dhe efikas dhe këshilla prindëror nëpër shkolla ku do të flitet për problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët;

- Nevoja për zhvillim të programeve për aktivitete pas-shkollore (si ndihma e fëmijëve në lëndë të cilat kanë ngecur/ kanë vështirësi, apo menaxhimi i dobishëm i kohës së lirë)
- Nevoja për forcimin e njoftimit për të drejtat e fëmijëve etj.

Strategjia jep udhëzime/drejtime të përgjithshme për procesin e socializimit në kuadër të familjes, sistemit arsimor, shëndetësisë, masave që duhet t'i ndërmerr bashkësia si dhe ngritja e vetëdijes publike tek qytetarët (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 18).

3. Preventiva sekondare – Nëpërmjet kësaj preventive synohen fëmijët dhe të miturit të cilët janë në rrezik për të kryer vepër penale ose fëmijët të cilët kanë kryer vepër penale por nuk kanë përgjegjësi penale. Pra, bëhet fjalë për identifikim të hershëm të fëmijëve në rrezik ose parashikim të fëmijëve dhe familjeve potenciale në rrezik. Përmes saj synohet të diagnostikohen dhe të trajtohen "sjelljet e papranueshme" para se ato të eskalojnë, ose të zhvillohen në forma më të rënda dhe serioze të veprimit. Qëllimi është që fëmijët të ndalohen së vazhduari asaj rruge. Shumë shpesh këta fëmijë u janë të njohur policisë dhe qendrave për punës sociale dhe shpesh këta fëmijë vijnë nga bashkësi të margjinalizuara apo grupe të tjera të shoqërisë (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 23).

Në kuadër të preventivës sekondare, janë identifikuar këto sfida:

- Nevoja për zhvillim të programeve dhe politikave për parandalim të delikuencës, të cilat do të jenë të afta për nevojat e fëmijëve nga grupe të ndryshme, posaçërisht nga bashkësia rome dhe programe sensitive gjinore të cilat do ti kishin nxjerrur në pah nevojat e personave të gjinisë femërore;
- Identifikim i fëmijëve dhe familjeve në rrezik;
- Numri i pamjaftueshëm i personave të punësuar në QPS;
- Mungesë e resurseve për punë aktive në terren, vizita shtëpiake, këshillime të duhura dhe në kohë, përkrahje të familjeve;
- Nevoja për forcim të trajnimeve për personelin, posaçërisht të rinjëve të punësuar nëpër institucione;
- Mungesa e një plani strategjik të detajuar dhe programe për parandalim të delikuencës së fëmijëve në kuadër të sektorit policor për preventivë etj.

Në kuadër të preventivës sekondare, Strategjia jep Udhëzime strategjike për: Arsimin, shëndetësinë, qendrat për punë sociale, policinë dhe bashkësitë lokale.

4. Preventiva terciere – Nëpërmjet kësaj preventive bëhet ndërlidhje me programe preventive të cilat do të mundësojnë që fëmiu të bartë përgjegjësi për veprën e kryer dhe për pasojat e veprës, por edhe do të ndihmohet që të mos kryejë më vepër penale. Kjo më së miri arrihet përmes programeve që do t'i sigurojnë fëmiut një tretman adekuat gjatë kohës së vuajtjes së sanksionit penal ose para se të dalë nga enti penitensiar. Këto programe do ti ofrojnë fëmiut ndihmë afatgjate post-penale, me qëllim të riintegrimit në shoqëri. Poashtu institute të preventivës terciere janë masat alternative, veçanërisht mbikqyrja e mbrojtur tek dënimi me kusht me mbikqyrje të përforcuar, puna në dobi të përgjithshme dhe mediacioni (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 28).

Në kuadër të preventivës terciere janë identifikuar sfidat në këto sfera:

- Forcimi i rolit mbrojtës të Qendrave për punë sociale;
- Nevoja për zhvillim të mekanizmave/instrumetave të standardizuara për vlerësim të shëndetit mental dhe fizik të fëmijëve të cilët janë pjesë e sistemit të drejtësisë për fëmijë, më saktësisht të cilët qëndrojnë në entet për fëmijë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale;
- Nevoja për zhvillim të programeve punuese me grupe të veçanta të fëmijëve kryerës të veprave penale;
- Zhvillim i programeve për ndjekje dhe mbështetje të fëmijëve pas lëshimit të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese, respektivisht institucioneve edukuese-përmirësuese.
- Vendosja dhe zhvillimi i lidhjes efikase me bashkësinë e biznesit, e cila do të kontribuonte në sigurimin e punësimeve si pjesë e procesit të integrimit;
- Zbatimi i mundësive të masave të diversitetit si opcion për shmangje nga procedura formale: Ndërmjetësimi, pajtimi dhe mediacioni;
- Zbatimi i masave alternative dhe zhvillimi i resurseve, si dhe forcimim i institutit të mbikqyrjes së përforcuar tek dënimi me kusht dhe puna në dobi të përgjithshme.

Udhëzimet strategjike në këtë nivel të preventivës Strategjia i jep në drejtim të masave alternative dhe mediacionit, kujdesit dhe shërbimeve institucionale, kujdesit dhe

shërbimeve pas daljes nga enti si dhe në drejtim të shëndetësisë (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 29).

4.2. Qëllimi i parandalimit special dhe gjeneral i dënimeve për fëmijë

Qëllimi parandalues i dënimeve në përgjithësi, duke mos i përjashtuar edhe dënimet që mund të i'u shqiptohen fëmijëve, fokusohet në dy aspekte: Në parandalimin gjeneral dhe atë special. Parandalimi gjeneral - nënkupton ndikimin e dënimeve të shqiptuara ndaj të tjerëve, respektivisht tek fëmijët apo të rinjtë kryerës potencialë të veprave penale që të mos ti kryejnë të njejtat. Kjo arrihet duke i frikësuar ata nga mundësia e shqiptimit të masave penale-represive, të cilat mund të i'u shqiptohen nëse bien në ndesh me ligjin sikurse u janë shqiptuar të dënuarve për veprimet e kundërligjshme. (Kambovski, 2007, f. 461)

Ndërkaq, preventiva speciale nënkupton parandalimin e personit të dënuar për të mos e përsëritur të njëjtin ose ndonjë krim tjetër. Kjo, arrihet me efektin e dënimit të shqiptuar ndaj personit të dënuar, respektivisht me efektin e masave të trajtimit penitensiar nëse bëhet fjalë për dënim me privim nga liria. Preventiva speciale, si qëllim i posaçëm i dënimit , nga ajo që u trajtua më lartë në punim, në pjesën e analizimit të Strategjisë Nacionale për Paradandalim të Delikuencës së të Miturve 2010-2020, shihet se paraqet poashtu një nga sfidat kryesore të kësaj Strategjie. Pra, është e qartë se politika parandaluese e Maqedonisë një nga qëllimet krysore ka Preventivën e ashtuquajtur "terciere", që nëkupton parandalimin e sjelljeve të ardhshme delikuente/krimiale të fëmijëve, të cilët do të përmirësohen, (re)edukohen gjatë tretmanit në institucionin penitensiar ku e vuajnë dënimin/masën institucionale. [41] Kjo që u theksua më lartë, paraqet qëllimet e posaçme të dënimeve, si lloji i sanksioneve të cilat mund të i'u shqiptohen fëmijëve në konflikt me ligjin, në pajtim me kushtet e përcaktuara të Kodit penal dhe Ligjit për drejtësinë për fëmijë të R.M.-së.

Qëllimi i këtillë i dënimeve është i përcaktuar shprehimisht në dispozitat e Kodit penal (n.32 i KPM) dhe në fakt ky qëllim (preventiva) është i njejtë gjatë shqiptimit dhe ekzekutimit, duke mos bërë dallimin mes atyre të dënuarve të grupmoshës madhore apo atyre jomadhore.

[41] Shih pjesën e punimit 5.1. Analiza e Strategjisë Nacionale për Parandalim të Delikuencës së të miturve 2010-2020 (Sfidat kryesore dhe drejtimet strategjike – Preventiva terciere)

Si qëllime të posaçme të dënimit përveç realizimit të drejtësisë të ndara janë këto: Ndalimi i autorit të kryejë vepra penale dhe riedukimi i tij, dhe ndikimi edukativ mbi të tjerët për të mos kryer vepra penale (n.32 i KPM) Me këtë, ligji i thekson në fakt funksionet polivalente të dënimit: retributivitetin dhe preventivën – preventivën gjenerale dhe speciale. Retribucioni, i formuluar si kërkesë për dënim proporcional të drejtë dhe të përpjestueshëm nuk është i definuar dhe nuk mund të definohet si qëllim i dënimit. Kryersin nuk e dënojmë për t'i shkaktuar të keqe (Kambovski, 2007, f. 461). Preventiva speciale përbëhet në pengimin e kryerësit të kryejë vepra penale dhe riedukimin e tij. E para realizohet në rrugën e frikësimit individual ose neutralizimin, kurse e dyta realizohet në rrugën e risocializimit. (Kambovski, 2007). Sipas Prof. Dr. Kambovski për realizimin e qëllimit riedukues është i qëlluar dënimi me burg me kohëzgjatje relativisht të gjatë por jo shumë të gjatë, në të cilën nëpërmjet trajtimit individual mund të organizohet procesi mirë i menduar i risocializimit të të dënuarit. Normalisht, se ky qëndrim së pari i përfshinë të dënuarit madhorë, edhe pse nuk mund ti përjashtojmë nga kjo rregull edhe fëmijët e dënuar me burgim, brenda kornizave ligjore të përcaktuara të kohëgjatjes për shqiptimin e këtij dënimi.

Preventiva gjenerale përbëhet nga ndikimi edukativ mbi të tjerët për të mos kryer vepra penale. Ndikimi i tillë realizohet në rrugën e frikësimit gjeneral si dhe me ndikimin e krijimit ose ndërrimit të qëndrimeve vlerësuese morale të qytetarëve kah respektimi i ligjeve dhe gjykimi i krimit. Së fundmi, mund të konstatojmë se dënimi duhet të jetë në përpjestim me peshën e veprës dhe me fajin e kryerësit dhe në funksion të preventivës gjenerale dhe speciale si qëllime të tij legjitime. Gjyqi duhet të ketë në konsideratë të gjitha qëllimet e dënimit gjatë peshimit të tij (n.39, p1 i KPM) (Kambovski, 2007, f. 461).

Meqë dënimet janë vetëm një lloj i sanksioneve penale që mund të i'u shqiptohen fëmijëve kryerës të veprave penal krahas shumë sanksioneve penale më të buta sesa ato, nuk përjashtohet edhe realizimi i qëllimit të tyre - retribucionit, si qëllim i posaçëm i dënimeve - ndaj fëmijëve të dënuar, krahas atij të preventivës. Por, konsideroj se parimet e përcaktuara në Ligjin për drejtësinë e fëmijëve gjykatat gjithmonë duhet ti kenë parasyshë gjatë përcaktimit dhe shqiptimit të llojit të sanksionit penal ndaj fëmiut. Këto parime janë:
Privimi i fëmijës nga liria të zbatohet vetëm si mjet i fundit në procedurë, dhe vetëm në kushte dhe në kohëzgjatje të përcaktuar me LDF (n.10); Zbatimi i masave dhe sanksioneve

të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me fëmijën janë paraparë në interes të tij për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë (n.13); Gjatë vendosjes për zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj, ç'do herë të i'u jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese (n.15) Nga këto rregulla mund të shihet edhe vetë fryma e ligjvënësit, sipas të cilit dënimet mund të i'u shqiptohen fëmijëve vetëm si masa të fundit nga ana e gjykatës, nëse ky organ konstaton se masat më të lehta nuk do ta arrinin efektin e (ri)edukimit të fëmiut të akuzuar.

4.3. Efekti parandalues i masave të ndihmës dhe mbrojtjes

Masat e ndihmës dhe mbrojtjes janë masa tek të cilat ekzistojnë më shumë avantazhe, si një segment i rëndësishëm i konceptit të ri, në krahasim me sistemin formal të drejtësisë penale për fëmijët. Kështu, sanksionet penale mund të jenë të ngurta, të rënda dhe jo të përshtatshme për nevojat e fëmijëve të cilët janë kryesisht kryes primarë ose kryes jo shumë të rrezikshëm. Përparësitë janë se aplikimi i këtyre masave është më i lirë. Kjo kosto është vetëm një pjesë e procedurave formale gjyqësore me atë që drejtimi-diversioni është gjerësisht i disponueshëm. Programet e diversitetit kanë për qëllim t'i japin fëmijës një pasqyrë për pasojat e veprimeve të tij. Me këtë pengohet që fëmijut ti hapet një dosie penale, e me këtë duke e zvogëluar stigmatizimin e sanksioneve formale të drejtësisë penale dhe i'u dhënë një mundësi më e mirë për rehabilitim fëmijëve. Poashtu kjo gjë e zvogëlon vëllimin e rasteve në gjykata dhe numrin e fëmijëve që mbahen në paraburgim në procedurë paraprake (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.3).

Është i veçantë karakteri i këtyre masave i cili shprehet në nenin 22 të KPM, sepse i bën ato të veçanta nga sanksionet penale, në atë që pasojat juridike të tyre godasin në raste të caktuara jo vetëm të miturin/fëmiun që ka kryer veprim delikuent por edhe prindin/prindërit apo tutorin/tutorët e tij/tyre.

Kjo arsyetohet nga obligimi i cili rredh nga Rekomandimi i 5-të (2005) i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve antare rreth të drejtave të fëmijëve të cilët qëndrojnë në Ente sipas të cilit "Roli i familjes si mjedis natyror i fëmiut është primar, kurse detyrimi për

edukimin normal të fëmiut mbi të gjitha i'u takon prindërve"[42]. Dokumentet ndërkombëtare përcaktojnë se shoqëria ka për obligim ti ndihmojë familjes, veçanërisht atyre familjeve tek të cilat janë prezente faktorë të rrezikut (varshmëri të caktuara, dhunë, sjellje kriminale etj.) që ajo ti sigurojë mbrojtje dhe kujdes fëmiut. Por edhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, i përcakton si prioritet të drejtat dhe detyrimet të cilat prindërit i kanë në raport me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve. Ndërkaq, Ligji mbi familjen i rregullon hollësisht obligimet ndaj fëmijëve të cilat i obligojnë prindërit nga e drejta prindërore (Buzharovska.G, Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, 2015, f. 200).

Masat e ndihmës dhe mbrojtjes nuk e prekin të drejtën e lëvizjes së fëmiut, ato paraqesin mbikqyrje dhe kontroll pa elemente të forcës dhe represionit. Edhe me këtë natyrë që e kanë, ato sërisht ndikojnë në mënyrë edukative në luftimin e shkaqeve të cilat kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e drejtë të personalitetit të fëmiut në rrezik. Pra, me zbatimin e këtyre masave prioritet i'u jepet aspekteve të kushtëzuara shoqërore socio-pedagogjike dhe psikologjike të delikuencës së fëmijëve, ndërsa aspekti penal-juridik vendoset në plan të dytë. (Кнежевиќ, С. Малолетничко кривично право, 2010, f.105).

Këtu dallojnë këto masa nga sanksionet penale krahas shumë dallimeve të tjera që i kanë, si për nga natyra dhe pëmbajtja e tyre, efekti juridik, organi që i shqipton etj., por edhe duke u ndalur në pikën dalluese ku sipas nenit 22, p.2 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve ato mund të zbatohen edhe ndaj prindit në rastet e përcaktuara në këtë ligj, gjë që nuk mund të ndodh me sanksionet penale, tek të cilat në zbatim vlen gjithmonë parimi i Përgjegjësisë penale individuale të kryesit të veprës penale.

Ligji për drejtësinë e fëmijëve nuk i specifikon llojet e masave të ndihmës dhe mbrojtjes, por vetëm përcakton se këto janë masa të përcaktuara me ligje materiale nga fusha e: arsimit, shëndetësisë, sociale, familjes dhe formave të tjera të mbrojtjes (n. 23).

Në këtë rast Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i ka përcaktuar llojet e këtyre masave në *Listën* e masave të ndihmës dhe mbrojtjes, duke i'a bashkangjitur si Dokument shtesë Rregullores për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit për zbatimin e

[42] (Appendix to Recommendation Rec (2005) 5 of the Committee of Ministers to member states on the rights of the children living in residential institutios, 16 May 2005)

masave të ndihmës dhe mbrojtjes ndaj fëmijëve dhe të miturve në rrezik të miratuar në vitin 2008 (Gazeta Zyrtare e R.M., nr. 24/2008, f. 24-31).

4.3.1. Llojet e masave të ndihmës dhe mbrojtjes janë:

- Nga Ligji për mbrojtje sociale: Preventiva sociale; mbrojtja jashtainstitucionale; puna në terren; sigurimi i dokumentacionit personal; kujdesi ditor dhe i përkohshëm si ndihmë ndaj individit dhe familjes dhe udhëzimi në qendër të përshtatshme (ditore); mbrojtje institucionale; akomodim në ent për mbrojte sociale; e drejta për mbrojtje sociale;
- Nga ligji mbi Familjen: Lidhja e martesës; krijimi/forcimi i raporteve prindër-fëmijë; mbikqyrja ndaj të drejtës prindërore, raporteve të keqësuara dhe të dhunshme në martesë dhe familje; birësimi; kujdestaria; mbajtja; procedura në konteste martesore;
- Nga Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve– Veprimi me fëmijë dhe të mitur në rrezik; dhënia e pëlqimit për personin e mitur, veprimi sipas Konventave për mbrojtjen e fëmijëve.

Siç shihet nga ndarja e masave më lartë, terminologjia e Rregullores nuk është e harmonizuar në termet e Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve. (Buzharovska, G., Кривични постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, 2015, f. 202). Ajo duhet të përditësohet sepse termi "i mitur në rrezik" nuk ekziston në LDF. Termi "fëmijë dhe i mitur në rrezik" duhet të zëvendësohet me fëmijë në rrezik që nuk i ka mbushur 14 vjet dhe fëmijë në rrezik mbi moshën 14 vjeçare.

Procedura për zbatim të masave të ndihmës dhe mbrojtjes bazohet në këto dy parime kryesore të përcaktuara me ligj:

- Në ç'do procedurë të veprimit joformal, sikurse në procedurë gjyqësore, fëmijëve i'u garantohen të gjitha të drejtat themelore dhe të posaçme në pajtim me KDF dhe me aktet e tjera ndërkombëtare, në ç'do fazë të veprimit, dhe
- Veprimi, përcaktimi dhe zbatimi i masave patjetër duhet ti përshtatet interesit më të mirë të fëmiut, duke i marrë parasyshë veçoritë e tij personale, shkallën e pjekurisë dhe kushtet ekonomike në të cilat fëmiu jeton, peshën e veprimit të inkriminuar si dhe

pasojat e shkaktuar. (Buzharovska, G. Кривично постапување спрема децата..., 2015, f. 200) .

Pra, gjithmonë duhet të respektohet udhëzimi që të ndiqet pjekuria e fëmiut dhe aftësia e tij për të kuptuar veprën e kryer krahas nisjes gjithmonë nga mosha e tij, e cila jo gjithmonë korrespodon me kriteriumet e pjekurisë (Pajoviq.M. S., Мерките на помош и заштита според Законот за малолетничка правда, 2011, f. 441-468).

Për dallim nga LDF i cili nuk i përcakton konkretisht llojet e masave të ndihmës dhe mbrojtjes, vlen të përmendim legjislacionin penal të Republikës së Kosovës (Ligji penal për të mitur i Kosovës, 2004) i cili i ka paraparë këto masa para vendit tonë dhe ato emërtohen si "*Masa të Diversitetit*". Të tillat janë:

- Ndërmjetësimi në mes të miturit dhe palës së dëmtuar;
- Ndërmjetësimi në mes të miturit dhe familjes së tij;
- Kompenzimi i dëmit palës së dëmtuar;
- Vijimi i rregullt në shkollë;
- Pranimi i punësimit ose aftësimit në një profesion;
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme;
- Edukimi në rregullat e trafikut;
- Këshillimi psikologjik etj. (Kodi nr.03/L-193 i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, neni 18).

Këto masa janë më të lehta në krahasim me sanksionet penale, respektivisht me masat edukuese me vetë faktin se mund të shqiptohen vetëm për vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore, janë afatshkurte dhe paraqiten si lloj i masave alternative, e në këtë rast ato paraqesin alternativë të sanksioneve penale. Qëllimi i këtyre masave është parandalimi i fillimit të procedurës penale (mosekspozimi i të miturit në procedurë penale), resocializimi i të miturit si dhe parandalimi i delikuencës së fëmijëve. Si kushte për shqiptim të masave të ndihmës dhe mbrojtjes janë:

- Pranimi i përgjegjësisë dhe fajit nga fëmiu;
- Gatishmëria për pajtim e fëmiut me palën e dëmtuar;

- Dhënia e pëlqimit nga fëmiu apo prindi i tij se do të zbatojë masën e diversitetit. (Kodi nr.03/L-193 të drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, neni 17).

4.4. Efekti i sanksioneve penale për fëmijë në arritjen e parandalimit special, me vështrim të posaçëm në masat e entit dhe dënimit me burgim për fëmijë

4.4.1. Rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të gjykuar me masën e entit – Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese

Analizë e pyetësorit anketues:

Anketën e kam realizuar më 03 Maj të vitit 2017 në burgun për fëmijë në Ohër, i cili është i vetmi ent ndëshkues-korrigjues për ekzekutim të dënimit me burg për fëmijë në Republikën e Maqedonisë. Është shqetësues fakti se në të njëjtat hapësira ekzekutohet edhe masa edukuese e entit Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese[43] ndaj fëmijëve të gjykuar me këtë masë të cilët në ditën e realizimit të anketës në numër ishin gjithsej 18-të. Me këtë rast duhet potencuar se në Planin Aksional dhe kornizën buxhetore për implementimin e Ligjit për drejtësinë e të miturve të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2008-2009 ishte paraparë që zgjidhja për objekin e Shtëpisë edukuese-përmirësuese- Tetovë do të bëhej më së voni deri në fund të vitit 2009! Ende deri sot nga viti 2001 kjo zgjidhje nuk është realizuar, ku si pasojë e konfliktit të armatosur në atë kohë fëmijët u transferuan nga ai objekt dhe gjatë tërë kësaj kohe ata e kanë vuajtur këtë masë në hapsira jo të pështatshme për ekzekutimin e sukseshëm të saj! (Plani Aksional dhe Korniza Buxhetore për implementimin të Ligjit për drejtësinë e të miturve 2008-2009)[44].

Struktura e anketës: Anketa u realizua të njëjtën ditë me të gjithë fëmijët e dënuar- me burgim dhe me ata të gjykuar me masën e entit. Gjithsej në numër ishin 23 fëmijë, nga të

[43] Ent i vetëm edukues-përmirësues në Republikën e Maqedonisë është Shtëpia edukuese-përmirësuese – Tetovë, e cila nuk funksionon në Tetovë nga viti 2001! Disa vite fëmijët e gjykuar me këtë masë kanë qenë të vendosur në një objekt në qytetin e Velesit, kurse vitet e fundit janë të vendosur në objektin e burgut për fëmijë në Ohër!

[44] https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&cad=rja&uact=8&ved=0ahUKEwiG6_OM1ZDWAhVFJJoKHcSUAKAQFgglMAA&url=http%3A%2F%2Fwww.pravda.gov.mk%2Fdocuments%2FAkcionen%2520Plan-23%5B1%5D.01.2008godina.doc&usg=AFQjCNEIz7gzx9kezHk799O-j1rlamnJ8A

cilët 5 të dënuar me burgim, kurse 18 prej tyre të gjykuar me masën Dërgim në Shtëpi edukuese-përmirësuese.

Anketa është realizuar në mënyrë të qasjes së drejtëpërdrejtë nga ana e fëmijëve, me ç'rast ata u janë përgjigjur pyetjeve aty për aty, në disa raste duke u ofruar asistencë nga organizuesi i anketës dhe personeli i institucionit, sepse disa nga fëmijët kishin vështirësi në shkrim dhe lexim. Ky fakt e vështirësoi pak tempon e realizimit së këtij procesi, si edhe duke pasur parasyshë faktin se kjo ishte anketë- anonime ku fëmijët duhej të përgjigjeshin individualisht dhe duke u mbrojtur në mënyrë absolute privatësia e tyre gjatë dhënies së përgjigjeve: Me këtë rast ngelet një dozë dyshimi për faktin se sa fëmijët ishin të sinqertë në rastin kur duhej gojarisht të jepnin përgjigje në pyetjet të cilat i'u parashtroheshin në prani të personelit të sigurimit të burgut.

Anketa u realizua në hapsira të burgut dhe brenda disa orësh u arrit që të gjithë fëmijët të mund ti plotësonin pyetësorët në atmosferë shumë bashkëpunuese nga ana e tyre si dhe e vetë personelit, të cilët i inkurajuan fëmijët për të qenë sa më objektiv gjatë dhënies së përgjigjeve.

Pyetësori përbëhet nga dy pjesë, shumica e pyetjeve me opcion të përgjigjeve të shkurtëra, si shënim, rrethime, ndërsa vetëm dy pyetjet e fundit me kërkesën që fëmijët të mund të shënonin më tepër informacione të kërkuara.

Pjesa e parë e anketës përbanë pyetje të përgjithshme, si *Gjinia; Mosha; Përkatësia etnike, Vendbanimi; Lloji i sanksionit penal që e vuajnë; Kohëzgjatja e masës/dënimit; Niveli i shkollimit; Lloji i veprës penale për të cilën është gjykuar fëmiu.*

Pjesa e dytë përbanë këto pyetje si në vijim:

- *A keni qenë të dënuar më parë me dënim me burgim?*
- *A keni qenë të gjykuar/dënuar më herët? Nëse po, me ç'farë sanksioni?*
- *Sa ka pasur ndikim pozitiv tek ju masa e vuajtur deri tani?*
- *Ç'ka më së shumti ju ka ndihmuar gjatë tretmanit në ent?*
- *Me cilat kushte të entit/ trajtimit nuk jeni të kënaqur?*
- *A ndiqni orë mësimore, dhe nëse po nga kush (kush ua mban ato orë)?*

- *Ç'ka ju mungon për tretman më të mirë?*

➢ Qëllimi: Nxjerrja në pah e efektit të sanksioneve penale për fëmijë, respektivisht masës edukuese institucionale- Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese në arritjen e qëllimit të parandalimit special tek fëmijët e gjykuar.

Qëllimi i parashtrimit të pyetjeve nga pjesa e parë ishte që të pasqyrohet struktura e fëmijëve të anketuar, sa i përket kategorizimit të tyre sipas moshës, përkatësisë etnike, nivelit të shkollimit etj. Kurse pjesa e dytë e anketës përmban pjesën kryesore, nga e cila pritej të nxirren rezultatet kryesore, rreth fakteve që kanë të bëjnë me tretmanin e fëmijëve të gjykuar brenda institucionit penitensiar dhe nxjerrjen e përgjigjes në pyetjen kyçe rreth *Suksesit të realizimit të qëllimit të preventivës speciale apo të ashtuquajturës "preventiva terciere" e dënimit me burg/masës së entit ndaj fëmijëve të gjykuar, respektivisht të dënuar.*

Në vazhdim do të paraqiten rezultatet nga anketa të shoqëruara me tabelat përkatëse me përgjigjet e fëmijëve të anketuar.

TABELA 1 - Numri dhe gjinia e fëmijëve të anketuar		
Gjithsej	23	
Gjinia e fëmijëve të anketuar	M	F
	23	0
Numri i fëmijëve të dënuar me burg	5	
Numri i fëmijëve të gjykuar me masën Dërgim në Shtëpi edukuese-përmirëse	18	

Pyetësorin e plotësuan të gjithë fëmijët në hapsirën e entit ndëshkues-korrigjues në Ohër. Gjithsej ishin 23 fëmijë, nga të cilët 5 ndaj të cilëve po ekzekutohej dënimi me burg për fëmijë, dhe 18-të të cilët e vuanin masën edukuese – Dërgim në Shtëpinë edukuese-përmirësuese.

Sa i përket gjinisë së fëmijëve të anketuar, të gjithë ishin të gjinisë mashkullore. Ekzekutimi i dënimit me burg të fëmijëve të dënuara femra në Republikën e Maqedonisë realizohet në institucionin penitensiar në Idrizovë, ku fatkeqësisht femrat e mitura të dënuara qëndrojnë

dhe e vuajnë dënimin së bashku me femrat madhore të dënuara me burg. Kjo sepse për tërë territorin e vendit, për të gjitha femrat e dënuara me burg, (të mitura dhe madhore) ekziston vetëm një hapsirë e veçantë në kuadër të burgut Idrizovë në Shkup. Ky fakt, së pari, që të miturat qëndrojnë në të njejtën hapsirë me ato të dënuarat e moshës madhore, dhe së dyti, që dënimi ekzekutohet në një institucion penitensiar të tipit të mbyllur sipas sigurisë (burg në të cilin vendosen personat e dënuar me mbi tre vite burgim) është në kundërshtim me rregullativën ndërkombëtare dhe atë nacionale sa i përket ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj personave jomadhorë. Megjithatë, fakt inkurajues është situata reale se gjatë vitit 2017 në Republikën e Maqedonisë nuk kishte asnjë fëmijë të gjinisë femrore të dënuar me dënim me burgim.

a) Rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të gjykuar me masën Dërgimi në Shtëpi edukuese- përmirësuese:

Pjesa I e anketës:

TABELA 2 – Numri dhe gjinia e fëmijëve të gjykuar me Masën e entit – Dërgimi në Shtëpi edukuese-përmirësuese				
Gjithsej	**18**	**Gjinia**	**M**	**F**
			18	**0**

Tabela 2 pasqyron numrin dhe gjininë e fëmijëve të anketuar, të cilët ishin të gjykuar me masën Dërgim në Shtëpi edukuese-përmirësuese, ku nga 18, të gjithë ishin të gjinisë

TABELA 3 – Mosha e fëmijëve të gjykuar me Masën e entit									
Mosha	15	16	17	18	19	20	21	22	23
	1	1	4	4	4	3	-	-	1

mashkullore. Ndërkaq, në tabelën 3 është e paraqitur mosha e fëmijëve të anketuar, nga mund të shihet se janë prezente grupmosha të ndryshme, shumica 17-20 vjeçarë. Një nga fëmijët ishte 23 vjet, ç'ka le të supozojmë se gjykata mesiguri do të vendosë për vazhdim të masës sipas nevojës, duke pasur parasysh përcaktimin ligjor sipas LDF, ku këto masa mund të ekzekutohen deri sa fëmiu të mbushë 23 vjet.

TABELA 4 – Përkatësia etnike e fëmijëve të gjykuar me Masën e entit				
Romë	Maqedonas	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq

12	1	2	1	2

Nga përkatësia etnike e fëmijëve të anketuar, shumica ishin të përkatësisë rome, siç shihet edhe në tabelën 4: 12(romë), ndërkaq të tjerët ishin të përkatësive të tjera.

TABELA 5 – Vendbanimi i fëmijëve të gjykuar me Masën e entit							
Shkup	Tetovë	Kavadar	Shtip	Manastir	Koçani	Strumicë	Kumanovë
9	2	1	1	1	2	1	1

Në tabelën 5 është paraqitur vendbanimi i fëmijëve të anketuar të gjykuar me masën e entit. 9 prej tyre vinin nga komuna e Shutkës, në qytetin e Shkupit që ndërlidhet me treguesin e lartëpërmendur të përkatësisë etnike të këtyre, duke e njohur faktin se kjo komunë përbëhet nga shumica e popullsisë me përkatësi etnike rome. Ndërkaq gjysma tjetër e fëmijëve kanë vendbanim në qytete të ndryshme të vendit, si Tetovë, Kavadar, Shtip, Manastir, Koçani, Strumicë dhe Kumanovë.

TABELA 6 - Kohëzgjatja e masës së vuajtur							
Vite/Muaj	6m	1v	1,5v	2	2,5	3	3v,2m
Nr. i fëmijëve	1	2	3	4	4	2	2

Në tabelën 6 është paraqitur kohëzgjatja e masës të cilën aktualisht e kanë vuajtur fëmijët, respektivisht koha të cilën e kanë kaluar në institucionin penitensiar nga momenti i egzekutimit të këtij sanksioni penal e deri në ditën e anketimit. Kohëzgjatja e plotë e masës, apo koha e plotë të cilën do ta kalojë fëmiu në këtë ent nuk mund të dihet saktë paraprakisht, sepse për vazhdimin apo ndërprerjen e kësaj mase gjykata vendosë në mënyrë plotësuese, varësisht prej rastit dhe nevojave individuale të fëmiut. Pra, gjykata ç'do vit e shqyrton nevojën për (mos)zgjatje të masës, varësisht nga rezultati i arritur i përmirësimit të fëmiut.

Aktualisht një nga fëmijët kishte mbushur 6 muaj qëndrim në këtë ent, dy nga ata ishin mbushur 1 vit, 3 nga ata kishin 1 vit e gjysëm, katër nga fëmijët ishin 2 vite, 4 të tjerë kishin 2,5 vite, dy të tjerë tre vite, ndërkaq 2 fëmijë kishin 3 vite e dy muaj.

TABELA 7 - Niveli i shkollimit të fëmijëve të gjykuar me masën e entit									
Fillor	Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
		2	2	-	1	1	-	-	6
I mesëm	Viti	I	II	III	IV				
		2	-	1	-				
Analfabetë		3							

Nga të dhënat e shënuara në tabelën 7, shihet niveli i shkollimit të fëmijëve të anketuar. Sipas rezultatetve shumica e tyre kanë mbaruar vetëm nivelin fillor të edukimit, dhe atë gjashtë prej tyre kanë mbaruar klasën e 8-të të shkollës fillore, kurse një klasën e 4-të dhe një atë të 5-të, e dy prej tyre vetëm klasën e 1-rë dhe dy të tjerë të 2-tën.

Kjo është një tregues shumë shqetësues për zhvillimin e këtyre fëmijëve, duke pasur parasysh moshën e tyre , ku të gjithë janë mbi moshën 14 vjet dhe nuk e kanë mbaruar së paku arsimin fillor. Disa nga ata kanë ngelur në klasat fillestare të shkollimit (1,2,4).

Problemi është edhe më i thellë me ata fëmijë të cilët nuk kanë ndjekur as edhe një ditë procesin edukativo-arsimor, ku për momentin në ent të gjykuar me masën Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese ishin tre fëmijë, të cilët nuk dinin shkrim-lexim.

Vështirësi në shkrim-lexim kishin edhe disa fëmijë të tjerë, fakt që konstatuam gjatë vëzhgimit të procesit të plotësimit të pyetësorit anketues!

TABELA 8 - Vepra penale për të cilën janë dënuar fëmijët dhe numri i tyre	
Vepra penale	**Nr. i fëmijëve**
Vjedhje	6
Vjedhje e rëndë	4
Vjedhje e automobilave	1
Pjesëmarrje në rrahje	1
Kontrabandë me migrantë	1

Shkaktim i lëndimit të rëndë trupor	2
Hedhje e materialit eksplodues	1
Dhunë	1
Dhunim	1

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 8, edhe një herë vërtetohet fakti se fëmijët janë të prirur të kryejnë më së shpeshti vepra penale kundër pasurisë. Nga tabela 8 shihet se shumica e fëmijëve janë të gjykuar për kryerje të veprës penale Vjedhje (6 fëmijë), e disa për Vjedhje të rëndë (4 fëmijë); Vjedhje të automobilave (1 fëmijë).

Edhe pse nuk mungojnë, ndonjëse në numër të vogël, ka vepra penale të tjera të ndryshme nga ato kundër pasurisë, si: Pjesëmarrja në rrahje; Dhuna; Dhunimi; Kontrabanda me migrantë; Hedhja e materialeve eksploduese; Lëndim trupor.

Pjesa II e anketës

Natyra e pyetjeve në pjesën e dytë të anketës lidhet drejtëpërdrejtë me efektivitetin e masës edukuese ndaj fëmijëve.

TABELA 9- A keni qenë të gjykuar më herët? Nëse po, me ç'farë sanksioni penal?			
JO	**12**	**PO**	**6**
PO	**6**		
		Dërgim në qendrën edukuese për fëmijë "Ranka Milanoviq" në Shkup;	3
		Dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese – Tetovë	1
		• Dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese – Tetovë • Burg për fëmijë	2

Në tabelën 9 janë paraqitur përgjigjet e fëmijëve në pyetjen se a kanë qenë të gjykuar më herët , nëse po – Ç'farë sanksioni penal i'u është shqiptuar? Shumica e tyre (12) nuk kanë

qenë të gjykuar më herët, pra janë kryerës primar. Ndërsa gjashtë prej tyre janë përgjigjur Po- pra janë përsëritës. Ku tre prej tyre kanë qenë të gjykuar me masën edukuese – Dërgimi në qendër të hapur edukuese për fëmijë " Ranka Milanoviq" në Shkup. Një prej tyre ka qenë i gjykuar me të njejtën masë edukuese të entit – Dërgimi në Shtëpi edukuese-përmirësuese; Dy prej tyre më herët kanë qenë të gjykuar më shumë se një herë – me masën edukuese të entit, si dhe me dënimin me privim nga liria.

Duke pasur parasyshë faktin se përbërja e këtyre fëmijëve sipas grupmoshave ishte e ndryshme, duke përfshirë shumicën e tyre në grupmoshat mbi 16 vjet deri në 23, ishte e arsyeshme kjo pyetje për të zbardhur faktin se nëse ata ishin përsëritës, respektivisht të gjykuar më herët dhe me ç'farë sanksioni penal.

Varësisht nga rrethanat e çështjes penale, gjykatësi edhe pse sipas parimeve ligjore duhet të i'u jep përparësi masave më të lehta krahas dënimit me privim nga liria, (i cili duhet të jetë vetëm si mjet i fundit për shqiptim atëherë kur gjykata do të çmojë se masat më të lehta nuk do të kenë efekt pozitiv për përmirësimin e fëmiut) është i lirë që të vendosë edhe në mënyrën e kundërt me këtë të përmendurën. Nga edhe shihet se në këto dy raste, edhe pse fëmijëve për veprat penale të kryera më herët i'u është shqiptuar dënim me burgim, për veprën e mëvonshme u është shqiptuar sanksion më i lehtë, siç është masa e entit.

TABELA 10 - Sa ka pasur deri tani ndikim pozitiv masa edukuese?		
Shumë	Pak	Shumë pak/Aspak
10	3	5

Në tabelën 10 janë paraqitur përgjigjet e fëmijëve rreth efikasitetit të masës, me ç'rast shumica e tyre (10 fëmijë) vlerësojnë se ndikimi pozitiv i masës është shumë i madh tek ata, ndërsa tre e vlerësojnë si jo shumë efikase, kurse pesë prej tyre si shumë pak, respektivisht aspak efikase masën që po e vuajnë.

Një nga treguesit më të rëndësishëm për joefikasitetin e masave të cilat ekzekutohen ndaj fëmijëve kryerës të vepra penale është përsëritja e veprës. Kështu, sipas një analize të realizuar nga Këshilli shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, rezultoi se

përsëritja tek tërë personat e anketuar paraqitet në 35.8%, dhe atë tek fëmijët të cilëve i'u është shqiptuar masë joinstitucionale përfshinë 33,0%, ndërkaq, tek fëmijët me masë institucionale (përfshirë edhe burgun për fëmijë), niveli i saj (i përsëritjes) është më i lartë dhe përfshinë 42,5%. Sipas të dhënave statistikore të Entit Shtetëror Statistikor për 2009, nga gjithsej 748 të mitur të gjykuar, 108 (14,44%) janë përsëritës. Nga ata, 98 (91,67%) janë dënuar për veprat e njejta, kryesisht delikte pasurore (92,86%) (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 47)

TABELA 11 - Ç'ka më së shumti ju ka ndihmuar gjatë tretmanit në ent?
➢ Biseda me psikologen (gati gjysma e fëmijëve e kanë potencuar), ➢ Bisedat me edukatoren, ➢ Bisedat/ seancat e organizuara nga psikologu në grup; ➢ Trajtimi individual me psikologen dhe drejtorin – për të na mbjellur idenë se nëse sillemi mirë do të dalim më shpejtë nga enti; ➢ Mundësitë e shkuarjes për fundjavë në shtëpi; Sporti; ➢ Koha e cila më ka mundësuar të mendoj vetë për gabimin dhe analizimin e situatës kritike.

Në tabelën 11 janë pasqyruar përgjigjet më të shpeshta të fëmijëve në pyetjen se ç'ka nga tretmani i deritanishëm ju ka ndihmuar atyre. Përgjigjet ishin deri-diku të ngjashme, që përsëriteshin nga shumica e fëmijëve.

TABELA 12 - Me cilat kushte të entit/ trajtimit nuk jeni të kënaqur?[45]
Përgjigje më të shpeshta nga tre mundësitë e zgjedhjes (**Higjiena, Personeli apo Siguria etj**): ➢ Higjiena e dobët, (Ankesa se mundësitë për të mbajtur higjienën personale ishin minimale, duke i'u mundësuar fëmijëve vetëm një herë në javë për të bërë dush

[45] Meqenëse anketa u realizua në prani të policit rojtar të burgur, dhe se shumica e fëmijëve kishin vështirësi në shkrim-lexim, duhej që të ua lexonim pyetjet e anketës e ata të përgjigjeshin gojarisht. Kishte disa prej tyre të cilët hezitonin të shprehen lirshëm për pakënaqësitë e tyre lidhur me trajtimin penitensiar, por që ishte shumë evidente nga vetë gjuha e trupit të tyre kur ju parashtronim pyetjet e asaj natyre.

(zakonisht të dielave);

- Hapsira shumë e ngushtë, (Ku fëmijët nuk kishin mundësi që të kalojnë kohën e lirë në ndonjë hapësirë më të madhe sesa oborri i objektit të burgur, i cili është i shtruar i tëri me beton, pa asnjë haprsirë gjelbërimi.
- Poashtu objekti është shumë i vjetër, i pa renovuar për shumë vite, i lokalizuar në mes të qytetit dhe i rrethuar me shtëpi banimi, vetë oborri i tij është i ngjitur me muret dhe dritaret e disa shtëpive të banuara.

Në tabelën 12 janë paraqitur pëgjigjet e fëmijëve reth pyetjes se me cilat kushte brenda entit ata nuk ishin të kënaqur. Të gjithë janë ankuar për kushtet e pamjaftueshme higjienike de sanitare të objektit. Poashtu për hapsirën shumë të ngushtë të vetë objektit.

Më shqetësues është fakti se këta fëmijë nuk duhet assesi të ishin të vendosur për disa vite tani më, në të njëjtin objekt me fëmijët e dënuar me burgim! Ata edhe pse de jure nuk janë të dënuar me burg për fëmijë, mirëpo ata de facto po e vuajnë dënimin me burg bashkë me ata të cilët janë të dënuar me burg.

Kishte edhe disa nga ata të cilën janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur me trajtimin nga personeli i burgut, si rojet dhe me vetë sigurinë brenda objektit. Poashtu edhe përgjigje të tipit " Me asgjë nuk jam i kënaqur".

TABELA 13 - A ndiqni orë mësimore, dhe nëse po nga kush?		
JO:	**9:**	
PO:	**9:**	*"Mbajmë orë mësimore me psikologun, edukatoren ose nga rojtarët. Lëndë të gjuhës maqedonase, shkrim dhe lexim, vizatim, muzikë, matematikë, gjeografi."*

Nga përgjigjet e fëmijëve në tabelën 13 mund të konstatojmë një fakt tjetër shumë shqetësues, për mosefikasitetin e dispozitave nacionale dhe ndërkombëtare sa i përket obligimit të ndjekjes së procesit edukativo-arsimor të fëmijëve, duke përfshirë atë fillor dhe të mesëm. Gjysma e tyre janë përgjigjur se nuk mbajnë aspak orë mësimore, pra, brenda entit

nuk funksionon sistemi edukativo-arsimor aspak. Kurse gjysma tjetër, poashtu me përgjigjet e dhëna, nën përgjigjen PO – e kanë vërtetuar faktin e lartëpërmendur.

Duke u referuar në dispozitat përkatëse të Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve, sipas të cilave qëllimi i dënimit të fëmijëve është edukimi, përmirësimi dhe mbrojtja e interesit të fëmiut, poashtu sipas Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Të Miturve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Pekinit), shtetet duhet të sigurojnë që fëmijët të vazhdojnë shkollomin brenda entit ku e vuajnë dënimin, me qëllim të mosngecjes së tyre në sistemin edukativo-arsimor. Por, meqenëse, Ministria e Arsimit e cila është kompetente për të angazhuar mësues/arsimtarë që do të mbanin orë me fëmijët e privuar nga liria, nuk ka ndërmarrë asnjë hap asnjëherë deri më tani në këtë drejtim, edhe personeli i burgut në një mënyrë "obligohet" që fëmijëve të paktën të ua organizojë disa leksione elementare, si ato që i kemi pëmendur më lartë në përgjigjet e fëmijëve.

Përgjigje tjetër për këtë problem morrëm edhe nga ana e dy antarëve të personelit të burgut për fëmijë. Përgjigjja e tyre në pyetjen se përse Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka angazhuar mësimdhënës për fëmijët e privuar nga liria, ishte për shkak të faktit se fëmijët janë me nivele të ndryshme të nevojave për edukim. Disa nga famijët aspak nuk kanë shkuar në shkollë dhe janë analfabetë, disa të klasave të ndyshme fillore dhe pak prej atyre kanë ngelur në atë të mesmëm. Pra, është e vështirë të organizohen orë mësimore sepse nevojat e fëmijëve janë të niveleve të ndryshme. Në këtë rast, konsideroj se kjo përgjigje nuk është arsyetim për këtë mosfunksionalitetin e ministrisë përkatëse kompetente. Mendoj se nuk mund të arrihet asnjë efekt përmirësimi në sjelljen e këtyre fëmijëve që ndodhen në entin penitensiar në Ohër, nëse ata për një periudhë të caktuar kohore (disa vite) ngelin të çkyçur nga procesi edukativo-arsimor. [46]

[46] Parashtrohet dilema, se si këta fëmijë do të munden të integrohen në shoqëri, pasi të kenë mbaruar me ekzekutimin e sanksionit penal? Kur moshatarët e tyre kanë kaluar disa nivele të arsimimit, apo cilat janë mundësitë që ata të punësohen apo të jenë të aftë për ndonjë veprimtari, kur në këtë ent asnjë zanat/mundësi profesionalizimi nuk ju mundësohet fëmijëve, përveç kuzhinierisë?! Cili është efekti i preventivës speciale të këtij sanksioni (qoftë masës së entit apo burgut për fëmijë), nëse fëmiu pas disa vitesh kur të del në liri, nuk do të ketë asnjë derë për tu drejtuar për të vazhduar jetë, përpos mundësisë për ekzistencë të cilën do të mundet ta arrijë ndoshta vetëm me mënyra ilegale? Këto janë disa pyetje

TABELA 14 - Ç'ka ju mungon për tretman më të mirë?
➢ Mjek (mungesa e së paku një mjeku) ➢ Shkollimi; ➢ Aktivitet sportive, pajisje për aktivitete sportive, si: Fusha për futboll, tenis, lojra të ndryshme, kompjutera; ➢ Ushqim më i pasur etj.

Siç mund të shihet nga vetë përgjigjet e fëmijëve në tabelën 14, duhet të investohet shumë nga ana e organeve kompetente (Ministria e Drejtësisë dhe të tjera) që fëmijët ti kenë kushtet më të volitshme për tu zhvilluar dhe për tu (ri)edukuar. Mungesa e kushteve e bën të pamundur këtë qëllim.

4.4.2.Rezultate nga anketa e realizuar me fëmijë të dënuar me burg për fëmijë

Pyetësori i cili u përdor me rastin e anketimit të fëmijëve të dënuar me dënimin me burg për fëmijë, ishte i njejti i cili u përdor edhe me fëmijët e gjykuar me masën edukuese- Dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese. Kështu që, natyra e pyetjeve, struktura dhe qëllimi i tyre janë të njejta si të përshkruara më lartë tek pjesa e Rezultateve nga Anketa e realizuar me fëmijët e gjykuar me masën edukuese të entit.

Pjesa I e anketës:

TABELA 15– Numri, Gjinia, Mosha e fëmijëve të dënuar me burg për fëmijë (2017)			
Gjithsej	5		
Gjinia	Mashkuj: 5	Femra: 0	
Mosha	18	19	22
	2	2	1

"Notore", të cilave nuk është e nevojshme të ju japim përgjigjen të cilën të gjithë mund ta gjejmë shumë lehtë, sepse fati i këtyre fëmijëve fatkeqësisht, në këtë gjendje nuk është shumë shpresëdhënës, nga ajo që parashihet *de lege!*

Siç është paraqitur në tabelën 15 - pra në vitin 2017 ishin 5 fëmijë të dënuar me dënimin me privim nga liria, i cili ekzekutohet në institucionin ndëshkues-përmirësues për fëmijë në Ohër. Të gjithë janë të gjinisë mashkullore. Dy janë18-vjeçar, dy janë 19-vjeçar, kurse një është 22-vjeçar.

TABELA 16 - Përkatësia etnike dhe vendbanimi i fëmijëve të dënuar me burg			
Përkatësia etnike	**Romë**	**Maqedonas**	**Shqiptarë**
	2	1	2
Vendbanimi	**Shkup**	**Shtip**	**Kumanovë**
	3	1	1

Në tabelën 16 është paraqitur numri i fëmijëve të anketuar sipas përkatësisë së tyre etnike dhe sipas vendbanimit të tyre. Dy prej tyre janë romë dhe dy të tjerë shqiptarë, kurse një maqedonas. Tre nga fëmijët kanë vendbanim në qytetin e Shkupit, një në Shtip dhe një në Kumanovë.

TABELA 17 - Shkalla e edukimit të fëmijëve të dënuar me burg					
Niveli i shkollimit	**Fillor**	Kl.	V	VII	VIII
			1	1	1
	I mesëm	Viti	III		
			1		
Analfabet			1		

Në tabelën 17 është paraqitur numri i fëmijëve sipas shkallës së edukimit të tyre. Tre prej tyre kanë mbaruar vetëm nivelin fillor të edukimit, dhe atë secili në nivele të ndryshme, njëri e ka mbaruar atë, ndërsa dy të tjerët - klasën e V-të; VII-të. Njëri nga fëmijët ka mbaruar vitin e tretë të shkollës së mesme para se të privohej nga liria. Kurse një prej tyre ishte analfabet – aspak nuk kishte shkuar në shkollë.

TABELA 18 – Kohëzgjatja e burgimit dhe lloji i veprës penale për të cilën është dënuar				
Kohëzgjatja e dënimit me burg	**Vite**	**2v**	**5v**	**9v**
	Nr. i fëmijëve	**1**	**2**	**2**

Lloji i veprës penale për të cilën janë dënuar[47]	**Nr. i fëmijëve**
Vrasje	**1**
Grabitje	**3**
Lëndim i rëndë trupor, Grabitje, Shitje të lëndëve narkotike…	**1**

Në tabelën 18 janë paraqitur për secilin fëmijë të anketuar rezultatet lidhur me kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar dhe llojin e veprës penale për të cilën janë dënuar. Është interesant e dhëna se dy nga fëmijët janë dënuar me kohëzgjatje afatgjate (afër maksimumit të paraparë ligjor për këtë dënim) prej 9 vitesh; dy të tjerë me 5 vite dhe një me 2 vite.

Njëri i dënuar me 9 vite burg është i dënuar për veprën penale Vrasje; Tjetri i dënuar me po aq vite (9 vite) është dënuar me këtë dënim të vetëm për kryerje të më shumë veprave penale, si Grabitje, Shkaktim i lëndimit të rëndë trupor, Shitje të lëndëve narkotike. Tre fëmijë janë dënuar për kryerje të veprës penale Grabitje.

Pjesa II e anketës së realizuar me fëmijë të dënuar me burgim:

TABELA 19: A keni qenë të gjykuar më parë?	
PO:	3
JO:	2

Në tabelën 19 është paraqitur gjendja e fëmijëve të dënuar me burg për fëmijë, sipas asaj nëse janë të gjykuar për herë të parë ose kanë qenë të gjykuar edhe më parë., respektivisht a janë kryerës primarë apo recidivistë. Tre prej tyre kanë qenë të gjykuar dhe më herët, kurse dy prej tyre jo.

[47] Të dhënat e paraqitura janë bazuar në deklarimet e fëmijëve të anketuar. Vërtetësia e tyre është relative, duke pasur parasyshë faktin se fëmijët në disa raste mund të mos ishin të sinqertë plotësisht gjatë përgjigjeve. P.sh. tek pyetja për llojin e veprës penale për të cilën është dënuar i mituri, njëri nga të miturit nuk u tregua i sinqertë – duke u deklaruar se ka kryer Grabitje, por në fakt është dënuar për vepër penale Sulm seksual ndaj fëmiut në moshë shumë të re! Kjo sepse fëmiu nuk mundej vetë ta plotëson pyetësorin dhe gjatë kontaktit direkt verbal me organizuesin e anketës – si duket ka hezituar për ta treguar të vërtetën!

TABELA 20: Nëse keni qenë të gjykuar më herët, ç'farë sanksioni është shqiptuar ndaj jush? JO- 2 fëmijë; PO – 3 fëmijë
1 fëmijë-Burg për të mitur 1 fëmijë- Dërgim në shtëpi edukuese – nga 6 muaj, dhe një herë me burgim për 1 vit 1 fëmijë- Dërgim në shtëpinë edukuese përmirësuese

Qëllimi i këtyre dy pyetjeve, të paraqitura në tabelat 19 dhe 20 është që të pasqyrohet efektiviteti i sanksioneve penale ndaj fëmijëve. Nëse ndaj fëmijëve të gjykuar do të arrihej efekti i (ri)edukimit të tyre, nuk do paraqiteshin raste të fëmijëve recidivistë. Shumica e fëmijëve të dënuar me burg (3 nga 5 fëmijët) janë përsëritës, respektivisht të dënuar më herët për vepra të tjera penale.

TABELA 21: Sa ka pasur ndikim pozitiv tek ju dënimi i vuajtur deri tani?		
Shumë	Ndopak	Shumë pak/Aspak
4	-	1

Sipas tabelës 21 - shumica e fëmijëve (4) e konsiderojnë vuajtjen e dëimit me burg - tretmanin penitensiar si faktorë pozitiv në përmirësimin e sjelljeve/bindjeve të tyre. Ndërsa një prej fëmijëve të anketuar është përgjigjur se qëndrimi në burg nuk ka ndikuar aspak pozitivisht tek ai, respektivisht tretmani që ofrohet në këtë institucion nuk i ka ndihmuar atij për përmirësimin e gjendjes/sjelljes së tij. Në vazhdim, në tabelat 22 dhe 23 janë paraqitur përgjigjet e fëmijëve rreth pyetjeve që lidhen me kushtet e tretmanit penitensiar – të dobishme/ jo të dobishme për fëmijët.

TABELA 22: Ç'ka më së shumti ju ka ndihmuar gjatë tretmanit në burg?
Disa nga përgjigjet më të shpeshta: Biseda me psikologen dhe seancat në grup me fëmijët e tjerë;Kursi për kuzhinier;Puna në kuzhinë;Një fëmijë kishte mbaruar shkollimin e mesëm në SHM "Vanço Pitosheski" në Ohër; "Asgjë, vetë puna individuale si dëgjimi i muzikës, leximi i librave dhe shkrimi i poezive.."
TABELA 23: Me cilat kushte të entit/ trajtimit nuk jeni të kënaqur?
Përgjigje më të shpeshta (Higjiena, Personeli apo Siguria etj)[48]:

[48] Ankesat e fëmijëve të dënuar ishin deri diku të njëjta me ata të fëmijëve të gjykuar me masën e entit, meqenëse e shfrytëzonin të njëjtin objekt, të njëjtën kuzhinë, të njëjtat dhoma dhe i njejti tretman nga i njëjti personel minimal (dy psikologe dhe një edukatore). Vetëm hapësira e oborrit ku fëmijët kalojnë aktivitetet brenda ditës është ndarë në mes me një ndarëse të rrjetës, e cila ua ndalon kontaktin fizik njërës palë me tjetrën!

• Higjiena e dobët (Këtë e kishin shënuar të pesë fëmijët e anketuar); Hapsira shumë e ngushtë; Siguria, Mungesa e kushteve elementare për jetesë, e cila i kushtëzon fëmijët që të marrin gjithçka prej shtëpive të tyre.

Nga të dhënat në tabelën 24 edhe një herë vërtetohet gjendja reale fëmijëve të gjykuar me sanksione që kanë për pasojë privimin nga liria (masa të entit/ burg për fëmijë) në raport me procesin edukativo-arsimor. Kjo e drejtë e fëmijëve dhe njëkohësisht obligim i institucioneve shtetërore përkatëse nuk realizohet në praktikë.

TABELA 24: A ndiqni orë mësimore, nëse po nga kush ?	
JO	3
PO	2
• "Mbajmë orë mësimore me psikologun, edukatoren ose nga rojtarët" • Njërit i është mundësuar që ta kryejë jashtë shkollimin e mesëm, ku e ka marrë edhe diplomën, në të cilën normalisht nuk shënohet se është fituar gjatë vuajtjes së dënimit me burg.	

Është shqetësues rezultati nga kjo pyetje, kur shihet se fëmijët përgjigjen se orë mësimore iu mbajnë punonjësit policorë të sigurimit të burgut ose nga psikologja!

TABELA 25: Ç'ka ju mungon për tretman më të mirë?
Përgjigjet më të shpeshta të fëmijëve: "Mungesa e mjekut të përgjithshëm, stomatologu (shumica e fëmijëve kishin gjendje të keqe të shëndetit oral); Shkollimi; Aktivitet sportive, pajisje për aktivitete sportive, si: Fusha për futboll, tenis, lojra të ndryshme, kompjutera; ushqim më i pasur etj.

Përgjigjet e fëmijëve të paraqitura në tabelën 25 rreth kushteve që i'u mungojnë ishin thuajse identike me ata të fëmijëve të anketuar të gjykuar me masën edukuese të entit.

KAPITULLI V

5. NDIKIMI I DISA FAKTORËVE SOCIAL NË PARANDALIMIN E KRIMINALITETIT TË FËMIJËVE

Kur flasim për preventivë, flasim për një qasje multisektorale dhe multidisiplinare në ndërtimin e strategjive për parandalim të delikuencës së fëmijëve, e cila ka për qëllim t'i identifikojë faktorët e rrezikut të cilët ndikojnë ndaj kësaj dukurie, por edhe ndaj faktorëve mbrojtës të cilët është e domosdoshme të forcohen me qëllim që rrethina mbrojtëse të jetë dominuese. Ekzistojnë shumë arsye se përse fëmijët dhe të rinjtë kryejnë vepra penale apo kanë sjellje antisociale. Ato të cilët janë përgjithësisht të pranuara, para se gjithash e përfshijnë mjedisin ekonomiko-shoqëror dhe social si: Kohërat turbulente, ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore, pasiguria sociale, varfëria dhe margjinalizimi, papunësia në përgjithësi dhe ajo tek të rinjtë, sfidat të cilat ekzistojnë brenda familjeve, hendeku mes gjeneratave, (jo)mundësitë për edukim dhe trajnim të përshtatshëm me pasojë të rezultateve të dobëta shkollore, keqpërdorimi i alkoolit, drogave dhe substancave të tjera, gjë që mund të sjellin deri tek kryerja e veprave penale nga ana e fëmijëve (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 13).

Për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve, shoqëria përdor në rend të parë masa parandaluese të cilat kanë të bëjnë me evitimin e faktorëve të përgjithshëm dhe individualë me ndikim në shfaqjen dhe ekzistimin e kësaj dukurie të dëmshme shoqërore (Gashi, 1997). Faktorët që ndikojnë tek të rinjtë që të jenë autorë të veprave penale, janë të shumtë. Shikuar në aspektin kriminologjik, faktorët socio-patologjikë ndikojnë në masë të madhe në shfaqjen e kriminalitetit në një shoqëri. Këto dukuri socio-patologjike kanë të bëjnë me atakimet dhe cënimet e disa vlerave morale, njerëzore, sociale, të cilat shkaktojnë shfaqjen e sjelljeve delikuente dhe kriminale në një vend (Halili, Kriminologjia, 2008, f. 288). Për shfaqjen e sjelljeve kriminale, përveç faktorëve të tjerë ndikim të theksuar ushtrojnë edhe dukuria e alkoolizmit dhe narkomania (Shishani, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, 2006, f. 113). Alkoolizmi ka lidhje të caktuara me kryerjen e një vargu aktivitetesh, si ofendime, shpifje, dhunime, lëndime trupore, plaçkitje, maltretim e lënie pas dore e kujdesit ndaj familjes, si veprime që kryhen drejtëpërsëdrejti nën ndikimin e gjendjes

së dehjes kronike. (Halili, Kriminologjia, 2008, f. 306) Prandaj, sot në disa vende të botës, si veprime që merren për të penguar shfaqjen e sjelljeve kriminale si pasojë e alkoolizmit, janë paraparë: Ndalimi për t'u dhënë alkool personave të mitur, ndalimi i ngasjes së automjeteve nën ndikim të alkoolit ose në gjendje të dehjes (Demolli, Problemet e Alkoolizmit dhe Narkomanisë Nocioni dhe Paraqitje e tyre rev. "E drejta", 1996, f. 145).

Faktorët e rrezikut vetë si të tillë nuk paraqesin shkak për delikuencë të fëmijëve, megjithatë në kombinim me faktorë të tjerë të rrezikut dhe me karakteristikat e posaçme të individit, mund të konsiderohen si shkaqe për delikuencë. Megjithatë ekzistimi i më shumë faktorëve të rrezikut tek disa fëmijë dhe të rinjë mundet por nuk do të thotë se duhet patjetër të shpiejë deri në delikuencë. Kjo, mbi të gjitha varet nga ekzistimi i faktorëve të cilët e mbrojnë fëmiun/të riun nga rreziqet që ndikojnë negativisht. Mund të thuhet se faktorët mbrojtës i amortizojnë faktorët e rrezikut dhe stimulojnë sjellje pozitive apo e forcojnë rezistencën tek individët, zhvillojnë sjellje pozitive, lidhje ndaj familjes, shkollës, ndaj ndonjë madhori në apo jashtë familjes etj. Edhe tek faktorët mbrojtës vlen rregulli se shumë shpesh ekzistimi i më shumë faktorëve mbrojtës siguron mbrojtje nga rreziqet ose zhvillon rezistencën ndaj tyre (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 13).

Është shumë e qartë se, identifikimi i faktorëve mbrojtës mund të jetë më i stimuluar për zbatim kur ekziston qasja drejtë forcimit të faktorëve të atillë, sesa drejtë zvogëlimit të faktorëve të rrezikut. Faktorët e rrezikut mund të gjenden në vetë individin apo në vetë mjedisin, hapsirën ku të rinjtë jetojnë, në raportet me shokët/shoqet, shkollën, bashkësinë lokale. Të gjithë këto faktorë i plotëson vetë individi me zhvillimin e vetë psikosocial, autonominë, ku dhe vetë adoleshenca paraqet një stad të veçantë të zhvillmit (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 14).

5.1. Familja si faktor mbrojtës dhe roli i saj në parandalimin e delikuencës së fëmijëve

Familjet janë thelbi kryesor për zhvillimin e drejtë dhe socializimin e fëmijëve. Familjet disfunkcionale mund të pamundësojnë socializimin e drejtë të fëmijëve i cili është i pa kompenzueshëm. Atmosfera familjare, mënyra e jetesës, raportet mes prindërve dhe fëmijëve (lidhje të dobëta familjare, largimi, raportet konfliktuoze, prezenca e dhunës,

drogës, alkoolit etj.) janë gjendje të cilat ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Përgjithësisht, faktorët e rrezikut në familje përfshijnë: Historinë familjare (p.sh. socializim i dobët, përkujdesje e keqe, lënie pas dore, diciplinë e keqe, kaotizëm dhe joorganizim; mbikqyrje joadekuate nga prindërit; jomirëkuptim në raportet prind-fëmijë, humbje emocionale; humbje e hershme e prindërve), konflikte familjare dhe dhunë; kriminalitet në familje (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 14). Rreziqet që paraqiten në familje mund të jenë të ndryshme, por në këtë kontekst të rëndësishëm për ti përmendur janë edhe niveli i ulët i arsimimit të prindërve, dhuna në familje, përdorimi i drogës dhe alkoolit, delikuenca në familje e të ngjashëm. Lidhur me jostabilitetin i cili paraqitet në familje, e që mund të jetë edhe shkak i delikuencës, është edhe numri i rritur i divorceve në vend (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 14).

Familja paraqet krijuesen e kushteve në të cilat fëmiu zhvillohet, respektivisht mund të jetë krijuese e përjashtimit social apo sërisht të jetë krijuese e rrethanave të cilat do të konsiderohen si mbrojtëse dhe do të ndikojnë në ndërtimin e rezistencës ndaj rreziqeve të cilat i rrethojnë fëmijët. Nga kualiteti i raporteve familjare do të varet nëse familja ka rol mbrojtës, është që, raportet e ngohta, mbështetëse emotive janë faktorë mbrojtës. Gjithsesi, gjithçka varet nga rrethanat, p.sh. familja me një prind, në të cilën nuk ka mundësi që t'i kushtohet vëmendje e duhur fëmiut, ku fëmiu është i lënë pas dore e ngjashëm, paraqet faktorë rreziku. Kurse nga ana tjetër, familja me një prind mund të jetë edhe faktorë mbrojtës përderisa raportet brenda saj janë pozitive, fëmiu është i përkujdesur, për dallim nga familja me dy prindër e cila jeton në konflikt permanent (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 14).

5.2. Edukimi*:*

Hallka tjetër e zinxhirit të faktorëve dhe akterëve në socializimin e fëmijëve është edukimi i përfaqësuar nga ana e shkollës dhe formave të tjera të edukimit të organizuar (p.sh. kopshtet). Si faktor, edukimi ndikon në sjelljen e fëmiut, që mund të shpije në paraqitjen e sjelljes kriminale e cila shpesh është e shoqëruar me nivel të ulët të edukimit, rezultateve të dobëta, mosndjekja e orëve mësimore, ose çrregjistrimi nga shkolla (për shkaqe të ndryshme, si varfëria e familjes dhe lënia e shkollës ose rezultate të dobëta nga shkolla për shkak të mosadaptimit ndaj shkallës së edukimit ose mënyrës së ligjërimit dhe angazhimit e

të ngjashme). Nga ana tjetër, kualiteti i arsimimit dhe mungesa e rolit edukues të shkollave janë faktor plotësues. Por, jo vetëm aktivitet shkollore por edhe ato jashta shkollore, si aktivitete të organizuara, me plotësim të dobishëm të kohës, kanë kontributin e tyre në zhvillimin e fëmijëve. Për fat të keq, sistemi edukativo-arsimor tek ne nuk po zhvillohet në këtë drejtim (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 15).

Arsimimi paraqet një nga bazat e mbrojtjes dhe parandalimit të delikuencës së fëmijëve. Ai si faktor mbrojtës është nën ndikim të fortë të familjes por edhe të shoqërisë. Kështu që, nëse prindërit kanë qëndrim pozitiv ndaj edukimit, shkollës dhe përmirësimit, apo prindërit me nivel të lartë arsimimi mund të paraqiten si faktorë mbrojtës. Shkolla do të paraqitet si faktorë mbrojtës nëse do të sigurojë një mjedis të sigurtë për fëmijët dhe të miturit, do të sigurojë një raport kualitativ mes nxënësit dhe mësimdhënësit, krijimin e një mjedisi interesant, të mundshëm dhe stimulues për edukim. Përderisa, nxënësi ndjehet i pranuar, do të krijojë një raport, si p.sh. tek fëmijët të cilët kanë rezultate të dobëta shkollore ose kanë sjellje anti-sociale, do të kthehen të kërkojnë mjedise të tjera " për t'u pranuar". Pra, është më se e qartë se më i rëndësishëm është kauliteti i raportit të krijuar. Në plotësim të kësaj, kalimi i kohës së lirë në formë të organizuar dhe konstruktive është thelbi i cili mundëson mësim, punë ekipore e etj. Pjesëmarrja në aktivitete të këtilla mundëson socializim të mëtutjeshëm konstruktiv të fëmiut me shoqërim pozitiv me moshatarët, por edhe me madhorë të tjerë (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 15).

5.3. Mjedisi jetësor:

Si faktor për sjellje të rrezikshme i cili duhet të merret parasyshë është edhe mjedisi, respektivish bashkësia në të cilën jeton fëmiu. Si faktorë të rrezikut të cilët ekzistojnë në mjedisin ku jeton fëmiu, e të cilët mund të ndikojnë në paraqitjen e delikuencës së fëmijëve, përmenden: Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, mundësitë për të kryer krime në bashkësi, lagje (fqinjësi) e pasigurtë (dhuna kronike në bashkësinë shoqërore, varfëria, humbjet ekonomike, kualiteti i ulët i kushteve shtëpiake dhe mbrojtjes shëndetësore), bashkësi lokale e dobët ose e pafuqishme për tu përballur me problemet. Në anën tjetër, bashkësia mund të paraqitet si edhe si faktor mbrojtës, përderisa për shembull mundëson ekzistimin e mjeteve të cilat do ta zëvendësojnë ose plotësojnë në ndonjë mënyrë funksionin e socializimit e cila

mund të mungojë në familje dhe shkollë. Kështu që, mundësitë për aktivitete të caktuara kulturore, sportive dhe aktivitete të tjera rekreative, volunterizmi ose angazhime të tjera të cilat në mënyrë kontruktive do ta plotësonin kohën e fëmijëve dhe të rinjëve janë një nga mjetet të cilat bashkësia mund ti ofrojë. Në anën tjetër, shoqërimi me moshatarë në bashkësinë mund të paraqesë faktor mbrojtës, por kuptohet varësisht nga kualiteti i raporteve dhe ndikimit që grupi ka ndaj individit – nëse është pozitiv apo negativ. Pra, i njejti element mund të paraqesë faktor rreziku ose faktorë mbrojtës (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 16).

5.4. Faktorë të tjerë (mbrojtës/ të rrezikut):

Individët, me nivelin e intelegjencës, ndjeshmërisë, sjelljen (impulsivitetin), qëndrimin dhe autonominë personale, bindjet e të ngjashme mund ti amortizojnë të gjitha rrethanat (faktorët) e përmendura më lartë (ndikimin e familjes, edukimit, shoqërisë etj.). Si plotësim, një faktor që nuk guxon të neglizhohet është **Adoleshenca,** respektivisht periudha kur të rinjtë transformohen, reagojnë vrullshëm, shpesh eksperimentojnë me rrezike si pirja e duhanit, drogat, sjelljet seksuale – që mund të jetë veçanërisht e rrezikshme. Këto elemente nuk duhet neglizhuar, sepse ata edhe pse mund të paraqesin rreziqe për sjelljen e të rinjëve, prapë se prapë ato mund të jenë të përkohëshme – siç edhe theksohet në Udhëzimet e Rijadit. Parandaj, vlerësimi adekuat individual është i domosdoshëm për zhvillimin e ç'do fëmiu në programe të përshtatshme në pajtim me nevojat e tij (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 16).

Si përfundim mund të potencojmë se masat parandaluese të cilat ndërmerren nga subjektet kompetentë duhet të fokusohen në zvogëlimin e faktorëve të rrezikut dhe forcimin e faktorëve mbrojtës. Në këtë drejtim, Këshilli i Evropës, me Udhëzuesin (2000) 20 përcakton masa të caktuara të cilat duhet të jenë të drejtuara kah faktorët e rrezikut, dhe në anën tjetër kah faktorët mbrojtës. Kështu, në drejtim të faktorëve të rrezikut i numëron:Vvështirësitë gjatë mësimit, hiperaktivitetin, impulsivitetin, abuzimin, lënien pas dore, problemet familjare, sistemimin nëpër ente, dhunën mes moshatarëve, lëshimin e shkollës, mossuksesin shkollor, diskriminimin racor, papunësinë e prindërve, ndikimin negativ ndaj moshatarëve, keqërdorimin e substancave, prostitucionin e fëmijëve, lypësinë, endjen etj. Kurse, në raport

me faktorët mbrojtës, i thekson: Lidhjen ndaj prindërve/familjes, moshatarët pozitiv, mjedisin jetësor, rregullat shtëpiake dhe sanksionet e qarta, konsistente dhe joautoritative, mjedisin shkollor gjithpërfshirës (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 16).

Pa dyshim se faktorët të cilët u trajtuan më lartë, si familja, edukimi, mjedisi jetësor paraqesin faktorë social / faktorë objektiv të cilët kanë ndikim të drejtëpërdrejtë dhe shumë të fuqishëm tek fëmijët. Veçanërisht roli i familjes është i pazëvendësueshëm në krahasim me të gjithë faktorët e tjerë të cilët mund të paraqiten qoftë si faktorë mbrojtës, respektivisht parandalues apo me efektin e kundërt- si faktorë të rrezikut, respektivisht si faktorë kriminogjen ndaj delikuencës së fëmijëve.

Meqenëse familja (prindërit) është e obliguar të ushtrojë rolin e saj mbrojtës dhe edukues ndaj fëmiut, kjo njëkohësisht supozon se ajo paraqitet si faktor parandalues ndaj sjelljeve devijante e kriminale të fëmiut. Por, kur ajo dështon në përmbushjen e këtij obligimi ndaj fëmiut, ndodh që të paraqiten sjellje devijante të të njejtit. Edhe pse, nga ky qëndrim ndodh të paraqiteten raste të përjashtimeve, kur edhe pse prindërit e fëmiut kanë investuar maksimalisht në edukimin e fëmiut, ndodh të kenë ndikuar faktorë të tjerë të rrezikut të cilët kanë dominuar mbi sjelljen e fëmiut, me ç'rast ai mund të bjerë në konflikt me ligjin, si p.sh. faktorë kriminogjen subjektiv të cilët ndërlidhen drejtëpërsëdrejti me personalitetin e fëmiut dhe me shëndetin e tij mendor (karakteri, temperamenti, emocionet, çrregullimet dhe sëmudjet shpirtërore) apo edhe faktorë të tjerë objektiv (si shoqëria, kushtet ekonomike etj.).

Sdo mend, se edukimi paraqet një faktor mbrojtës shumë të rëndësishëm dhe prandaj koncentrimi në zhvillimin cilësor të këtij procesi gjithnjë luan rol parandalues ndaj akteve delikuente e kriminale të fëmijëve. Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë masa të natyrës parandaluese në këtë drejtim, duke i kushtuar rëndësi pikërisht rolit parandalues të edukimit ndaj delikuencës së fëmijëve. Procesi edukativo-arsimor fillor dhe ai i mesëm janë të obligueshëm për tu ndjekur nga ana e të gjithë fëmijëve në vend. Ky obligim ligjor përfshinë pikërisht grupmoshat deri në 18 vjet, të cilët janë të obliguar të jenë të kyçur në këtë proces. Konsideroj se ky është një hap shumë i suksesshëm për vendin, i cili gjithsesi se ndikon si faktorë mbrojtës ndaj delikuencës së fëmijëve.

5.5. Anketa me nxënës të shkollave të mesme lidhur me efektin parandalues të shkollës ndaj kriminalitetit

Analizë e pyetësorit anketues:

Rezultatet e paraqitura më poshtë janë bazuar në anketën të cilën e kam realizuar në shtator të vitit 2017, në tre shkolla të mesme në komunën e Tetovës me 120 nxënës të moshave 15-18 vjeç. Pyetësori përmban gjithsej 40 pyetje të sistemuara, respektivisht të ndara në gjashtë pjesë, dhe atë: Koha e lirë e fëmijëve; Roli i familjes; Niveli ekonomik; Rrethi i personave me të cilët shoqërohet fëmiu; Aktivitetet e lira zbavitëse ; Qasja në mjetet e komunikimit masiv.

Natyra e pyetjeve të pyetësorit u formulua në bazë të vlerësimit rreth ndikimit të disa faktorëve socialë që mund të ndikojnë më së shumti në shfaqjen e sjelljeve devijante dhe kriminale tek të rinjtë – si faktorë të rrezikut. Gjithashtu në anën tjetër të njëjtët faktorë mund të shfaqen si masa parandaluese për sjelljen kriminale të të rinjëve- si faktorë mbrojtës.

Fokusi i pyetjeve ishte mbi faktorët e mëposhtëm:

• Ndikimi i sistemit arsimor në parandalimin e delikuencës së fëmijëve, respektivisht sa është dhuna e përhapur në shkolla dhe sa të rrezikuar / të mbrojtur janë nxënësit në shkollë?

• Cilat masa parandaluese ndërmarrin shkollat për të parandaluar veprimet devijuese/kriminale të të rinjëve?

• Ndikimi i familjes tek të rinjtë?

• Ndikimi i rrethit të personave me të cilët shoqërohen të rinjtë?

• Ndikimi i kohës së lirë (aktiviteteve pas-shkollore)?

• Ndikimi i mas-mediave (TV, internet etj)?

5.5.1. Të dhëna të përgjithshme rreth nxënësve të anketuar dhe sigurisë në shkolla

Tabela 1: Numri dhe mosha e nxënësve të anketuar					
Mosha	14	15	16	17	18
Numri i fëmijëve	11	28	1	40	40
Përqindja	9.2%	23.3%	0.8%	33.3%	33.3%

Në anketë morrën pjesë 120 nxënës të shkollave të mesme, me ç'rast 11 prej tyre ishin të moshës katërmbëdhjetë vjeçare, 28 të moshës pesëmbëdhjetë vjeçare, 1 i moshës gjashtëmbldhjetë vjeçare, 40 të moshës shtatëmbëdhjetë vjeçare dhe 40 të moshës tetëmbëdhjetë vjeçare. Pra, siç edhe janë shënuar të dhënat në tabelën 1, shumica e tyre bënin pjesë në grupmoshat 17 dhe 18 vjeçare (33.3%), kurse të tjerët të grupmoshave më të ulta. Por, me rëndësi për realizimin e anketës ishte pjesëmarrje e fëmijëve që u përkasin të katër moshave të cilat bëjnë pjesë nga 14-18 vjet. Kjo sepse përgjigjet e tyre kishin rëndësi për analizimin e faktorëve të rrezikut dhe faktorëve mbrojtës- të cilat janë trajtuar si pyetje të anketës në vazhdim, për të pasqyruar se si pikërisht fëmijët e kësaj grupmoshe (14-18) i shohin dhe gjykojnë këto probleme/ faktorë që ndikojnë në parandalimin/ nxitjen e paraqitjes së delikuencës së fëmijëve "në rrezik" apo atyre "në koflikt me ligjin"!

Tabela 2: Gjinia e nxënësve të anketuar		
Gjinia	**Meshkuj**	**Femra**
Numri i fëmijëve	44	76
Përqindja	37%	63%

Kriter relevant për përcaktim të pjesëmarrësve në anketë kishim moshën e nxënësve, respektivisht qëllimi ishte të përfshihen të gjitha grupmoshat nga 14-18 vjet. Sa i përket gjinisë, rezultoi që 44 të anketuar ishin nxënës të gjinisë mashkullore (37%), kurse 76 nxënës të gjinisë femrore (63%) (tabela 2).

Tabela 3: Klasa/ viti i shkollimit			
I	**II**	**III**	**IV**
0	40	0	80
0%	33.3%	0%	66.7%

Nxënësit që morën pjesë në anketë, aktualisht ishin në vitin e dytë dhe të tjerë në vit të katërt. Siç edhe është ilustruar në tabelën 3, 66.7% prej tyre ishin nxënës të vitit të katërt, kurse 33.3% të vitit të dytë.

Tabela 4: Përkatësia etnike e nxënësve				
Shqiptarë	**Maqedonas**	**Turk**	**Romë**	**Tjetër**
119	0	1	0	0

Nxënësit pjesmarrës në anketë ishin kryesisht të përkatësisë etnike shqiptare (tabela 4), pra 119, kurse vetëm një i përkatësisë etnike turke.

Tabela 5: Sa orë qëndroni në shkollë gjatë ditës?				
3	4	5	6	7
-	-	-	35	83
-	-	-	29.4%	69.7%

Në pyetjen se sa orë qëndrojnë në shkollë gjatë ditës (tabela 5), 29.4% janë deklaruar se qëdrojnë 6 orë, kurse 69.7% - 7 orë.

Tabela 6: Sa herë gjatë vitit keni biseda/takime me pedagogun edhe me psikologun e shkollës? (119 përgj.)			
Dy/tri here	**Ç'do muaj**	**Një herë**	**Asnjëherë**
19	2	14	84
16%	1.7%	11.8%	70.6%

Nga pyetja tjetër (tabela 6) se sa shpesh nxënësit kanë takime / konsultime me personat kompetentë në shkollat e tyre për t'u dhënë këshilla dhe mbështetje, si pedagogu dhe

psikologu, përgjigjet ishin dëshpëruese! 70.6% e nxënësve u përgjigjën se asnjëherë nuk i takojnë këta pjesëtarë të personelit të shkollës dhe të tjerët u përgjigjën se një herë në vit ose me 2-3 herë në vit kanë takime me to. Këto rezultate të përmendura janë gjithashtu jo shumë shpresëdhënëse , duke pasur parasysh rolin e padiskutueshëm të pedagogut dhe psikologut në shkolla rreth edukimit të fëmijëve/ nxënësve. Duke marrë në konsideratë moshën delikate të nxënësve në shkollat e mesme, është i pajustifikueshëm pasiviteti i këtyre personave në ushtrimin adekuat të profesionit të tyre (Arifi B. A., 2017).

Tabela 7: Cilët persona nga personeli i shkollës tuaj ndikojnë tek ju më tepër për të përmirësuar/parandaluar sjelljet negative? (117 përgj.)			
Kujdestari i klasës	**Drejtori i shkollës**	**Psikologu apo pedagogu**	**Të tjerë**
111	0	1	5
94.9%	0%	0.9%	4.3%

Në pyetjen e shënuar në tabelën 7, shumica e nxënsve (94.9%) janë deklaruar se Kujdestari i klasës është personi në shkollë, i cili ndikon më së shumti për përmirësimin e sjelljeve negative tek ata, respektivisht për të parandaluar paraqitjen e sjelljeve negative. As 1% janë përgjjigjur se psikologu apo pedagogu, kurse 4.3% për persona të tjerë të ndryshëm nga këto dy kategoritë e përmendura paraprakisht.

Tabela 8: A keni ndjekur ndonjë ligjëratë/projekt rreth parandalimit të kriminalitetit të të rinjëve në shkollë?	
PO	J0
36	84
30%	70%

Tabela 9: Nëse po, nga kush keni ndjekur? (29 përgjigje)
• Nga pedagogu i shkollës (1) • Nga policët që erdhën në klasë (24) • Nga profesori (2) • Në një kamp veror (1) • Nga profesori i psikologjisë (1)

Në pyetjen se a kishin ndjekur nxënësit ndonjë leksion se si të parandalohet kriminaliteti, (tabela 8) shumica e tyre (70%) janë përgjigur Jo, dhe vetëm 30% janë përgjigjur Po. Ishte e qartë nga rezultatet e pyetjes së shënuar në tabelën 9, se vetëm në një nga tre shkollat ku u bë ky hulumtim, kishte pasur disa programe për informimin e fëmijëve se si të parandalohet krimi. Kjo ishte realizuar nga ana e pjesëtarëve të policisë, të cilët kishin mbajtur ligjërata për nxënësit rreth temave se cilat sjellje janë vepra penale bazuar në legjislacionin e vendit dhe disa aspekte të tjera se si të parandalohen këto veprime negative. Por, rezultati jo i kënaqshëm doli nga përgjigjet e shumicës së të anketuarve të cilët nuk ishin të informuar për këtë temë (Arifi B. A., 2017).

Tabela 10: Sa ndjeheni të sigurtë gjatë qëndrimit tuaj në shkollë?		
Shumë	Jo shumë	Aspak
62	54	4
51.7%	45%	3.3%

Sipas rezultateve të nxjerrura nga pyetja në tabelën 10, përqindja e nxënësve është shumë e përafërt mes atyre të cilët janë deklaruar se ndjehen shumë të sigurtë në shkollë(51.7%) dhe atyre që nuk ndjehen shumë të sigurtë (45%). Me rëndësi është se një përqindje shumë e vogël prej tyre nuk ndjejnë pasiguri në shkollë - vetëm 3 %. Kjo është një tregue pozitiv për rolin e shkollës në këtë aspekt – Ofrimi i sigurisë nxënësve në ambientet shkollore.

Tabela 11: A mendoni se duhet të shtohet siguria në shkollën tuaj?	
PO	**JO**
82	38
68.3%	31.7%

Në pyetjen se a mendojnë nxënësit se duhet të rritet niveli i sigurisë në shkollën e tyre (tabela 11), arritën me 68.3% të rezultateve që kanë thënë Po, dhe 31.7% kanë thënë Jo. Pra shumica e nxënësve mendojnë se shkollat e tyre duhet të marrin masa më strikte dhe rigoroze për mbrojtjen e nxënësve dhe për t'i bërë ata të ndihen të sigurtë gjatë qëndrimit atje (Arifi B. A., 2017).

Tabela 12: Nëse po, (duhet të rritet siguria), çka duhet të ndërmerret sipas jush? Shënoni komentet tuaja! (43 përgjigje) Përgjigjet më të shpeshta:
Më shumë sigurim *Duhet të ketë kontrollim të nxënësve* *Sigurim në hyrje të shkollës* *Ndalimi i hyrjes në shkollë të nxënësve nga shkollat e huaja dhe të vendosen rregulla për kodin e veshjes së nxënësve (vajzave)* *Një sigurim më i aftësuar* *Sigurimi të jetë në rregull, psh të jetë prezent kur ndodh problemi, e jo pasi të mbarojë të paraqiten* *Numër më i madh i personelit të sigurimit* *Të shtohet sigurimi dhe të ndalohet hyrja e nxënësve të huaj* *Të vendosen kamera nëpër korridoret e shkollës*

Në tabelën 12 janë paraqitur të gjitha komentet e nxënësve të anketuar, ku nga 43 komente, dominojnë dhe përsëriten shumë herë të njejtat sugjerime se duhet të rritet sigurimi, respektivisht numri i rojeve të sigurimit në hyrjen e shkollës. Edhe pse shkollat kanë ndërmarrë masa sigurie, përsëri raste të ndryshme të eskalimit të situatave ndodhin, prandaj edhe sugjerimet e nxënësve janë me vend dhe duhet marrë masa në këtë aspekt nga personat përgjegjës nëpër këto shkolla përkatëse.

Tabela 13: A keni dëgjuar/parë raste në shkollën tuaj nga këto më poshtë, nëse Po, rrethoni cilat (me më shumë opcione të përzgjedhjes) (115 përgjigje)		
Ikje nga orët e mësimit	117	99.1%
Pjesëmarrje në rrahje	58	50.4%
Ngacmim nga shkokët e shkollës/fyerje/tallje ("Bulizmi")	77	67%
Kërcënim	21	18.3%
Përdorim të lëndëve narkotike (p.sh. marihuanë)	17	14.8%
Mbajtje të armëve të frohta (thikë)	20	17.4%
Mbajtje të armëve të zjarrit (pistoletë)	3	2.6%

Në tabelën 13 janë paraqitur përgjigjet e nxënësve lidhur me një pyetje shumë të rëndësishme të anketës, nga e cila del në pah se ka raste të dhunshme apo shfaqje të sjelljeve negative nga nxënësit nëpër shkolla. Nga shtatë opcionet të cilat i kishin nxënësit në pyetësor, rezulton se të gjitha rastet e paracaktuara kanë ndodhur nëpër shkollat e mesme, dhe atë : 99.1% e kanë paraqitur se në shkollë ka raste të ikjes së nxënësve nga orët mësimore; 50.4% kanë deklaruar se në shkolla kanë ndodhur raste të pjesëmarrjes në rrahje mes nxënësve; 67% kanë deklaruar se kanë ndodhur raste të Bulizmit, si të ngacmimit/fyerjes apo talljes mes nxënësve; 18.3% kanë deklaruar se ka ndodhur kërcënim i nxënësve; 17.4% kanë deklaruar se ka pasur raste të mbarjtjes së armëve të ftohta, si p.sh. thika nga ana e nxënësve në shkollë; 2.6% kanë deklaruar se ka pasur raste te mbajtjes së armëve të zjarrit, si p.sh. pistoletës nga ana e nxënësve në shkollë. Edhe pse në përqindje shumë më të vogël të deklarimit, lidhur me prezencën e dy rasteve të fundit – megjithatë edhe këto të dhëna mjaftojnë si të tilla të jenë alarmante lidhur me nivelin e sigurisë së nxënësve nëpër shkolla.

Tabela 14: A keni qenë ju ndonjëherë viktima të ndonjërit prej rasteve të lartëshënuara në pyetjen paraprake?	
PO	**JO**
22	93
19.1%	80.9%

Pyetja në tabelën 14, lidhet me dy çështjet në vazhdim (tab.15,16), për të pasqyruar sa raste të viktimizimit ka pasur nga nxënësit e anketuar, si dhe për të nxjerrë në pah dilemën se a ekziston "numri i errët", respektivisht i pa evidentuar i rasteve të tilla të viktimizimit. Nga përgjigjet e fituara, doli që vetëm 19.1% e të anketuarve kanë qenë të përfshirë drejtëpërdrejtë në ndonjërin nga rastet devijante/kriminale në tabelën 13, dhe atë në cilësi të viktimës.

Tabela 15: Nëse keni qenë viktima, a e keni paraqitur rastin? (39 p)	
PO	**JO**
17	22
43.6%	56.4%

Në tabelën 15, 43.6% janë deklaruar me Po, se kanë qenë viktima të rasteve të lartëshënuara në tabelën 13 dhe e kanë paraqitur rastin, kurse 56.4% janë deklaruar se edhe pse kanë qenë viktimë e ndonjërit rast, nuk e kanë paraqitur atë. Pra, shumica nuk e kanë paraqitur rastin, ku nga kjo e dhënë mund të konstatohet se numri i "errët" i akteve të ndryshme devijante dhe kriminale nëpër shkolla të mesme është shumë më i lartë nga ai që është i evidentuar nga organet kompetente shtetërore.

Tabela 16: Nëse po, (keni qenë viktima dhe e keni paraqitur rastin) tek cilët persona e keni paraqitur rastin tuaj të viktimizimit?	
Kujdestari i klasës	13
Në polici	1
Tek profesorët	2
Tek persona të tjerë	1

Shumica e viktimave (13 nga 17) të cilat e kanë paraqitur rastin tek kujdestari i klasës. Kjo e dhënë përputhet me përgjigjet e nxënësve në pyetjen në tabelën 7, ku sipas tyre personi më me ndikim/ i besueshëm për përmirësimin e sjelljeve të tyre është kujdestari i klasës.

Tabela 17: Nëse keni qenë viktimë dhe nuk e keni paraqitur rastin, PSE?	
Sepse kisha frikë	2 përgjigje

Vetëm dy përgjigje të nxënësve të anketuar kishim në pyetjen se nëse kanë qenë viktima të ndonjë akti devijant në shkollë dhe nuk e kanë paraqitur të njejtin, cila ka qenë arsyeja - "Kisha frikë" ishte komenti i të anketuarve. Edhe pse 56.4% e viktimave nuk e kishin paraqitur rastin, ata nuk janë përgjigjur në këtë pyetje, duke lënë të supozojmë se cili ka qenë shkaku që viktimat kanë heshtur?! Frika, pasiguria, jo besimi në organet e ndjekjes së kriminalitetit janë shpesh faktorë që ndikojnë tek viktimat që ato të mos i paraqesin rastet e viktimizimit të tyre.

5.5.2. Koha e lirë e fëmijëve

Tabela 18: A mendoni se keni shumë kohë të lirë pasi i mbaroni orët mësimore?	
PO	**JO**
71	49
59.2%	40.8%

Në pyetjen se a kanë nxënësit shumë kohë të lirë pas përfundimit të orëve mësimore, (tabela 18) , kemi arritur në rezultate ku 59.2% janë përgjigjur Po, dhe të tjerët konsiderojnë se nuk kanë shumë kohë të lirë pas përfundimit të orarit të shkollës, duke pasur parasysh angazhimet të cilat i presin pas orarit mësimor, si p.sh. angazhimet mësimore të me të cilat ngarkohen nxënësit për të mësuar në shtëpi, në formë të "detyrave shtëpiake", por edhe aktivitete të tjera të lira.

Kjo pyetje është bërë me qëllim që të marrim përgjigje dhe të konfirmohet hipoteza jonë se në Republikën e Maqedonisë fëmijët kanë (shumë) kohë të lirë dhe se ky është një nga faktorët që ndikon në paraqitjen e akteve devijante të të rinjve. Kjo sepse, nuk ka mundësi të mjaftueshme për aktivitete të lira-ku të rinjtë mund të kalojnë kohën pas shkollës, për shembull, nxënësit që mbarojnë orët e mësimit rreth orës 13.30. ata vërtetë nuk kanë mundësi të ofruara nga shteti ose shkolla ku ata mund të përfshihen për ndonjë aktivitet të lirë zbavitës/ profesional. Andaj, mund të konstatohet se kjo është arsyeja pse ndodh shpesh që të rinjtë e kalojnë kohën e lirë në kafeteri dhe si pasojë mund të përfshihen në veprime delikuente / kriminale edhe duke u bashkuar me të rriturit të cilët lehtë mund t'i manipulojnë dhe t'i inkriminojnë në akte të ndryshme, si trafikimi i drogës, përdorimi i alkoolit, vjedhje, pjesëmarrje në rrahje etj. (Arifi B. A., 2017).

Tabela 19: A do të kishit dashur të keni aktivitete të lira në shkollë, pasi ti mbaroni orët obligative, p.sh. Orë zbavitëse- aftësim për gatim/ zanat të caktuar?	
PO	**JO**
98	21
82.4%	17.6%

Për shkak se në sistemin edukativo-asrsimor të vendit tonë nuk parashihen në programet shkollore aktivitete shtesë, respektivisht orë shtesë për nxënësit pasi ti mbarojnë orët obligative, si që ndodh në shumë vende evropjane, si psh. Zvicër, Norvegji etj., pyetja u parashtua në pyetësorin anketues, për të matur dëshirën, respektivisht interesimin e nxënësve tonë për këtë çështje. Nga përgjigjet e fituara (tabela 19) rezultoi se 82.4% e tyre do të kishin dashur që të kenë orë të lira, zbavitëse, apo ku do të mësonin ndonjë zanat të caktuar pasi ti mbaronin orët mësimore obligative.

Tabela 20: A mendoni se koha e gjatë e lirë (p.sh. pasdite pas mbarimit të orëve, nga ora 13.30) ndikon tek shumë të rinjë që të merren me veprime negative?	
Po, ka shumë ndikim	**Jo, nuk ndikon ky faktorë**
76	43
63.9%	36.1%

Në pyetjen se si e vlerësojnë nxënësit ndikimin e kohës që e kanë në dispozicion – si të lirë (edhe pse nëse mbulohet kjo kohë pas shkollës me aktivitete të ndryshme të lira, si ndjekja e kurseve nga lëmi të ndryshme, apo kohë për të mësuar nuk do të i'u mbetej shumë kohë që ata të merren me veprime tjera, në raste të caktuara me ato delikuente/kriminale), respektivisht a mund të ndikojë ajo që të rinjtë të merren me veprime negative (tabela 20), rezultoi se 63.9% nga të anketuarit e vlerësojnë se ajo ka shumë ndikim në këtë aspekt. Ndërsa 36.1% kanë vlerësuar se koha e lirë pas shkollës nuk është faktor që ndikon tek të rinjtë për të shfaqur sjellje devijante.

5.5.3. Roli i familjes

Tabela 21: Sa ndikim ka tek ju familja, në manifestimin e sjelljeve tuaja në shkollë/jashta me shoqërinë?		
Shumë	**Shumë pak**	**Aspak**
102	12	6
85%	10%	5%

Tabela 22: A mendoni se familja është faktori kryesor që një fëmijë (adoleshent) të jetë i sjellshëm, ose e kundërta- të jetë problematik?		
PO, gjithmonë	**J0**	**PO, mirëpo ka përjashtime**
89	2	29
74.2%	1.7%	24.2%

Nga përgjigjet e fitura nga pyetjet lidhur me ndikimin e familjes në sjelljen e të rinjëve (tabela 21 dhe 22), përsëri vërtetohet fakti se familja është faktori kryesor në parandalimin e delikuencës së fëmijëve! Kjo sepse 85% e nxënësve u përgjigjën se familja e tyre ka shumë ndikim në sjelljen e tyre dhe të tjerët janë përgjigjur se familja nuk ka shumë ndikim mbi ta (10%), kurse numri më i vogël i të anketuarve janë përgjigjur se familja aspak nuk kanë ndikim tek ata (5%). Poashtu 74.2% janë përgjigjur se familja është gjithmonë faktori kryesor që një fëmijë a do të jetë i sjellshëm, ose do të jetë problematik; 24.2% e të anketuarve poashtu pajtohen me këta të parët, por duke mos e absolutizuar si faktor të tillë, sepse ka raste ku ekzistojnë përjashtime. Vetëm1 .7% kanë konsideruar se familja nuk paraqet faktorin kryesor kundrejt sjelljes së mirë/devijante të fëmijëve.

Tabela 23: A mendoni se prindërit të cilët punojnë në një orar të gjatë brenda ditës dhe nuk e kalojnë shumicën e ditës me fëmijët, janë faktorë (fajtorë) që fëmijët e tyre të merren me veprime delikuente?		
PO	**JO**	**Përjashtimisht, në disa raste**
78	40	1
65%	33.3%	1.7%

Në pyetjen se a mendojnë se prindërit të cilët punojnë dhe një periudhë të gjatë brenda ditës nuk e kalojnë me fëmijët (tabela 23), janë faktorë (fajtorë) që fëmijët e tyre devijojnë, 65% e të anketuarve janë përgjigjur me përgjigje positive, 33.3% me atë negative, 1.7% e konsiderojnë si përjashtim, pra si faktorë që mund të ndikojë në disa raste.

Tabela 24: A njihni fëmijë problematikë edhe pse ata kanë familje (prindër) shumë të përkushtuar ndaj tyre?	
PO	**JO**
74	**46**
61.7%	**38.3%**

Në pyetjen se a njohin fëmijë problematikë edhe pse ata kanë familje (prindër) shumë të përkushtuar ndaj tyre (tabela 24), 61.7% e nxënësve të anketuar janë përgjigjur me përgjigje pozitive, ndërsa 38.3% me përgjigje negative. Nga këto rezultate nxirret në pah edhe përjashtimi që mund të paraqitet në raste të caktuara, i cili u përmend më lartë – i familjes si faktori kryersor në ndikimin e parandalimit/paraqitjes së delikuencës së fëmijëve.

5.5.4. Rrethi i personave me të cilët shoqërohen të rinjtë

Tabela 25: Sa ndikim ka shoqëria në sjelljet e një adoleshenti?		
Shumë, është faktori më i rëndësishëm	**64**	**53.3%**
Jo shumë, varet nga personaliteti i ndividit	52	43.3%
Aspak	4	3.3%

Në pyetjen se ç'farë vlere ka mendimi i miqve për të rinjtë/ për sjelljet e tyre (tabela 25), 53% janë përgjigjur se është më e rëndësishmja se çfarë mendojnë shokët e tyre për ta apo sjelljen e tyre. 43.3% u përgjigjën se nuk është shumë i rëndësishme opinioni i miqve dhe vetëm 4% e tyre nuk kujdesen për opinionin e miqve aspak. Është vërtetuar se në shumicën e rasteve veprimet delikuente manifestohen nga të rinjtë vetëm për shkak se ato janë pjesë e një ose grupi tjetër në shkollën e tyre.

Tabela 26: Sa është e rëndësishme për ju, se ç'ka mendon shoqëria për veprimet/vendimet tuaja?		
Shumë	**Pak**	**Aspak**
26	65	29
21.7%	54.2%	24.2%

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka shoqëria në moshën e adloleshëncës, u parashtrua pyetja në tabelën 26, me ç'rast në pyetjen Sa është e rëndësishme për ju, se ç'ka mendon shoqëria për veprimet/vendimet tuaja, 21.7% u përgjigjën - Shumë. Janë interesante këto rezultate sepse shumica e të anketuarve janë përgjigjur se nuk ju intereson se ç'farë mendimi kanë personat me të cilët ata shoqërohen për sjelljet e tyre - 54.2% janë përgjigjur se pak është i rëndësishme ky fakt, kurse për 24.2% aspak.

Tabela 27: A keni dijeni për raste kur një adoleshent, si pasojë e shoqërimit me shoqërisë "jo të mire", ka manifestuar sjellje problematike?		
Po dhe kjo gjithmonë ndodhë	**Jo**	**Po, edhe pse rallë shoqëria mund të ndikojë**
64	9	47
53.3%	7.5%	39.2%

Në pyetjen se a kanë dijeni për raste kur një adoleshent ka manifestuar sjellje problematike si pasojë e shoqërisë "jo të mirë" (tabela 27), 52.2% janë përgjiur se Po kanë dijeni, dhe se kjo gjithmonë ndodhë; 39.2% poashtu kanë dijeni për raste të këtilla por janë të mendimit se rallë shoqëria mund të jetë faktor nxitës i një rasti të tillë negativ; Vetëm 7.5% e të anketuarve nuk kanë dijeni për raste të tilla.

Tabela 28: A do të ju pengonte të shoqëroheshit me persona problematikë/delikuentë?	
Po shumë, menjoherë do ti largoja nga rrethi im	**Jo, sepse sjelljet e tyre nuk kanë efekt tek shoqëria jonë**
83	37
69.2%	30.8%

Në pyetjen se a të ju pengonte të shoqërohen me persona problematikë/delikuentë (tabela 28), 69.2% e të anketuarve janë përgjigjur se shumë do të ju pengonte dhe menjëherë do ti largonin nga rrethi i tyre, ndërsa 30.8% konsiderojnë se nuk do të iu pengonte, sepse sjelljet e tyre negative nuk e ndikojnë shoqërinë e tyre. Pra, shumica janë të mendimit se nuk duhet të shoqërohen me fëmijët të cilët manifestojnë sjellje negative, me siguri për të vetmen arsye – për të parandaluar ndikimin e sjelljes negative të tyre tek ata.

5.5.5. Aktivitetet e lira jashtashkollore/zbavitëse

Tabela 29: Me ç'farë aktivitete jashtashkollore merreni gjatë kohës së lirë? (Me mundësi për më tepër opcione përzgjedhjeje)(112 përgjigje)		
Sport	52	(46.4 %)

Muzikë	48	(42.9%)
Vizatim	9	(8%)
Kurse të gjuhëve të huaja	15	(13.4%)
Punë	8	(7.2%)

Në pyetjen se me ç'farë aktivitete të lira jashtashkollore merren nxënësit gjatë kohës së lirë (tabela 29) pëgjigjet janë të ndryshme, nga mund të konstatohet se ata përveç angazhimeve shkollore merren me një apo më shumë aktivitete të tjera, si sport, muzikë, vizatim, ndjekin kurse të gjuhëve të huaja dhe ka edhe nga ata që punojnë, ndonëse një përqindje shumë të vogël (7.2%), kurse shimica merren me sport (46.4%) dhe muzikë (42.9%).

Tabela 30: A ka mungesë të kushteve në vendin tonë për të realizuar aktivitete të lira për të rinjtë?	
Jo, ka shumë mundësi	**Po, mungojnë kushte si Kinema, pishina, salla sportive etj.**
13	106
10.9%	89.1%

Në pyetjen se sa ofrohen kushte që të rinjtë të merren me aktivitete të lira në vendin tonë (tabela 30), përgjigjet rezultuan me shumicën të cilën konsiderojnë se mungojnë kushte të tilla, si p.sh. Kinema, pishina, salla sportive etj.(89.1%), kurse vetëm 10.9% të cilët konsiderojnë se nuk mungojnë kushtet, respektivisht ofrohen shumë mundësi.

Tabela 31: A ndikon angazhimi në aktivitete të lira jashtashkollore, në parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve?	
PO	**JO**
93	26
78.2%	21.8%

Sipas rezultateve të fituara nga pyetja se a ndikon angazhimi në aktivitete të lira jashtashkollore në parandalimin e kriminalitetit (tabela 31), shumica e të anketuarve pajtohen se ky faktorë ndikon në paraqitjen e fenomenit të kriminalitetit të të rinjëve 78.2%,

kurse vetëm 21.8% konsiderojnë se aktivitetet e tilla nuk janë faktorë kriminogjen për të rinjtë.

5.5.6. Qasja në mjetet e komunikimit masiv

Tabela 32: Sa kohë kaloni gjatë ditës në Internet (Facebook, Instagram etj) Shënoni afërsisht numrin e orëve!

Orë	**0**	**1**	**1.5**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**18**	**24**
Nr. i nx.	2	16	3	20	25	11	11	8	2	3	2	1	2	2	1	1	10

Duke pasur parasysh prirjen e të rinjëve dhe varësinë që e ka krijuar përdorimi i internetit tek ata, në pyetjen e parashtruar se sa orë afërsisht ata kalojnë gjatë ditës në internet (tabela 32), përgjigjet e fituara ishin nga më të ndryshmet. Ka nxënës që kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale të Internetit dhe atë mbi 1 orë deri në 24 orë në raste ekstreme. Ky rezultat konsiderojmë se lidhet me mosangazhimin e të rinjëve mjaftueshëm në aktivitete jashtashkollore, ku ata do të zhvillonin aftësi të ndryshme në mënyrë aktive, e nga të cilat do të përfitonin shumë në krahasim me kalimin e kohës së lirë duke vizituar faqet e ndryshme të rrjete sociale, si p.sh. Facebook, Instagram etj.

Tabela 33: Sa ndikon Interneti në krijimin e personalitetit tuaj?

Shumë	**Aspak**
45	75
37.5%	62.5

Ndonëse nga rezultatet e pyetjes paraprake në tabelën 32 më lartë u vërtetua se të rinjtë kalojnë shumë kohë në përdorimin e internetit, ata në pyetjen se sa ndikim ka Interneti në personalitetin e tyre (tabela 33) dhanë përgjigje interesante. Dhe atë shumica janë përgjigjur (62.5%) se interneti aspak nuk ka ndikim në krijimin e personalitetit të tyre, kurse vetëm 37.5% kanë pohuar se ai ka shumë ndikim tek ata.

Tabela 34: A mund të inspirohet një person i ri për të manifestuar një sjellje devijante nga informacionet që i merr në internet?	
PO	**JO**
84	36
70%	30%

Në pyetjen lidhur me ndikimin e informacionit në internet mbi sjelljen e të rinjve (tabela 34), kemi marrë 70% përgjigje pozitive se interneti mund të jetë një mjet frymëzues / motivues për të manifestuar një veprim negativ nga një i mitur. Vetëm 30% e të anketuarve thanë se nuk mund të frymëzohen nga interneti për të vepruar negativisht, respektivisht për të kryer ndonjë vepër delikuent apo kriminal. Ky është gjithashtu një tregues tjetër se interneti mund të jetë shpesh mjeti më efektiv për parandalimin e kriminalitetit të rinisë, apo dhe e kundërta – mjeti provokues për manifestimin e sjelljeve të atilla negative.

Tabela 35: Ç'ka mund të jetë më inspiruese për të rinjtë që të sillen në mënyrë agresive apo kriminale?		
Rrjetet sociale	**Libri/ ndonjë personazh**	**Filmi**
73	17	32
60.8%	14.2%	26.7%

Nga të dhënat e fituara nga pyetja se ç'ka mund ti inspirojë të rinjtë që të sillen në mënyrë agresive apo kriminale (tabela 35), nxënësit kanë përzgjedhur opcionin Rrjetet sociale(60%) në krahasim me dy opcionet e tjera të cilat rezultuan me përzgjedhje më inferiore- libri me 14.2%, kurse filmi me 26.7%. Nga këto rezultate mund të konstatohet edhe prirja e nxënësve për përdorimin e rrjeteve sociale në shkallë shumë më të lartë në krahasim me leximin e librave apo ndjekjen e filmave.

5.5.7. Njohuri rreth të drejtës penale për fëmijë

Tabela 36: A e dini ç'ka paraqet termi "vepër penale" ose "krim"?	
PO	**JO**

109	11
90.8%	9.22%

Shumica e nxënësve të anketuar e dinin se ç'ka paraqet vepra penale apo krimi si nocion (90.8%), kurse vetëm një numër i vogl prej tyre nuk e dinin kuptimin e këtij nocioni (9.22%) (tabela 36).

Tabela 37: Nëse po, prej nga e keni mësuar se çka është vepra penale? (Më tepër mundësi përzgjedhjeje)		
Shkollë	50	48.1%
TV	42	40.4%
Internet	22	21.2%
Familje	1	1%
Kam parë vepër penale duke ndodhur	1	1%

Ata që e dinin se ç'ka është vepra penale (tabela 37), këtë e kishin mësuar në shkollë – shumica prej tyre (48.1%), të tjerë nga progamet televizive (40.4%), kurse të tjerët në internet (21.2%); Nga familja (1%) apo kanë parë duke ndodhur vepra penale (1%). Në planprogramet mësimore të shkollave të mesme – gjimnazeve parashihet realizimi i një lënde nga lëmia e drejtësisë, zakonisht në vit të tretë të studimeve, poashtu ekzistojnë shkolla profesionale që kanë drejtime studimore në lëminë e drejtësisë. Fakti se nxënësit e dinë se ç'ka është vepra penale, supozon se e dinë edhe faktin e pasojës juridike nga kryerja e një vepre të tillë dhe prandaj kjo gjë paraqet një tregues pozitiv që do të ndikonte në parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve.

Tabela 38: Cila është mosha minimale e përgjegjësisë penale kur një person i ri (jomadhorë) të mund të dënohet për një krim që e ka kryer?				
7	**10**	**14**	**16**	**18**
1	6	2	20	91
0.8%	5%	1.7%	16.7%	78.5%

Në pyetjen se cila është mosha minimale e përgjegjësisë penale kur një person i ri (jomadhorë) të mund të dënohet për një krim që e ka kryer, shumica e nxënësve janë përcaktuar për opcionin - mosha 18 vjeçare (78.5%), kurse vetëm 1.7% për opcionin – mosha 14 vjeçare! Këtu (tabela 38) dalin të dhëna për prezencën e mosinformimit të duhur të nxënësve lidhur me këtë çështje. Shumica e tyre, respektivisht gati se të gjithë ata nuk e kanë të njohur faktin se përgjegjësi penale për një vepër penale të kryer sipas Kodit penal të vendit tonë kanë personat nga mosha 14 vjeçare – kategori të grupmoshave ku bëjnë pjesë vetë nxënësit e anketuar. Në këtë drejtim duhet punuar nga subjekte të ndryshme në forma të ndryshme – duke organizuar ligjërata para nxënësve të shkollave të mesme për ti njoftuar ato për tema që kanë të bëjnë me objektin e të drejtës penale në përgjithësi dhe asaj për fëmijët në veçanti, me qëllim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve – Nuk mund të mbrohet një fëmijë para gjykatës me arsyetimin se nuk e ka ditur se veprimi i tillë është vepër penale në KPM, pasi që mosnjohja e ligjit dëmton!

Tabela 39: A e dini nr. e Policisë?	
PO	**JO**
93	25
78.8%	21.2%

Tabela 40: Nëse e dini shënojeni numrin e policisë! (95 përgjigje)		
192	95	100%

Shumica e të anketurve e dinin numrin e policisë së vendit dhe këtë e kanë dëshmuar duke e shënuar të njejtin (tabela 39 dhe 40), edhe pse ka nga ata të cilët nuk e dinë këtë numër. Policia është organi i parë ku ata do të referoheshin për të parandaluar një krim apo për ta paraqitur atë nëse ka ndodhur. Prandaj edhe nga këto të dhëna vërtetohet fakti se ekziston nevoja për informim më të gjërë të fëmijëve/të rinjëve për tema nga lëmia penale – me qëllim të parandalimit të të rasteve nga delikuenca e fëmijëve. Parandalimi i kriminalitetit të

të rinjëve mund të bëhet vetëm nëse ekziston një bashkëpunim midis të gjitha institucioneve kompetente shtetërore për përmirësimin e kushteve sociale për mirëqenien e të rinjve. Është më mirë të parandalojmë sesa të korrigjojmë.. e në vendin tonë duhet të punohet shumë më tepër në drejtim të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit të të rinjve (Arifi B. A., 2017).

5.6. Intervista me personelin e shkollave të mesme lidhur me ndikimin e shkollave në parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve

Intervistat i kam realizuar në Maj të vitit 2017 në dy shkolla të mesme në qytetin e Tetovës.

1. Pozita e punës së të intervistuarve:

- I intervistuari nga shkolla e mesme "Nikolla Shtejn"-Tetovë (Në tekstin në vazhdim do të përdoret shkronja **A** për përgjigjet e të intervistuarit), Pozita: **Psikolog i shkollës.**
- I intervistuari nga shkolla e mesme Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq-Tetovë (Në tekstin në vazhdim do të përdoret shkronja **B** për përgjigjet e të intervistuarit), Pozita: **Zëvendës drejtor i shkollës.**

2. **" Përshkruani shkurtimisht kompetencat tuaja në shkollë në raport me nxënësit:**

A: Këshillim me nxënësit; Organizimi dhe realizimi i mësimit, aktivitete të lira dhe të hapura me nxënës, prind, mësimdhënës, projekte, seminare etj.

B: Mbikqyrje e procesit arsimor, komunikim me nxënësit përsa i përket mbarëvajtjes së procesit, shqyrtim dhe zgjidhje të problemeve eventuale, këshilla dhe sugjerime për sjelljen dhe suksesin.

3. Ç'farë masa ndërmerr shkolla ku ju punoni për të parandaluar/ ndaluar kriminalitetin e të rinjëve?

A: Në shkollën tonë funksionon Ekipi për mediacion nga nxënësit dhe mësimdhënësit, në secilën paralele ka kujdestarë për siguri në shkollë; në shkollë ka zyra të veçanta ku punojnë mësimdhënës dhe nxënës – Mediacioni; projekti për shkolla të sigurta, Qendra e të rinjëve etj.

B: Biseda, Ligjërata, Këshillime, Kontrolle etj.

4. A keni pasur raste në shkollën tuaj, ku nxënësit kanë manifestuar sjellje devijane/ kriminale? Nëse po, ju lutem shënoni ato sjellje, apo rrethoni nga këto opcione?

a. Ikja nga orët mësimore**; -A, B**
b. Vijimi jo i rregullt në shkollë pa arsye; **-A**
c. Manifestimi i sjelljeve të dhunshme; **-A**
d. Pjesëmarrje në rrahje; **-A**
e. Përdormi i lëndëve narkotike;
f. Konsumimi i duhanit apo alkoolit et.

5. Si i menaxhoni/trajtoni nxënësit të cilët manifestojnë sjellje problematike?

A: Biseda dhe këshillim me prindër, nxënës, mësimdhënës, pedagog dhe psikolog etj.
B: I këshillojmë, i'u tërheqim vërejtjen, komunikojmë me prindërit dhe nëse ka nevojë edhe ju shqiptojmë masa pedagogjike.

6. Sa e fortë është lidhja e komunikimit Shkollë-Prind- Nxënës?

A: Ka lidhje të forta por edhe duhet më tepër të funksionojë ky raport. Ka prindër që vijnë vetëm në fundin e vitit etj.
B: Besoj se nuk është në nivel të kënaqshëm.

7. Sa psikologë dhe sa pedagogë janë të punësuar në shkollën ku ju punoni, dhe a i mbulojnë ata nevojat e të gjithë nxënësve?

A: Një pedagog dhe një psikolog. Jo nuk i mbulojnë nevojat e të gjithë nxënësve, sidomos të nxënësve shqiptarë.
B: Një pedagog dhe një psikolog.

8. A mendoni që koha (e tepërt) e lirë që e kanë nxënësit (p.sh. pas orës 13.30) pasi mbarojnë orët mësimore, mund të paraqesë faktor kriminogjen, që ata të infiltrohen qoftë në shoqëri të keqe apo grupe kriminale etj? A: JO
B: Po, Aplikimi i mësimit tërë ditor sigurisht se do të kishte rezultate më të mira në të gjitha aspektet.

9. Nëse keni rekomandime/komente të tjera se si mund të përmirësohet dhe të forcohet ndikimi i shkollave në parandalimin e kriminalitetit të të rinjëve, ju lutem shënoni ato më poshtë:

A: Shkurtimi i orëve mësimore, Shkurtimi i planprogrameve (nxënësit janë të ngarkuar), angazhimi i Ministrisë së Arsimit në organizim të planprogrameve, Interesimi i prindërve sidomos, atyre me gjendje ekonomike e sociale të dobët, Kohën e lirë nxënësit duhet ta kalojnë në aktivitete të lira të cilat do ti pengonin nga faktorët e rrezikshëm etj.

B: Në shkollat tona aspekti edukativ në procesin arsimor është lënë thuajse tërësisht pas dore, andaj besoj se prioritet duhet ti jepet anës edukative."

Konstatimet lidhur me rezultatet e nxjerrura nga Anketa e realizuar me nxënës dhe Intervistat me personelin e shkollave janë shtruar hollësisht në pjesën e Përfundimeve të punimit.

KAPITULLI VI

6. ROLI I DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE SUBJEKTEVE TË TJERA JURIDIKE NË PARANDALIMIN E DELIKUENCËS SË FËMIJËVE

Sipas Ligjit mbi drejtësinë për fëmijët të Republikës së Maqedonisë, në pjesën e tij të emërtuar "Parandalimi" obligohen të gjitha organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokuroritë publike, si dhe personat juridikë të cilit kryejnë autorizime publike nga sfera e arsimit, edukimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, të bashkëpunojnë me Këshillin Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve për realizimin e funksioneve të veta (neni 155). Prandaj, bazuar në dispozitat ligjore mbi parandalimin e delikuencës së fëmijëve si dhe në Raportin final të Këshillit shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve të vitit 2015, në vijim do të trajtohet roli dhe aktivitetet preventive që i ndërmarrin ministritë kompetente, institucionet, këshillat komunalë, Avokati i popullit dhe organizatat joqeveritare të cilat bashkëpunojnë me këtë Këshill.

6.1. Roli i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve

Ligji mbi drejtësinë për fëmijë i Republikës së Maqedonisë (2013), në pjesën e gjashtë (kap. i gjashtëmbëdhjetë, nenet 154-159) të titulluar "Parandalimi", rregullon çështjet lidhur me organet shtetërore kompetente të cilat punojnë në parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore themelohet një organ i veçantë publik i quajtur Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Ky Këshill është i mëvetësishëm dhe i pavarur në kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj .

Këshilli është i përbërë nga 15 anëtarë që i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me mandat prej pesë vitesh me të drejtë të rizgjedhjes, nga të cilët: Shtatë anëtarët e Këshillit shtetëror i propozon ministri i Drejtësisë dhe janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës Supreme

të Republikës së Maqedonisë dhe Odës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë, kurse tetë anëtarë të Këshillit zgjidhen përmes shpalljes publike nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë dhe profesionalë që punojnë në mbrojtjen e interesit të fëmijëve nga të cilët një përfaqësues është nga radhët e organizatave joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Këshilli Shtetëror ka seli në Ministrinë e Drejtësisë dhe në marrëdhënie me organe dhe persona tjerë paraqitet me logon e vet, që e përcakton Këshilli.

Në punën e Këshillit Shtetëror merr pjesë edhe përfaqësuesi i Avokatit të Popullit. Nga radhët e anëtarëve të zgjedhur, Këshilli Shtetëror zgjedh kryetar me mandat prej dy vitesh, me të drejtë të zgjedhjes së sërishme. (Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë, 2013, neni 154).

Kompetencat e Këshillit Shtetëror sipas Ligjit mbi Drejtësinë e fëmijëve janë:

- Miraton Strategji nacionale për parandalim të delikuencës së fëmijëve;
- Miraton programe dhe plane vjetore për realizimin e programit;
- Miraton Rregullore për punën e vet;
- Propozon mjete në propozimin e llogaritjes buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë të nevojshme për punën e tij;
- Merr iniciativa për përmirësimin e zgjidhjeve ligjore dhe jep mendime për propozimligjet me rëndësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e delikuencës së fëmijëve;
- Ngrit iniciativa për njohje më të gjerë të qytetarëve me të drejtat e fëmijëve dhe debate për familje të shëndoshë, për mbrojtje të fëmijëve nga narkomania, alkoolizmi dhe sëmundje tjera të varësisë, për problemet e arsimit dhe edukimit, për marrëdhëniet me mjetet e informimit publik dhe për faktorë tjerë që ndikojnë në parandalimin e delikuencës së fëmijëve;
- Inicion hulumtime dhe studime për tema nga delikeunca e fëmijëve;
- Bashkëpunon me organizata dhe trupa ndërkombëtarë, të angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe parandalimin e delikuencës së fëmijëve;
- Përgatit raporte vjetore për punën e vet dhe për gjendjet në sferën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së fëmijëve, të cilat i dorëzon te Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, të cilët janë

të obliguar t'i shqyrtojnë dhe t'i marrin masat dhe aktivitetet përkatëse, në pajtim me kompetencat e veta (neni 156).

Në përputhje me kompetencat e veta dhe Planin Operacional për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, të përgaditur në bazë të Strategjisë Nacionale për parandalimin e delikuencës së të miturve, Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve monitoron gjendjen në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijës dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve parandaluese të cilat ndërmerren nga: Ministritë kompetente, institucionet, këshillat komunalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, ombudspersoni dhe organizatat joqeveritare që kanë bashkëpunuar me Këshillin (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 40).

Në vitin 2011 u krijua një sistem gjithpërfshirës monitorimi për drejtësinë e fëmijëve. Ministritë përkatëse e pranuan, kurse Këshilli Shtetëror e përpiloi listën e treguesve si standarde për monitorimin e zbatimit të drejtësisë për të mitur si dhe miratoi një metodologji të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave për ç'do tregues. Ato janë 21 tregues, të krahasueshëm ndërkombëtarisht ose të përzgjedhur nga listat ekzistuese të përdorura në shtetet anëtare të BE-së të cilat poashtu mbështeten në treguesit e Kombeve të Bashkuara, por duke marrë parasysh prioritetet kombëtare dhe specifikat e tyre. Me këtë rast, Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës dhe situatës në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve në vitin 2011 është përgatitur në bazë të këtij rrjeti të treguesve, dhe Këshilli vazhdon të monitorojë situatën e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të miturit duke përdorur këto tregues (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.4-5).

Poashtu, një aktivitet tjetër parandalues, që vlen të përmendet se në kuadër të projektit "Drejtësi për Fëmijët" të UE-së dhe UNICEF-it me ç'ratst gjykatat themelore dhe zyrat e prokurorëve publik u pajisën me softwerë kompjuterik që u mundësojnë atyre të raportojnë jo vetëm për gjendjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, por edhe për fëmijët viktima dhe dëshmitarët. Të dhënat e marra në bazë të këtij sistemi tregues mundësojnë përcaktimin e vërtetë dhe monitorimin e politikave, aktiviteteve dhe masave për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve në konflikt dhe fëmijëve në kontakt me ligjin (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.5). Gjatë vitit 2012, Këshilli Shtetëror

ka punuar në Projektin Hulumtues "Ndërtimi i një politike parandaluese mbi delikuencën e të miturve". Duke vepruar në mënyrë aktive brenda autorizimeve të tij, Këshilli u nis nga fakti se ç'do shoqëri ka nevojë për të investuar në parandalim në të gjitha aspektet, sidomos në parandalimin e delikuencës së të miturve, sepse ajo parandalon kriminalitetin në përgjithësi. Në një situatë ku ka rritje të numrit të fëmijëve në rrezik, drejtimet strategjike dhe prioritetet për parandalimin e delikuencës së të miturve, të përcaktuara në Strategjinë Nacionale për Parandalimin e delikuencës, paraqisnin një bazë të mirë për ndërtimin e politikave parandaluese në mbarë vendin. Objekt i këtij hulumtimi ishte mënyra në të cilën realizohej politika parandaluese ndaj delikuencës së fëmijëve.

Kur bëhet fjalë për parandalim, duhet të trajtohet qasja multi-sektoriale ndërdisiplinore në ndërtimin e strategjive për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, e cili synon të identifikojë faktorët e rrezikut që ndikojnë në paraqitjen e saj, por edhe faktorët e nevojshëm për të forcuar komponentën mbrojëse për të dominuar dhe për të parandaluar kriminalitetin. Në këtë drejtim, Këshilli Shtetëror ka një karakter multidisiplinar dhe, sipas përbërjes së tij, është një qendër ku përfaqësuesit e shumicës së subjekteve në sistemin e drejtësisë për të mitur takohen.

Prandaj është e logjikshme të paraqitet si një iniciues dhe autor i publikimit të titulluar "Informatori për subjektet që punojnë në sistemin e drejtësisë për fëmijë", i publikuar në vitin 2013. Ky publikim për subjektet që punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur është një pjesë e projektit të lartëpërmendur të Këshillit. Publikimi në fjalë shtë një udhëzues i dobishëm dhe pragmatik që ofron detaje të kontaktit dhe informata të shkurtra mbi një gamë të gjerë temash që kanë nevojë të koordinojnë dhe zbatojnë shumë aktivitete të përbashkëta që synojnë parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Aktivitetet parandaluese mund të jenë të suksesshme në fushat ku marrin pjesë pjesëmarrës nga sektori qeveritar dhe joqeveritar dhe ku ekziston një interes i përbashkët dhe partneritet me qytetarët (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.6).

Konsideroj se themelimi i Këshillit shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve paraqet një hap pozitiv drejtë pengimit dhe luftimit të fenomenit të delikuencës së fëmijëve në vendin tonë. Edhe në këtë drejtim, Republika e Maqedonisë është duke përparuar në

drejtim të respektimit të detyrimeve të cilat rrjedhin nga Konventa e OKB-së për të drejtat e njeriut, sipas të cilës shtetet palë duhen të themelojnë organe dhe trupa të specializuara të cilat do të trajtojnë çështjet që lidhen me fëmijë. Organizimi dhe përbërja e Këshillit shtetëror si organ i mëvetësishëm dhe i pavarur e bën atë të jetë profesional në punën e vet drejtë parandalimit të kriminalitetit të fëmijëve. Nga raportet vjetore të cilat i publikon ky këshill mund të konstatojmë se ai ndërmerr aktivitete të shumta serioze në bashkëpunim me organe të ndryshme shtetërore si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Në vazhdim do të paraqesim disa rezultate nga aktivitetet e realizuara të subjekteve të tjera juridike gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me Këshillin shtetëror, të cilat padyshim se kanë dhënë rezultate në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve në vend.

6.2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Përmes institucioneve të saj, MASH vazhdimisht ndërmerr aktivitete që kanë të bëjnë sidomos me parandalimin primar të delikuencës së fëmijëve. Në vitin 2015 veçohen aktivitetet e mëposhtme të këtij institucioni:

- Në kuadër të projektit "Shkolla e sigurtë" në shkollat e mesme është implementuar programi i ashtuquajtur "Ndërmjetësim i moshatarëve", nëpërmjet të cilit nxënësit kanë fituan shkathtësi ndërmjetësimi - tejkalimin e problemeve përmes dialogut;
- Projekti “Politika për përshirjen e mediatorëve romë të arsimuar në arsimin fillor”, me ç’rast u hap thirje për 20 mediatorë në 16 komuna;
- Nëpër shkolla të mesme vazhdon të funskionojë sistemi i zgjedhjes së mentorëve të cilët i pregadisin nxënësit romë për vazhdim në arsimin e lartë. Për vitin akademik janë zgjedhur 127 mentorë.
- Për motivim të nxënësve që ta ndjekin procesin arsimor në mënyrë të vazhduar, ndahen bursa të llojeve të ndryshme;
- Vazhdon formimi i klubeve sportive nëpër shkolla dhe organizimi i ndeshjeve sportive në disciplina të ndryshme të sportit, si futboll, basketboll me ç’rast në këtë drejtim zhvillohet fryma garuese dhe sportive tek nxënësit, gjithë kjo me qëllim të pengimit të paraqitjes dhe zhvillimit të delikuencës së fëmijëve.

- Projekti garues “Lider” (2015) për zgjedhjen e nxënësit më të mirë në drejtimet profesionale të arsimimit, me ç’rast stimolohet kreativiteti tek nxënësit;
- Janë hapur 52 Qendra të karrierës, ku nxënësit mund të flasin për ardhmërinë e tyre të mbështetur me arsimimin.
- Zbatimi i institutit “Këshillimi i prindërve”, ku gjatë vitit akademik 2014/15 janë realizuar gjithsej 18.539 këshillime nëpër shkolla fillore dhe ato të mesme – që lidhen me çështje që kanë të bëjnë me rritjen e suksesit të nxënësve (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 44).

  Aktivitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në drejtim të prandalimit të delikuencës së fëmijëve, të cilat ndërmerren nga kjo ministri në bashkëpunim me Këshillin shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve janë të shumta, duke u përqëndruar tek kategoria e fëmijeve në rrezik. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse paraqet edhe qëllimi i realizimit të Preventivës primare dhe asaj sekondare të përcaktuar me Strategjinë Nacionale për parandalim të delikuencës së të miturve (2010-2020). Megjithatë, konsideroj se kjo ministri duhet që fokusin e aktiviteteve ta drejtojë më tepër kah fëmijët në konflikt me ligjin – duke e përmbushur obligimin lidhur me mundësimin e zhvillimit të procesit edukativo-arsimor nëpër entet ku ekzekutohen masat e enteve dhe dënimi me burg për fëmijë. Në këtë drejtim do të kontribuohej që qëllimi i preventivës terciere të Strategjisë të jetësohej në këtë drejtim.

6.3. Ministria e Punëve të Brendshme

Në ç'do shoqëri demokratike, parandalimit i jepet përparësi në raport me represionin, gjatë zbulimit dhe luftimit të kriminaliteti, sepse “Parandalimi është më i mirë sesa ndëshkimi“ (Stupmer, Vorbengung ‘Steitkindder polizeilichen Arbeit, 1987, f.21). Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha formacionet historike shoqërore dhe në të gjitha vendet në botë (Latifi, Taktika kriminalistike, 2001, f. 28). Me qëllim që veprimtaria parandaluese e policisë të jetë sa më efektive, është e nevojshme që programet dhe udhëzimet e përgjithshme të politikës kriminale, të formulohen në nivelin më të lartë kombëtar (Screvens, Police et prevention de la criminalite, 1979, f.121). Kërkimet më të reja të aktivitetit policor, si sektori i posaçëm i kontrollit shoqëror, tregojnë

se aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin preventiv, e kështu duhet ti kuptojmë edhe vetë pjesëtarët e policisë, se ata janë njëkohësisht edhe zyrtarë të prevencionit, dhe se prevencioni i krimit , marrë në kuptimin më të gjërë, është funksion i shërbimit të policisë (Latifi, Taktika kriminalistike, 2001, f. 28). Veprimtaria parandaluese e policisë nënkupton së pari mbikqyrjen e përgjithshme dhe sistematike ndaj ngjarjeve në vende të caktuara, kontrollet policore (veprimtaria patrulluese dhe vrojtuese) dhe veprimtari të tjera, sidomos: Mbikqyrjen ndaj prodhimit dhe qarkullimit të armëve, materialeve eksploduese të rrezikshme; Mbikëqyrjen ndaj dukurive sociale negative (bredhja, alkoolizmi, narkomania, prostitucioni, bixhozi etj.); Mbikëqyrjen ndaj të dënuarve, recidivistëve, të papunëve, delikuentëve të mitur dhe kategorive të tjera si autorë potencialë të veprave penale; Mbikëqyrjen e vendeve të caktuara publike (vendet e argëtimit, kafiteritë etj.) dhe të mjeteve të komunikacionit publik, mjeteve siguruese etj. (Milosovlevič, Nauka o policiji, 1997, f.159).

Sipas Prof. Dr. Vesel Latifi :“ Prevencioni policor mund të shfaqet në forma të ndryshme- të aktivitetit dhe të pasivitetit, siç është mbikqyrja dhe patrullimi i terrenit, kryerja e shërbimit të mbikëqyrjes që trajtohet si prevencion policor, kryerja e kontrollit në rrugë, të cilin e praktikojnë policitë e shumë vendeve, dhënia e këshillave qytetarëve me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti...themelimi i klubeve të të rinjëve për plotësimin e shkollimit profesional, zgjidhja e profesionit dhe dhënia e ndihmave dhe e këshillave individuale, kryerja e “mbikëqyrjes joformale” ndaj të rinjëve të rrezikuar dhe forma të tjera specifike për shërbimet policore të vendeve të caktuara” (Latifi, Taktika kriminalistike, 2001, f. 28).

Një njësit që vlen të theksohet, është Policia për bashkëpunim me komunitetin. Ky njësit ka lidhje e bashkëpunim me institucionet edukativo-arsimore, sidomos të arsimit fillor e atij të mesëm (Shishani, 2006, f. 95).

Formimi i njësive antidrogë, shkollimi i kuadrit adekuat dhe profesionalizimi i tij jashtë vendit, ushtrimi i detyrës së ndjekjes dhe vëzhgimit të personave të dyshimtë e të lokaleve të dyshimta nga ana e policisë në rroba civile, do të ishte një punë e suksesshme dhe dobiprurëse në këtë drejtim. Nëse bashkëpunimi i policisë dhe qytetarëve vjen duke u përsosur, sidomos përsa i përket shfaqjes dhe përhapjes së këtyre dukurive negative, rezultatet në parandalimin e kriminalitetit nga individë që ushtrojnë këtë veprimtari kriminale, nuk do të mungojnë (Shishani, 2006, f. 117).

Parandalimi i kriminalitetit në ç'do shoqëri, nuk është detyrë dhe e drejtë vetëm e policisë, por është obligim i tërë shoqërisë – qytetarëve të saj, dhe që punën e saj policia e mbështet, përveç të tjerash, edhe tek iniciativa dhe ndihma e qytetarëve si dhe shoqatave të tyre, pastaj tek ndihma dhe bashkëpunimi me institucione shtetërore etj. (Shishani, 2006, f. 141) Bashëpunimi i policisë me qytetarët parimisht mund të jetë i dy llojtë:

- Bashkëpunimi me një numër të pakufizuar qytetarësh, subjektesh të tjera dhe
- Bashkëpunimi me subjekte konkrete.

Bashkëpunimi dhe mbajtja e kontakteve të rregullta të policisë me shkollat e ndryshme, qofshin ato të mesme a fillore, pa dyshim ka rëndësi të madhe në parandalimin e kriminalitetit, por edhe në përmirësimin e marrëdhënieve të policisë me opinionin publik (Shishani, 2006, f. 164). Autori dhe studiuesi i njohur amerikan i delikuencës së të miturve, Josef Rauk, në veprën "Delikuenca e të miturve", në mes të tjerash thekson: "Më tepër se 29 faktorë janë të lidhur me ambientin shkollor dhe me institucionet shkollore, të cilët ndikojnë në shfaqjen delikuente dhe kriminale të fëmijëve dhe nxënësve! (Halili, Kriminologjia, 2000, f.262). Policia e komunitetit paraqet një njësi të veçantë policore sa i përket bashkëpunimit me qytetarët. Koncepti "Policia e komunitetit" i pranuar fillimisht në SHBA, Kanada e Britani të Madhe, ka nisur të përqafohet edhe në Evropën Kontinentale. Kjo formë e bashkëpunimit, e cila është e orientuar në parandalimin e kriminalitetit, si një nga detyrat më të rëndësishme të policisë, aplikohet përmes mbajtjes së ligjëratave nga ana e policëve nëpër shkolla që kanë të bëjnë me sigurinë dhe edukimin e fëmijëve, si p.sh. siguria në trafik, pasojat nga përdorimi i drogës, pasojat e krimit, bashkëpunimi i mirë i qytetarëve me policinë etj (Shishani, 2006, f. 167).

Kur policia do të vijë në kontakt me fëmiun, nga tretmani i tij i mëtutjeshëm varet se si do të jetë sjellja delikuente e tij e mëtutjeshme. Është shumë e rëndësishme qasja e parë, respektivisht veprimi me fëmijët kryerës primarë të cilët tani më kanë shfaqur sjellje delikuente. Nga kjo thuhet se policia e ka rolin kyç në zvogëlimin e rrezikut për përsëritje (recidivizëm). Nga ajo se (policia) a do të sillet me respekt, apo edhe një herë do ta etiketojë si delikuent apo do të veprojë me "kujdes prindëror" dhe në interes më të mirë të tij, do të varet edhe se si fëmiu do ta përjetojë reaksionin e parë. Prandaj, është e domosdoshme që qasja e personave zyrtarë nga MPB ndaj fëmijëve të bazohet në njohuri të veçanta teorike

dhe aftësi të fituara praktike në punën me fëmijë (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.24).

Konsideroj se janë të rëndësishme të paraqesim aktivitetet konkrete parandaluese të realizuara nga MPB e Republikës së Maqedonisë, të evidentuara në Raportin Vjetor të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e delikuencës së fëmijëve për vitin 2015. Këto aktivitete ishin të drejtuara kah zhvillimi i programeve dhe planeve për parandalim dhe luftim të delikuencës së fëmijëve dhe si të tilla ishin këto:

- Vizitat e rregullta të punonjësve policorë nëpër shkolla;
- Forcimi i bashkëpunimit me shërbimet profesionale për të detektuar sa më herët fëmijët në rrezik;
- Projektet: "Bashkëpunimi me të rinjë në rrezik"; " Matura të sigurta"; "Shkolla të sigurta", "Sport PO, Drogë JO"; „Mbrojtës të përzier" – Policia dhe prindërit; "Të sigurtë në ditën e parë të shkollës" etj. (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 41).

6.4. Ministria e Punës dhe Politikës sociale

- **Qendrat për punë sociale**

Qendrat për punë sociale, si institucione publike nga sfera e mbrojtjes sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës sociale, për funksion themelor kanë mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesit të fëmiut. Ç'do qytetar, organ dhe person juridik është i obliguar ta njoftojë qendrën për punë sociale menjëherë sa bie në dijeni se prindi nuk e ushtron të drejtën prindërore apo nga arsye të tjera është e nevojshme mbrojtja e personalitetit, të drejtave dhe interesit të fëmiut (Ligji mbi familjen, n.84). Në bazë të të drejtave nga mbrojtja sociale, qendra për punë sociale si institucion publik ofron shërbime dhe ndërmerr masa, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, përmes të cilave realizon: Preventivë sociale, mbrojtje jashta institucionale, mbrojtje institucionale dhe të drejtën e ndihmës financiare (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.16).

Në rast se qendra për punë sociale njoftohet për fëmijë në rrezik, ajo menjëherë inicon procedurë për zbatim të masave për ndihmë dhe mbrojtje. Shërbimet profesionale mund të ndërmarrin më tepër masa si: Mbikqyrje ndaj ushtrimit të të drejtës prindërore; Vendosjen e fëmijëve nën kujdestari; Vendosjen në qendër ditore, në familje përkujdesëse ose në institucion; Këshillimin e prindërve dhe fëmijëve në konflikte martesore dhe familjare; si dhe zbatimin e masave diciplinore dhe masat e mbikqyrjes së shtuar (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.16).

Sipas Ligjit mbi drejtësinë e fëmijëve, fëmijë në rrezik është ç'do fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhvillimit mental, viktimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizimi funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/ëve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypësi, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotropike dhe prekursorë ose alkool, *e i cili për shkak të gjendjeve të këtilla është ose mund të bie ndesh me ligjin* si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është paraparë si vepër penale (neni 19, p.2).

Shqiptimi i masave : Sipas LDF - masa janë masat për ndihmë dhe mbrojtje të përcaktuara me ligj të cilat nuk përbëhen në heqjen dhe kufizimin e lirive dhe të drejtave të fëmijëve për shkak të veprimit të kryer të paraparë me ligj si vepër penale ose kundërvajtje ose ***gjendje të rrezikut***, të cilat ndaj fëmijës, prindit/ëve, ose tutorit/ëve mund t'i zbatojnë, gjykata ose ***organet tjera të përcaktuara me këtë ligj***! (neni 19, p.9).

Organe tjera të specializuara janë ***qendrat për punë sociale***, prokuroria publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet për ekzekutimin e sanksioneve për fëmijë (neni 19, p.12).

Nga Raporti Final i Këshillit për parandalim të delikuencës së fëmijëve për vitin 2015, u konstatua se Ministria e Punës dhe politikës sociale gjatë këtij viti ka ndërmarë një varg aktivitetesh preventive në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga keqpërdorimet dhe anashkalimet dhe në sferën e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore. Ajo që është relevante për temën tonë ndërlidhet me kompetencat ligjore të Qendrave për punë sociale në veprimin me fëmijët në rrezik (deri në moshën 14 vjeçare dhe ato mbi 14

vjet) dha ata në konflikt me ligjin në rastet e përcaktuara me LDF. Sipas këtij raporti u konstatua se për preventivë më efikase të delikuencës së fëmijëve, duhet të ndërmerren masa për luftimin e recidivizmit, respektivisht përsëritjes së veprimeve devijante të fëmijëve në rrezik dhe atyre në konflikt me ligjin.

Në bazë të një hulumtimi të bërë nga Këshilli shtetëror për parandalim në mbështetje të Ministrisë së drejtësisë dhe ekspertëve nga jashtë, gjatë vitit 2015, është definuar dukuria e përsëritjes/recidivizmit, është fituar një profil i saktë i recidivistëve dhe janë përcaktuar faktorët e rrezikut të cilët janë shkaktarë për recidivizmin – të gjitha këto për parandalim më të mirë të delikuencës së fëmijëve. Gjatë hulumtimit është fituar një pasqyrë më e qartë mbi veprimin dhe punën e institucioneve, e mbi të gjitha të Qendrave për Punë sociale të cilat punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin/përsëritës dhe në sigurimin e shërbimeve sociale kualitative për fëmijët përmes zhvillimit të modeleve praktike të cilat sigurojnë përfshirjen e tyre në shoqëri.

Në pajtim me rezultatet e fituara nga hulumtimi i lartëpërmendur, Këshilli shtetëror i parasheh këto rekomandime dhe propozime për aktivitetet e ardhëshme për luftim të recidivizmit të fëmijëve , si këto në vijim:

- Përmirësimi i rregullativës ligjore;
- Hapja e këshillimoreve për prindër brenda dhe jashta Qendrave për punë sociale në shumicën e qyteteve të Republikës së Maqedonisë;
- Aktivizimin e masës edukuese - Dërgimi në Qendër për fëmijë;
- Aktivizimin e familjeve përkujdesëse të specializuara për vendosjen e fëmijëve me probleme edukativo-sociale ose fëmiut kryes të veprës penale/kundërvajtëse;
- Inkuadrimin e programeve të mentorimit me ç'ka do të rriten kapacitetet e qendrave për punë sociale në punën e tyre me fëmijët në rrezik apo ata në konflikt me ligjin;
- Përmirësimin e kushteve teknike, zgjërimin e kapaciteteve hapsinore për punë dhe kushte për punë në terren në qendrat për punë sociale;
- Forcimi i bashkëpunimit të qendrave për punë sociale me bashkësinë lokale me qëllim të socializimit social të fëmiut etj. (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 11).

6.4.1. Kompetencat e Qendrave për Punë sociale sipas LDF

Ligji për drejtësinë për fëmijë e përjashton mundësinë e shqiptimit të sanksioneve për fëmijë të parapara me këtë ligj ndaj fëmiut i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale apo kundërvajtje nuk i ka mbushur 14 vjet (neni 20). Ndërsa ndaj fëmiut në rrezik deri në moshën 14 vjet dhe atij mbi moshën 14 vjet mund të zbatohen vetëm masat për ndihmë dhe mbrojtje të parapara me ligj, të cilat janë me interes për fëmiun dhe për zhvillimin dhe edukimin e tij (neni 21).

Qendra për punë sociale është kompetente për të vlerësuar se kur do të zbatohen masat e lartëpërmendura ndaj fëmijëve në rrezik dhe atë kur do të vlerësojë se gjendja e rrezikut reflektohet mbi personalitetin e fëmiut dhe mbi edukimin e tij të drejtë. Këto masa mund të zbatohen edhe ndaj prindërve ose tutorëve, nëse e kanë lënë pas dore ose e kanë keqpërdorur realizimin e të drejtave ose obligimeve të veta lidhur me mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmiut (neni 22).

6.4.2. Veprimi i Qendrës për punë sociale me fëmijët në rrezik sipas LDF

Sipas LDF, për veprimin e fëmiut në rrezik deri në moshën 14 vjet që me ligj është paraparë si vepër penale, për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, si dhe kur gjatë kryerjes së veprës kanë marrë pjesë edhe persona tjerë për të cilët mund të zhvillohet procedurë para gjykatës, si dhe për veprimin e fëmiut në rrezik mbi moshën 14 vjet që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg deri në tri vite ose dënim me para, Ministria e Punëve të Brendshme dorëzon njoftim te Qendra për Punë Sociale dhe te prokurori publik kompetent.

Për gjendje tjera të rrezikut, Ministria e Punëve të Brendshme, shkolla ose ndonjë institucion tjetër ku fëmija është në përkujdesje, si dhe prindi/ët e tyre, ose tutori/ët e fëmijës e njoftojnë Qendrën, me ç'rast ajo vepron menjëherë pas njoftimeve të tyre ose kur kanë arritur tek ato informacione në bazë të njohurive personale. Qendra, Ministria e Punëve të Brendshme dhe shkolla ose ndonjë institucion tjetër ku fëmija është në përkujdesje, janë të obliguar të njoftohen në mënyrë reciproke për sjelljen e fëmijës, si dhe për të gjitha rrethanat tjera që sipas ligjit konsiderohen si gjendje në rrezik. (neni 24).

Në afat jo më të gjatë se 15 ditë nga pranimi i njoftimit ose njohurisë tjetër, e në rastet kur

ekziston rrezikimi i personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmiut, jo më gjatë se 36 orë, Qendra e thirr në bisedë fëmiun në rrezik, prindin/ët, ose tutorin/ët e tij dhe ngrit procedurë me karakter të besueshëm për përcaktimin e rrethanave faktike të ngjarjes konkrete ose gjendjes së rrezikut. Nëse edhe krahas dorëzimit të rregullt biseda nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së fëmiut dhe prindit/ëve ose tutorit/ëve të tij, Qendra e njofton prokurorin publik kompetent dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprim të mëtejmë. Bisedën e mban përfaqësuesi i ekipit profesional ose ekipi profesional i përbërë nga pedagogu, punëtori social, psikologu dhe juristi i diplomuar, në lokale të veçanta. Në rastet kur vepra e fëmijës në rrezik deri në moshën 14 vjet me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku pesë vitesh ose kur ekziston rrezikim i personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës, në mënyrë të obligueshme në bisedë merr pjesë mbrojtësi i cili i mbron të drejtat dhe interesat e fëmijës.

Prezenca e mbrojtësit është e obligueshme edhe në rastet kur prokurori publik propozon masa për fëmijën në rrezik mbi moshën 14 vjet për vepër që me ligj është paraparë si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg deri në tri vite, nëse sipas vlerësimit të qendrës ekziston rrezikim i personit, të drejtave dhe interesave të fëmijës, dhe nëse në ekipin profesional nuk merr pjesë juristi (neni 25).

Në bazë të njoftimeve të grumbulluara dhe të dhënave tjera me të cilat disponon qendra, si dhe bisedës së realizuar me prindin/ët, ose tutorin/ët dhe fëmijën në rrezik, ekipi profesional i lartëpërmendur (në nenin 25) në afat prej 30 ditësh përgatit plan me masa dhe aktivitete për punën individuale me fëmijën dhe prindin/ët, ose tutorin/ët dhe atë plan e zbaton. Ekipi profesional nga qendra e zbaton planin në mënyrë dhe me dinamikë të marrjes së masave, të përcaktuara në plan. Në përgatitjen e zbatimit të planit marrin pjesë edhe organe ose persona tjerë të specializuar (neni 27).

Më së shumti në afat prej dhjetë ditësh pas miratimit të planit, ekipi profesional (nga neni 25) bisedon për herë të dytë me prindin/ët, ose tutorin/ët me të cilin jeton fëmiu në rrezik me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë të vërtetohet nëse ata mund të kujdesen për të dhe nëse mund të evitohen arsyet për sjelljen e tij dhe gjendjen në rrezik. Ky ekip poashtu i njofton prindin/ët, ose tutorin/ët me Planin, për shkak të pjesëmarrjes aktive të tij në zbatimin e masave për ndihmë dhe mbrojtje edhe i paralajmëron për pasojat e mëtejme nga mosbashkëpunimi me qendrën. Ata duhet të takohen së paku një herë në muaj, ndërsa

ndryshime të planit mund të bëhen varësisht suksesit të masave të shqiptuara ose të rrethanave të reja që mund të paraqiten. Masat mund të zgjasin deri në arritjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeçare të fëmiut, kurse mbikëqyrje mbi zbatimin e planit kryen Enti për Punë Sociale (neni 28).

Ligji poashtu rregullon rastet kur mund të ndodhë që Plani i përpiluar nga ana e Qendrës të mos zbatohet nga ana e prindërive apo tutorëve të fëmiut, me ç'rast pas konstatimit të gjendjes së tillë, në afat prej shtatë ditësh duhet ta njoftojë gjykatësin kompetent për fëmijë, i cili në afat prej tri ditësh vendosë lidhur me zbatimin e masave të përmbajtura në Plan dhe jep udhëzime të përcaktuara për Qendrën. E në rast kur prindërit/tutorët nuk veprojnë as sipas vendimit të gjykatës, gjykata e njofton prokurorin publik për veprim të mëtejshëm.

Ndërsa, në ratet kur nuk është i mundur zbatimi i masave të përmbajtura në planin e qendrës për shkak se fëmiu, prindërit apo tutorët nuk janë prezent apo kur Qendra nuk ka qasje tek ata, ajo duhet ta njoftojë prokurorin publik dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme (neni 29).

6.4.3. Procedura për ndërmjetësim

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve e autorizon Qendrën për punë sociale si organ i cili mund ta zhvillojë procedurën e ndërmjetësimit mes fëmiut në rrezik dhe prindërve/ tutorit dhe të dëmtuarit/viktimës në rastet e përcaktuara me këtë ligj, dhe atë: Për veprimin që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje nga i cili fëmiu në rrezik ka përfituar dobi pasurore ose i ka shkaktuar dëm tjetrit. Qëllimi i zhvillimit të kësaj procedure është arritja e pajtimit të palëve dhe premtimit nga ana e fëmiut se nuk do të përsëritet vepra (satisfaksioni moral i viktimës) dhe për kthimin e dobisë pronësore ose kompensimin e dëmit të shkaktuar (satisfaksioni material i viktimës).

Kjo procedurë mund të zgjasë më së shumti 30 ditë pas miratimit të vendimit për ngritjen e procedurës për ndërmjetësim. Për pajtimin përpilohet marrëveshje që ka rëndësi të barazimit jashtëgjyqësor. Ndërsa, në rast se ndërmjetësimi mbetet pa sukses, i dëmtuari mundet në afat prej 30 ditësh pasi është konstatuar mossuksesi për ndërmjetësim, të parashtrojë propozim për ngritjen e procedurës për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore nga personi mbi të cilin është bartur prona ose dobia pronësore ose kërkesa pronësore juridike për kompensim të dëmit (neni 30).

Është me rëndësi të theksohet se evidencat me të dhënat lidhur mezbatimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes të gjitha qendrat i dorëzojnë te Regjistri për zbatim të masave të ndihmës dhe mbrojtjes, që e udhëheq Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, mirëpo pas mbushjes së moshës 18 vjeçare të fëmijës të dhënat nga evidencat e qendrave dhe nga Regjistri i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale shkatërrohen (neni 31). Kjo me të vetmin qëllim - që të mbrohet interesi i fëmiut gjatë inkuadrimit në jetën shoqërore si person madhor, duke mos bartur pasoja juridike për "gabimet" nga mituria.

Në vazhdim do të paraqiten të dhëna për aktivitetet e Qendrave për punë sociale në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve:

Tabela 1: Fëmijë të referuar në qendrat për punë sociale gjatë vitit 2015, sipas gjinisë

	Numri	**%**
Meshkuj	1821	85,4
Femra	310	14,5
Gjithsej	2131	100,0

(Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 15-16)

Me këtë tabelë pasqyrohet numri i fëmijëve në rrezik të cilët janë dërguar në Qendër për punë sociale nga ana e institucioneve të tjera ose individëve, gjatë vitit 2015. Burim i të dhënave të paraqitura në tabelën 1 janë 30 Qendra për punë sociale të vendit, ku tek të gjitha ka të evidentuar fëmijë në rrezik, me përjashtim të Demir Hisarit ku nuk ka fëmijë në rrezik të evidentuar. Në vitin 2015 janë dërguar gjithsej 2131 fëmijë në rrezik në QPS, nga të cilët 86% janë fëmijë të gjinisë mashkullore, kurse 14% të gjinisë femrore.

Tabela 2 - Numri i fëmijëve të referuar në Qendrat për punë sociale gjatë periudhës 2013-2015 në Republikën e Maqedonisë

Viti	**Numri**
2013	1357
2014	2062
2015	2131

(Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 15).

Sipas të dhënave në tabelën 2, në krahasim me vitin 2014, gjatë vitit 2015 ka 69 fëmijë në

rrezik më shumë të evidentuar, që paraqet një rritje prej 3%.

Tabela 3: Fëmijë në rrezik ndaj të cilëve janë zbatuar masa të ndihmës dhe mbrojtjes në Qendrat për punë sociale gjatë vitit 2015

	Meshkuj	**Femra**	**Gjithsej**
Demir Hisar	0	0	0
Kriva Pallankë	0	0	0
Kratovë	1	0	1
Resen	2	0	2
Krushevë	3	0	3
Kërçovë	3	1	4
Dellçevë	4	1	5
Probishtip	1	4	5
Ohër	4	2	6
Vinicë	6	1	7
Gjevgjeli	3	4	7
Berovë	8	0	8
Vallandovë	5	3	8
Makedonski B.	3	7	10
Radovish	10	0	10
Strumicë	3	7	10
Shtip	6	4	10
Koçani	15	1	16
Strugë	15	1	16
Prilep	11	16	27
Shën Nikollë	22	6	28
Dibër	18	22	40
Manastir	28	4	32
Gostivar	40	5	45
Kavadar	37	18	55
Tetovë	62	22	84
Veles	140	6	146
Negotinë	121	34	155
Kumanovë	302	27	329
Shkup	399	27	426
Gjithsej	1276	219	1495

(Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 29)

Me të dhënat në tabelën nr.3 matet përqindja e fëmijëve në rrezik ndaj të cilëve nga QPS janë shqiptuar dhe kanë zbatuar masa të ndihmës dhe mbrojtjes në vitin 2015, duke u krahasuar me të gjithë fëmijët të cilët janë referuar në Qendër. Të dhënat janë mbledhur nga të gjitha 30 Qendrat për punë sociale në Republikën e Maqedonisë. Nga gjithsej 2131 fëmijë në rrezik të evidentuar në QPS, në vitin 2015 masa të ndihmës dhe mbrojtjes janë zbatuar ndaj 1495

fëmijëve, respektivisht ndaj 70% të fëmijëve në rrezik. Nga ata 85% janë të gjinisë mashkullore, kurse 15% të gjinisë femrore. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me ato të vitit 2014, kur përqindja e fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e ndihmës dhe mbrojtjes ishte 77%, në vitin 2015 vërehet një rritje e vogël për 7% (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 29).

6.4.4. Numri i masave të ndihmës dhe mbrojtjes të zbatuara ndaj fëmijëve në rrezik në QPS

Në të dhëna e publikuara në Raportin vjetor të Këshillit Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, është matur numri i masave për ndihmë dhe mbrojtje për periudhën një vjeçare gjatë vitit 2015, në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve në rrezik. Ato tregues na tregojë se sa masa zbatohen mesatarisht për një fëmijë. Ndaj 1495 fëmijëve në rrezik, në vitin 2015, janë aplikuar 4024 masa, pra nga 2.7 masa për fëmijë. Numri i masave është zvogëluar krahasuar me vitin 2014, kur janë aplikuar 3 masa për fëmijë. Lidhur me gjininë, mesatarisht 2,8 masa janë aplikuar për femra, ndërsa për meshkujt janë aplikuar 2,7 masa. Në nivelin e QPS-së, në Koçan, Ohër dhe Dibër, shumica nga masat janë zbatuar ndaj meshkujve, ndërsa në Vinicë, Shkup, Shën Nikollë dhe Manastir ndaj fëmijëve femra (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 30).

- **Fëmijë në rrezik të përfshirë në procedurën e ndërmjetësimit në QPS**

Në vazhdim është pasqyruar përqindja e fëmijëve në rrezik, për të cilët Qendra ka zhvilluar procedurë ndërmjetësimi në krahasim me numrin e fëmijëve në rrezik të referuar në QPS. Në vitin 2015, ndërmjetësimi është aplikuar në 133 fëmijë në rrezik, duke përfaqësuar 6% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve në rrezik (2131). Ndërmjetësimi është zhvilluar me sukses ndaj 126 fëmijëve ose 95% të fëmijëve tek të cilët është aplikuar. Në vitin 2014, u zbatua procedura e ndërmjetësimit ndaj 80 fëmijëve (3.9% e fëmijëve në rrezik). Ndërmjetësimi ishte i suksesshëm tek 74 fëmijë (92%). Pra, sipa kësaj në vitin 2015 shohim një rritje të vogël të aplikimit të procedurës së ndërmjetësimit si një nga masat për ndihmë dhe mbrojtje me 2% (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 32).

6.4.5. Ndihma e dhënë fëmijëve nga ana e Qendrës për punë sociale pas daljes nga enti

Nl vazhdim është pasqyruar numri i fëmijëve të cilët pas mbarimit të ekzekutimit të masës së entit – Referimi në ent edukues/ Shtëpi edukuese-përmirësuese dhe fëmijëve të cilëve ju ka mbaruar dënimi – Burg për fëmijë, i kanë lëshuar entet dhe kanë fituar ndihmë dhe kujdes të strukturuar nga ana e QPS gjatë zbatimit të disa masave të ndihmës dhe mbrojtjes. Në vitin 2015 gjithsej 23 fëmijëve i'u është pushuar së ekzekutuari masa e entit apo dënimi, nga të cilët 22 janë të gjinisë mashkullore, kurse një e gjinisë femrore. Nga ana e QPS-ve kujdes i'u është siguruar 22 fëmijëve, nga të cilët 19 të gjinisë mashkullore dhe 3 të gjinisë femrore.
Kurse, në vitin 2014, masa e entit ose dënimi i'u ka pushuar 13 fëmijëve, kurse ndihma pas penale i'u është ofruar 15 prej tyre (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 32).
Në këtë aspekt, Qendrat për punë sociale – të gjitha këto aktivitete të lartëpërmendura i ndërmarrin me qëllim të realizimit të preventivës primare, sekondare dhe asaj terciere ndaj delikuencës së fëmijëve.

6.5. Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë

Avokati i Popullit, krahas të drejtave elementare të qytetarëve, është kompetent të sigurojë mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve, për të cilin qëllim, sipas obligimit të përcaktuar ligjor, në kuadër të institucionit Avokati i Popullit është formuar departament i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në pjesën e drejtësisë për fëmijë, Avokati i popullit, respektivisht Departamenti i lartëpërmendur, i kushton kujdes të veçantë respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rrezik para institucioneve shtetërore dhe organizatave të tjera të cilat kryejnë autorizime publike, si në drejtim të masave preventive ashtu edhe në drejtim të masave për mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve viktima (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.40). Për shkak të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, parashtresa deri tek ky organ kanë të drejtë të parashtrojnë fëmiu dhe përfaqësuesi i tij ligjor, respektivisht kujdestari, si dhe ç'do person tjetër, organ apo organizatë të cilët kanë njohuri se është cënuar e drejtë e caktuar e fëmiut. Poashtu ky organ është kompetent që të inicojë procedurë për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve me vetë iniciativë, nëse vlerëson se organet apo organizatat para të cilëve është i

autorizuar të veprojë i cënojnë të drejtat e fëmijëve me ndërmarrje apo mosndërmarrje të ndonjë veprimi të caktuar; si dhe të ndjekë gjendjen e realizimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, pra edhe të kategorisë së fëmijëve të përfshirë me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.40).

Në përbërje të Këshillit Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, përveç 15 anëtarëve të cilët zgjidhen nga ana e Kuvendit, merr pjesë dhe një përfaqësues nga Avokati i Popullit (neni 154, p.6 i LDF). Avokati i Popullit bashkëpunon me Këshillin në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve. Poashtu raporton për punën e tij në këtë drejtim, respektivisht në Raportin vjetor të punës së Këshillit janë potencuar edhe aktivitetet e Repartit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta në kuadër të Avokatit të Popullit. Avokati i popullit si ç'do vit edhe në 2015-tën vazhdoi ta përcjellë gjendjen me sigurimin e lirive dhe të drejtave të barabarta për të gjithë fëmijët, mundësimin e një jete dinjitoze dhe respektimin e fëmiut si bartës të këtyre të drejtave. Megjithatë, konstatoi se në praktikë realizimi i të drejtave të fëmijëve dhe respektimi i tyre ende nuk ishte në nivel të kënaqshëm (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016).

Ky organ viziton sistematikisht, si dhe në vitin e fundit të hulumtimit Entet shtetërore në të cilat janë të vendosur fëmijë në rrezik, ku dhe kishte konstatuar se edhe në vitin 2015 këto ente nuk kishin arritur plotësisht që të i'u ndihmojnë këtyre fëmijëve për përmirësimin e sjelljes së tyre dhe zhvillimit të drejtë. Gjatë vizitave të ente u konstatua se fëmijët shpesh janë në ikje, kurse personeli nuk ka mundësi ti plotësojnë qëllimet e planifikuara me planet individuale dhe programet për punë. Për këtë shkak, në vend të përmirësimit të sjelljes së fëmijëve dhe kthimit eventual në familjet e tyre, një pjesë e fëmijëve të vendosur në qendrën "25 Maj"-Shkup, dërgohen në qendrën "Ranka Milanoviq"-Shkup, për shkak të sjelljes destruktive të tyre. Është shqetësues edhe konstatimi se shpesh fëmijët të cilët takohen gjatë vizitave në Shtëpinë edukuese-përmirësuese –Tetovë, Veles paraprakisht kanë kaluar në këto Qendra! Avokati i popullit ju rekomandon organeve dhe institucioneve kompetente ndërmarrjen e masave urgjente dhe aktiviteteve për tejkalim të situatës së lartëpërmendur, me qëllim të realizimit të të drejtave të fëmijëve të vendosur nëpër entet e ndryshme (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016) .

6.6. Organizatat joqeveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve

Në Republikën e Maqedonisë janë të themeluara numër i madh i organizatave joqeveritare, të cilat shumica veprojnë në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ato mund të kenë rol plotësues me institucionet tjera publike dhe shtetërore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por, poashtu paraqiten edhe si korrigjuese, ose si organizata të cilat ofrojnë shërbime plotësuese dhe ndihmë në raste kur nuk ekzistojnë institucione publike të specializuara për qëllime të caktuara. Organizatat joqeveritare ofrojnë shërbime të ndryshme, mes tjerash: Ndihmë dhe mbrojtje direkte fëmijëve; Ngritjen e vetëdijes publike për të drejtat e fëmijëve; Lobim dhe përfaqësim për ndryshime dhe plotësime të rregullativës ligjore; Trajnime të personave nga sektori publik dhe privat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërtim të kapaciteteve dhe sigurim të përkrahjes tjetër publike (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.55).

Në listën e "Informatorit për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur", të publikuar nga Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve (Prill, 2013), janë të evidentuara gjithsej 44 organizata joqeveritare të cilat veprojnë në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Po përmendim disa nga ato, si: ***Asociacioni për mbështetje të fëmijëve dhe familjeve në rrezik; Asociacioni për promovim të shëndetit mental dhe parandalim të keqpërdorimit të fëmijëve "Fëmijëri e sigurtë"; Ambasada e parë botërore e fëmijëve "Megjashi"- R.M.; Shpëtoni fëmijët; Komiteti i Heksinkut për të drejtat e njeriut i R.M.; Asociacioni i qytetarëve SOS "Fshati i fëmijëve"; Asociacioni për të drejtat e fëmijëve – Qendra ditore për fëmijët në rrugë*** etj. Në vazhdim, do të paraqesim veprimtarinë e dy organizatave joveritare të cilat kanë realizuar bashkëpunim me Këshillin gjatë vitit 2015, dhe ato janë: "SOS Fshati i fëmijëve", dhe " Asociacioni për të drejtat e fëmiut".

- **"SOS Fshati i fëmijëve":** Programi preventiv në kuadër të kësaj organizate joqeveritare funksionon nga viti 2007, në dy lokacione në qytetin e Shkupit, përmes dy Këshillimoreve- qendra për fëmijë dhe prindër. Grupi target i tyre janë familjet me fëmijë të mitur, ku fëmijët janë në rrezik për ta humbur kujdesin e prindërve/kujdestarëve, për shkak

të prezencës së një apo më shumë gjendjeve të rrezikut social me të cilat ballafaqohen familjet. Prej themelimit e deri në nëtor të vitit 2015, përmes këtyre dy Qendrave këshilldhënëse janë përkrahur gjithsej 746 fëmijë nga 215 familje, me 260 prindër/kujdestarë. Nga ky numër 41 familje me 180 fëmijë bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijëve të rrugës. Në të dy Qendrat përmes ndihmës me këshillëdhënie dhe puntorive ofrohet mbështetje arsimore, psiko-sociale dhe shëndetësore për fëmijët, mbështetje për prindërit, edukim për zhvillim të hershëm të fëmijëve, mbështetje për sigurim të qëndrueshmërisë ekonomike të familjeve dhe ndërtim të kapaciteteve të prindërve. Kjo organizatë ofron edhe shërbime të tjera plotësuese për familjet në rrezik social (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 46) .

- **"OJQ Asociacioni për të drejtat e fëmiut":** Kjo organizatë joveritare e zhvillon " Qendrën ditore edukative dhe zbavitëse për fëmijët në rrugë" në Shuto Orizari, e cila qendër është e themeluar nga viti 2007 dhe deri më sot ajo ofron ndihmë dhe mbrojtje për fëmijët dhe familjet e tyre. Qendra ditore për fëmijë punon me grupe të fëmijëve në rrugë nga bashkësia rome, në komunën e cekur më lartë. Këto janë fëmijë nga familje sociale rome me shumë fëmijë, të moshave 4-17 vjeçarë, të cilët nuk janë të kyçur në sistemin edukativo-arsimor, dhe kohën më të madhe e kalojnë rrugëve, të kyçur në lypsari apo duke jetuar në kushte të pavolitshme banesore dhe materiale (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 47). Bëhet fjalë për preventivë primare, me ç'rast në Qendër adresohen shkaqet apo faktorët kryesorë ende para se fëmijët të bëhen pjesë e sistemit të delikuencës së fëmijëve, me qëllim që të sigurohet një mjedis i sigurtë për të gjithë fëmijët. Në këtë Qendër Ditore mundësohen nevoja të ndryshme për fëmijët, si: Mbajtja e higjienës personale, ndjekja e fëmijëve në aspektin shëndetësor, bashkëpunim me institucionet shëndetësore për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, imunizim dhe edukim shëndetësor për fëmijët, mbathje, ushqim, angazhim në aktivitete të dobishme (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 47).

Qëllimi kryesor i programit të punës së Qendrës ditore për fëmijët e rrugës është integrimi social dhe ndërprerja e ciklit të margjinalizimit të tyre, respektivisht largimi i tyre nga rruga dhe kyçja në rrjedhat e rregullta të jetës. Kjo Qendër tashmë dhjetë vite ofron mbështetje të gjatë për përmirësimin e shkallës së regjistrimit, ndjekjes dhe mbarimit të sistemit edukativo-arsimor për kategorinë e fëmijëve në fjalë. Gjatë vitit 2015, Qendrën ditore e kanë

vizituar 143 fëmijë, nga të cilët në vitin akademik 2014/15 shkollën e kanë vijuar 84 dhe 81 e kanë mbaruar atë me sukses (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016, f. 48).

6.7. Ministria për vetëqeverisje lokale

- **Këshillat komunalë për parandalim të delikuencës së fëmijëve**

Vetëqeverisja lokale, si një nga pjesëmarrësit e rëndësishëm në preventivë, posaçërisht permes Këshillave komunalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Ajo ka për qëllim të krijojë një vend të sigurtë për jetesë, rritje, edukim dhe shoqërim të fëmijëve me një integrim të plotë të grupeve të margjinalizuara dhe të rrezikuara të qytetarëve respektivisht fëmijëve dhe sigurimin e kushteve për zhvillim të drejtë të popullatës së re të saj. Kontributi i bashkësisë në parandalimin e delikuencës së fëmijëve është sidomos i rëndësishëm, sepse problemi i delikuencës së fëmijëve është njëkohësisht problem edhe i bashkësisë. Prandaj, bashkësia lokale ka përgjegjësi në kontrollimin dhe parandalimin e kriminalitetit, veçanërisht të delikuencës së fëmijëve dhe për këtë qëllim duhet të sigurojë ndihmë dhe mbrojtje, kushte të përshtatshme për: jetesë, sport, shoqërim, si dhe për riintegrim dhe risocializim të fëmijëve kryerës të veprave penale (INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur, 2013, f.27). Në bazë të obligimit ligjor i cili pason nga Ligji për drejtësinë e fëmijëve, Këshillat e komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe i qytetit të Shkupit duhet të emërojnë Këshilla komunalë dhe Këshill të qytetit të Shkupit për Parandalim të Delikuencës së Fëmijëve (neni 158.1.).

6.7.1. Kompetencat e Këshillave komunalë sipas LDF janë:

- Miratojnë programe vjetore për punën e tyre që e miratojnë këshillat e komunave dhe Këshilli i qytetit të Shkupit,
- Miratojnë rregullore për punën e vet, në rajonin e komunës dhe qytetit të Shkupit,
- Kryejnë punë për përcjelljen e gjendjeve,
- Ngritin iniciativë për përmirësimin e tyre,
- Zhvillojnë programe për përfshirjen e bashkësisë lokale në parandalimin e delikuencës së fëmijëve dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprimeve të cilat me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kundërvajtje.

- Për punën e tyre këshillat komunalë së paku një herë në vit e njoftojnë këshillin e komunës, ose qytetin e Shkupit dhe Këshillin Shtetëror për parandalim e delikuencës së fëmijëve. Programi i këshillave komunalë financohet në bazë të planit financiar nga buxheti i komunës, ose qytetit të Shkupit dhe nga mjetet tjera (neni 159).

Edhe gjatë vitin 2015 Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve vazhdoi me ndërmarrjen e iniciativave për formimin e këshillave të rinjë komunalë për parandalim të delikuencës së fëmijëve. Aktualisht në Republikën e Maqedonisë funksionojnë tetë këshilla të tillë komunalë në bazë të Programit të përpunuar dhe zbatojnë aktivitete me karakter preventiv, dhe atë në: Kavadar, Veles, Manastir, Gazi Babë, Strugë, Shtip, Radovish dhe Makedonski Brod. Ndërkaq, ka edhe këshilla komunalë të formuar, por të cilët gjatë vitit 2015 nuk kanë funksionuar, në komunat: Kumanovë, Ohër, Karposh, Butel, Kisela Vodë dhe Gjorçe Petrov (Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF, 2016). Në komunat e tjera këshilla për parandalim të delikuencës së fëmijëve ende nuk janë formuar, edhe përkrah obligimit ligjor të përcaktuar në nenin 158 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve.

Mendoj se Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve duhet të ndermarrë masa më intenzive përmes të cilave do të nxiste komunat të cilat nuk kanë themeluar Këshilla komunalë për parandalim të delikuencës së fëmijëve që t'i themelojnë të njejtit. Pasi që deri më tani masat të cilat janë ndërmarrë nga Këshilli shtetëror në këtë drejtim janë treguar relativisht të pasuksesshme, që rezulton vetëm me 8-të këshilla komunale funksionalë për vitin 2015, duhet bërë ndryshime në strategjinë e punës në këtë drejtim. Komunat duhet ta përmbushin detyrimin ligjor i cili rrjedh nga neni 158 i LDF dhe t'i emërojnë këshillat për parandalim. Këto këshilla normalisht se do të ishin shumë më efikas në punën e tyre drejtë parandalimit të delikuencës së fëmijëve, duke marrë parasyshë rrethin e fëmijëve të targetuar që do të jetë më i vogël në kuadër të secilës komunë në krahasim me atë që e disponon Këshilli Shtetëror për parandalim në nivel nacional. Nëse problemi i kësaj ngecjeje qëndron në sigurimin e mjeteve financiare për funksionimin e këtyre këshillave komunalë, mendoj se komunat duhet ta planifikojnë edhe këtë aktivitet Planin për Buxhetin e tyre vjetor.

PJESA E TRETË

METODIKA E ZBULIMIT DHE SQARIMIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE

Kapitulli VII

7. SPECIFIKAT E ZBULIMIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE

7.1. Zbulimi i delikuencës së fëmijëve

Për zbulimin e delikuencës së fëmijëve, respektivisht veprave penale të cilat kryhen nga fëmijët organet e ndjekjes zbatojnë metoda të ndryshme për zbulimin dhe provimin e tyre. Meqenëse kriminaliteti i fëmijëve paraqet tërësinë e veprave penale të kryera nga personat nën moshën 18 vjeçare, në praktikë ndodh që fëmijët të paraqiten si kryes të veprave të ndryshme penale. Nga të dhënat statistikore të publikuara nga Enti shetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë (të paraqitura në pjesën e katërt të këtij punimi) rezulton se fëmijët në praktikë paraqiten si kryes të shumicës së veprave penale të parapara me Kodin penal, edhe pse me numër të theksuar tek ato kundër pasurisë.

Është e pamundur në këtë punim të trajtohen metodat kriminalistike për zbulimin e të gjitha llojeve të veprave penale të cilat i kryejnë fëmijët, prandaj në vazhdim, do të trajtohen metodat për zbulimin e veprave penale të cilat më së shpeshti kryhen nga fëmijët, respektivisht do të sqarohet metodika e zbulimit të disa veprave penale kundër pasurisë. Poashtu, do të paraqiten disa specifika për zbulimin e fëmijëve delikuentë, të cilat paraqesin kusht të patjetërsueshëm për zbardhjen e çështjeve penale në përgjithësi, e posaçërisht kur në ato raste janë të përfshirë fëmijë, respektivisht karakteristiakat që lidhen me kriminalitetin e fëmijëve dhe rrethanat e kryerjes së tij, siç janë vendi i kryerjes së veprës penale, koha, mënyra, mjeti, motivi, rrethi i fëmiut etj.

7.2. Karakteristikat e fëmijëve kryes të veprave penale dhe taktika e zbulimit të tyre

7.2.1. Koha e kryerjes së veprave penale të kryera nga fëmijët

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të dukurisë së delikuencës së fëmijëve është koha e kryerjes së veprës penale. Përcaktimi i kohës së kryerjes së krimit ka rëndësi për këto shkaqe:

- Për përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe për zbatimin e sanksionit penal është vendimtare mosha e kryesit në kohën e kryerjes së veprës;
- Vjetërsia e ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga koha e kryerjes së veprës penale;
- Përgjegjësia për veprën penale përcaktohet sipas Kodit penal, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale;
- Koha e kryerjes së veprës ka rëndësi edhe tek ato vepra penale, te të cilat koha e kryerjes është edhe karakteristikë e veprës penale (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Derisa te përcaktimi i vendit të kryerjes është e mundshme që si vend i kryerjes të konsiderohet qoftë vendi i veprimit, qoftë vendi i pasojës dhe rëndësia e njejtë të njihet për të dyja këto vende, nuk mund të veprohet kur është fjala për përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale. Këtu është e domosdoshme të përcaktohet vetëm një moment, koha e veprimit ose koha e pasojës (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982). Në rastin e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penal, e gjithashtu, krahas pasojave juridike dhe penale, mund të planifikohen në masë të madhe edhe masat përkatëse të parandalimit dhe luftimit të veprës penale të fëmijëve. Për analizën komplete të delikuencës së fëmijëve si dukuri, është shumë e domosdoshme të regjistrohet koha, në të cilën më së shumti kryhen veprat penale në tërësi, e në veçanti të atyre të kryera nga fëmijët. Përcaktimi më i përafërt i kohës (ora, dita, muaji) së kryerjes së veprës është një e dhënë që mund të ketë në mënyrë globale, jo vetëm rëndësi preventive kriminologjike, por edhe kriminalistike (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Nga aspekti i metodikës së zbulimit të delikuencës së fëmijëve, janë bërë hulumtime shumë të rëndësishme të kohës, mënyrës dhe vendit të kryerjes së veprës penale nga fëmijët, me ç'rast: Te fëmijët delikuentë vërehet se numri më i madh i veprave penale janë të kryera verës (qershor-gusht), që do të thotë kanë ndodhur pas kryerjes së mësimeve dhe në kohën e pushimeve verore! (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982). Konstatoj se caktimi i këtyre karakteristikave, si koha e kryerjes së veprës penale, vendi, mënyra etj., paraqet patjetërsueshmëri për zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit të fëmijëve.

7.2.2. *Vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale të fëmiut*

Sipas Prof. Latifi, kur është fjala për vendin e kryerjes së veprës penale të fëmiut, është e nevojshme përveç tjerash, të planifikohen çështjet dhe masat për vërtetimin e tyre, si: Territoret se ku është kryer vepra; Lokacioni se ku është kryer vepra (qyteti, fshati apo ndonjë terrritor tjetër); Vendi më i afërt ku gjendet objekti i atakuar; Precizimi i pjesës së objektit të sulmuar (dhoma, zyra, stacioni etj.). Lidhshmëria e zbulimit të veprave penale të fëmijëve është zinxhirore dhe lidhet mes të tjerash edhe me rrethanën e mënyrës së kryerjes së veprës penale. Me ç'rast, në bazë të përcjelljeve ekzistuese analitike e kriminalistike të kriminalitetit të fëmijëve, është vërtetuar se ata nuk ndryshojnë shumë sipas llojit të veprave të kryera penale, sipas mënyrës së kryerjes dhe organizimit të grupeve në kryerjen e disa veprave penale, në krahasim me kategoritë e tjera të kryesve (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Ka rëndësi shumë të madhe kriminalistike se a do të realizohet në grupe vepra penale e kryer nga fëmijët apo në mënyrë individuale, përkatësisht ç'farë shoqërizimi bëhet dhe cila mënyrë është për veprat penale. Krahas oscilimeve të kohëpaskohshme, tendenca e rritjes së numrit të veprave penale të kryera në mënyrë të shoqëruar të fëmijëve është e shprehur qartë. Kështu, për shembull, në sjelljet delikuente dhe kriminale të të rinjëve paraqiten edhe bandat e të rinjëve (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Duke marrë parasyshë se numri më i madh i veprave penale në masën e kriminalitetit të fëmijëve bëhet ndaj delikteve pronësore, në vazhdim do të trajtohet mënyra e kryerjes së këtyre veprave penale nga fëmijët. Me rëndësi është të theksojmë se, në varësi nga ndërtimi i sistemit të veprave penale kundër pasurisë, mund të jepet edhe përkufizimi i tyre: "Me vepra penale kundër pasurisë së personave fizikë, të personave juridikë dhe të shtetit, kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) që shfaqen në marrjen, hedhjen në dorë ose kthimin e saj në mënyrë të kundërligjshme, të kryera me dashje dhe me qëllim për të mos e kthyer më e për të nxjerrë përfitim material për vete ose në dobi të personave të tjerë, si dhe në shkatërrimin ose dëmtimin e saj" (Elezi, 2002).

Në vazhdim do të paraqesim veprat penale kundër pasurisë shoqërore dhe private, që i kryejnë fëmijët. Bazuar edhe në të dhënat statistikore zyrtare mbi kriminalitetin e fëmijëve

të vendit tonë (të paraqitura në pjesën e fundit të këtij punimi), mund të konstatojmë se gjysmën e masës së kriminalitetit të fëmijëve e paraqet pikërisht ky lloj i kriminalitetit – kundër pasurisë. Prandaj, jo vetëm nga pikëpamja e ndarjes së këtyre veprave penale nga aspekti juridiko-penal në Kodin penal – që edhe është trajtuar në pjesën e lartëpërmendur, por këtu do të analizohen format e manifestimit të tyre nga pikëpamja e metodikës kriminalistike.

Sipas kodit penal të vendit tonë, në grupin e veprave penale kundër pasurisë, bëjnë pjesë: Vjedhja, Vjedhja e rëndë, Grabitja, Vjedhja grabitqare, Evazioni, Shërbimi, Marrja e sendeve të huaja, Marrja e automjetit motorik, Dëmtimi i sendit të huaj, Mashtrimi, Mashtrimi i konsumatorëve, Keqpërdorimi i besimit, Reketi, Shantazhi, Fajdeja etj. (nenet 235-263).

7.2.3. Taktika e zbulimit të delikteve pronësore:

Format themelore të delikteve pronësore nga aspekti i ***taktikës së posaçme*** janë:

a) Marrja e gjësendeve të huaja të patundshme;
   - Pa përdorimin e mjeteve për thyerje (vjedhja, vjedhja e rëndë dhe pjesët e imta të vjedhjeve, fshehja dhe mashtrimi),
   - Me anë të mjeteve për thyerje (vjedhjet e rënda nëpërmjet thyerjes ose shpërthimit të ndërtesave të mbyllura, të dhomave, kasafortave, dollapërve ose të ndonjë sipërfaqeje të mbyllur),
   - vjedhjet nga xhepa, ose vjedhjet e tjera të rrezikshme, që bëhen në mënyrë shumë të rrezikshme ose të ashpra- nëpërmjet përdorimit të fuqisë apo kërcënimit (vjedhja grabitqare, grabitja);

b) Nxitja për veprim kundër të drejtave dhe interesave personale:
   -me mashtrim,
   - me keqpërdorimin e besimit (përvetësimi, fshehja)
   - me fuqi apo kërcënim (shtrëngimi dhe shantazhi).

c) Rrezikimi i pasurisë
   - Me shërbim (marrja e automjetit),
   - Me dëmtim (dëmtimi i gjësendeve të huaja),
   - Me shkatërrim.

d) Fshehja e sendeve.

e) Vjedhjet pa përdorimin e mjeteve për thyerje janë: Vjedhjet e banesave, vjedhjet e shitoreve dhe të shtëpive të mallrave etj.

f) Vjedhjet me përdorimin e mjeteve për thyerje janë: Thyerjet e banesave dhe të vilave, thyerjet e shitoreve, të kooperativave bujqësore, thyerjet e magazinave, thyerjet e bodrumeve, të vitrinave, kishave, xhamive, postave, mjeteve të transportit etj.

- Nga pikëpamja e metodikës kriminalistike, ***vjedhjet e rëndomta (të zakonshme)*** mund të ndahen në (Latifi, Kriminalistika, 2011, Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):
  - Vjedhje në rast të volitshëm;
  - Vjedhje në banesa;
  - Vjedhje nga oborret, depotë shtëpiake;
  - Vjedhje në zyrë- gjatë ose jashtë orarit të punës;
  - Vjedhjet nga shitoret tregtare;
  - Vjedhjet nëpër ndërmarrje dhe institucione;
  - Vjedhjet nëpër konvikte dhe shtëpi nxënësish;
  - Vjedhje në stacione hekurudhore, të autobusëve, anijeve;
  - Vjedhjet nëpër hotele dhe salla kinemash;
  - Vjedhjet në shtëpi (që i bëjnë banuesit në shtëpitë e tyre);
  - Vjedhjet e biçikletave, motoçikletave;
  - Vjedhje e automjeteve;
  - Vjedhje e armëve dhe eksplozivit;
  - Vjedhje të veprave artistike;
  - Vjedhje të librave;
  - Vjedhjet prej xhepave etj.

- **Vjedhjet me thyerje të pasurisë** mund të hasen në këto lloje si vijon (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):
  - Atakimi i bravave, rezeve dhe drynave,
  - Atakimi i gjësendeve prej druri (dyerve),
  - Atakimi i dritareve, vitrinave dhe i rrjetave,
  - Atakimi i plafonave dhe pullazeve,

- Atakimi i kasafortave dhe i trezorëve.

Këto vepra penale kundër pasurisë realizohen me këto metoda (Latifi, Kriminalistika, 2011): Me anë të thyerjes së pengesave ku ruhet pasuria, me anë dokumentesh të falsifikuara nga një person i jashtëm, me dhunë ndaj personave që e kanë nën dorësi ose e ruajnë pasurinë nga personat e jashtëm. Vjedhja më e njohur është vjedhja me thyerje.

Sikurse edhe te personat madhorë, mënyrat më të shpeshta të vjedhjeve me thyerje të fëmijëve janë (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):

- Hyrja në lokal me ndihmën e çelësit të ngjashëm apo të rrejshëm,
- Nxjerrja nga vendi dhe thyerja e dyerve me ndihmën e lozave të metaltë dhe mjeteve të tjera,
- Thyerja e derës me fuqi fizike,
- Thyerja e dritares (xhamit të saj),
- Thyerja nëpërmjet gërmimit të murit,
- Hyrja në lokal duke hequr tjegullat,
- Hyrja në lokal duke thyer tavanin,
- Thyerja e vagonëve duke hequr dërrasat,
- Thyerja e sirtarëve, dollapërve, pakove si dërgesa postare etj.

Zbulimi i sa më shumë të dhënave, gjurmëve, provave materiale, duke përdorur metoda e mjete tekniko-shkencore në hetimin e vjedhjeve me thyerje, merr një rëndësi të veçantë. Çështja penale fillon: kur zbulohet vendi i thyerjes, kur zbulohen sendet e vjedhura, kur bëhet kallëzimi nga personi me përgjegjësi materiale për sendet që janë vjedhur, kur bëhet kallëzimi nga persona që kanë parë ose që kanë zbuluar të parët vjedhjen, kur ka të dhëna nga organet e rendit publik. Në bazë të këtyre materialeve kryhen veprimet e para hetimore dhe veprime të tjera siç janë (Latifi, Kriminalistika, 2011):

- Këqyrja e vendit të ngjarjes;
- Pyetja e dëshmitarëve të parë;
- Kontrollimi në banesat e personave që dyshohen;
- Pyetja e të ndaluarit kur është kapur në flagrancë me sendet e vjedhura;

- Ekspertimi i gjurmëve të thyerjes ose i gjurmëve të tjera që janë lënë gjatë hyrjes dhe daljes;
- Ekspertimi mjeko-ligjor i viktimës, kur vjedhja është kryer me dhunë ose armë dhe kur asaj i janë shkaktuar plagë;
- Pyetja e personit të dëmtuar kur e lejojnë kushtet;
- Kërkimi i sendit të vjedhur;
- Caktimi i inventarizimit të depos, të magazinës, të objektit ku është kryer vjedhja etj.

Në vjedhjet me thyerje, këqyrja e vendit të ngjarjes është veprimi i parë hetimor. Me anë të saj organi procedues përcakton drejtimin që do të marrë hetimi, zbulon e fikson gjurmët e provat materiale, studion mekanizmin e kryerjes së vjedhjes, ngre versionet përkatëse hetimore, sidomos versionin kryesor, se cili mund ta ketë kryer këtë vjedhje në bazë të gjurmëve e provave materiale të lëna në vendet e ngjarjes. Këqyrja përfshin jo vetëm ndërtesën ku është kryer vjedhja, por edhe vendin e hapët (Latifi, Kriminalistika, 2011).

Për zbulimin e vjedhjes me thyerje, hetuesi synon t'i sqarojë këto rrethana: Mënyrën e futjes së fajtorit në vendin e vjedhjes; mënyrën e veprimit të fajtorit në vendin e vjedhjes; mënyrën e nxjerrjes dhe transportimit të sendeve të vjedhura. Një vëmendje e posaçme i kushtohet edhe problemit nëse bëhet fjalë për një inskenim (simulim) të vjedhjes (Latifi, Kriminalistika, 2011).

Përveç këqyrjes së vendit të ngjarjes, si veprim i parë hetimor për sigurimin e provave materiale, veprim tjetër i rëndësishëm për zbardhjen e çështjes është edhe gjurmimi ndaj provave personale dhe dëshmive të dëshmitarëve si dhe deklaratat e të dëmtuarit/ve apo të dyshuarit/ve.

Në vjedhjet me thyerje, ***dëshmitarët*** e parë janë dëshmitarët që e kanë parë ose e kanë zbuluar ngjarjen. Pyetja e dëshmitarëve, po të ketë mundësi, të ndihmojnë për t'i përcaktuar masat operative ndjekëse sa më shpejtë!... Poashtu, kur personi është ndaluar duke vjedhur (në flagrancë) ose menjëherë pas kryerjes së vjedhjes, ***pyetja*** e tij, ***verifikimi i thënieve*** dhe ***kontrollimi*** ndihmojnë për të mbledhur material provues të mjaftueshëm për fajësinë e tij

dhe për të sqaruar nëse ai merret në mënyrë sistematike me veprimtarinë kriminale (Latifi, Kriminalistika, 2011).

7.3. Metodika e sqarimit të disa veprave penale kundër pasurisë

7.3.1. Vjedhjet nga xhepat:

Në grupin e vjedhjeve të xhepave dhe vjedhjeve të tjera të rënda dallojmë vjedhjet individuale dhe të përbashkëta të xhepave. Kjo formë e veprave penale është zakonisht e theksuar tek fëmijët. Kurse te vjedhjet me përdorimin e forcës ose kërcënimit janë karakteristika të banditëve në rastet e vjedhjeve grabitqare, kur ato kryhen në grupe nga ana e fëmijëve. (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Në masën e veprave penale që i kryejnë fëmijët përqindja më e madhe ka të bëjë edhe me vjedhjet e xhepave. Ndër të gjithë kriminelët profesionistë, "xheparoshët" dallohen me mënyrën specifike të jetës dhe psikologjinë e tyre. Të hollat e fituara lehtë, poshtu lehtë i shpenzojnë. Sipas mënyrës së kryerjes mund të caktohen disa forma dhe metoda të atakimeve të vjedhjeve të xhepave, të cilat i kryejnë fëmijët (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):

a) Atakimi i xhepit të epërm e të jashtëm,
b) Vjedhjet nga xhepi i jashtëm,
c) Vjedhja nga xhepi i sprasmë i pantallonave,
d) Vjedhjet nga xhepi i jashtëm i sakos, palltos ose bluzës,
e) Atakimi në xhepin e brendshëm të sakosë.

Vjedhësi i xhepave para se të futet në tollovi zgjedh me kujdes të madh viktimën e pastaj e shikon mirë terrenin. Kur të vërtetohet se nuk ka afër persona zyrtarë, ai e kërkon viktimën. Po që se punon në xhepin e jashtëm, për ndryshim nga kryesi madhorë (i cili e mbanë mbi dorë mantelin, çantën e dorës, cilindrin, librin etj.), fëmijët në vend të këtyre sendeve e nxjerrin dorën e tyre të dytë (të majtën ose të djathtën), varësisht prej asaj me të cilën "operojnë" (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Zbulimi, sidomos të provuarit e vjedhjeve nga xhepat është punë shumë e vështirë, sepse te këto vjedhje nuk ka kurfarë gjurmësh. Për këtë arsye, më së miri është zënia e kryesit në kryerje të veprës në flagrancë ose të gjenden tek ai sendet e vjedhura. Kryesit e vjedhjeve nga xhepat më shpesh veprojnë në grupe, nga disa sish bashkë (Latifi, Kriminalistika, 2011). Kështu për shembull, kur grupi prej 4-5 fëmijësh niset për në punë në stacionin e trenit, apo në tren, në mesin e tyre është e caktuar në mënyrë precize se çka duhet të punojë secili syresh. Njëri ka për detyrë të gjejë viktimën, e cila ka sasi të mëdha të hollash dhe të vërtetojë se në cilin xhep i mban ato. Për këtë e njofton "kryesorin", i cili pastaj ka detyrë ta nxjerrë portofolin nga xhepi i tij. Sipas rregullit, personi i tillë është më i afti prej tyre, e shpeshherë është person madhor. Kur kryesi ta ketë gjetur viktimën, atëherë të gjithë antarët e grupit i'a nisin punës. Këtu dallojmë personat që quhen: "kryesi", "mbuluesi", "bartësi" etj. (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982), (Latifi, Kriminalistika, 2011).

7.3.2. Grabitja (Vjedhja me dhunë dhe vjedhja me armë)

Grabitja paraqet vepër penale më të rëndë kundër pasurisë. Kjo paraqet vjedhje të pasurisë të shoqëruar me përdorim dhune nga ana e kryesit. Grabitësi përdor dhunë, tortura, vrazhdësi dhe mizori të ndryshme, por shpesh herë edhe e vret personin që ta paaftësojë për rezistencë e pastaj vjedh në dëm të tij (Latifi, Kriminalistika, 2011).

Veprimet hetimore për zbulimin e grabitjeve dhe grabitqarëve në përgjithësi, të cilat vlejnë edhe për ata fëmijë, sipas prof. Latifit janë këto si në vijim:

- Identifikimi i personave;
- Përcaktimi i identitetit është aktivitet operativ–taktik dhe teknik i cili ndërmerret gjithmonë kur paraqitet dyshimi në identitetin e personit të caktuar fizik. Identiteti përcaktohet me metodat e taktikës dhe teknikës kriminalistike. Vërtetimi i identitetit të personit të caktuar nuk mjafton të bëhet vetëm në bazë të disa karakteristikave, por ai është i padyshimtë dhe i sigurt vetëm atëherë kur për personin e tillë vërtetohen të gjitha ato cilësi me të cilat personi fizik dallohet nga cilido person tjetër. Këto veti apo cilësi mund të sistemohen në tri grupe themelore, siç janë: a. *Vetitë juridike* (emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, shtetësia, gjendja martesore, vendbanimi, vendqëndrimi, dhe ndryshimet gjatë jetës);

b.*Vetitë faktike* (dita, muaji dhe viti i lindjes, vendi i lindjes, kombësia, numri i amzës, i cili është i pandryshueshëm) c. *Vetitë fizike* (vetitë trupore dhe gjinia, përshkrimi personal, shenjat e gishtërinjve) (Korajlić, 2007).

- Verifikimi i indicjeve – verifikimi i alibisë së të dyshuarit;
- Evidentimi i të dhënave në evidencën MOS;
- Këqyrja në detaje e vendit të ngjarjes, e rrethinës së afërt dhe më të largët;
- Të përcaktuarit e drejtimit të arritjes dhe largimit të grabitësit;
- Fiksimi i gjurmëve dhe i sendeve nga: kacafytja eventuale në vendin e ngjarjes, gjurmëve të mjeteve të kryerjes dhe përcaktimi ç'ka është marrë;
- Zbulimi i gjurmëve – të kryesit, veshjes së tij, mënyrës së mbajtjes dhe manipulimit me mjetet e kryerjes:
- Pyetja e dëshmitarëve;
- Këqyrja mjekësore e lajmëruesit (viktimës);
- Eksperimenti dhe ekspertimi kriminalistik.

Poashtu, për zbulimin e kryesve (fëmijë dhe madhorë) të vjedhjeve me dhunë dhe vjedhjeve me armë zbatohen kryesisht këto masa operative- taktike: Pritat, raciet, zënia e kurtheve, përcjellja e personave të dyshimtë (observimi special i shokëve dhe farefisit të të dyshuarit), vëzhgimi i fshehtë i vendeve të caktuara, shpallja e qarkores dhe letërrreshtimit për sendet e vjedhura, kontrollimi mbi shitjen e sendeve të vjedhura, kontrollimi i mjeteve të transportit dhe i stacioneve të ndryshme për kërkimin e sendeve të vjedhura ose personat e dyshuar (Latifi, Kriminalistika, 2011).

Në vazhdim, po paraqesim kuptimin mbi disa nga këto masa operative- taktike të lartëpërmendura, sipas autorit Korajlić, në librin e tij „Taktika kriminalistike" (Korajlić, 2007):

- **Observimi special** është veprimi kriminalistik-taktik i mbledhjes së fshehtë të informatave me anë të metodës së perceptimit personal. Ky observim ka të bëj me vëzhgimin e fshehtë , mbikëqyrjen dhe përgjimin e personave të caktuar, automjeteve, objekteve dhe lokaleve apo hapësirave me qëllim të realizimit të pamjes dhe

mbledhjes së informatave për gjendjen kriminale, aktivitetet dhe për identitetin e atyre të cilët mbikëqyren.

- **Prita (Pusia)** është veprim i organizuar kriminalistik taktik, gjegjësisht vëzhgim dhe mbikëqyrje e fshehtë e hapësirës dhe objektit me qëllim të zbulimit dhe arrestimit të kryesit të veprës penale. Për suksesin e pritës është me rëndësi që kriminalistët t'i përmbahen parimit kriminalistik të shpejtësisë apo urgjencës, të befasisë dhe konspiracionit "fshehtësisë". Duke pasur parasysh qëllimin dhe detyrën, pusia mund të ketë njëkohësisht karakter represiv dhe preventiv, ashtu që befasia dhe konspiracioni ta përbëjnë esencën e pusisë. Konspiracioni është i rëndësishëm gjatë përgatitjes së pritës, kurse përbëhet para së gjithash nga vëzhgimi i fshehtë dhe vrojtimi i vendeve ku vendoset pusia, verifikimi i fshehtë i personave interesant, dhe gjithsesi puna e fshehtë e ç'do polici veç e veç. Me rastin e vendosjes së pritave dhe të qëndrimit në pritë konspiracioni duhet të jetë në nivelin më të madh të mundshëm, sepse në të kundërtën pusia nuk do të jetë efikase.
- **Përcjellja** paraqet masën dhe aktivitetin operativ taktik që ka të bëjë me ndjekjen e fshehtë të personave të caktuar gjatë lëvizjes, si dhe me monitorimin diskret të atyre personave me qëllim të perceptimit dhe të regjistrimit të të gjitha rrethanave që janë të rëndësishme për ndriçimin e veprës konkrete penale. Këtë aktivitet zakonisht e realizojnë personat e autorizuar zyrtarë, kurse më së shpeshti e kryejnë me qëllim të ndriçimit të veprave të rënda penale dhe të zbulimit të kryerësve të tyre si dhe të pjesëmarrësve në veprën e kryer, sidomos kur është fjala për kryesit të cilët kanë vepruar në mënyrë të organizuar, të lidhur në grupe apo në organizata tjera kriminale.
- **Racia** paraqet aksion të rrufeshëm policor me të cilin ndërmerret bllokada e thuktë e vendeve dhe sipërfaqeve më të mëdha (blloqeve të ndërtesave, shesheve, rrugëve etj), me qëllim të identifikimit të të gjithë personave të hasur në atë vend dhe të arrestimit të të dyshuarve që hasen aty ose të kategorisë të caktuar të njerëzve siç janë prostitutat, kontrabandistët, tregtarët ilegal etj.

  Racia, si formë e reagimit të personave të autorizuar zyrtar më së shpeshti ndërmerret dhe drejtohet kundër kryesve të pa caktuar dhe të pa njohur, por për të

cilët egzistojnë bazat e dyshimit ose dyshimi i bazuar se janë pjesë e grupit të njohur kriminal. Racia ndërmerret në bazë të informatës se në vendin e caktuar, rregullisht, shpesh ose në një kohë te zakonshme takohen ose gjendën persona të kërkuar. Është me rëndësi që për zhvillimin e racias të gjendet koha kur, me siguri, të gjithë personat e kërkuar, ose shumica e tyre do të jenë së bashku.

7.4. Mjetet më të shpeshta që i përdorin fëmijët për kryerjen e veprave penale

Në rastet e numrit më të madh të delikteve pronësore fëmijët i përdorin mjetet përkatëse për kryerjen e tyre. Varet prej shumë faktorëve se cilat mjete për kryerje do të përdoren. Mënyra e kryerjes së veprës penale nga ana e fëmijëve zakonisht është më primitive, në krahasim me mënyrën e kryerjes së këtyre veprave nga ana e personave të rritur, pa pregaditje të mjaftueshme, e rrallë herë me aplikimin e almiseve. Fëmijët shpesh i përsërisin veprat penale në të njejtin vend dhe në të njejtën mënyrë. Megjithë këtë, nga praktika e deritanishme kriminalistike e organeve të punëve të brendshme dhe njohuritë e tjera, mund të përmenden mjetet më të shpeshta për kryerjen e veprave penale nga fëmijët (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):

- Kaçavidhat;
- Darët;
- Darët e kombinuara;
- Llozët e ndryshëm metalikë të dorës;
- Thikat automatike (thikat patent dhe kamat);
- Mjetet metalike të mprehta dhe me maje të formatit të xhepit;
- Kamat me tehe të njëanshme, të dyanshme;
- Më rallë revolet;
- Edhe më rrallë materiet ekplozive (bombat, dinamiti etj.);
- Lozët e drunjtë;
- Litarët etj.

Ka raste kur disa nga almiset për thyerje shfrytëzohen edhe te veprat penale kundër jetës dhe trupit, zakonisht në situatat e rezistencës ose në rastet e rrahjve e të tjera (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

7.5. Mbikqyrja e përforcuar dhe kontrolli lokal

Mbikqyrja e përforcuar ndaj disa kategorive të delikuentëve është sistem i veprimtarisë operative të organeve të punëve të brendshme të karakterit preventiv-represiv, që ka të bëjë me disa kategori të caktuara të delikuentëve (kriminelët ndërkombëtarë, recidivistët e shumëfishtë, profesionalistët etj.), të cilët përshkak të rrethanave të caktuara dhe të vetive të tyre, në masë të madhe rrezikojnë sigurinë publike në kuptimin më të gjërë të fjalës. Qëllimi i mbikqyrjes dhe kontrollit të përforcuar është që nga ana e organit të punëve të brendshme të mundësohet mbikqyrja e plotë e veprimtarisë së personave të dhënë pas kriminalitetit dhe në kohën kur ato banojnë jashtë vendbanimit apo vendqëndrimit të tyre. Në këtë mënyrë krijohet mundësia më e madhe për zbulimin e tyre kur aktivizohen përsëri në kryerjen e veprave penale ose që në kohë të duhur të pengohen nga veprimtaritë e palejuara (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Duhet të plotësohen kushtet e caktuara në mënyrë që personi përkatës të mund të vihet nën mbikqyrjen e përforcuar të organeve të punëve të brendshme. Në këtë rast, sipas Prof. Dr. Latifi, vijnë në konsiderim kryerësit e atyre veprave penale te të cilët përsëritja dhe veprimi në territorin e gjërë është i rregullt dhe në të cilat kryerje shprehet profesionalizmi dhe specializimi. Nga aspekti i praktikës, bëhet fjalë për vjedhësit e xhepave, për kryerësit e shumëfishtë të vjedhjeve të rënda, për thyesit e kasafortave, për mashtruesit profesionalë ose "shfercerët", për falsifikuesit e të hollave, të letrave me vlerë dhe dokumentave të qarkullimit, për tregti me lëndë narkotike e të tjera (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Fëmijët delikuentë janë burim i përhershëm nga të cilët rekrutohen kriminelët, bile ata të rrezikshmit, kriminelët profesionalë, që paraqesin rrezik të veçantë shoqëror në shtëpitë edukuese përmirësuese, sepse ata realisht kanë filluar mirë të ecin rrugës së kriminalitetit. Personat e tillë të lëshuar nga shtëpitë edukuese përmirësuese dhe nga burgjet për të mitur, paraqesin rrezik potencial, andaj duhet domosdo të evidentohen dhe ndaj tyre duhet të ushtrohet kontroll rigoroz, për të përcjellë lëvizjet dhe sjelljet e tyre (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

7.6. Njohja e mjedisit të fëmijëve si kusht për zbulim

Në kuadër të ndërmarrjes së të gjitha masave të nevojshme në planin e zbulimit të fëmijëve dhe të veprave të tyre penale, kriminalisti do të duhej të përpiqej që sa më parë dhe sa më mirë ta njohë mjedisin e fëmiut. Për shkak të moshës së tij dhe specifikave të tjera të kryesve nga rradhët e të rinjve, shumë përshtypje, manifestime, ose indikacione gjenden edhe në mjedisin, nga i cili vjen, ose në të cilin gjendet fëmiu (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982). Në rastet më të shpeshta fëmijët delikuent në pjesën më të madhe kryejnë vepra penale në vendin e tyre të banimit, ose edhe në afërsinë e drejtëpërdrejtë. Ata, zakonisht, i fillojnë deliktet me vjedhje të imta, madje në të shumtën e rasteve në gjirin familjar, te të afërmit ose te të njohurit, e më pastaj jashtë këtij rrethi, por gjithsesi në rastet më të shpeshta në vendbanimet e tyre, kurse në fillim të karrierës edhe në afërsi të vendit ku tubohen. Për të kuptuar në mënyrë të gjithanshme mjedisin e fëmiut, ndër të tjera, është e nevojshme (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):

- Të merren në pyetje personat e tjerë mbi personalitetin e fëmiut,
- Të kontaktohet me fqinjët e tij,
- Të kontaktohet me shokët e tij të shkollës, po që se ka vazhduar shkollën, ose e vazhdon,
- Me ata të vendit të punës, po që se ka qenë, ose është i angazhuar me punë.

Prandaj, nga e gjithë kjo që u tha më lartë, mjedisi i fëmiut duhet të merret parasysh si rrethanë në kuadër të të gjithë treguesve të tjerë, kur ndërmerren masat përkatëse për zbulimin dhe luftimin e delikuncës së fëmijëve.

KAPITULLI VIII

8. AKTIVITETI I POLICISË NË ZBULIMIN DHE TË PROVUARIT E KRIMEVE TË KRYERA NGA FËMIJËT

8.1. Shërbimet e specializuara për zbulimin e kriminalitetit të fëmijëve

Policia e specializuar për luftimin e delikuencës së fëmijëve është një formë e zgjidhjes së këtij problemi, me të cilën janë shërbyer shumë polici, por edhe që ka dhënë rezultate. Duke shfrytëzuar numrin e madh dhe përhapjen e policisë, teknikën e saj dhe mundësitë e tjera, janë formuar aradhat e specializuara ose referada që merren me delikuencë dhe dukuri të tjera negative të rinisë. Këta punëtorë të specializuar rekrutohen nga radhët e punëtorëve socialë dhe pedagogjikë apo që e kryejnë shkollimin plotësues, në të cilin, përveç njohurive të përgjithshme policore, krijojnë edhe njohuri të nevojshme pedagogjike, psikologjike dhe sociale. Duke menjanuar vetë shkaqet e delikuencës së fëmijëve, policia preventive e zhduk në masë të dukshme kriminalitetin, i cili nesër do të mund të ishte kriminalitet i të rriturve, e së këndejmi edhe shumë më i rrezikshëm (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982) .

Sipas Ligjit mbi policinë të Republikës së Maqedonisë, autorizimet policore ndaj personave jomadhorë i zbatojnë nëpunësit policor të cilët janë të trajnuar posaçërisht për luftimin e delikuencës së fëmijëve. Në raste të përjashtimit, autorizimet policore ndaj fëmijëve mund ti ndërmarrin edhe zyrtarë të tjerë policor nëse për shkak të rrethanave të rastit nuk mund të veprojnë zyrtarët policor të trajnuar posaçërisht në këtë drejtim. Ndërsa, autorizimet policore ndaj fëmijëve zbatohen nën kushtet e përcaktuara me ligj të posaçëm (n.37), respektivisht me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve. Aktiviteti i shërbimit të specializuar që punon në zbulimin e kriminalitetit të fëmijëve në kuadër të organeve të punëve të brendshme ka karakter të theksuar preventiv.

Me këtë qëllim ato studiojnë në mënyrë sistematike rrethanat dhe gjendjet në këtë lëmi, kontrollojnë vendet e rrezikimit të mundshëm dhe të rrezikuar (kafenetë, baret, sallat e vallzimit, kinematë, stacionet, bazenet e të tjera, përcjellin punën e disa individëve dhe të

grupeve negative, bashkëpunojnë ngushtë me shërbimin social dhe me organizatat shoqërore etj. (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

8.2. Taktika e pyetjes së fëmijëve

Si edhe ç'do deklaratë tjetër, ashu edhe dëshmia e fëmijës mund të vlerësohet si e saktë dhe jo e saktë, e pa vërtetë dhe e rrejshme (Sahiti, 1993). Edhe pse edhe fëmijët e moshave më të reja mund të paraqiten si dëshmitarë, edhe atë dëshmitarë të çështjeve të rënda penale, sidomos dhunës në familje, vrasjeve, përdhunimeve, maltretimeve, torturës etj. (Avziu, 2015). Taktika e pyetjes së fëmijëve të moshave shumë të reja, i ka specifikat e veta varësisht nga mosha e fëmiut i cili merret në pyetje. Prandaj, në literaturën bashkëkohore kriminalitistike janë veçuar të gjitha specifikat që duhet të kihen parasyshë nga ana e organit procedues i cili e merr në pyetje një fëmijë, të moshës: 2-3 vjet, 3-5 vjet, 5-7 vjet, 7-9 vjet, 9-12, 12-15 e kështu me rradhë.

Në vazhdim të kësaj teme do të trajtojmë çështjet që lidhen me taktikën e pyetjes së fëmijëve në cilësi të dëshmitarëve dhe të pandehurve, duke i vënë theksin pyetjes së fëmijëve të cilët kanë arritur së paku moshën 14 vjeçare.

Adoleshenca-puberteti quhet moshë kririke, e vështirë, moshë delikate sepse vështirësitë e rritjes janë të shumta, ndërlikimi i problemeve që lindin është i shpeshtë, rëndësia e ndryshimeve në jetën e fëmijës është e madhe, koha e zgjidhjes së kundërshtive që shfaqen është e shkurtër, njohja e zhvillimeve të brendshme tek adoleshenti është i pakët dhe reflektimi i kualifikuar e kompetent i të rrituve nuk është në nivelin e duhur. Ndërlikimet shtrohen edhe nga karakteri kalimtar dhe i ndërmjetëm i kësaj periudhe moshore. Vrulli dhe koha e shkurtër e zhvillimeve fizike e fiziologjike, sociale e psikologjike i japin adoleshencës nuancë e karakter spontan e të papritur, shpërthyes e efektiv. Problemet dhe dukuritë që shfaqen në adoleshencë kanë natyrë të ndërlikuar ku ndërthuren e integrohen aspektet fizike e fiziologjike me ato psikike e sociale. Prandaj, pajtohem me qëndrimin e Prof. Dr. Latifi sipas të cilit trajtimi i tyre si kryes të veprave penale ose viktima të krimit duhet t'i ketë parasyshë të gjitha këto fakte dhe procese të zhvillimit të personalitetit të kësaj moshe (Latifi, Kriminalistika, 2011).

8.3. Kushtet për marrjen në pyetje të fëmijëve

Në vazhdim po numërojmë disa veçori të taktikës së pyetjes së fëmijëve nga mosha 14-18 vjeçe, të përcaktuara shumë hollësisht në veprën e cituar "Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimit" të Prof. Dr. Vesel Latifi (në pjesën Taktika e pyetjes së të miturit):

- Taktika e pyetjes së fëmijëve varet nga pozita e tyre procedurale (dëshmitarë ose të pandehur) dhe nga disa veçori psikike që kanë të bëjnë me perceptimin, kujtesën dhe riprodhimin. Edhe pyetja e fëmijëve ka veçoritë e veta psikike, që e dallojnë nga pyetja e të rriturve;
- Pyetja e fëmijëve duhet t'i përfshijë ato rrethana që kuptohen dhe perceptohen nga ata;
- Fëmijët janë përgjithësisht të mirë po të drejtohen dhe trajtohen mirë.
- Organi procedures duhet të pregaditet seriozisht kur pyet dëshmitarë ose të pandehur fëmijë (të mitur);
- Të fitojë besimin e fëmiut;
- Fëmiu ta shoh si mbrojtësin e tij pyetsin. Këto rrethana e lirojnë dhe e bëjnë fëmiun të saktë në shpjegimet e tij;
- Pyetësi duhet vendosur kontakt psikologjik;
- Pyetja e fëmiut (të pandehur ose dëshmitar) nuk duhet të fillojë drejtëpërsëdrejti me pyetjet që i interesojnë organit procedures, por me bisedë të lirë. Kjo e lejon atë të njihet me shkallën e zhvillimit mendor të fëmiut, me veçoritë e psikikës së tij dhe për t'u afruar me të;
- Organi procedures duhet ta pyesë fëmiun hollësisht dhe po qe e mundur, vetëm një herë. Një pyetje e dytë për të njejtat rrethana nuk është e këshillueshme;
- Fëmiu, si rregull, nuk ka mundësi fizike e mendore të përqëndrohet për një kohë të gjatë dhe ti kuptojë e ti riprodhojë me saktësi rrethanat që ka parë ose dëgjuar me rastin e kryerjes së veprës penale (Latifi, Kriminalistika, 2011).

  Veçoritë e pyetjes së fëmiut në cilësi të të pandehurit:
- I pandehuri fëmijë ka frikë të tregojë për bashkëpunëtorët e tij më të mëdhenj se ai.

- I pandehuri fëmijë mund ta marrë përsipër fajin edhe kur bashkëpunëtorët e tij më të mëdhenj e kërcënojnë ose e bindin atë se duke pohuar, do të shpëtojnë nga dënimi shumë i rëndë. Meqenëse fëmiu e kupton shtrembër ndjenjën e shoqërisë, ndonjëherë ai e merr përsipër fajin dhe e konsideron këtë si akt heroizmi (Begeja, Kriminalistika). Prandaj organi procedures është i detyruar të bëjë verifikimet e nevojshme kur ka arsye për të besuar se fëmiu është i pandehur.
- Të pandehurit fëmijë i sigurohet ndihma juridike dhe psikologjike, në praninë e prindit ose personave të tjerë të kërkuar nga fëmiu dhe të pranuar nga organi procedures. Ndihma për fëmiun e pandehur nga një mbrojtës është e detyrueshme.
- Me qëllim që të sqarohet përgjegjshmëria dhe shkalla e përgjegjësisë së fëmiut, organi procedures detyrohet të merr të dhëna për kushtet e jetës personale, familjare e shoqërore të fëmiut. Ai duhet të mbledhë informacione nga personat që kanë pasur marrëshënie me fëmiun dhe të dëgjojë mendimin e ekspertëve.
- Në radhë të parë studiohet personaliteti i fëmiut, marrëdhëniet me prindërit, me arsimtarët, sjelljet në shtëpi, në shkollë, në rrugë, prirjet që ka; kushtet ku punon dhe edukohet; shkalla e zhvillimit intelektual dhe veçoritë e psikikës së tij- përshtypja, kujtesa, vëmendja, ndikimi; fëmijët me të cilët shoqërohet që ndikojnë mbi të; gjendja fizike etj.
- Fëmijët duhet të ftohen të thonë ç'farë dinë vetë dhe jo ç'farë kanë dëgjuar të flitet..
- Organi procedues duhet t'i shikojë thëniet e fëmiut me sy kritik. Ata duhet pyetur menjëherë porsa ka ndodhur vepra penale e kryer, për arsye se fëmiu dëshmitar, me kalimin e kohës e harron atë që e ka parë, ndërsa fëmiu i pandehur nën ndikimin e personave të interesuar, i mohon ose i ngatërron rrethanat e veprës penale.
- Pyetjet që bën organi procedues, pas tregimit të lirë të fëmiut, për të plotësuar, saktësuar ose verifikuar thëniet e tij, duhet të bëhen në formë bisede, me gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të.
- Pyetja nuk duhet të zgjasë më shumë se koha e nevojshme (Latifi, Kriminalistika, 2011). Nëse hetuesi konstaton se fëmiu është i lodhur, duhet ta ndërpresë bisedën dhe ta vazhdojë më vonë. Pyetja me kohë të zgjatur deri në orët e vona është e

dëmshme dhe e papranueshme për të marrë njoftime të sakta prej tij dhe rreziku për të thënë gjëra krejt të paqena është i madh (Begeja, 1999).

- Me rastin e pyetjes së të riut, zbatohet edhe parashtrimi i provave.
- Fiksimi i rezultateve të pyetjes së fëmijëve bëhet me mbajtjen e procesverbalit. (Latifi, Kriminalistika, 2011).

Fëmijët dëshmitarë duhet të pyeten në një mjedis të përshtatshëm për ta, për shembull në shtëpi, në shkollë, ndërsa fëmijët në cilësi të të pandehurit dhe ata fëmijë të një moshe të rritur është e këshillueshme të pyeten në zyrën e organit procedures. Në rast se fëmiu pyetet për një ngjarje që e ka parë, këshillohet që pyetja të bëhet në vendin e ngjarjes. Kjo mënyrë taktike jep rezultate të dyfishta: Nga njëra anë krijohet mundësia për të treguar konkretisht atë që ka perceptuar dhe për t'u kujtuar për hollësitë e ngjarjes, dhe, nga ana tjetër, verifikohet saktësia e thënieve të tij. Para pyetjes duhet vendosur kontakti psikologjik. Nuk mund të jepen udhëzime të caktuara në ç'mënyrë organi do ta vendosë atë. Ai zgjidhet për ç'do rast konkret, për ç'do fëmijë. Për disa fëmijë ky kontakt vendoset lehtë, duke biseduar për shkollën, për filma, për sport, për lojëra etj. Kurse tek të tjerë ky kontakt mund të vendoset me ndihmën e edukatorit ose ndonjë personi të afërt (Latifi, Kriminalistika, 2011).

- Poashtu, njejtë sikur që është e ndaluar për personat madhorë, edhe ndaj fëmijëve të pandehur është e ndaluar që organi procedues të parashtrojë pyetje kapcioze apo sugjestive. Pyetja kapcioze nënkupton formulimin e pyetjes asisoj që me rastin e formulimit të saj, pyetësi niset nga supozimet se i pandehuri ka pohuar diçka që në realitet nuk e ka pohuar. Pyetje sugjestive është ajo pyetje e cila në veti përban përgjigjen (Sahiti E., Zejneli I., 2017).

8.4. Shfrytëzimi i Informatorit

Kur është fjala për organet represive, para së gjithash për policinë, burim i shpeshtë për kryerjen e veprës penale dhe për kryerësin janë personat e besueshëm, lojalët dhe informatorët. Në kuptimin e gjerë fjala "Informator" është nocion përmbledhës kriminalistik – taktik për disa kategori të personave të cilët policia herë pas herë, apo gjithmonë, por

gjithherë fshehurazi, i shfrytëzon për marrjen e informatave të cilat kanë rëndësi kriminalistike, kurse kanë të bëjnë me veprën penale të planifikuar apo të kryer, për kryesit e saj, pjesëmarrësit në vepër etj. Ky institut kriminalistik – taktik është i lidhur për të gjitha llojet e observacioneve speciale të policisë, mbikëqyrjen e fshehtë, vendosjen e kurtheve, etj. Parimisht, ky koncept i gjerë përmbledhës i informatorëve përfshinë: Informatorët, të besueshmit, vigjilentët, provokatorët, hetuesit (zbuluesit) e fshehtë, agjentët e fshehtë (sekret) (undercover agents) etj. Informatorët mund të jenë qytetarë me të meta dhe pa të meta. Pra Informator, në kuptimin e ngushtë është ç'do person i cili është i gatshëm që në bashkëpunim të fshehtë (sekret) me policinë apo organet tjera represive të angazhohet në zbulimin, qartësimin apo evitimin e veprave penale (Korajlić, 2007, f. 63).

Informimi operativ i shërbimit të sigurimit publik mbi aktivitetin e kryesve të veprave penale është parakusht i domosdoshëm për punën e tij dhe angazhimin në luftimin dhe zbulimin e delikuencës së fëmijëve (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982).

Informatorët rradhiten dhe orientohen në atë mënyrë që të sigurojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe urgjente sa vijon (Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, 1982):

- Mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetin kriminal të fëmijëve, sigurimin e dëshmive ose të shënimeve, të cilat e eliminojnë fëmiun nga rrethi i personave të dyshimtë;
- Mbledhjen e të dhënave interesante (relevante) mbi fëmiun dhe grupet e tij;
- Kontrollin e personave të caktuar dhe të punkteve të tyre;
- Krijimin e kushteve për zbatimin e masave dhe të veprimeve operative-taktike;
- Kryerjen e detyrave të tjera konkrete me interes për zbulimin dhe luftimin e delikuencës së fëmijëve.

8.5. Intervistë me punonjëse të policisë lidhur me aktivitetet policore për zbulimin e fëmijëve të dyshuar për kryerje të veprave penale

Intervistën e kam realizuar në dhjetor të vitit 2017 me znj. L.Jakovçevska nga Shkupi. Pyetjet dhe përgjigjet janë të paraqitura në vazhdim:

1. **"Funksioni juaj në MPB"?**

- *"Këshilltar i lartë i policisë për delikuencën e të miturve, dukurive sociopatologjike dhe dhunës në familje;*
- *Anëtar i Këshillit Shtetëror për parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë- Përfaqësues i MPB-së."*

2. **"Cilat janë kompetencat tuaja gjatë ushtrimt të funksionit tuaj si Këshilltare e lartë e policisë për delikuencën e të miturve në MPB?"**

- *" Koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i punës së punonjësve të policisë në të gjitha Sektorët për punë të brendshme, bashkëpunimi me të gjitha ministritë kompetente, organet e institucioneve, personat juridikë që punojnë në fushën e drejtësisë së fëmijëve, bashkëpunimi me përfaqësuesit diplomatikë, ekspertë ndërkombëtarë, komisione dhe organe, MPB jashtë vendit, përgatitja dhe realizimi i trajnimeve, pjesëmarrja në konferenca, në emisione televizive, tribuna të debateve etj."*

3. **"Cili është roli i Këshillit Shtetëror për Parandalim të delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë?"**

- *"Këshilli Shtetëror monitoron nivelin e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2010-2020) në Republikën e Maqedonisë në tri nivele të parandalimit (primar, sekondar dhe terciar) në të gjithë sektorët e përfshirë direkt në mbrojtjen e fëmijëve në rrezik dhe duke dhënë rekomandime për veprim të ardhshëm."*

4. **" Sa është efikas Këshilli Shtetëror në drejtim me obligimet të cilat përshkruhen për punën e tij në nenin 156 të Ligjit për drejtësinë e fëmijëve të vitit 2013?"**

- *"Kompetencat shtetërore të përfshira në nenin 156 të LDF, Këshilli Shtetëror i zbaton plotësisht, gjë që është dëshmuar dhe e paraqitur në përmbajtjet në raportet vjetore të Këshillit, të cilat përgatiten ç'do vit dhe i dorëzohen Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Qeverisë, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe deri më tani të gjithë janë vlerësuar pozitivisht."*

5. "Cili është bashkëpunimi mes oganeve shtetërore me Këshillin Shtetëror? (bazuar në nenin 155 të LDF), Ju lutem shënoni disa raste të bashëpunimit mes këtyre organeve shtetërore?"

- *" Në pajtim me nenin 155 të Ligjit për Drejtësinë e fëmijëve, të gjitha institucionet, organet dhe personat juridikë të listuar janë të detyruar të bashkëpunojnë me Këshillin Shtetëror dhe kjo bëhet duke dorëzuar raporte vjetore në Këshill për punën e tyre me të dhënat e paraqitura përmes treguesve të përgatitur nga anëtarët e këshillit. Bashkëpunimi zhvillohet rregullisht përmes pjesëmarrjes në tryeza të rrumbullakëta, diskutime në panele, projekte të përbashkëta, kërkime, pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të përfaqësuesve nga institucionet kompetente në mbledhjet e këshillit për debat mbi një çështje apo temë specifike dhe të ngjashme."*

6. "Cili është roli i MPB-së në parandalimin e delikuencës së fëmijëve?"

- *"Zbulimi në kohë i fëmijëve në rrezik dhe ndalimi – parandalimi në bashkëpunim me institucionet e tjera kompetente që ai fëmijë të mos kalojë në fëmijë në ndeshje me ligjin."*

7. "Ç'farë masa parandaluese ndërmerr MPB për parandalim të delikuencës së fëmijëve?"

- *" Në Ministrinë e Punëve të Brendshme me sjelljen e Ligjit mbi delikuencën e të miturve 2007 dhe hyrjen në fuqi në vitin 2009, janë formuar departament të veçanta për parandalimin në të gjitha Sektorët për Punë të Brendshme dhe punonjësit e policisë nga këto departamente janë përgjegjëse për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Kërkohet të përgatiten programe vjetore dhe plane për parandalimin dhe luftimin e delikuencës së fëmijëve; realizohen vizita të rregullta në institucionet arsimore- shkollat fillore dhe të mesme; Realizohen bashkëpunime me shërbimet profesionale nëpër shkolla me qëllim të zbulimit të hershëm të fëmijëve në rrezik dhe përmes formave dhe aktiviteteve të tjera.*

Janë mbajtës të një morie projektesh të realizuara me nxënësit, mësuesit dhe prindërit, si p.sh..: Bashkëpunim me të rinjtë në rrezik; Festime të sigurta të diplomimit; Shkolla të sigurta; Sport po, drogë jo; etj. Përfaqësues të MPB marrin pjesë direkt në punën e shumë organeve koordinuese, komiteteve, grupeve punuese etj."

8. "Përshkruani procedurën e zbulimit të fëmijëve kryerës të veprës së rëndë penale nga ana e zyrtarëve të policisë"

- *"Nëse i mituri që ka kryer një vepër penale për të cilin parashihet dënimi për burgim deri në tre vjet, përsëri paraqitet si kryes (recidivist), në këtë rast kallëzim penal dorëzohet tek Prokuroria Themelore Publike, e jo tek Qendra Komunale për Punë Sociale.*

- Të dhënat duhet të jenë të plota, (materiali provues dhe detyrimisht - çertifikata e lindjes).

- *Fëmiu mund të mbahet si i ndaluar nga zyrtarët e autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, vetëm nëse kapet në kryerjen e një vepre të rëndë penale, ose në rast se kundër tij është lëshuar urdhër ose kur kapet në kryerje të një vepre tjetër dhe nëse ekziston rreziku për ta përsëritur apo për ta përfunduar ose kur kapet në kryerjen e vepre tjetër penale në një gjendje që kërkon masa për mbrojtjen e tij ose në qoftë se nuk mund të vërtetohet identiteti i tij.*

Afati i ndalimit të fëmiut është shkurtuar deri në 12 orë, deri në momentin e nxjerrjes së fëmiut para gjykatësit për fëmijë, me ç'rast menjëherë duhet të njoftohet Prokurori Publik, prindërit, mbrojtësi dhe qendra komunale për punë sociale.

Caktohet mbrojtës për fëmiun.

Fëmiu i ndaluar, në afat prej 12 orëve duhet të nxirret para gjykatësit për fëmijë i cili do të vendosë për caktim të paraburgimit ose për lëshim të fëmiut në liri."

9. "Cilat vepra penale i kryejnë më së shpeshti fëmijët?
Bazuar në përvojën tuaj – cilët janë faktorët e rrezikut që i shtyjnë fëmijët deri në delikuencë?"

- *“ Fëmijët janë më së shpeshti të përfshirë në krimet kundër pasurisë (Vjedhjet e rënda, grabitjet dhe vjedhjet grabitqare), si dhe në krimet e dhunës si vepra penale; Krimet kundër jetës dhe trupit; Sigurisë në trafikun publik; Prishja e rendit publik etj.*
- *Rreziqet/faktorët janë:*
- *Rreziqet që paraqiten në baza individuale (veçoritë personale të fëmiut: intelektuale, fizike-biologjike, rreziqet e shëndetit – droga, alkooli, sjellja seksuale etj.),*
- *Në familje (dhunë në familje, familje ekonomikisht të varfëra; familje me probleme asociale; madhësia e familjes etj.),*
- *Arsimimi (mospërshtatja, rezultate të dobëta, jetesa me familje të varfër etj.) dhe*
- *Rrethi (Shoqërimi me fëmijë me sjellje antisociale, stigmatizimet, diskriminimi dhe mohimi nga të tjerët, varfëria, rrethi rural etj.)*
- *Nga shumë analiza të bëra nga ana e MPB-së, është vërtetuar se pjesë e shkaqeve që sjellin deri tek sjelljet delikuente tek fëmijët janë:*
- *Pamundësia për kënaqjen e nevojave bazike të fëmijëve;*
- *Dobësimi i funksionit themelor të familjes;*
- *Vështirësitë në pjekurinë emocionale dhe sociale;*
- *Mungesa e vetërespektit;*
- *Ndikimi negativ i moshatarëve, dëshira për dominim;*
- *Mosrespektimi i autoriteteve;*
- *Si dhe përdorimi i paorganizuar i kohës së lirë – si pjesëmarrja e gjatë dhe e shpeshtë në hapsira të ahengjeve dhe objekteve hotelierike – ku janë të ekpozuar para një numri të madh të ndikimeve negative.”*

10. “Ç’ka do të veçonit lidhur me procedurën e marrjes në pyetje e fëmiut?”

“Funksioni kryesor i Policisë është mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave elementare të qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e vendit, ligjet dhe konventat e ratifikuara nërkombëtare (Konventa për të drejtat e fëmijës). Sipas Ligjit mbi Policinë, striktë është e përcaktuar se autorizimet policore ndaj fëmijëve i zbatojnë zyrtarë të policisë të cilët janë të aftësuar në lëminë e luftimit të kriminalitetit të fëmijëve! Autorizimet policore ndaj fëmijëve sipas rregullit zbatohen në prani të prindit apo kujdestarit të fëmiut, përveç në raste të posaçme apo të urgjencës së veprimit”.

11. "Çka duhet ndryshuar/plotësuar në politikën penale (represive dhe preventive) që të zvogëlohet kriminaliteti i fëmijëve?"

" Para së gjjithash harmonizimi i rregullativës ligjore, sjellja e disa akteve nënligjore, protokolove nënsektoriale, akcenti të vendoset në preventivën e delikuencës së fëmijëve, kurse dispozitat penale ndëshkuese të zbatohen atëherë kur janë shterrur të gjitha zgjidhjet e mundshme paraprakisht, si p.sh.: (masat alternative, zbatimi i mediacionit, mbikqyrja e shtuar dhe masat e entit)."

12. "Koment tjetër rreth temës?":

- *" Kyçja e të gjitha institucioneve relevante të parapara në sistemin e drejtësisë për fëmijë dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes tyre për efikasitet më të madh në zbatimin e procedurave ndaj fëmijëve të parapara me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve.*
- *Ç'do problem mund të zgjidhet nëse vertet për këtë ekziston dëshira. Prej rinisë varet përparimi i bashkësisë tonë prandaj, duhet të reagohet në kohë, në mënyrë të organizuar dhe preventive.*
- *Ç'do shoqëri ka nevojë për rini të shëndoshë dhe të lumtur.*
- *Delikuenca nuk është sëmundje medicinale, por diagnozë sociale, për shkak se delikuentët janë persona të cilët nuk jetojnë në pajtim me normat morale dhe juridike, për të cilin shkak edhe janë përkohësisht ose gjithmonë në konflikt me ligjin."*

PJESA E KATËRT

ANALIZË E SHTRIRJES SË FENOMENIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KAPITULLI IX

9. SHTRIRJA E FENOMENIT TË DELIKUENCËS SË FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË: 2006-2015

Në këtë kapitull janë paraqitur të dhëna mbi numrin e fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar, sipas grupit të veprës penale dhe llojit të sanksionit të shqiptuar gjatë periudhës kohore 2006-2015, bazuar në të dhëna të publikuara nga Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë.

9.1.1. Numri i fëmijëve të paraqitur në Republikën e Maqedonisë: 2006-2015 [49]



Grafikoni 1. (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016, tabela 24).

Grafikoni nr. 1 përmban të dhëna për numrin e fëmijëve të paraqitur gjatë periudhës 2006-2015 në nivel nacional. Këto të dhëna të publikuara nga Enti shtetëror statistikor tregojnë se gjatë vitit 2006 ka pasur gjithsej 1500 fëmijë të paraqitur si të dyshuar për vepra penale, gjatë vitit 2007 gjithsej 1229, gjatë vitit 2008 gjithsej 1355, gjatë vitit 2009 gjithsej 1519,

[49] http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.08Kor.pdf

gjatë vitit 2010 gjithsej 1244, gjatë vitit 2011 gjithsej 1163, gjatë vitit 2012 gjithsej 1001, gjatë vitit 2013 gjithsej 1005, gjatë vitit 2014 gjithsej 972 dhe gjatë vitit 2015 gjithsej 772 fëmijë të paraqitur. Ndonëse në vitin 2009 paraqitet numri më i lartë i evidentuar i fëmijëve të paraqitur, nga vitit 2010 e këndej shfaqet tendenca e rrënies së këtij numri, veçanërisht në vitin 2015, si viti me numër më të ulët të fëmijëve të paraqitur për vepra penale gjatë këtyre dhjetë viteve të hulumtimit. Ky fakt paraqet një tregues pozitiv për zhvillimin e dinamikës së fenomenit të delikuencës së fëmijëve gjatë viteve të fundit në vendin tonë, sepse të dhënat e paraqitura në graf.1 tregojnë një rrënie afërsisht deri në 50% të numrit të fëmijëve të paraqitur në vitin 2015 në krahasim me vitet 2006 dhe 2009.

9.1.2. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të gjykuar në Republikën e Maqedonisë: 2006-2015 dhe numri i fëmijëve të gjinisë femrore të gjykuar gjatë kësaj periudhe

Gjithsej	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
	844	676	715	748	547	722	556	473	461	348
Femra	-[50]	24	38	49	20	22	9	24	16	22

Tabela 1 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016).

Në tabelën nr.1 është paraqitur numri i fëmijëve të gjykuar në Republikën e Maqedonisë për gjatë periudhës kohore të përcaktuar të hulumtimit, nga vitit 2006 deri në vitin 2015, duke specifikuar nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të gjykuar për secilin vit edhe numrin e gjinisë femërore të fëmijëve të cilat janë gjykuar gjatë kësaj periudhe kohore.

Në vitin 2006 rezultojnë 844 fëmijë të gjykuar, në vitin 2007 ka gjithsej 676 të gjykuar, në vitin 2008 gjithsej 715 të gjykuar, në vitin 2009 gjithsej 748 të gjykuar, në vitin 2010 gjithsej 547 të gjykuar, në vitin 2011 gjithsej 722 të gjykuar, në vitin 2012 gjithsej 556 të gjykuar, në vitin 2013 gjithsej 473 të gjykuar, në vitin 2014 gjithsej 461 të gjykuar, dhe në vitin 2015 gjithsej 348 fëmijë të gjykuar. Ajo që mud të vërehet në shikim të parë të kësaj tabele, është

[50] Nuk ka publikim të posaçëm ku pasqyrohet numri i kriminalitetit për vitin 2006 e më parë në webfaqe të Entit Shtetëror Statistikor të R.M.-së. Ndërkaq në publikimet e viteve 2007-2015 nuk ekzistojnë të dhëna për numrin e fëmijëve të gjykuar të gjinisë femrore për vitin 2006!

fakti mbi tendencën e uljes së numrit të fëmijëve të gjykuar në vendin tonë, gjatë viteve të fundit, veçanërisht në qoftë se krahasojmë vitet e para të hulumtimit me ata të fundit shihet se numri i fëmijëve të gjykuar është zvogëluar mbi 50%!

Treguesi tjetër i tabelës nr.1 pasqyron numrin e fëmijëve të gjinisë femrore të gjykuara gjatë periudhës 2006-2015 në vend, në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të gjykuar. Edhe në këtë rast nuk është aspak e vështirë të zbulohet relacioni i fëmijëve të të dy gjinive, në kontekst të prirjes së tyre për veprime delikuente. Shihet një numër shumë i vogël i gjinisë femrore të gjykuara përgjatë dhjetë viteve të hulumtimit në krahasim me atë mashkullore.

Respektivisht, për vitin 2006 nga gjithsej 844 të gjykuar, nuk ka të dhëna të publikuara në Entin Shtetëror Statistikor të R.M.-së për numrin e fëmijëve të gjinisë femrore; në vitin 2007 nga gjithsej 676 fëmijë të gjykuar vetëm 24 janë femra (Kryerës të veprave penale në 2007, 2008); në vitin 2008 nga gjithsej 715 vetëm 38 femra (Kryerës të veprave penale në 2008, 2009); në vitin 2009 nga gjithsej 748 vetëm 49 femra (Kryerës të veprave penale në 2009, 2010); në vitin 2010 nga gjithsej 547 të gjykuar vetëm 20 femra (Kryerës të veprave penale në 2010, 2011); në vitin 2011 nga gjithsej 722 të gjykuar vetëm 22 femra (Kryerës të veprave penale në 2011, 2012); në vitin 2012 nga gjithsej 556 të gjykuar vetëm 9 femra (Kryerës të veprave penale në 2012, 2013); në vitin 2013 nga gjithsej 473 të gjykuar vetëm 24 femra (Kryerës të veprave penale në 2013, 2014); në vitin 2014 nga gjithsej 461 të gjykuar vetëm 16 femra (Kryerës të veprave penale në 2014, 2015); dhe në vitin 2015 nga gjithsej 348 fëmijë të gjykuar vetëm 22 prej tyre janë femra (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016).

Pra, nga këto numra mund të konkludojmë se femrat e mitura, respektivisht fëmijët e gjinisë femrore janë shumë herë më pak të prirura në krahasim me gjininë mashkullore për të kryer vepra penale, e kjo shihet nga përqindja shumë e vogël e evidentuar e tyre si të gjykuara gjatë viteve 2007-2015. Poashtu nëse mund të themi se numri i përgjithshëm i fëmijëve të gjykuar është zvogëluar kënaqshëm gjatë viteve të fundit, e njejta gjë nuk mund të thuhet specifikisht për numrin e femrave të gjykuara, sepse siç shihet në tabelë ky numër ka një gjendje relativisht stabile me një mesatare që lëviz mes 20 deri 40 fëmijë femra të gjykuara brenda ç'do viti.

Kjo tendencë e rrënies së numrit të fëmijëve të gjykuar nga viti 2012-2013 e këndej, mund të lidhet me disa dilema, apo zgjidhje, si p.sh. përparësia në shqiptim nga organet kompetente dhe zbatueshmërinë e masave jopenale ndaj fëmijëve – masave të ndihmës dhe mbrojtjes, e cila ka mundur të sjellë numrin më të vogël të fëmijëve të cilët janë gjykuar, pasi që ndaj tyre janë shiptuar këto masa jopenale. Pra, ka mundësi që fenomeni kriminal i fëmijëve në vend të mos jetë zvogëluar, por vetëm numri i sanksioneve penale të shqiptuara. Kjo pyetje mund të zbardhet deri diku, nëse analizojmë numrin e fëmijëve të paraqitur gjatë këtyre viteve të hulumtimit në tabelën nr. 1. Por, këtu normalisht se mund të analizohen edhe faktorë të tjerë të cilët kanë ndikuar në uljen e numrit të fëmijëve të gjykuar, si p.sh. masat preventive për kriminalitetin e fëmijëve, të cilat ndoshta me të vërtetë kanë korrur sukses në zvogëlimin e kriminalitetit të fëmijëve gjatë këtyre viteve të fundit.

9.1.3. Numri i personave madhorë të gjykuar në raport me fëmijët e gjykuar: 2006-2015



	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
MADHORË	9280	9639	9503	9801	9169	9810	9042	9539	11683	10312
FËMIJË	844	676	715	748	547	722	556	473	461	348

Grafikoni 2 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016):45,115.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikonin 2, është pasqyruar në mënyrë krahasimore gjendja e tërësisë së numrit të personave madhorë të gjykuar në Republikën e Maqedonisë krahas

numrit të fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës kohore 2006-2015. Nëse krahasojmë numrin e fëmijëve të gjykuar me ato madhorët, për të gjitha veprat penale gjatë kësaj periudhe të hulumtimit, s'do mend se ai numër është shumë më vogël, deri në tridhjetë herë.

9.1.4. Numri i fëmijëve të paraqitur sipas grupit të veprave penale: 2006-2015

Tabela 2	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej	1500	1229	1355	1519	1244	1163	1001	1005	972	772
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	83	72	84	103	107	88	60	66	64	68
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	1	2	7	2	2	1	6	5	5	3
Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit	1	-	1	1	4	-	1	-	-	1
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	24	19	18	17	24	14	10	19	25	19
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	8	6	18	12	14	11	16	8	23	20
Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	7	12	21	12	14	14	10	4	5	2
Vepra penale kudër pasurisë	1 231	967	1023	1192	937	917	773	745	654	520
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	13	11	4	1	10	14	9	8	6	4
Vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik	53	67	77	88	61	43	50	28	29	33
Vepra penale kundër drejtësisë	6	36	25	8	1	7	1	-	1	-
Vepra penale kundër rendit public	64	29	53	70	56	45	52	117	156	100

Të tjera	9	8	24	13	14	9	13	5	4	2

Tabela 2 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016).

Në tabelën nr. 2 janë të pasqyruar numrat e fëmijëve të paraqitur penalisht në Republikën e Maqedonisë, gjatë viteve 2006-2015, sipas grupit të veprave penale për të cilat janë paraqitur. Meqenëse gjatë analizimit të tabelës nr. 2 u trajtua çështja e numrit të përgjithshëm e fëmijëve të paraqitur gjatë dhjetë viteve të fundit, këtu do të ndalemi vetëm në analizimin e grupeve të veprave penale për të cilat janë paraqitur fëmijët.

Siç mund të shihet nga këto të dhëna të paraqitura, numër më të lartë të fëmijëve të paraqitur bartë grupi i veprave penale kundër pasurisë, dhe atë në të gjithë vitet e hulumtimit në krahasim me të gjitha grupet e tjera të veprave penale. Veprat kundër pasurisë siç shihet janë krimet që më së shumti i kryejnë fëmijët dhe paraqesin përqindjen më të madhe të kriminalitetit të përgjithshëm të fëmijëve. Kjo mund të mbështetet pikërisht nga fakti që e vërtetojnë të dhënat statistikore nga tabela nr, 3 ku shihet se në vitin 2006 nga gjithsej 1500 fëmijë të paraqitur - 1 231 prej tyre janë paraqitur për vepra penale kundër pasurisë; në vitin 2007 nga 1229 – 967 të paraqitur për krime kundër pasurisë, në 2008 nga 1355 – 1023 krime kundër pasurisë , në 2009 1519- 1192 kundër pasurisë, në 2010 nga 1244 – 937 kundër pasurisë , në 2011 nga1163 – 917 kundër pasurisë, në 2012 nga 1001 – 773 kundër pasurisë, në 2013 nga 1005 – 745 kundër pasurisë , në 2014 nga 972 – 654 kundër pasurisë dhe në 2015 nga 772 – 520 për krime kundër pasurisë.

Pra, mbi 80% e fëmijëve të paraqitur nga viti 2006 deri 2015 janë të paraqitur pikërisht si të dyshuar për vepra penale kundër pasurisë, e nga kjo arrijmë të përfundojmë se fëmijët në vendin tonë janë më shumë të prirur për të kryer vepra penale kundër pasurisë. Megjithatë, duhet përmendur faktin se kjo, nuk është karakteristike vetëm për fëmijët e vendit tonë, por është cilësi e tyre e përgjithshme, e cila vlen edhe në shumicën e vendeve të tjera të botës. Në vend të dytë pasojnë veprat penale kundër jetës dhe trupit, kurse pas tyre në vend të tretë vijojnë veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe veprat penale kundër rendit publik. Siç mund të shohim, edhe tek të gjitha grupet e tjera të veprave penale vërehet në numër i caktuar i fëmijëve të paraqitur, për grupe të ndryshme të veprave penale, përveç atyre që i përmendëm më lartë, edhe për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut

dhe qytetarit; Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit; Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor; Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve; Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë; Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës; Vepra penale kundër drejtësisë etj.

9.1.5. Numri i fëmijëve të akuzuar sipas grupit të veprave penale: 2006-2015

Tabela 3	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej	987	839	981	1030	750	1002	778	657	712	465
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	66	56	54	60	68	100	58	57	52	53
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	1	-	3	4	1	5	3	5	2	2
Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit	1	-	2	1	1	2	-	-	-	1
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	15	12	20	15	15	21	11	5	17	15
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	11	7	15	9	9	17	10	13	6	8
Vepra penale kudër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	6	11	7	5	13	8	9	3	4	6
Vepra penale kudër pasurisë	789	680	742	795	573	727	597	500	468	282
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	4	10	10	2	1	9	5	4	8	5
Vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik	38	23	63	53	37	45	28	30	16	29
Vepra penale kundër drejtësisë	7	6	37	23	1	1	1	-	-	1
Vepra penale kundër rendit public	44	25	24	51	23	59	50	34	133	56
Të tjera	5	9	4	12	8	8	6	6	6	7

Tabela 3 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016).

Në tabelën nr. 3 janë prezantuar të dhënat mbi numrin e fëmijëve të akuzuar për grupet e caktuara të veprave penale gjatë viteve 2006-2015. Edhe në këtë tabelë mund të shihet se ndonëse numri i përgjithshëm i fëmijëve të akuzuar gjatë të gjitha viteve të hulumtimit është më i vogël në krahasim me numrin e fëmijëve të paraqitur (Tabela nr.3), megjithatë nëse analizohet grupi i veprave penale për të cilat është ishin akuzuar fëmijët, është pothuajse i njejtë sikur grupi i veprave penale për të cilat ishin paraqitur.

Kështu që, në vend të parë në tabelën nr. 4 prijnë veprat penale kundër pasurisë, kurse në vend të dytë pasojnë veprat penale kundër jetës dhe trupit, e pas tyre në vend të tretë vijojnë veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe veprat penale kundër rendit publik. Mirëpo nuk mungojnë edhe të dhëna për fëmijë të akuzuar për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit; Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit; Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor; Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve; Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë ; Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës; Vepra penale kundër drejtësisë etj.

9.1.6. Numri i fëmijëve të gjykuar sipas grupit të veprave penale: 2006-2015

Tabela 4	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej	844	676	715	748	547	722	556	473	461	348
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	54	49	44	49	59	79	43	39	47	43
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	1	-	2	4	1	5	1	5	-	2
Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit	1	-	-	1	-	2	-	-	-	1
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	13	11	16	14	7	12	8	5	14	13
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	9	5	5	6	7	15	7	12	4	7
Vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë	1	2	-	-	1	1	-	1	1	-

Vepra penale kudër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	5	9	6	4	13	7	9	3	3	5
Vepra penale kudër pasurisë	672	537	529	547	403	513	409	353	267	198
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	4	7	7	2	1	6	4	4	6	2
Vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik	35	22	50	46	35	39	26	24	14	28
Vepra penale kundër drejtësisë	5	5	37	20	1	1	1	-	-	1
Vepra penale kundër rendit public	40	24	16	45	16	35	43	25	100	42
Të tjera	4	5	3	10	3	7	5	2	5	6

Tabela 4 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016, f.119)

Në tabelën nr. 4 është paraqitur numri i fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës kohore 2006-2015 sipas grupit të veprave penale. Sipas këtyre të dhënave gjatë të gjitha viteve të analizuara të këtij hulumtimi, numër më të madh paraqesin fëmijët e gjykuar për vepra penale kundër pasurisë. Në vend të dytë janë ata të gjykuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit, më pas për vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe për veprat penale kundër rendit publik. Poashtu shihet një numër më i vogël i fëmijëve të gjykuar edhe për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit; Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit; Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor; Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve; Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë ; Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës; Vepra penale kundër drejtësisë etj.

Pasi që deri tani paraqitëm të dhëna për numrin e fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar gjatë viteve 2006-2015 dhe u theksua se numri i fëmijëve bie nga ai i të paraqiturve në atë të të akuzuarve dhe pastaj në rrënie edhe më të madhe tek numri i atyre të gjykuarve, vlen të paraqitet më poshtë një ilustrim komparativ i numrit të fëmijëve bazuar në këto tre tregues për të gjitha vitet e përcaktuara në hulumtim, si vijon në tabelën nr. 5:

9.1.7. Numri i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar: 2006-2015

Viti	Të paraqitur	Të akuzuar	Të gjykuar
2006	1500	987	844
2007	1229	839	676
2008	1355	981	715
2009	1519	1030	748
2010	1244	750	547
2011	1163	1002	722
2012	1001	778	556
2013	1005	657	473
2014	972	712	461
2015	772	465	348

(Tabela 5)

Në tabelën nr. 5 është pasqyruar numri i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe i atyre të gjykuar për secilin vit: 2006-2015, nga mund ta shohim dallimin e numrave që bën vetë kalimi i një çështjes penale nga njëra fazë e procedurës penale në tjetrën. Qartë shihet se jo ç'do çështje penale që inicohet nga MPB do të arrijë deri në fazën akuzuese, e poashtu në shqyrtim gjyqësor, respektivisht do të përfundojë me aktvendim/aktgjykim gjyqësor dënues! Ky fakt sidomos ekziston kur bëhet fjalë për të dyshur, të akuzuar apo të pandehur i cili është fëmijë, duke pasur parasyshë trajtimin e veçantë e të privilegjuar që e kanë fëmijët në tërë sistemin juridik-penal, me të vetmin qëllim – mbrojtjen e interesit të fëmiut.

9.1.8. Numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 14-16 vjeçare: 2006-2015 sipas llojit të sanksionit të shqiptuar[51]

Viti	Gjithsej (14-18 vjet)			Fëmijë të moshës 14-16 vjeçare							
	Gjithsej	Femra	Tentativë	Gjithsej (14-16)	Masa disiplinore		Masa të mbikq. së shtuar			Masa të enteve	
					Qortim	Qendër disiplinore	Nga prindi	Familja tjetër	Qendra soc.	Ent ed.	Shtëpi edukk
2006[52]	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
2007[53]	537	15	16	155	11	-	96	-	42	1	5
2008	529	17	23	169	19	-	95	-	44	-	11
2009	748	39	12	210	21	-	116	-	64	1	8
2010	547	20	10	162	33	-	80	-	42	2	5
2011	722	22	16	220	27	-	116	-	64	2	11
2012	556	9	9	140	12	-	85	-	36	-	7
2013	473	24	4	123	17	-	67	-	33	2	4
2014	461	16	18	107	10	1	59	-	28	1	8
2015	348	22	9	73	14	-	35	-	21	-	3

Tabela 6: (Kryerës të veprave penale në 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë)

Në tabelën nr. 6 janë paraqitur të dhëna për numrin e fëmijëve të gjykuar gjatë periudhës 2006-2015, konkretisht numri i fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare sipas llojit të sanksionit penal, respektivisht masës edukuese. Nga këto tregues shihet se gjatë secilit vit të hulumtuar, sa fëmijë të moshës 14-16 vjeçare janë gjykuar nga numri i plotë i fëmijëve të gjykuar të grupmoshave 14-18 vjet. Poashtu janë të përcaktuar edhe numrat e llojeve të ndryshme të

[51] Edhe nga të dhënat e Publikuara nga Enti Shtetëror Statistikor mund të vërehet ndryshimi ligjor lidhur me emërtimin e kategorive të fëmijëve para vitit 2013 dhe pas tij; Me ç'rast në Publikimet nga viti 2007 deri 2013 haset ndarja në të mitur"të rinjë", dhe "të rritur", kurse nga Publikimi i vitit 2014 e këndej kjo ndarje zëvendësohet me: "Fëmijë të moshës 14-16" dhe "Fëmijë të moshës 16-18"!

[52] Mungojnë të dhëna për vitin 2006 sepse nuk ka të publikuar një Publikim për kriminalitetin gjatë vitit 2006 nga Enti Shtretëror Statistikor i R.M.-së!

[53] СТОРИТЕЛИ на кривични дела во 2007 , Скопје, 2008, Државен завод за статистика на Република Македонија, Статистички преглед –Население и социални статистики,2.4.08.07 (594):124.

masave edukuese që janë shqiptuar ndaj tyre, ndonëse ndaj kësaj kategorie mund të shqiptohet vetëm ky lloj i sanksioneve penale, për dallim nga kategoria tjetër më e vjetër.

Nga këto të dhëna shihet se gjatë kësaj periudhe kohore (2006-2015), masa edukuese e shqiptuar më shpeshë ndaj fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare ka qenë masa e Mbikqyrjes së përforcuar nga ana e prindit, kurse pas saj vjen masa Mbikqyrja e përforcur nga ana e Qendrës për punë sociale. Nuk mungon në numër të konsiderueshëm edhe masa disiplinore Qortimi, e më pak në numër paraqiten të shqiptuara masat e enteve. Ajo që është interesante, ka të bëjë me treguesit mbi (mos)shqiptimin e masave: Masës disiplinore Dërgimi në Qendër disiplinore, e cila është shqiptar vetëm një herë gjatë këtyre nëntë viteve (2007-2015) dhe masës me mbikqyrje të intensifikuar – Mbikqyrja e shtuar nga familja tjetër, e cila rezulton se as një herë të paktën nuk është shqiptuar nga ana e gjykatave të vendit tonë. Në këtë rast, mendoj se është koha të rishqyrtohet kjo gjendje reale mbi efikasitetin e këtyre masave edukuese nga ana e ligjvënësit, mbi nevojën e egzistimit të tyre në grupin e sanksioneve për fëmijë në legjislacionin penal, duke marrë parasyshë se deri më tani nuk kanë gjetur zbatueshmëri në praktikë! Nga të dhënat tabelare shihet se ndaj gjithsej 348 fëmijëve të gjykuar gjatë vitit 2015 (Kryerës të veprave penale në 2015, 2016), 73 i përkasin moshës 14-16 vjeçare, e ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale si: Qortim (14 herë), Mbikqyrje e përforcuar nga prindi(35 herë); Mbikqyrje e përforcuar nga Qendra për Punë Sociale (21 herë) si dhe Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese (3 herë).

9.1.9. Numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18 vjeçare sipas llojit të sanksionit penal: 2006-2015

		Burg për fëmijë	Masa edukuese	Masa disiplinore		Masa të mbikq. së shtuar			Masa të enteve	
Viti	Gjithsej			Qortim	Qendër disiplinore	Nga prindi	Familja tjetër	Qendra soc.	Entekues	Shtëpi eduk
2006[54]	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
2007	479	15	464	46	-	254	-	155	0	9
2008	510	11	499	95	-	234	-	156	4	10

[54] Mungojnë të dhëna për vitin 2006 sepse nuk ka të publikuar një Publikim për kriminalitetin gjatë vitit 2006 nga Enti Shtretëror Statistikor i R.M.-së!

2009	537	14	523	64	-	251	-	202	2	4
2010	385	9	376	74	-	165	-	122	5	10
2011	502	2	500	65	-	277	-	151	-	7
2012	416	7	409	45	-	213	-	137	2	12
2013	350	-	350	63	-	154	-	127	-	6
2014	354	3	351	52	-	192	-	91	1	15
2015	275	8	267	65	-	111	-	83	1	7

Tabela 7: (Kryerës të veprave penale në 2007, f.125-126; Kryerës të veprave penale në 2008, f. 124-125; Kryerës të veprave penale në 2009, f. 24-125; Kryerës të veprave penale në 2010, f. 126-127; Kryerës të veprave penale në 2011, f. 122-123; Kryerës të veprave penale në 2012, f.122-123; Kryerës të veprave penale në 2013, f.120-121; Kryerës të veprave penale në 2014, f.122-123; Kryerës të veprave penale në 2015, f.122-125)

Në tabelën nr.7 është paraqitur numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18 vjeçare gjatë periudhës kohore 2006-2015 sipas llojit të sanksionit penal të shiptuar. Nga këto të dhëna mund të shihet fillimisht nëse krahasojmë edhe të dhënat nga tabela nr. 7 se nga gjithsej numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 14-18 vjeçare, shumica e tyre që janë të gjykuar janë të grupmoshës 16-18 vjeçare. Poashtu siç mund të shohim në tabelën nr. 8 ndaj kësaj kategorie të fëmijëve mund të shqiptohen edhe sanksione të tjera, krahas masave edukuese, ku në këtë rast paraqitet vetëm dënimi me burgim për fëmijë. Ndonëse nëse krahasohet numri i dënimeve me burgim, me numrin e masave tjera edukuese të shqiptuara ndaj fëmijëve është shumë i vogël, por ky dënim kështu edhe parashihet në Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve, i proklamuar me parimin *Privimi nga liria i fëmiut është mjet i fundit në procedurë..(*n. 10).

Edhe këtu shihet se masa më e shpeshtë e shqiptuar ndaj fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18 vjeçare ka qenë masa e Mbikqyrjes së shtuar nga prindi dhe më pas masa e Mbikqyrjes së shtuar nga Qendra sociale. Pas tyre në numër pason masa disiplinore Qortimi, kurse më pak të shqiptuara janë masat e Enteve. Siç shihet edhe ndaj kësaj kategorie të fëmijëve gjykatat në asnjë rast nuk i kanë shqiptuar masat Dërgimi në Qendrën disiplinore dhe Masën e mbikqyrjes së shtuar nga familja tjetër.

9.1.10. Numri i fëmijëve të gjykuar gjatë 2014 sipas vendit dhe grupit të veprës penale

Vepra penale kundër:											
	GjITHSEJ	Jetës dhe trupit	Lirive dhe të drejtave të njeriut	Nderit dhe autoritetit	Lirisë dhe moralit gjinor	Pasurisë	Sigurisë së përgj. të njerëzve dhe pasurisë	Sigurisë së trafikut public	Drejtësisë	Rendit publik	Të tjera
Gjithsej	461	47	-	-	14	267	6	14	-	100	13
Gazi Baba	50	1	-	-	-	43	-	-	-	6	-
Gjorçe Petrov	2	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-
Karposh	48	1	-	-	2	31	-	-	-	14	-
Kisela V.	52	4	-	-	1	30	2	1	-	14	-
Qendër	40	3	-	-	-	13	-	-	-	22	2
Çair	37	4	-	-	1	21	-	-	-	10	1
Aerodrom	12	1	-	-	-	6	-	-	-	5	-
Butel	5	-	-	-	-	4	-	-	-	1	-
Berovë	4	-	-	-	-	1	-	-	-	3	-
Manastir	4	-	-	-	-	4	-	-	-	-	-
Bogdanci	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Bogovinë	2	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-
Vallandovë	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Vasilevë	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Veles	22	10	-	-	-	10	-	2	-	-	-
Vinica	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Gjevgjeli	4	1	-	-	-	3	-	-	-	-	-
Gradsko	5	1	-	-	-	2	1	1	-	-	-
Delçevë	6	-	-	-	-	6	-	-	-	-	-
Zhelinë	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zërnovc	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Kavadar	23	-	-	-	-	13	-	2	-	8	-
Koçani	8	1	-	-	-	6	-	-	-	-	1
Kumanovë	3	-	-	-	-	3	-	-	-	-	-

Kamenicë	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Negotinë	8	2	-	-	1	5	-	-	-	-	-
Novo Sellë	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Ohër	4	1	-	-	-	2	-	1	-	-	-
Probishtip	14	2	-	-	-	11	-	-	-	-	1
Radovish	11	-	-	-	1	7	1	1	-	1	-
Sveti Nikole	7	4	-	-	-	2	-	-	-	1	-
Strumicë	17	1	-	-	2	11	-	1	-	1	1
Studeniçan	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tetovë	40	4	-	-	2	18	2	4	-	7	3
Çashka	5	1	-	-	-	1	-	1	-	2	-
Çeshino	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
Shtip	15	2	-	-	1	10	-	-	-	-	2
Jashtë vendi	3	-	-	-	3	-	-	-	-	-	-

Tabela 8 (Kryerës të veprave penale në 2014, 2015, f.126)

Në tabelën nr. 8 janë të prezantuara të dhënat për vitin 2014 rreth numrit të fëmijëve të gjykuar sipas vendit të kryerjes së veprës penale. Në këtë rast shihet se më së shumti janë kryer vepra penale nga fëmijë në komunën Kisella Vodë, ku figurojnë 52 fëmijë të gjykuar, më pas në Gazi Babë me 50 dhe Karposh me 48 të gjykuar. Më pas vijojnë komuna Qendër dhe Tetova me 40, komuna e Çairit me 37 fëmijë të gjykuar. Format më të shpeshta të veprave penale të kryera gjatë këtij viti, në të gjitha këto vendbanime të Maqedonisë janë ato kundër pasurisë dhe kundër rendit publik.

9.2. Studim i rasteve individuale nga kriminaliteti i fëmijëve, bazuar në Praktikën gjyqësore të gjykatave në Republikën e Maqedonisë

Në vazhdim është analizuar praktika gjyqësore nga sfera e drejtësisë penale të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë. Duke pasur parasyshë parimet e drejtësisë për fëmijë si parimi i mbrojtjes së interesit të fëmiut dhe përjashtimi i publicitetit në procedurë penale ndaj fëmiut- grumbullimi i materialit për këtë pjesë të hulumtimit, respektivisht arritja deri në

qasje të Vendimeve dhe Aktgjykimeve gjyqësore të shqiptuara ndaj fëmijëve nuk ishte shumë e lehtë. Kjo për faktin se ato nuk janë publike dhe nuk mund të gjinden në webfaqet e gjykatave të vendit, siç mund të gjenden shumë lehtë aktgjykime të shqiptuara ndaj të dënuarve madhorë. Për qasjen tek vendimet gjyqësore kemi parashtruar kërkesa formale drejtë autoriteteve kompetente të disa gjykatave të vendit, të cilat u treguan kooperuese në këtë aspekt duke na ofruar ndonëse numër simbolik të këtyre shkresave, por të mjaftueshëm për të paraqitur qëllimin e kësaj pjese të punimit.

Vendimet gjyqësore janë grumbulluar nga gjykata të ndryshme të Republikës së Maqedonisë, dhe atë nga gjykata Themelore e Tetovës (4 raste), Gjykata Themelore Shkupi I (2 raste) dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë (1 rast). Vendimi i Gjykatës Supreme ishte i publikuar në Përmbledhjen e Vendimeve gjyqësore të kësaj gjykate për periudhën 2004-2014. Vendimet poashtu janë të sjellura në periudha të ndryshme kohore, dhe atë në vitin 2008, 2014, 2016 dhe 2017.

9.2.1. Rasti 1: Vrasje

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vrasje

Pjesë nga Aktgjykim i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-16/17:

"(NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjykata Themelore e Tetovës, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për fëmijë të përbërë nga gjykatësi për të mitur-XX si Kryetar i Këshillit dhe gjykatësit porotë AK dhe SG-si antarë të Këshillit, vendosi sipas Propozimit për shqiptim të dënimit me burgim nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë për veprën penale VRASJE, në bazë të nenit 123 p.1 i KPM, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të prokurorit publik, përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarve, mbrojtësit të fëmiut të akuzuar dhe fëmiut, u soll ky Aktgjykim kundër fëmiut XX , të lindur në vitin 2000, shtetas i R.M., i privuar nga liria në datë X.X. 2017 e solli këtë:

AKTGJYKIM

FËMIU I AKUZUAR XX, i lindur më X.X.1999...shqiptar, shtetas i R.M.,

SHPALLET FAJTORË:

SEPSE në datë X.X. 2017 në orën 16.00, në X, në oborr të X me paramendim e ka privuar nga jeta fëmiun X nga i njejti fshat, në atë mënyrë që me përdorimin e armës së zjarrit – armë pistoletë, ngjyrë të zezë, marla "Paarabelum M-90,"9mm me numër serik XX, ka qëlluar nga një afërsi e afërt një plumb në shpinën e të dëmtuarit XX edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se përshkak të veprimit të tij mund të rezultojë pasojë e dëmshme, por duke u pajtuar me paraqitjen e saj, me të cilën i ka shkaktuar plagë nga arma e zjarrit nga shpina drejtë pjesës së parme të anës së majtë, i cili si rast urgjent është sjellur në Qendrën e urgjencës në Shkup dhe pas realizimit të operacionit, pas tri ditësh tek fëmiu i dëmtuar ka pasuar vdekja, me të cilin veprim e ka kryer veprën penale VRASJE sipas n. 123 p.1 i Kodit penal.

Në pajtim me n.51 të Ligjit të drejtësisë për fëmijë:

DËNOHET

Me dënim me burgim për fëmijë në kohëzgjatje prej 8-tetë vitesh.
Në dënimin e shqiptuar do të llogarritet edhe koha e kaluar në paraburgim deri në lëshimin e tij.
Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të Republikës së Maqedonisë. I dëmtuari X për kërkesën e tij juridiko-pasurore drejtohet në kontest civil. Kurse mjeti i përdorur për të kryer veprën penale (Pistoleta) I MERRET.

A r s y e t i m

Nga ana e PPTH- Tetovë nr.19/17 nga X.X.2017. është parashtruar Propozim për shqiptim të dënimit burgim për fëmijë ndaj fëmiut X nga X për veprën penale VRASJE sipas n.123, p.1 nga KP.
Duke vepruar sipas Propozimit, gjykata mbajti shqyrtim kryesor më datë X.X.2017, në prezencë të përfaqësuesit të Prokurorisë publike Tetovë, përfaqësuesit të të dëmtuarve, mbrojtësit të të akuzuarit dhe fëmiut.
Në shqyrtimin e mbajtur kryesor fëmiu i akuzuar vullnetarisht e pranoi fajin për veprën e kryer, i vetëdishëm për pasojat nga pohimi i tillë, prandaj edhe gjyqi e shpalli fajtor për këtë vepër penale dhe e dënoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë vitesh...”).

Gjatë matjes së dënimit në këtë rast gjykata i kishte marrë parasyshë të gjitha rrethanat sipas n. 39 të KPM-së, ku si rrethana rrënduese në pjesën e Arsyetimit kishte përcaktuar: Llojin dhe karakterin e veprës penale dhe mospajtimin me familjen e fëmiut të ndjerë, kurse si rrethana lehtësuese - gjendjen materiale të fëmiut, repektivisht situatën se i njejti rrjedh nga një familje e varfër- fakt i cili u vërtetua me dokument të siguruar nga QPS –Tetovë, situatën se vjen nga familje me nivel të ulët socio-kulturor dhe edukativ; I njejti është emocionalisht i papjekur dhe jostabil si dhe i papërgjegjshëm – e nxjerrur nga mendimi dhe konstatimi i ekipit profesional nga QPS Tetovë; Rrethana se në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për ta kuptuar rëndësinë e veprës si dhe zotësia për të kontrolluar veprimet e tij ka qenë e zvogluar – e nxjerrur nga ekspertimi neuropsikiatrik, si dhe pendimi i fëmiut.

Fëmiu ka qëndruar në paraburgim dy muaj pas momentit kritik, që len të nënkuptohet fakti se shkak i përcaktimit të paraburgimit në këtë rast mund të ketë qenë pikërisht gjendja jostabile e fëmiut apo ekzistimi i ndonjë kushti tjetër të përcaktuar ligjor (sipas LPP të R.Maqedonisë).

Në këtë rast konsideroj se duke pasur parasyshë rrethanat e natyrës subjektive që lidhen me gjendjen emocionale të kryesit, kohëzgjatja e përcaktuar e dënimit me burg nga ana e gjykatës - deri në 8 vite është e përshtatshme për rastin në fjalë. Kjo sepse kryesi në fjalë sipas gjendjes emocionale të tij të përshkruar nga eksperti përkatës, ka pasur nevojë për një tretman penitesiar më të gjatë me qëllim të (ri)edukimit të tij, e mesiguri edhe gjykata e ka

konsideruar këtë fakt në momentin e matjes së dënimit, krahas shkallës së rrezikshmërisë së veprës penale të kryer.

9.2.2. Rasti 2: Vjedhje e rëndë

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vjedhje e rëndë.

Pjesë nga Aktvendimi i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-28/17:

"(**Gjykata Themelore e Tetovës**, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për të mitur të përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe gjykatësit porotë, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të masës edukuese nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë ndaj fëmijëve X dhe Y për veprën penale VJEDHJE E RËNDË , në bazë të nenit 236 p.5 në lidhje me p.1, al.1, në lidhje me n. 22 të KPM, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të prokurorit publik, mbrojtësve të fëmijëve, e në mungesë të fëmijëve dhe Përfaqësuesit të QPS- Tetovë, me datë X.X.2017, e solli këtë:

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT:

1. X, i lindur më X.X.1999...shqiptar, shtetas i R.M.,
2. Y, i lindur më X.X.2000...shqiptar, shtetas i R.M.,

Në pajtim me n.37 dhe 41 të Ligjit të drejtësisë për fëmijë ju shqiptohet masa edukuese:

MBIKQYRJE E SHTUAR NGA ANA E PRINDËRVE

Masa edukuese do të zgjasë së paku 1-një, e më së shumti 3-tri vite, për të cilën gjykata do të vendos në mënyrë plotësuese.
Prindërit detyrohen ti menjanojnë ndikimet e dëmshme ndaj fëmijëve.
Shpenzimet e procedurës për të dy fëmijët bien në ngarkesë të buxhetit të R.M.
I dëmtuari X për kërkesën e tij juridiko-pasurore drejtohet në kontest civil.

A r s y e t i m

....Pas njoftimit të të pranishmive për ecurinë e procedurës përgaditore dhe pas shqyrtimit të provave të propozuara gjyqi vërtetoi se fëmijët me të vërtetë gjatë natës mes XX/X.X /**2014,** në f.X, nga marketi XX në pronësi të X, si bashkëkryerës, me thyerje, kanë marrë sende të huaja të luajtshme me vlerë të vogël, me qëllim të përvetësimit të tyre të paligjshëm, në mënyrë me çka me mjet të fortë – pllakë begatoni e kanë thyer qelqin e shitores nga dera e hyrjes, janë futur brenda dhe nga sirtari kanë marrë dy kartona "Malboro, të bardhë", dy kartona "Malboro" të kuq, një kuti "Malboro" të kuq me të bardhë, dy kuti "West" ngjyrë hiri dhe një kuti "West" të kuq, me vlerë të pavërtetuar në veçanti, kurse në vlerë totale nga 9000 denarë , ku pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes.
Fëmijët pavarëshit nga njëri tjetri e pohojnë këtë gjendje faktike. Vërtetojnë se me të vërtetë në kohën kritike kanë hyrë brenda në marketin "X" nga dera e hyrjes së marketit dhe se nga brenda kanë marrë më shumë pako të cigareve të ndryshme e pastaj e kanë lëshuar vendin.
I dëmtuari dëshmitar X vërtetoi pohimet e dhëna të fëmijëve...

Në këtë situatë faktike të vërtetuar gjyqi u përcaktua që fëmijëve të u'a shqiptojë masën edukuese Mbikqyrje e shtuar nga ana e prindërve si proporcionale me peshën e veprës penale të kryer dhe adekuate për moshën dhe përgjegjësinë e tyre, në të cilën shpie rrethana se ata rrjedhin nga familje me nivel të mesëm socio-kulturor dhe edukues, se vepra e kryer është e karakterit të rastësishëm, se kanë kushte të mira për zhvillim si dhe se premtojnë se kësi apo gabim i ngjashëm në të ardhme nuk do të i'u ndodhë – rrethana të cilat dalin nga mendimi dhe konstatimi i ekipit profesional të QPS Tetovë...").

Nga ky rast mund të vërtetojmë një fakt që paraqet një veçori të përbashkët apo të shpeshtë të delikuencës së fëmijëve – kryerja në bashkëpunim e veprës penale nga fëmijët. Pra, për dallim nga kryesit madhorë, fëmijët më së shpeshti gjatë kryerjes së veprës penale operojnë në bashkëpunim e më rrallë vetë. Kjo ndodh, deri sa ata të fitojnë vetëbesimin në vetvete për të operuar vetë.

Siç shihet në këtë rast, gjykata ka shqiptuar një masë edukuese e cila shpesh shqiptohet ndaj kryesve fëmijë në vendin tonë (bazuar në të dhënat zyrtare të Entit Statistikor) – Mbikqyrje e përforcuar nga ana e prindërve.

9.2.3. Rasti 3: Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve.

Pjesë nga Aktvendim i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-29/17:

"(Gjykata Themelore e Tetovës, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për të mitur të përbërë nga gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatësit porotë, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të masës edukuese nga Prokuroria Themelore Publike – Tetovë ndaj fëmiut X për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve, në bazë të nenit 216 p.2 në lidhje me p.1 të Kodit penal, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të Prokurorit publik, mbrojtësit të fëmijut, e në mungesë të fëmiut dhe përfaqësuesit të QPS- Tetovë, me datë X.X.2017, e solli këtë:

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT:

1. X, i lindur më X.X.2000...shqiptar, shtetas i R.M. në pajtim me n.37 dhe 43 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë i shqiptohet masa edukuese:

MBIKQYRJE E PËRFORCUAR NGA ANA E QENDRËS

Masa edukuese do të zgjasë më së paku 1-një vit e më së shumti 3-tri vite, për të cilën gjyqi do të vendosë në mënyrë plotësuese.
Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të R.M.-së.

A r s y e t i m

...Pas njoftimit të të pranishmëve për vijimin e procedurës përgaditore dhe pas shqyrtimit të provave të propozuara, gjyqi vërtetoi se fëmiu me tëvërtetë më X.X.2017, rreth orës 22.30 në X sheshin e qytetit në mënyrë të paautorizuar për shitje ka mbajtur një sasi të vogël të drogës narkotike marihuanë me masë neto 2,55 gramë në mënyrë që është hasur nga ana e punonjësve policorë të MPB Tetovë se si personit X duke i shitur një qese të paketuar me drogën narkotike marihuanë me masë neto 0,92 gramë, kurse me vete ka mbajtur edhe dy paketime me nga 0,79 gramë dhe 0,84 gramë ose gjithsej 1,63 gramë të cilat me vërtetim i janë marrur.
Fëmiu e pohoi këtë gjendje faktike, pranon se në kohën dhe vendin kritik me të vërtetë ka qenë i ndalur nga punonjësit policor me paketimet e marihuanës nga të cilat njërin i'a ka dhënë X dhe se marihuana e gjetur menjëherë i është marrë me vertetim.
Dëshmitari X në mënyrë shumë identike u deklarua në lidhje me faktet e përmendura nga ana e fëmiut. Në dëshminë e tij të dhënë më X.X.2017, me siguri e potencon se personalisht e ka njohur X dhe se nga ai afër sheshit të qytetit X ka blerë paketim marihuanë për 200 den....").

Pas vërtetimit të gjendjes faktike të shprehur më lartë në Arsyetimin e vendimit, gjykata është përcaktuar që fëmiut të i'a shqiptojë masën edukuese Mbikqyrje e shtuar nga ana e Qendrës. Kjo masë konsideroj se është proporcionale me peshën e veprës penale të kryer dhe e përshtatshme me moshën e tij, në të cilën drejton rrethana se bëhet fjalë për fëmijë të lënë pas dore, i cili rrjedh nga familje me nivel të ulët socio-kulturor, emocionalisht është i papjekur dhe jostabil, jo vetë kritik dhe i papërgjegjshëm, vështirë socializohet – rrethana të cilat dalin nga konstatimi dhe mendimi i ekipit profesional të QPS – Tetovë.

9.2.4. Rasti 4: Rrezikim i sigurisë në komunikacion

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Rrezikim i sigurisë në komunikacion.

Pjesë nga Aktvendim i sjellur nga Gjykata Themelore Tetovë, 2017, KM-27/17:

"(**Gjykata Themelore Tetovë,** si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për të mitur të përbërë nga gjykatësi për fëmijë dhe gjyqtarë porotë, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të masës edukuese të Prokurorisë Themelore Publike – Tetovë ndaj fëmiut XX për veprën penale Rrezikim i sigurisë në komunikacion, në bazë të nenit 297 p.3 në lidhje me p.1, të Kodit penal, ku pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor gojor dhe të mbyllur, në prezencë të prokurorit publik, mbrojtësit të fëmijut, e në mungesë të fëmijut dhe përfaqësuesit të QPS- Tetovë, me datë X.X.2017, e solli këtë:

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT:

XX, i lindur më X.X.1999...shqiptar, shtetas i R.M.... në pajtim me nenin 37 dhe 39 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë i shqiptoi **MASËN EDUKUESE:**

QORTIM

I bëhet me dije për dëmin e shkaktuar nga veprimi i tij dhe paralajmërohet se në rast të përsëritjes së tij, ndaj tij mund të shqiptohet sanksion tjetër.

TË PAGUAJË

Në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 5.555,00 den në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit.

I dëmtuari X për kërkesën e tij juridiko-pasurore drejtohet në kontest.

A r s y e t i m

.... Pas njoftimit të të pranishmëve me rrjedhën e procedurës përgaditore dhe pas shqyrtimit të provave të propozuara gjyqi vërtetoi se fëmiu me të vërtetë më X. X. 2017 rreth 09.00 në rrugën lokale f.X si pjesëmarrës në komunikacionin publik me mospërmbajtje në rregullat e komunikacionit e ka rrezikuar komunikacionin publik dhe e ka sjellur në rrezik trupin e njerëzve në mënyrë duke drejtuar me automjet "X"me numër të tabelave të regjistruara XX, në pronësi të X në X ka lëvizur në rrugën lokale drejtë f.X, para se ta fitojë të drejtën për drejtim të automjetit motorik, ka ndërmarrë veprim të kthimit në të majtë duke mos u vërtetuar paraprakisht se atë mund ta bëjë duke mos rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se nga ai veprim i tij ka mund të vijojë pasojë e ndaluar, por nga mendjelehtësia ka konsideruar se ajo nuk mund të ndodhë ose do të mundet ta ndalojë, për shkak të së cilës me pjesën e parme të automjetit e ka goditur veturën XX, ...të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndim trupor të tipit të shtypjes së trupit dhe kokës.

Fëmiu e pohon gjendjen e këtillë faktike.

E pohon se e ka drejtuar automjetin duke mos pasur leje vozitjeje dhe se fatkeqësia ka ndodhur kur ai kishte dashur të kthente në të majtë, edhe pse në atë vend të rrugës regjionale ka vizë të plotë në mes, si pasojë e tillë ka ardhur deri tek ndeshja me automjetin XX, i cili pas sulmit ka goditur në shtyllë të betonit....

Në kontekst të deklaratave të tyre janë edhe fotodokumentacioni nga sektori i krim-teknikës të MPB-Tetovë në të cilën qartë shihet vendi i ndeshjes në komunikacion dhe gjendja e veturave. Pas vërtetimit të një gjendjeje të këtillë faktike gjyqi u përcaktua që fëmit ti shqiptojë masën edukuese Qortim, si proporcionale me peshën e veprës penale dhe moshën adekuate të tij, dhe përgjegjësinë, në të cilën çon fakti se fëmiu rrjedh nga familje me nivel të ulët socio-kulturor, e cila mundet ti ofrojë kushte të mira për zhvillim, zotëron me aftësi normale intelektuale, emocionalisht është i pjekur dhe stabil si dhe vetë kritik, veprën e kryer e ka të parin gabim të cilin e pranon- rrethana të cilat dalin nga konstatimi dhe mendimi i ekipit profesional të Qendrës për punë sociale Tetovë...)".

Mendoj se krahas rrethanave të shumta lehtësuese të këtij rasti të cekura në Arsyetimin e këtij Aktvendimi, gjykatat duhet të jenë më të rrepta në rastet e këtilla të shkeljeve ligjore. Veprat penale Rrezikim i sigurisë në komunikacion nga fëmijët në vendit tonë janë të shpeshta, si pasojë pikërisht e fenomenit të "neglizhencës" së prindërve/kujdestarëve të fëmijëve të cilët i'u lejojnë atyre të drejtojnë automjetet para se ato të pajisen me lejen e vozitjes, si dhe e organeve të ndjekjes dhe gjykatave të cilat tregohen "të buta" sikur në këtë

rast, duke shqiptuar masa shumë të lehta represive ndaj fëmijëve, e në këtë rast asnjë masë represive ndaj prindërve/kujdestarëve të fëmiut të cilët janë të obliguar për tu kujdesur për to.. Si pasojë e drejtimit të automjeteve motorike pa paisje me leje përkatëse për t'i drejtuar ato, nuk mungojnë raste ku fëmijët kryejnë edhe vepra penale më të rënda, deri tek ato kundër jetës dhe trupit. Prandaj, konsideroj se politika represive ndaj këtij fenomeni të përhapur duhet të jetë më e ashpër, që njëkohësisht të ketë efekt të preventivës ndaj rasteve të këtilla.

9.2.5. Rasti 5: Vjedhje grabitqare

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vjedhje grabitqare.

Pjesë nga Aktvendim i sjellur nga Gjykata Themelore Shkupi I, 2016, II. KM.nr.20/16:

" (Gjykata Themelore Shkupi I Shkup, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për fëmijë të përbërë nga Gjykatësi për fëmijë XX Kryetar i këshillit dhe gjykatësit porotë XX dhe YY, antarë të këshillit, me procesbajtës XX, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të sanksionit nga ana e Prokurorisë Themelore Shkup nr.XX/16, ndaj fëmiut në ndeshje me ligjin të moshës 14-16 vjeç nga Shkupi, për veprim që me ligj është i paraparë si vepër penale Vjedhje grabitqare sipas n.238, p.4 në lidhje me p.1 të KPM, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gojor dhe jopublik në Shkup, mbrojtësi i caktuar sipas detyrës zyrtare i fëmiut XX dhe prindi i fëmiut XX, kurse pa prezencën e përfaqësuesit të QPS Shkup, pas këshillimit në datë XX.XX.2016, e solli këtë

AKTVENDIM
NDAJ FËMIUT NË NDESHJE ME LIGJIN TË MOSHËS 14-16 VJEÇ

XX nga babai XX, nëna XX, rr.YY i lindur më XX.XX.2000, ...boshnjak, shtetas i R.M., nxënës në vitin e dytë në SHM "XX" Shkup, ndaj të cilit deri më tani nuk është shqiptuar masë edukuese, kurse janë duke u zhvilluar procedura për vepra penale të tjera sipas lëndëve XX/15, XX/16, XX/16, XX/16, XX/16.

I SHQIPTOHET **MASA EDUKUESE E ENTIT DËRGIMI NË SHTËPI EDUKUESE-PËRMIRËSUESE**, sipas n.46 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë.

Në shtëpinë edukuese-përmirësuese fëmiu do të qëndrojë së paku një vit, e më së shumti pesë vite, respektivisht deri në arritje të moshës 23 vjeçare.

Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjyqi nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj, kurse për atë do të vendosë në mënyrë plotësuese.

Në pajtim me n.100-a të Kodit penal, ndaj fëmiut XX nga Shkupi, SHQIPTOHET MASA MARRJA E SENDEVE, kështu që mjeti i cili është përdorur gjatë kryerjes së veprimit që me ligj parashihet si vepër penale dhe atë: 1 (një) kaçavidhë, i cili përkohësisht është marrë nga fëmiu XX me Vërtetim për marrje të përkohëshme të sendeve më XX.XX.2015 nga MPB Karposh n.XX, 2015, I MERRET fëmiut XX.

Shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.300,00 denarë...në pajtim me n.130, p.2 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë, bien në barrë të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Në pajtim me n.130 p.3 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë, OBLIGOHEN prindërit e fëmiut në ndeshje me ligjin të moshës 14-16 vjeçare XX nga Shkupi – XX dhe YY, të dy nga Shkupi, në mënyrë solidare ti kompenzojnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.000,00 denarë, të realizuara nga mbrojtësi i emëruar sipas detyrës zyrtare për fëmiun XX në afat prej 15 ditësh...

A r s y e t i m

Fëmiu XX në fjalimin përmbyllës deklaroi se e pranon mbrojtjen nga ana e mbrojtësit të tij. Ai përsëri deklaroi se pendohet për atë që e ka bërë dhe premton se këtë nuk do ta përsërisë.

Më XX.XX.2015, rreth orës 18,00, në rr."XX" në Shkup, fëmiu në ndeshje me ligjin i moshës 14-16 vjeçare XX, i kapur në vjedhje në shtëpinë në pronësi të të dëmtuarit XX nga Shkupi, ka përdorur forcë dhe drejtëpërdrejtë e ka sulmuar jetën dhe trupin e të dëmtuarit me përdorim të një mjeti të rrezikshëm- kaçavidhë me dorezë të kaltërt-të zezë, me qëllim që sendin e vjedhur ta mbajë, kështu që pasi ka cingëruar në zilen e derës së hyrjes disa herë dhe askush nuk e ka hapur derën, me përdorim të një mjeti të përshtatshëm forcërisht e ka hapur një nga dritaret e dhomës së ndenjes, përmes së cilës është futur brenda, e përmes shkallëve të brendshme është ngjitur në katin e epërm dhe pas kontrollimit në njërën nga dhomat e ka marrë një gjerdan me varëse në formë të kokës së tigrit me cirkone me ngjyrë ari, pastaj duke zbritur poshtë në shkallët e brendshme është ndeshur me të dëmtuarin, ndaj të cilit ka treguar kacavidhën, e në një moment është larguar nga i dëmtuari, i cili ka arritur ta kapë për tesha dhe e ka shtyrë, por fëmiu përsëri është ngritur dhe është drejtuar kah dalja, ku përsëri është kapur nga i dëmtuari dhe personi XX, i cili ka qenë në anën e jashtme të derës së hyrjes, i cili së bashku me të dëmtuarin e kanë ndaluar dhe e kanë mbajtur fëmiun XX deri në mbërritjen e Shërbimeve kompetente të SP Karposh.

....Gjyqi vërtetoi faktin se në kohën e ngjarjes, fëmiu XX me vete kishte mbajtur dhe përdorur kacavidhë, sepse ky fakt u vërtetua nga Vërtetimi për marrje të përkohshme të sendeve nga fëmiu..., por e vërtetoi me deklaratën e tij edhe fëmiu XX i cili pohoi se me vete kishte pasur kacavidhë të gjatësisë 20 cm me dorezë të zezë-kaltërt, për të cilën theksoi se e kishte gjetur dhe marrë nga një auto mekanik, e me të njejtën atë mbrëmje me dhunë e kishte hapur dritaren e dhomës së ndenjes për të hyrë në shtëpi....

....Gjatë shqiptimit të Masës edukuese të entit Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese ndaj fëmiut XX, gjyqi veçanërisht e vlerësoi rrethanën se ndaj fëmiut XX pranë kësaj gjykate po zhvillohen procedura për vepra të tjera penale sipas lëndëve, në këtë gjykatë II.KM XX,15...., ku sipas kësaj është e qartë se ndaj fëmiut XX duhet të ndërmerren masa më të gjata dhe më të ashpra për edukim dhe riedukim në ent, ku do të sigurohet dhënia e mbrojtjes dhe ndihmës fëmiut, mbikqyrja ndaj tij nga ana e personave profesionalë, mbrojtja shëndetësore e tij, arsimi i tij dhe aftësimi profesional dhe zhvillimi i përgjegjësisë së tij, me të cilat do të arrihet në edukimin e tij, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë në të ardhmen. Në këtë mënyrë do të përmbushet qëllimi i masave edukuese nga neni 35 i Ligjit mbi drejtësinë për fëmijë, me plotësimin e të cilit gjyqi ka pritshmëri se fëmiu në të ardhmen do ta përputh sjelljen e tij me normat e përgjithshme të pranuara shoqërore dhe nuk do të kryejë vepra të tjera penale, me të cilën do të arrihet në edukimin dhe zhvillimin e suksesshëm të tij...)".

Nga rasti i paraqitur më lartë –Vjedhje grabitqare, në grupin e veprave penale kundër pasurisë mund të nxjerrim një pasqyrim rreth mënyrës së kryerjes së veprave penale të këtij lloji nga ana e fëmijëve, duke marrë parasysh faktin se shpesh ato kryhen nga fëmijët . Pra, në kërë rast mjeti të cilin e ka përdorur fëmiu për ta kryer veprën penale, ka qenë një kaçavidhë-mjet të cilin e ka gjetur ditën e kryerjes së veprës penale në hapsirën e një auto-

mekaniku. Kjo është një karakteristikë e cila sqarohet nga metodika kriminalistiske për sa i përket mënyrës së kryerjes së veprave penale të kësaj natyre nga ana e fëmijëve.

Pra, fëmijët zakonisht përdorin mjete të cilat i gjejnë lehtë dhe shpesh rastësisht në ambientet ku ata gjenden. Ato janë objekte, sende të cilat shërbejnë për përdorim të zakonshëm, si thika të kuzhinës, gurë, shkopinjë, mjete të ndryshme mekanike etj. Megjithatë, në rastin konkret (rasti 4), bëhet fjalë për fëmijë recidivist, ndonëse të pa gjykuar më parë, por ndaj të cilit paralelisht zhvillohen edhe disa procedura të tjera gjyqësore penale. Prandaj, konsederoj se gjykata i ka shqiptuar masë adekuate këtij fëmiu, i cili ka nevojë për një trajtim afatgjatë në Shtëpinë edukuese-përmirësuese.

9.2.6. Rasti 6: Lëndim i rëndë trupor dhe Lëndim trupor

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprave penale Shkaktim i lëndimit të rëndë trupor dhe lShkaktim i lëndimit trupor.

Pjesë nga Aktvendim i sjellur nga Gjykata Themelore Shkupi I, 2014, I KM-210/14:

" (Gjykata Themelore Shkupi I Shkup, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Këshill për fëmijë të përbërë nga Gjykatësi për fëmijë XX kryetar i këshillit dhe gjykatësit porotë XX dhe YY, antarë të këshillit, me procesmbajtës XX, duke vendosur sipas Propozimit për shqiptim të sanksionit me propozim për vazhdim të masës paraburgim shtëpiak nga ana e Prokurorisë Themelore Shkup nr.XX/14, ndaj fëmiut në ndeshje me ligjin të moshës mbi 16 vjeç nga Shkupi, për veprime që me ligj janë paraparë si një vepër penale – Lëndim i rëndë trupor sipas n.131, p.3 të KPM, dhe një vepër penale – Lëndim trupor sipas n, 130, p.1 të KPM, pas mbajtjes së seancës së këshillit në prani të PP nga PTHP Shkup, fëmiu XX i sjellur nga paraburgimi shtëpiak, prindërit e fëmiut X dhe Y, mbrojtësi i caktuar sipas detyrës zyrtare i fëmiut XX , përfaqësuesi i QPS i qytetit të Shkupit dhe përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarve avokat X nga Shkupi, pas këshillimit në datë XX.XX.2016, e solli këtë

AKTVENDIM

NDAJ FËMIUT NË NDESHJE ME LIGJIN TË MOSHËS MBI 16 VJEÇARE

XX me nr amze XX nga babai X dhe nëna Y, i lindur më X.X.1997 në Shkup, ku dhe jeton, adresa XX, maqedonas, shtetas i R.M., me shkollë fillore të kryer, nuk i janë shqiptuar masa edukuese më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohen procedura të tjera. Me Vendim nga gjykatësi për fëmijë në Gjykatën Themelore Shkupi 1 – Shkup I KM.nr. X/2014 nga X.X.201, i'u caktua masa paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, llogarritur nga X. 2014 deri X.2014, masë e cila i'u vazhdua me Vendim KM.nr.X/2014 edhe për 30 ditë llogarritur nga ..., kurse me Vendim KM.nr.X/2014... i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i caktohet masa paraburgim shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 ditësh, llogarritur nga X/2014 deri X/2015. Me Vendim KM.nr.X/2014 nga X.X.2015 fëmiut i ndërpritet masa paraburgim shtëpiak.

I SHQIPTOHET **MASA EDUKUESE MBIKQYRJE E PËRFORCUAR NGA ANA E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE**, në pajtim me n.43 nga Ligji mbi drejtësinë për fëmijë.

Masa e shqiptuar nuk mund të zgjasë më shkurtë se një vjet, e as më gjatë se tri vite, kurse gjyqi do të vendosë në mënyrë plotësuese për përfundimin e kësaj mase.

Në pajtim me n.130, p.1 nga LDF, të dëmtuarit X dhe Y, për kërkesën pasurore të paralajmëruar drejtohen që të njejtën ta realizojnë në kontest civil.

Në pajtim me n.130, p.3 nga LDF, obligohen prindërit e fëmiut që shpenzimet e procedurës të realizuara gjatë procedurës në shumë prej 4.000,oo denarë ....ti kompenzojnë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e Vendimit.

A r s y e t i m

PTHP Shkup deri te kjo gjykatë më X.X. 2015 parashtroi Propozim për shqiptim të sanksionit me propozim për vazhdim të masës paraburgim shtëpiak KOD.nr.X/14 nga X.X.2016, ndaj fëmiut në ndeshje me ligjin mbi 16 vjeç XX nga Shkupi, për veprimet e parapara me ligj si një vepër penale – Lëndim i rëndë trupor nga n.131, p.3 i KPM dhe vepra penale –Lëndim trupor nga n.130, p.1 i KPM, me propozim që gjyqi pas mbajtjes së seancës t'i shqiptojë një nga sanksionet në pajtim me n.35 të Ligjit për drejtësinë për fëmijë.

...Situatën e këtillë faktike, gjyqi e vërtetoi nga provat e shqyrtuara materiale dhe personale. I dëmtuari XX në dëshminë e tij e përshkruan rastin juridiko penal kështu që thekson se në mbrëmjen kritike bashkë me të dëmtuarin YY kanë vrapuar në lagjen X dhe Z, e kur kanë ardhur në lagjen Z ai ka filluar të vrapojë para të dëmtuarit Y, e ka qenë në largësi prej 50 metra nga ai, e në një moment është kthyer pas për të parë nëse Z e ndjek atë. Atëherë ka parë Y se është drejtuar kah dy persona të panjohur nga të cilët njëri ka qenë në pozitë gjysmë të shtrirë në një shtyllë betoni, ndërsa tjetri në një largësi prej 3 metrash, e kur Y është ofruar drejtë tyre është përshëndetur dhe ka filluar diçka të flasë me ta. Për të parë se ç'ka po ndodh edhe ai është drejtuar kah ata, e në atë moment ka ardhur edhe një person i tretë i cili kishte qëndruar mes banesave Y dhe i është drejtuar me:"Çka po më shikon!". Atëherë fëmiu i cili qëndronte në pozitë gjysmë të shtrirë me thikën të cilën e kishte mbajtur me vete e kishte shpuar atë në pjesën e parme të anës së fundit të këmbës së majtë, e pastaj me thikën e njejtë e ka shpuar edhe X në pjesën e parme të këmbëve, e kështu të frikësuar nga ngjarja dhe duke ndjerë dhimbje kanë filluar të ikin drejtë stacionit të autobusëve dhe duke e kaluar rrugën i dëmtuari X e humb vetëdijen dhe ka rënë në tokë i tëri i mbuluar në gjak. Në atë moment është oftuar një nga të punësuarit e pompës së benzinës "X" e sepse mesiguri dikush ka thirrur automjetin e ndihmës së shpejtë e cila kishte mbëritur pas një kohe, së bashku të dy të dëmtuarit ishin dërguar në qendrën urgjente....)"

Gjatë shqiptimit të masës edukuese ndaj fëmiut, gjyqi posaçërisht kishte çmuar rrethanën se prindërit e fëmiut nuk kanë qenë në gjendje të ushtrojnë mbikqyrje të përforcuar ndaj tij që ai të mos kryejë vepër penale, si dhe gatishmërinë e tyre për bashkëpunim me Qendrën. Gjyqi ndaj fëmiut shqiptoi masë Mbikqyrje e shtuar nga ana e Qendrës, me qëllim që Qendra të ndikojë favorshëm ndaj tij dhe ta mbikqyrë atë që në të ardhmen të mos kryejë tjetër vepër penale. Gjyqi në këtë rast ka konsideruar se me ekzekutimin e masës edukuese të shqiptuar do të arrihet qëllimi i masave edukuese i përcaktuar me n.37 të Ligjit për

drejtësinë për fëmijë, në planin e sigurimit të mbrojtjes dhe ndihmës fëmiut, që të arrihet edukimi, riedukimi dhe zhvillimi i drejtë i tij. Poashtu gjyqi i'a ka bërë me dije fëmiut dhe prindit të tij se do ta ndjekë ekzekutimin e masës së shqiptuar edukuese dhe nëse bindet se nuk janë arritur rezultate pozitive në edukimin dhe riedukimin e fëmiut, gjyqi mund ta ndërrojë masën edukuese me masë tjetër edukuese me të cilën mund të arrihet edukim dhe riedukim i suksesshëm i fëmiut.

9.2.7. Rasti 7: Vrasje

Në vazhdim është paraqitur një rast i fëmiut të gjykuar për kryerje të veprës penale Vrasje.

Pjesë nga Vendimi në Seancë të Përgjithshme - Zbatim i gabuar i Kodit penal, i sjellur nga Gjykata Supreme e R.M.-së më 9/2008:

"(" NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË"
GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, në Seancë të përgjithshme nën kryesi të kryetarit të Gjykatës Supreme të R.M. me procesmbajtës – Sekretari gjeneral i gjykatës, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë III. KO3.nr. 3/2008 nga 19.03.2008, kundër Aktgjykimit të Këshillit për vendosje sipas kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Supreme të R.M. K.nr.211/07 nga 10.10.2007, të mbajtur më 24.06.2008, në prani të Prokurorit të përgjithshëm nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, K.n. në pajtim me n.35, p.1, al.6 të Ligjit mbi gjykatat dhe n.22, p.8 dhe n.308 të Ligjit të procedurës penale, solli:

AKTGJYKIM

Kërkesa e Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë për mbrojtje të ligjshmërisë III. nr.3/2008 nga 10.03.2008, PRANOHET.

Aktgjykimi i Këshillit për vendosje sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë nr.211/07 nga 18.10.2007, NDRYSHOHET DHE VENDOSET: Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në K. KM.nr.7/06 nga 16.03.2007 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në S. КЖМ. nr.7/07 nga 21.05.2007, parashtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, të miturit të vjetër B.S. nga K. V.T. mbrojtës nga B. Dhe J.T. , mbrojtësi nga S., REFUZOHET SI E PA BAZË.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në K. me Aktgjykim nr. 7/06 –I nga 16.03.2007, të akuzuarin, të miturin e vjetër V.S. nga K. E shpalli fajtor për veprën penale "Vrasje" sipas nenit 123, p.1 të KPM dhe e dënoi me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 8-tetë vjet dhe 6-gjashtë muaj, me të cilin i kishte llogarritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, të llogarritur nga 06.09.2006. Ndaj të akuzuarit ishte shqiptuar edhe masa e sigurisë – marrja e sendeve, nga i cili ishin marrë: Pistoleta gjysmëautomatike e tipit "Numerator çek" model 50, kalibër 7,65 me numër fabrike C15082, me një kornizë me 45 plumba.
I akuzuari ishte obliguar të paguajë 4.000,00 denarë në emër të shpenzimeve gjyqësore paushale dhe ti kompenzojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 29.900,00 denarë, tërë në afat prej 15

ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. I dëmtuari T.S. për kërkesën e parashtruar pasurore-juridike është drejtuar në kontest të rregullt civil.
Gjykata e Apelit në S. me Aktgjykim nr.7/2007 nga 21.05.2007, ankesën e të akuzuarit, të miturit të vjetër V.S. të parashtruar përmes mbrojtësve V.T., B i J.T., pjesërisht e ka pranuar, aktgjykimin e Gjykatës Themelore nr.7/2006-I nga 16.03.2007, e ka ndryshuar vetëm në pjesën që i referohet vendimit për sanksionin penal, kështu që i akuzuari, i mituri i vjetër V.S., për veprën penale "Vrasje", sipas n.123, p.1 nga KPM, përshkruar në aktgjykimin e ankimuar, për të cilën është shpallur fajtor, e është dënuar me dënim burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 5-pesë vitesh, në të cilën i'a ka llogarritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, nga X.YY.2006 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Në pjesën tjetër Aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.
Duke vendosur në bazë të Kërkesës për Rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm, të parashtruar nga mbrojtësit e të dënuarit, të miturit të vjetër V.S. nga K., mbrojtësi V.T. dhe J.T, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për vepra penale, me aktgjykimin e goditur nr. 211.2007 nga X.YY.2007, ka ardhur në qëndrimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar elementet ligjore të veprës penale Vrasje nga n.123, p.1 i Kodit penal.
Sipas mendimit të Këshillit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë në veprimin e të dënuarit, të miturit të vjetër V.S. janë të përmledhura elementet e veprës penale "Vrasje nga pakujdesia" sipas nenit 126 të KPM, sepse nuk ka qenë e dëshmuar se i dënuari ka vepruar sipas një vendimi të marrë paraprakisht për të shkrepur me pistoletën, sipas të cilës aktgjykimin e plotëfuqishëm e ka ndryshuar, për zbatim të drejtë të Kodit penal, kështu që veprimet e të miturit të vjetër V.S. të përshkruara në aktgjykimin e plotëfuqishëm, i ka kualifikuar në veprën penale " Vrasje nga pakujdesia" sipas nenit 126 nga KPM. Në pjesën tjetër aktgjykimet e goditura i ka vërtetuar.
Kundër vendimit të Këshillit të Gjykatës Supreme të R.M. , Prokurori Publik i R.M., ngriti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë III.KO3.nr.3/08 nga 19.03.2008, për lëndime thelbësore të dispozitave të procedurës penale sipas n.355, p.2, al.11 në lidhje me n.355, p.2 në lidhje me n.415,408,p.1 dhe n.409 nga Ligji i procedurës penale dhe për shkak të lëndimit të Kodit penal nga n.356, al.5 nga Ligji i procedurës penale.
Prokurori Publik i R.M. theksoi se Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. në këndvështrim të veprës penale që ka qenë objekt i akuzës ka zbatuar Ligj i cili nuk ka mundur të zbatohet.
Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. atë e ka bërë në mënyrë duke mos e pranuar kualifikimin ligjor të veprës penale, objekt i aktgjykimit të plotëfuqishëm të goditur, "Vrasje" sipas n.123, p.1 nga KPM por ka pranuar se është kryer vepra penale Vrasje nga pakujdesia sipas n.126 nga KPM.
Në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë vërtetohet se Këshilli i Gjykatës Supreme të R.M. nuk ka mundur veprimet e përshkruara në Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore t'i vendosë nën nocionin *Pakujdesi*. Përshkrim i tillë i elementeve të rëndësishme të veprës penale nga neni 126 i KP, në rastin konkret nuk ekzistojnë dhe prova të tilla gjatë procedurës së shkallës së parë dhe të dytë nuk janë shqyrtuar, e as një gjë e tillë nuk ka ndodhur para Këshillit të Gjykatës Supreme të R.M.-së. Nga kjo, me aktgjykimin e goditur në të kundërtën e elementeve të veprës penale e cila ka qenë objekt i akuzës është zbatuar Ligj i cili nuk mund të zbatohet dhe në atë mënyrë aktgjykimi i sulmuar është i pakuptimtë, ndërsa faktet vendimtare në vendim janë nën dyshim dhe janë të kundërta me dispozitat e Ligjit të procedurës penale sepse Gjykata e ndryshon gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykim të shkallës së parë dhe të dytë...
...Seanca e përgjithshme konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar...
...Nga përmbajtja e aktgjykimeve të gjykatave më të ulta del se ata kanë pranuar ekzistimin e veprës penale "Vrasje" nga neni 123, p.1 nga KP, të cilën i mituri i vjetër V.S. e ka kryer në mënyrë që me X.YY.2006 rreth orës 12,00 në K.në shtëpinë e tij me të shtënë nga pistoleta e ka privuar nga jeta të dëmtuarën e mitur M.T. nga K., edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se si pasojë e atyre veprimeve mund të pësojë pasojë e dëmshme, por është pajtuar me ndodhjen e saj, në mënyrë që pasi të dy paraprakisht janë marrë vesh se pas mbarimit të orëve mësimore të ndrimit të parë të shkonin tek shtëpia e tij dhe pasi nga dollapi në dhomën e fjetjes ka nxjerrur pistoletën gjysmëautomatike të tipit

"Numrator çek", model 50 kalibri 7,65 me numër fabrike C 15082, pronë e babait të tij, pasi që paraprakisht ka kontrolluar a përban brenda municion dhe e ka pregaditur, ka shkrepur një plumb në gjysmën e majtë të ballit të saj, nga çka proektili metalik ka hyrë në pjesën e parme të kokës, ka çarrë lëkurën dhe kockën e ballit dhe ka dalë në pjesën e pasme të kockës së epërme së djathtë, prej nga ka ardhur deri në tronditje të indit të trurit, ku si pasojë ka ndodhur vdekja tek e mitura M.T...)"

Në rastin penalo-juridik konkret, sipas gjetjeve të Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të R.M. me siguri mund të vërtetohet se i dënuari është pajtuar me ndodhjen e pasojës së dëmshme. Kështi që, faktet të cilat janë të pakontestueshme në tërë pjesën rreth veprimeve të tij, posaçërisht shpejtësia dhe aftësia për ta vendosur në gjendje të përdorimit pistoletën, shpiejnë në përfundimin se i dënuari në asnjë moment nuk ka mundur të presë se nga veprimi i armës që e ka përdorur nuk do të ndodhë pasoja e dëmshme, ose se do ta largonte nëse e njejta do të ndodhte. Nëse merret parasysh edhe rrethana konkrete se pasoja ka ndodhur- vdekja e të dëmtuarës, ekziston vetëm një përfundim i mundshëm, e kjo që i dënuari ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit të tij mund të ndodhte pasoja e dëmshme, por është pajtuar me ndodhjen e saj. Përshkak të gjithë asaj që është përmendur më lartë, Gjykata Supreme e R.M.-së në Seancën e përgjithshme, kërkesën për mbrotje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori publik i R.M. III KO#.nr.3/2008 nga X.YY.2008 kundër Aktgjykimit të Këshillit për vendosje sipas Kërkesës për Rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm në sektorin e veprave penale në Gjykatën Supreme të R.M. nr. 211/07 nga XX.Y.2007, e pranoi dhe aktgjykimin e goditur e ndryshoi në mënyrë që Kërkesën për rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të plotëfuqishëm të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në K. Nr.06-I nga 16.03.2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Sh. Nr.7/2007 nga 21.05.2007, e refuzoi si të pabazuar (ЗБИРКА на судски одлуки 2004-2014, (11), 2015,f. 10-16).

Qëllimi i paraqitjes së vendimeve gjyqësore në këtë kapitull, duke përshkruar Dispozitivin e tyre, si dhe pjesë të caktuara të Arsyetimit të tyre ishte pasqyrimi i rasteve të caktuara penale me të cilët fëmijët e gjykuar janë shpallur fajtorë për kryerje të veprave penale. Nga këto raste, mund të nxjerrim në pah disa elementeve të rëndësishme si:

- ***Lloji i veprave penale*** të cilat i kanë kryer fëmijët – Janë përzgjedhur raste të veprave të ndryshme penale, si: ***Vrasje*** (rasti 1 dhe 7); ***Vjedhje e rëndë*** (rasti 2); ***Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prokusorëve*** (rasti 3); ***Rrezikim i sigurisë në***

komunikacionin publik (rasti 4); ***Vjedhje grabitqare*** (rasti 5); ***Shkaktim i lëndimit të rëndë trupor dhe Lëndimit (të lehtë) trupor*** (rasti 6). Nga këto raste mund të përfundojmë se fëmijët paraqiten si kryes të veprave të ndryshme penale, sikurse edhe kryesit madhorë. Ndonëse nga të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror Statistikor Republikës së Maqedonisë mund të vërehet se fëmijët kryejnë më së shpeshti krime kundër pasurisë, megjithatë nuk mungojnë edhe raste të veprave penale të ndryshme nga atofëmijët paraqiten si kryes të tyre. Shiç shihet nga rastet e paraqitura më lartë, fëmijët mund të kryejnë edhe vepra penale shumë më të rënda sesa p.sh. vjedhjet, dhe atë krime kundër jetës dhe trupit, si vrasje, lëndime të rënda trupore; Tregti me lëndë narkotike etj.

- ***Mënyra e kryerjes së veprës penale*** – Nga vendimet gjyqësore të paraqitura më lartë, mund të analizohet se si fëmijët i manifestojnë sjelljet kriminale gjatë kryerjes së veprave penale. Poashtu dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, si: mjeti i përdorur për kryerjen e veprës penale; objekti i sulmit – viktima (Në dy rastet e paraqitura viktima ishte fëmijë i cili kishte pësuar me pasojë privim nga jeta!); sjellja e fëmiut pas kryerjes së veprës penale; cilësia e fëmiut – si kryes primar apo recidivist etj.
- ***Lloji i sanksionit penal*** që gjykatat u'a kanë shqiptur fëmijëve të gjykuar për veprën penale përkatëse – janë përzgjedhur vendime me të cilat gjykatat kishin shqiptuar lloje të ndryshme të sanksioneve penale, disa lloje të masave edukuese, por nuk mungojnë edhe raste ku gjykatat kanë shqiptuar dënimin me burgim për fëmijë.

PËRFUNDIME

Në këtë pjesë janë paraqitur përfundimet lidhur me pyetjet hulumtuese të cilat kanë qenë baza e hulumtimit të këtij punimi:

1. Lidhur me hipotezën e parë të punimit "***Cili është vendi i të drejtës penale për fëmijë në sistemin juridiko-penal në raport me të drejtën penale në kuptimin e gjërë? A paraqet ajo degë të pavarur të së drejtës nga e drejta penale për persona madhorë?",*** mund të përfundohet se e drejta penale për fëmijë paraqet një nëndegë të të drejtës penale në kuptimin e gjërë. Kjo sepse, drejtësia penale për fëmijë është pavarësuar nga e drejta penale për personat madhorë me aktin e sjelljes së Ligjit për drejtësinë e të miturve në vitin 2007 (hyrja në fuqi 2009), poashtu edhe ligji pozitiv mbi drejtësinë e fëmijëve nga viti 2013 vetëm se e ka përsosur drejtësinë penale për fëmijë si vazhdim i reformës së vitit 2007.

Me vetë faktin se me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kategorizimin e fëmijëve, respektivisht personave jo madhorë sipas moshës, çështjet rreth sanksionimit të tyre për vepra penale dhe kundërvajtje, procedurat penale dhe ato kundërvajtëse, procedurat e veçanta për shqiptimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes – si p.sh. Procedura e ndërmjetësimit, çështjet rreth parandalimit të kriminalitetit të fëmijëve- kompetencat e organeve shtetërore për parandalimin e këtij fenomeni mund të përfundohet se e drejta penale për fëmijë është e pavarur nga dy degët e së drejtës penale në kuptimin e gjërë – e drejta penale materiale dhe procedurale, por jo edhe nga ajo ekzekutive. Kjo sepse, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve ngelet burim kryesor i brendshëm i të drejtës penale për fëmijë së bashku me Ligjin për drejtësinë e fëmijëve dhe Kushtetutën e vendit.

Edhe pse me Ligjin për drejtësinë për fëmijë rregullohen çështje të natyrës materiale dhe procedurale të cilat vlejnë për fëmijët në rrezik dhe ato në konflikt me ligjin, sërisht vinë në shprehje zbatimi i dispozitave të Kodit penal nga pjesa e përgjithshme, si p.sh. përcaktimi i shkallës dhe formës së fajit, apo shkaqet për përjashtimin e kundërligjshmërisë etj. Apo tek çështjet e natyrës procedurale si p.sh. Përcaktimi i kompetencës së gjykatës që do ta procedojë çështjen penale ndaj fëmiut, zbatohen dispozitat e Ligjit të procedurës penale.

Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve përmbanë dispozita që rregullojnë vetëm ekzekutimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes, por jo edhe të sanksioneve penale. Ligji përcakton vetëm

se gjatë ekzekutimit të masave edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar, gjyqi mund t'i caktojë fëmiut një apo më tepër obligime për zbatim më të suksesshëm të asaj mase. Dispozita të tjera të natyrës së të drejtës mbi ekzekutimin e sanksioneve penale LDF nuk përmban, prandaj edhe Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve ngelet burim kryesor i kësaj dege të së drejtës. Andaj, mund të përfundohet se në sistemin juridiko-penal të Republikës së Maqedonisë ekziston një degë e veçantë e të drejtës penale për fëmijët, por që njëkohësisht qëndron e varur nga e drejta penale e përgjithshme, në kuptimin e gjërë, pra me një përkufizim më të drejtë mund të thuhet se ajo paraqet një nëndegë të së drejtës penale.

2. Për hipotezën e dytë: "**Sa është arritur qëllimi i parandalimit special të sanksioneve penale tek fëmijët e gjykuar për vepra penale në Republikën e Maqedonisë?** ***(Mjaftueshëm apo jomjaftueshëm?)"*** janë arritur këto përfundime:

2.1. Për të konkluduar se sa është realizuar ky qëllim, duhet vështruar treguesit statistikor rreth ecurisë së kriminalitetit të fëmijëve në vendin tonë. Të dhënat statistikore të publikuara nga Enti Shtetëror Statistikor për periudhën kohore 2006-2015 pasqyrojnë rezultate që qartësojnë këtë dilemë.

- Gjatë periudhës kohore 2006-2015 në Republikën e Maqedonisë numri më i madh i fëmijëve janë gjykuar për vepra penale kundër pasurisë. Në vend të dytë janë ata të gjykuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit, më pas për vepra penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe për veprat penale kundër rendit publik. Poashtu edhe pse në numër më të vogël nuk mungojnë edhe fëmijët e gjykuar për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, për vepra penale kundër nderit dhe autoritetit, vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, vepra penale kundër shëndetit të njerëzve, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës, vepra penale kundër drejtësisë etj.
- Për periudhën kohore 2006-2015 shihet tendenca e rrënies së fenomenit të kriminalitetit të fëmijëve. Kjo shihet nga numri i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe nga numri i fëmijëve të gjykuar! Për dekadën e fundit në vendin tonë numri i fëmijëve të paraqitur ka shkuar në rrënie konstante nga viti në vit, e për krahasim të vitit 2006 dhe atij 2015 diferenca është deri në 50%, njejtë sikurse edhe numri i atyre të akuzuar dhe të

gjykuar. Në vitin 2006 datojnë në të dhënat zyrtare 1500 fëmijë të paraqitur, kurse në vitin 2015 vetëm 772 të paraqitur. Në vitin 2006 datojnë 987 fëmijë të akuzuar kurse në vitin 2015 – 465 fëmijë! Në vitin 2006 datojnë 844 fëmijë të dënuar kurse në vitin 2015 vetëm 348! Ç'do vit nga 2006-2015 vërehet një tendencë e uljes afërsisht në 100 fëmijë në secilën nga këto tre kategori të hulumtimit tek numri i fëmijëve të paraqitur, të akuzuar dhe të gjykuar! Është një tregues shumë pozitiv trendi i kësaj rrënieje permanente.

- Gjatë periudhës kohore 2006-2015, masa edukuese e shqiptuar më shpeshë ndaj fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare ka qenë masa Mbikqyrje e përforcuar nga ana e prindit, kurse pas saj masa Mbikqyrja e përforcur nga ana e Qendës për punë sociale. Në numër të konsiderueshëm është shqiptuar edhe masa disiplinore Qortimi, e më pak në numër masat e enteve. Masa disiplinore Dërgimi në Qendër disiplinore është shqiptuar vetëm një herë gjatë viteve 2007-2015, kurse masa Mbikqyrja e shtuar nga familja tjetër as një herë.
- Masa më e shpeshtë e shqiptuar ndaj fëmijëve të gjykuar të moshës 16-18 vjeçare ka qenë masa e Mbikqyrjes së shtuar nga prindi dhe masa e Mbikqyrjes së shtuar nga qendra sociale. Pas tyre në numër pason masa disiplinore Qortimi, kurse më pak të shqiptuara janë masat e enteve. Ndaj kësaj kategorie të fëmijëve gjykatat në asnjë rast nuk i kanë shqiptuar masat Dërgimi në Qendrën disiplinore dhe masën e Mbikqyrjes së shtuar nga familja tjetër.
- Nga gjithsej numri i fëmijëve të gjykuar të moshës 14-18 vjeçare shumica e tyre që janë të gjykuar janë të grupmoshës 16-18 vjeçare. Ndaj kësaj kategorie të fëmijëve është shqiptuar krahas masave edukuese në disa raste edhe dënimi me burgim për fëmijë. Numri i dënimeve me burgim në krahasim me numrin e masave edukuese të shqiptuara ndaj fëmijëve është shumë i vogël. Në këtë rast shihet se është respektuar edhe parimi i proklamuar në Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve: *Privimi nga liria i fëmiut është mjet i fundit në procedurë..(*n. 10).
- Gjatë periudhës 2006-2015 sipas të dhënave të Entit Shtetëror statistikor, asnjë nga këto dënime të parapara me LDF (neni 50) nuk është shqiptuar asnjëherë ndaj fëmijëve të gjykuar për vepra penale, si: Dënim me para, ndalim i drejtimit të

automjetit motorik të llojit ose kategorisë së caktuar dhe dëbim i të huajit nga vendi. I vetmi dënim i shqiptuar ndaj fëmijëve është dënimi me burg.

- Gjatë vitit 2014 më së shumti janë kryer vepra penale nga fëmijë në komunën Kisella Vodë, në Gazi Babë, Karposh, Qendër, Tetovë dhe Çair. Format më të shpeshta të veprave penale të kryera gjatë këtij viti në të gjitha këto vendbanime të lartëpërmendura janë ato kundër pasurisë dhe kundër rendit publik.
- Në krahasim me numrin e fëmijëve të gjykuar me ato madhorët, për të gjitha veprat penale gjatë periudhës dhjetë vjeçare të hulumtimit, s'do mend se ai numër është shumë më i vogël, deri në tridhjetë herë. Kjo paraqet një tregues pozitiv, se fëmijët në krahasim me personat madhorë paraqiten shumë herë më rrallë si kryes të veprave penale. Numri i personave madhorë të gjykuar qëndron në një konstante rreth numrit 9000 deri në 10000, kurse numri i fëmijëve të gjykuar shënon rrënie permanente nga 822 deri vitin e fundit të hulumtimit (2015) në 348.
- Fëmijët e gjinisë femrore janë shumë herë më pak të prirur në krahasim me gjininë mashkullore për të kryer vepra penale, e kjo shihet nga përqindja shumë e vogël e evidentuar e tyre si të gjykuara gjatë viteve 2007-2015. Ka një gjendje relativisht stabile me një mesatare që lëviz mes 20 deri 40 fëmijë femra të gjykuara brenda ç'do viti.
- Sipas të dhënave të publikuara nga Këshilli shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, gjatë vitit 2015 ndaj 70% të fëmijëve në rrezik, Qendrat për punë sociale kanë zbatuar masa të ndihmës dhe mbrojtjes, kurse ndërmjetësimin si një nga këto masa e kanë zbatuar ndaj 6.3% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në rrezik, që paraqet një rritje të vogël në aplikim e kësaj mase në krahasim me vitin 2014 me diferencë prej 2%.

2.2. Gjatë vizitës së realizuar në institucionet penitensiare në vitin 2017, ku fëmijët e gjykuar i vuajnë sanksionet me heqje lirie: Masën e entit Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese - Tetovë dhe dënimi me burg për fëmijë- Ohër dhe nga rezultatet e nxjerrura nga anketat e realizuata me fëmijët e gjykuar, u konstatua:

- Fëmijët e gjykuar me masën e entit Dërgim në shtëpi edukuese përmirëuese e vuajnë këtë masë vite me rradhë në objektin e njejtë të burgut për fëmijë së bashku me fëmijët e dënuar me dënimin me burg!
- Është në ndërtim e sipër një objekt i ri i Shtëpisë edukuese-përmirësuese në afërsi të qytetit të Gostivarit, por për momentin Shtëpia edukuese-përmirësuese Tetovë nuk i plotëson standardet ligjore dhe ato ndërkombëtare për strehimin e fëmijëve dhe zbatimin e kësaj mase edukuese.
- Objekti i burgut për fëmijë në Ohër është i vogël dhe me kushte banesore jo të pranueshme me standardet nacionale dhe ndërkombëtare për edukimin e fëmijëve.
- Fëmijët e gjykuar me masën Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese Tetovë dhe ata të dënuar me burg për fëmijë Ohër nuk janë të kyçur në sistemin edukativo-arsimor!
- Fëmijëve të vendosur në ent nuk i'u sigurohet mbrojtje e duhur shëndetësore – mungesa e një mjeku të përgjithshëm , e një stomatologu etj. Gjendja e shëndetit oral e fëmijëve në këtë ent ishte shumë e keqe.
- Kushtet e lartëpërmendura jo të kënaqshme në objektin e burgut për fëmijë – nuk ofrojnë mundësi për edukimin, resocializimin e fëmijëve të gjykuar dhe arritjen e parandalimit special të dënimit/masës së entit tek ata.

3. Lidhur me hipotezën "**Sa është e harmonizuar politika penale e Republikës së Maqedonisë ndaj kriminalitetit të fëmijëve në raport me kërkesat dhe trendet ndërkombëtare në këtë drejtim?** ***(Mjaftueshëm apo jo mjaftueshëm?)",*** këto janë konstatimet në vazhdim:

- Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës (1989) është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 2 Dhjetor 1993.
- Me unifikimin e drejtësisë penale për fëmijë me një ligj të veçantë, Republika e Maqedonisë është duke i përmbushur obligimet e përcaktuara me Konventën për të drejtat e fëmijës.
- Politika represive dhe preventive e Republikës së Maqedonisë në drejtim të harmonzimit të legjislacionit ka shënuar progres dhe është në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare të cilat rregullojnë drejtësinë penale për fëmijë: Konventën

e OKB-së për të drejtat e fëmijës (1989), Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit);

- Ngecja e vendit nuk qëndron në harminizimin e legjislacionit në pajtim me kërkesat ndërkombëtare, por në zbatimin e tij në praktikë.
- Veçanërisht, problemi është i theksuar në respektimin e Rregullave Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985) dhe Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990) si dhe posaçërisht të Konventës së OKB-së mbi të drejtat e fëmijës – gjatë **ekzekutimit** të masave edukuese dhe sanksioneve penale ndaj fëmijëve.
- Republika e Maqedonisë parasheh një minimum dhe maksimum ligjor të moshës për përcaktimin e përgjegjësisë penale të fëmijëve i cili është i pranueshëm dhe në pajtim me dispozitat e Konventës për të drejtat e fëmijëve.
- Sikurse shtetet fqinje Shqipëria, Kosova, ato të rajonit -Kroacia edhe vendi ynë ka marrë parasyshë rekomandimet e Komitetit pët të drejtat e njeriut duke i përmbushur detyrimet që dalin nga Konventa për të drejtat e njeriut, së pari me vetë sjelljen e ligjit të posaçëm që rregullon drejtësinë penale për fëmijët.
- Republika e Maqedonisë në krahasim me shtetet e përmendura ka shkuar më larg në drejtim të progresit në këtë aspekt dhe në pajtim me dispozitat e Konventës, duke i emërtuar të gjithë personat jomadhorë me emërtimin "fëmijë" me specifikat e përcaktuara në ligjin pozitiv për drejtësinë e fëmijëve(2013) (fëmijë në rrezik, fëmijë në ndeshje me ligjin), duke e larguar emërtimin "i mitur" , me ç'ka shtetet e lartëpërmendura ende e kanë ruajtur emërtimin "i mitur" dhe duke e mbajtur emërtimin "fëmijë" për personat të cilët janë të përjashtuar nga sfera penale për shkak të moshës së tyre (fëmijë në këto legjislacione janë personat nën moshën 14 vjeçare).
- Në krahasim me vendet evropjane, si Zvicra e cila poshtu ka miratuar ligj të veçantë për drejtësinë e fëmijëve, Holanda dhe Norvegjia të cilat e rregullojnë drejtësinë e fëmijëve

me disa ligje penale si Kodi penal, Kodi i procedurës penale, pra, nuk kanë miratuar një ligj të veçantë në këtë drejtim. Legjislacioni i vendit tonë dallon në shumë pika me legjislacionet e vendeve të lartëpërmendura, jo vetëm në drejtimin e unifikimit të kësaj dege të së drejtës, por edhe në përcaktimin e minimumit të moshës për përgjegjësi penale, me ç'rast disa nga ato parashohin një moshë minimale shumë më të ulët se vendi ynë, si Holanda- moshën dymbëdhjetë vjeçare dhe Zvicra- moshën dhjetëvjeçare, Anglia – moshën dhjetëvjeçare, ndërkaq Norvegjia p.sh. parasheh një minimum pak më të lartë - moshën 15 vjeçare.

- Shtetet dallojnë poashtu në përcaktimin e moshës minimale për shqiptimin e dënimit me burg për fëmijë, me ç'rast sikurse edhe Republika e Maqedonisë, shumica e tyre janë përcaktuar në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare (Shqipëria, Kosova, Kroacia dhe Holanda), disa të tjera kanë përcaktuar një minimum moshe pak më të ulët në krahasim me të parat – Zvicra, Norvegjia dhe Welsi në atë pesëmbëdhjetë vjeçare, kurse Anglia ngelet në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Të gjitha shtetet e përmendura, të cilat janë trajtuar më lartë në punim, kanë pikë të përbashkët përcaktimin e moshës maksimale të përfundimit të "miturisë" – atë 18 vjeçare.
- Shtetet e Ballkanit kanë një sistem të drejtësisë penale për fëmijë të ngjashëm, sa u përket shumë specifikave – moshës minimale dhe maksimale të përcaktimit të përgjgegjësisë penale të fëmijëve, sanksioneve penale, sistemit të organeve të drejtësisë që veprojnë me fëmijët etj.
- Vendet evropjane dallojnë me vendin tonë në llojet e sanksioneve penale dhe masave, programeve të cilat i parashohin për trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe atyre në konflikt me ligjin.

4. Konstatimet rreth hipotezës **"Sa janë treguar efikase masat parandaluese ndaj kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë? (*Mjaftueshëm apo jo mjaftueshëm?*)"** janë si në vijim**:**

- Meqenëse numri i fëmijëve të paraqitur dhe atyre të gjykuar për vepra penale shkon në ulje nga viti në vit, konstatohet se politika preventive ndaj kriminalitetit të fëmijëve në Maqedoni tregohet efikase mjaftueshëm, edhe pse ende duhet përparuar në këtë aspekt.

- Masat parandaluese në pajtim me dispozitat ligjore pozitive (të LDF) janë: Themelimi i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Ky Këshill është i mëvetësishëm dhe i pavarur në kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj.
- *Strategjia Nacionale për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (2010-2020)* është strategjia e parë në Republikën e Maqedonisë që synon përcaktimin e udhëzimeve strategjike dhe prioriteteve në parandalimin e delikuencës së fëmijëve, e cila është miratuar nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve në dhjetor 2010. (Strategjia për Parandalim, 2010, f. 9). Kjo Strategji është rezultat nga Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë (2007) dhe nga detyrimi që ajo të sillet nga Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve sipas n. 145 të këtij ligji. Strategjia i referohet periudhës 2011-2020 dhe synon të përcaktojë udhëzimet strategjike dhe prioritetet për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.
- Duke zbatuar kompetencat e tij nga Ligji për Drejtësinë e të Miturve, Këshilli Shtetëror miratoi Programin e tij Pesëvjeçar (2010-2014), dhe miratoi plane veprimi vjetore për operacionet e tij.
- Këshilli miraton Raportet vjetore rreth punës së realizuar në dretjim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve, me ç'rast në Raportin e vitit 2015 konstatoi se:

➢ Në pajtim me Programin e punës për vitin 2015 e ka realizuar kompetencën e vetë në pajtim me LDF dhe me këtë ka kontribuar në realizimin e aktiviteteve drejtë parandalimit të delikuencës së fëmijëve dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve.

➢ Janë marrë iniciativa për formimin e Këshillave komunalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, edhe pse aktualisht funksionojnë tetë këshilla të tillë komunalë në bazë të Programit të përpunuar dhe zbatojnë aktivitete me karakter preventiv, dhe atë në: Kavadar, Veles, Manastir, Gazi Babë, Strugë, Shtip, Radovish dhe Makedonski Brod. Ndërkaq, ka edhe këshilla komunalë të formuar, por të cilët gjatë vitit 2015 nuk kanë funksionuar, në komunat: Kumanovë, Ohër, Karposh, Butel, Kisela Vodë dhe Gjorçe Petrov.

- Në vitin 2011 u krijua sistemi gjithpërfshirës i monitorimit për drejtësinë e fëmijëve. Ministritë përkatëse e pranuan, kurse Këshilli Shtetëror e përpiloi listën e

treguesve standard për monitorimin e zbatimit të drejtësisë për të mitur si dhe miratoi një metodologji të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave për 21 tregues të krahasueshëm ndërkombëtarisht ose të përzgjedhur nga listat ekzistuese të përdorura në shtetet anëtare të BE-së, të mbështetura në treguesit e Kombeve të Bashkuara, por duke marrë parasysh prioritetet kombëtare dhe specifikat.

- Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e delikuencës dhe situatës në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve në vitin 2011 është përgatitur në bazë të rrjetit të treguesve të përcaktuar dhe Këshilli vazhdon të monitorojë situatën e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të miturit duke përdorur po këto tregues për ç'do vit.
- Aktivitete rreth parandalimit të delikuencës së fëmijëve përveç Këshillit Shtetëror për parandalimin të delikuencës së fëmijëve ndërmarrin edhe organet shtetërore dhe subjektet e tjera, si ministritë e ndryshme – ajo e Arsimit dhe Shkencës, e Punës dhe politikës sociale, e Shëndetësisë, e Drejtësisë, e Vetëqeverisjes lokale, rol shumë dominant në këtë aspekt kanë Organizatat e ndryshme joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve etj.
- Qendrat për Punë Sociale janë subjekte kyçe në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët në rrezik, si dhe ato që lidhen me fëmijët në ndeshje me ligjin. Në rast se Qendra për punë sociale njoftohet për fëmijë në rrezik, ajo menjëherë inicon procedurë për zbatim të masave për ndihmë dhe mbrojtje.
- Familja, sistemi edukativo-arsimor dhe faktorë të tjerë mbrojtës ngelen kyç për ndikimin e tyre ndaj fëmijëve për parandalimin e tyre nga dukuritë devijante dhe kriminale.

- Nga *anketa e realizuar me 120 nxënës* në 3 shkolla të mesme gjatë vitit 2017 dhe intervistat me 2 punonjës në këto shkolla u konstatua:
- Prania e ndikimit shumë të dobët të psikologëve dhe pedagogëve të punësuar në këto shkolla;
- Numri shumë i vogël i këtij kuadri – nga një psikolog dhe një pedagog të punësuar në secilën shkollë;
- Prezenca e sjelljeve të dhunshme, devijante, kriminale në shkolla;

- Prezenca e numrit të "errët " të kriminalitetit të fëmijëve në shkolla të mesme;
- Ndikimi i madh i familjes dhe i rrethit të shoqërisë tek të rinjët;
- Ndikimi i madh i masmediave tek sjellja e të rinjëve;
- Nevoja e rritjes së sigurisë nëpër shkolla.
- Nevoja e ndryshimit të sistemit ekukativo-arsimor – mbushja e kohës së lirë të nxënësve, duke e kombinuar mësimin në dy ndërrime – me qëllim të moslënies hapsirë të fëmijëve që të kenë kohë për t'u kyçur në grupe që mund të kenë influencë negative në sjelljen e tyre;
- Mungesa e bashkëpunimit prind-shkollë-nxënës;
- Mungesa e infromatave tek nxënësit rreth inkriminimit të veprave penale sipas legjislacionit pozitiv të vendit – si p.sh. mosha minimale e përgjegjësisë penale etj.

5. Përfundimet që ndërlidhen me hipotezën e fundit **"A dallon taktika kriminalistike për zbulimin e fëmijëve të dyshuar për vepra penale nga ata të moshës madhore? (*Po, Jo?)"*** janë këto:

- Zbulimi i fëmijëve të dyshuar për veprime devijante dhe kriminale i ka specifikat e veta të cilat dallojnë nga taktikat dhe metodat e zbulimit dhe trajtimit të personave madhorë, kjo për arsye të karakteristikave të vetë kryesve jomadhorë: Mosha e kryesve, mënyra e kryerjes, llojet e veprave penale të cilat më së shpeshti ato i kryejnë, kufizimet ligjore për trajtimin e këtyre personave etj.
- Fëmijët në praktikë kryejnë shumicën e veprave penale të parapara me Kodin penal, sikurse edhe personat madhorë, ndonëse me theks të veçantë paraqiten si kryes të veprave penale kundër pasurisë.
- Nga aspekti i metodikës së zbulimit të delikuencës së fëmijëve: Te fëmijët delikuentë vërehet se numri më i madh i veprave penale janë të kryera gjatë stinës së verës (qershor-gusht), që do të thotë kanë ndodhur pas kryerjes së mësimeve dhe në kohën e pushimeve verore.
- Caktimi i këtyre karakteristikave, si koha e kryerjes së veprës penale, vendi, mënyra etj., paraqet patjetërsueshmëri për zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit të fëmijëve!

- Sipas Ligjit mbi policinë të Republikës së Maqedonisë, autorizimet policore ndaj personave jomadhorë i zbatojnë nëpunësit policor të cilët janë të trajnuar posaçërisht për luftimin e delikuencës së fëmijëve. Autorizimet policore ndaj fëmijëve zbatohen nën kushtet e përcaktuara me ligj të posaçëm, respektivisht me Ligjin mbi drejtësinë e fëmijëve. Aktiviteti i shërbimit të specializuar që punon në zbulimin e kriminalitetit të fëmijëve në kuadër të organeve të punëve të brendshme ka karakter të theksuar preventiv.
- Gjatë zbulimit të fëmijëve të dyshuar për krime, policia qoftë në ndërmarrjen e masave hetimore apo atyre operative, gjithmonë duhet ti zbatojë dispozitat ligjore dhe regullat kriminalistike që kanë të bëjnë me trajtimin e fëmijëve në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

REKOMANDIME

1. Republika e Maqedonisë duhet të vazhdojë ta ketë prioritet parandalimin e delikuencës së fëmijëve, respektivisht kriminalitetin e të rinjëve – si kusht për të pasur sukses në drejtim të luftimit të kriminalitetit të përgjithshëm. Kjo sepse, nëse arrihet sukses në mbajtjen nën kontroll të numrit të këtij fenomeni, me tendenca të uljes sa më të theksuar të numrit të rasteve të paraqitura, do të mund të arrihet në rezultatin e një rinie të suksesshme, përmes së cilës do të sigurohet një ardhmëri më e ndritur e cila do ta përfaqësojë vendin në të ardhmen e afërt.
2. Sistemi edukativo-arsimor të implementohet sa më parë në Shtëpinë edukuese-përmirësuese Tetovë dhe në burgun për fëmijë Ohër ndaj fëmijëve të dënuar që gjenden atje.
3. Sa më shpejtë të sigurohet vënia në përdorim e objektit të ri të Shtëpisë edukuese-përmirësuese Tetovë, i cili është në proces të ndërtimit dhe largimi i fëmijëve të gjykuar me këtë masë nga objekti i burgut për fëmijë në Ohër.
4. Të investohet në përmirësimin e kushteve të banimit në objektin e burgut për fëmijë dhe në rinovimin e këtij objekti, apo edhe ndryshimin e objektit me një objekt tjetër në një lokacion më të përshtatshëm se sa ai aktual dhe me kushte më të mira për sigurimin e edukimit dhe resocializimit të fëmijëve të privuar nga liria.
5. Nëpër shkolla fillore dhe sidomos në ato të mesme të investohet në kuadrin profesional në aspekt kualitativ dhe kuantitativ, duke punësuar persona të cilët posedojnë aftësi profesionale për trajtimin e nxënësve si dhe rritjen e numrit të këtij personeli- të pedagogëve dhe psikologëve për të mundësuar trajtimin e duhur të nxënësve në proporcion me kapacitetet dhe nevojat e nxënësve në shkollat përkatëse.

6. Të ndërmerren nisma në nxitjen e gjykatave për shqiptimin e masave edukuese të cilat edhe pse ekzistojnë në listën e sanksioneve penale për fëmijë në Ligjin mbi drejtësinë për fëmijët, që për një dekadë asnjëherë nuk janë shqiptuar ndaj fëmijëve të gjykuar për vepra penale – siç janë Masa e mbikqyrjes së përforcuar nga familja tjetër dhe Dërgimi në Qendër për fëmijë. Në të kundërtën, ligjvënësi duhet të rishikojë këto sanksione penale për fëmijë, duke gjetur një modifikim për të arritur deri tek efektiviteti i tyre, respektivisht përshtatja me rrethanat reale të mjedisit tonë shoqëror.

7. Zgjidhja aktuale ligjore lidhur me afatet e masave të enteve të cilat paraqesin minimumin dhe maksimumin absolut të kohëzgjatjes së masës, konsideroj se duhet të pësojë ndryshime. Kjo sepse, aktualisht është e rregulluar në mënyrën që gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen strikte të masës, por për këtë vendosë më vonë. Prandaj, rekomandoj që të bëhen ndryshime ligjore në këtë drejtim, me zgjidhjen që gjykata të caktojë kohëzgjatjen konkrete të masës në momentin e sjelljes së vendimit, me mundësi që me vendim plotësues të shkurtoj afatin e caktuar.

8. Në drejtim të politikës preventive – institucionet e ndryshme shtetërore kompetente duhet të ofrojnë mundësi për të rinjtë që ata ta kalojnë kohën e lirë në angazhim në aktivitete të ndryshme të cilat do të ndikonin në zhvillimin pozitiv të tyre, si p.sh. Hapja e mundësive të ndryshme të punësimit të fëmijve mbi 15 vjet, aktivitete sportive, artistike etj. Këto mundësi zbavitëse, si kinema, biblioteka dhe vende tjera rekreacioni aktualisht ekzistojnë vetëm në kryeqytetin e vendit, kurse nëpër qytetet e tjera janë në dispozicion minimal për të rinjtë.

9. Të rritet zbatimi i programeve me natyrë preventive ndaj delikuencës së fëmijëve, si p.sh. promovimi i parandalimit të delikuencës së fëmijëve dhe i ndikimit negativ të faktorëve kriminogjen ndaj saj, si dukuritë socio-patologjike – alkoolozmi, narkomania, prostitucioni etj.;

10. Të realizohet promovim i programeve parandaluese përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe formave të tjera, si organizimi i ligjëratave, debateve me tema të natyrës preventive sidomos nëpër shkolla fillore dhe ato të mesme - tek nxënësit, stafi i shkollave dhe tek prindërit;

11. Të modifikohet programi i sistemit edukativo-arsimor i nivelit të mesëm, duke i angazhuar nxënësit për një periudhë më të gjatë në shkollë – paradite dhe pasdite, me të vetmin qëllim që të shmanget koha e lirë e cila paraqet faktor rreziku dhe ndikon në paraqitjen e delikuencës së fëmijëve.

12. Të investohet në ngritjen e nivelit ekonomik të vendit – sepse shumica e krimeve të cilat kryhen nga fëmijët janë ato kundër pasurisë, ku si faktorë i shpeshtë kriminogjen e cili ka ndikuar tek paraqitja e sjelljeve të këtilla kriminale të fëmijëve ka qenë pikërisht niveli i ulët ekonomik i familjes/prindërve të fëmiut.

13. Politikat parandaluese të koncentrohen veçanërisht tek fëmijët në rrezik.

14. Të vazhdohet me drejtimin e filluar të punës së policisë së specializuar për preventivë të kriminalitetit të fëmijëve dhe për trajtimin e fëmijëve të dyshuar për veprime kriminale – duke i ndjekur praktikat më të mira të policive rajonale dhe ndërkombëtare, gjithmonë me qëllim të mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijëve.

15. Në të ardhmen duhet të ndiqen praktikat e mira të vendeve të ndryshme të cilat mund të përshtaten dhe implementohen në vendin tonë, si p.sh. Masat e ndryshme respresive dhe preventive, programet të cilat parashihen në legjislacionet e vendeve evropjane, si Holanda, Zvicra apo Norvegjia.

LISTA E SHKURTESAVE

LDF – Ligji mbi drejtësinë për fëmijë

LDM – Ligji mbi drejtësinë për të mitur

KPM – Kodi penal i Republikës së Maqedonisë

LPP – Ligji mbi procedurën penale

OJQ – Organizata Joqeveritare

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

BE – Bashkimi Europjan

MASH – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

QPS – Qendrat për Punë Sociale

R.M. – Republika e Maqedonisë

PTHP – Prokuroria Themelore Publike

KDMSH – Kodi i Drejtësisë për të mitur i Republikës së Shqipërisë

KDMK – Kodi i Drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës

BIBLIOGRAFIA

LIBRA DHE PUNIME SHKENCORE

- Appendix to Recommendation Rec (2005) 5 of the Committee of Ministers to member states on the rights of the children living in residential institutios, 16 May 2005
- Arifi, B. (2017). THE CHILD CRIME PHENOMENON IN REPUBLIC OF MACEDONIA: 2006-2015. ANNUAL of ISPJR , XLI (I), 103-104.
- Arifi, B. A. (2017). How to prevent youth crime in Macedonia? European Journal of Social Sciences Education and Research , 8-15.
- Avziu, Q. (2015). Hyrje në Kriminalistikë. Tetovë.
- Bajrami, T. (2017). Masat ndaj të miturve delikuentë në Kosovë. CENTRUM 7 , 290-304.
- Bateman, T. (2013). Youth Justice News. 13(1) Youth Justice 85, 87.
- Begeja, S. "KRIMINALISTIKA", Tiranë, 2004.
- Begeja, S. (1999). Kriminalistika. Tiranë.
- Blakeman, I. (2008). THE YOUTH JUSTICE SYSTEM OF ENGLAND AND WALES, 139TH INTERNATIONAL TRAINING COURSE (http://www.unafei.or.jp/english/pdf/RS_No78/No78_13VE_Blakeman.pdf).
- Božičević-Grbić M. & Roksandić Vidlička S. (2011). Reforma maloljetničkog prava i sudovanja, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu. [Croatian Annual for Criminal Law and Practice], Vol. 18, No. 2, , 715.
- Buzharovska, G.L., Nanev, L , Kashevaliska O. Кривично постапување спрема децата во ризик и во судир со законот, Shkup, 2015

- Cavadino & Dignan. (2006 (2010)). Youth Justice in Great Britain. In J. D. Micheal Cavadino, Penal Systems: A Comparative Approach (pp. 220-232). London: SAGE Publications, British Library.
- Cavadino & Dignan. (2006 (2010)). Youth Justice in the Netherlands. In Penal Systems - A Comparative Aproach (pp. 268-272). Los Angeles, London, New Delhi, Singapore, Washington DC: SAGE Publications.
- Concluding observations on the combined second to fourth periodic reports of Switzerland CRC/C/CHE/CO/2-4. UN Committee on the Rights of the Child (CRC) (26.02.2015): http://www.refworld.org/docid/566e80214.html (Data e akcesit: 10.08.2017).
- Demolli, H. (1996). Problemet e Alkoolizmit dhe Narkomanisë, Nocioni dhe paraqitje e tyre. Revista E drejta , 145.
- Detention and Training Order. Youth Justice Board for England and Wales. (2008).
- Elezi, I. (2002). Mbrojtja juridike penale e pasurisë. Tiranë.
- F.Baçiç, E drejta penale – Pjesa e përgjithshme, Zagreb- 1998.
- F.Hirjan&M.Singer, Maloletnici u krivicnom pravo, Zagreb, 1991
- Feikert, C. (2007 (update 2015)). Children's Rights: United Kingdom (England and Wales). Law Library of Congress.
- Garside, R. (2009). Too young to be a criminal. The Guardian- Youth justice opinion.
- Gashi, R. (1997). Aplikimi i dënimit me burg për të mitur në territorin e gjykatës së Qarkur të Prishtinës gjatë periudhës 1976-1990. Revista E drejta , 113.
- Golomeova, E. (2013). Превенција на малолетничка деликвенција, анализа на законската регулатива и пракса. Shtip: Faculty of Law, University "Goce Delcev".
- Hajdari, A. (2010). Sistemi i Drejtësisë për të mitur. Prishtinë.

- Halili, R. (2008). Kriminologjia. Prishtinë.
- Halili, R. (2010). Penologjia. Prishtinë.
- Haxhiu, Myftari, “DAKTILOSKOPIA”, Tiranë, 2004.
- Hydle, I. M. (2014). First report of the Research based evaluation of the trial project of establishing a particular youth unit for young offenders between 15 and 18 years old in Norway – 2009–2015. Oslo: Welfare Research Institute NOVA - Oslo and Akershus University College of Applied Sciences.
- INFORMATOR për subjektet të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë për të mitur. Shkup: Këshilli shtetëror për parandalim të delikuencës së fëmijëve, (2013).
- J. Muncie & B. Goldson. (2006). England and Wales: The New Correctionalism. In J. M. Goldson, Comparative Youth Justice: Critical Issues (pp. 34-47). London: SAGE Publications Ltd (Data e akcesit: 11 May 2017).
- J.Junger-Tas, M.Steketee, M.Moll. (2010). The Netherlands. In J. J.-T. Editors, Juvenile Delinquency in Europe and Beyond (Results of the Second International Self–Report Delinquency Study) (pp. 15-28). New York: Springer Science + Business Media, LLC.
- JACOBSEN & HALLGREN SANDVIK. (2015). An Outline of the New Norwegian Criminal Code. Bergen Journal of Criminal Law and Criminal Justice • Volume 3, Issue 2, 162-183.
- Jashoviq, Z. Kriminologija maloletnicke delikvencije, Beograd, 1991
- John Graham, Colleen Moore. (2006). Beyond Welfare Versus Justice: Juvenile Justice in England and Wales (in The Ango-Saxon Orientation). In S. H. Josine Junger-Tas, International Handbook of Juvenile Justice (pp. 65-92). New York: Springer.
- Kambovski, V. (2007). E DREJTA PENALE Pjesa e përgjithshme. Shkup: Furkan ISM.
- Kambovski, V., Maloletnicka pravda, Shkup, 2008

- Kemény, S. (2005). VICTIM-OFFENDER MEDIATION WITH JUVENILE OFFENDERS IN NORWAY . In S. G. ANNA MESTITZ, Victim-Offender Mediation with Youth Offenders in Europe An Overview and Comparison of 15 Countries (pp. 101-114). Bologna, Italy: Springer, Published in the Netherlands.
- Кнежевиќ, С. (2010). Малолетничко кривично право- материално, процесно и извршно, Projekt: Право на приступ правсуду, Ниш.
- Korajlić, N. (2007). Taktika kriminalistike. Sarajevë/Prishtinë: “Kriminalistička taktika”.
- Kryerës të veprave penale në 2007. Shkup: "Preperators of criminal offences in 2007", Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Statistical review, Population and social statistics, 2.4.08.07 (594). p.124.(2008).
- Kryerës të veprave penale në 2008. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2008" Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së maqedonisë, Statistical review / Population and social statistics,2.4.09.11 (631),p. 121. (2009).
- Kryerës të veprave penale në 2009. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2009", Statistical review / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.10.012 (665),p.128. (2010).
- Kryerës të veprave penale në 2010. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2010", Statistical review / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics,2.4.11.15 (698), p.123. (2011).
- Kryerës të veprave penale në 2011. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2011", Statistical review / Enti Shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.12.09 (724), p.119. (2012).
- Kryerës të veprave penale në 2012. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2012", Statistical review / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.13.11 p.119. (2013).

- Kryerës të veprave penale në 2013. Shkup: !Perpetrators od criminal offences in 2013", Statistical review / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.14.11 (789) p.117. (2014).
- Kryerës të veprave penale në 2014. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2014", Statistical review / Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.15.12 (823) p.115. (2015).
- Kryerës të veprave penale në 2015. Shkup: "Perpetrators od criminal offences in 2015", Statistical review, Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Population and social statistics, 2.4.16.08 (8544). (2016).
- Latifi, V. (1982). Kriminalistika e delikuencës së të miturve. Prishinë: Rilindja.
- Latifi, V. (2001). Taktika kriminalistike. Prishtinë.
- Latifi, V. (2010). Kriminalistika. Prishtinë: Fakulteti juridik i Prishtinës.
- Latifi, V. (2011). Kriminalistika. Prishtinë: (Zbulimi dhe të provuarit e krimit), Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës.
- Latifi, V., Elezi, I., Hysi ,V. ”POLITIKA E LUFTIMIT TË KRIMINALITETIT”, Prishtinë, 2012
- Lisle, C. (2014). Is the United Kingdom failing its Children? Applying International Youth Justice Standards in a Devolved Legal System. Westminster Law Review , 3 (2).
- M Killias, M F. Aebi, L.Herrmann, C. Dilitz, S. Lucia. (2010). Switzerland. In J. J.-T. (eds.), Juvenile Delinquency in Europe and Beyond (pp. 79-96). New York: Springer Science + Business Media, LLC.
- M. Berger, J. Brummelman. (2015). Juvenile Offenders Detention Alternatives in Europe. National Report - The Netherlands .
- M.Singer, Kriminalitet na stetu maloletnika, Zagreb.1989

- Maršavelski, A. ALTERNATIVES TO CUSTODY FOR YOUNG OFFENDERS. NATIONAL REPORT ON JUVENILE JUSTICE TRENDS: CROATIA. INTERNATIONAL JUVENILE JUSTICE OBSERVATORY.
- Michael J. Allen, Textbook on Criminal Law, Oxford University Press, 2003.
- Milosovlevič, B. (1997). Nauka o policiji. Beograd.
- Muhoviq, M. "Etika me bazat e etikës kriminalistike",(Përkthim në shqip) Sarajevë/Prishtinë, 2006
- Muncie, Goldson and contrib. (2006). The Netherlands: Penal-Welfarism and Risk Management. In B. G. John Muncie, Comparative Youth Justice: Critical Issues (pp. 65-78). London: SAGE Publications Ltd.
- Pajoviq.M. S., Мерките на помош и заштита според Законот за малолетничката правда, Зборник за малолетничка правда, Факултет за безбедност Скопје, 2010 & Овластување на центрите за социална работа и на јавниот обвинител во малолетничката правда, Трет Загребско- Скопски правен колоквиум, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 61 No. 2 Ožujak 2011, f. 441-468.
- Plani Aksional dhe Korniza Buxhetore për implementimin e Ligjit për drejtësinë e të miturve 2008-2009. (Акционен План и Буџетска Рамка за Имплементација на Законот за Малолетничка Деликвенција 200-2009): Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë.
- Raporti për 2015 i Këshillit SHPDF. (2016). Raport Vjetor për Punën e Këshillit Shtetëror për paradanlimin e delikuencës së fëmijëve dhe për gjendjetnë sferën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së fëmijëve në vitin 2015. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është hequr liria (Rregullat e Havanës 1990); United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)

- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit" -1985), United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)
- Sabina Mandić, D. D. (2017). Perception of a Croatian Juvenile Justice System - Professionals' Perspective . ERFCON 2017 9th International Conference of the Faculty of Education and Rehabilitation Sciences University of Zagreb . Zagreb.
- Sahiti E., Zejneli I. (2007, 2017). E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë. Tetovë.
- Sahiti, E. (1993). Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale. Prishtinë.
- Screvens, R. (1979). Police et prevention de la criminalite (Vol. 3). Zagreb: Izbor članaka iz stranih časopisa.
- Sevdiren, O. (2011). Alternatives to Imprisonment in England: Destined to Fail? (A Mixed Approach towards Non-custodial Sanctions). In O. Sevdiren, Alternatives to Imprisonment in England and Wales, Germany and Turkey (pp. 89-100). Verlag Berlin Heidelberg: Springer.
- Shishani, F. (2006). Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit. Prishtinë.
- Strategjia për Parandalim. (2010). Strategjia Nacionale për parandalim të delikuencës së të mituve 2010-2020. Shkup: Këshilli Shtetëror për parandalim të delikuencës së të miturve ("Национална Стратегија за Превенција на Малолетничко Престапништво 2010-2020").
- Stupmer, A. (1987). Vorbengung ' Steitkindder polizeilichen Arbeit (Vol. 1'2). Zagreb: Izvor članaka iz stranih časopisa.
- Sue Titus Reid, Criminal Law, McGraw-Hill, Boston, 1998.
- SUFAJ, F. (2011). Sistemi i drejtësisë për të mitur në Shqipëri krahasuar me standardet ndërkombëtare. Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Volumi 1 , 63-84.

- Summary of Juvenile Justice related issues. (2015). 2nd to 4th periodic report of SWITZERLAND 68th session of the United Nations Committee on the Rights of the Child. : https://defenceforchildren.org/wp-content/uploads/2015/05/Switzerland-CRC-template.pdf: defenceforchildren.org.
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Rijadit); Titulli original: UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Deliquency (Riyadh Guidelines)
- Wormer, K. V. (1990). The hidden juvenile justice system in Norway: A journey back in time. Federal Probation Volume:54 Issue:1 , 57-61.
- Youth Justice Board for England and Wales, Custody. (2008).
- Zejneli, I. (2008). Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë. Tetovë.
- Zejneli, I. (2018). Delikuenca e të miturve. Tetovë/ Prishtinë.
- Zejneli, I. (2018). Delikuenca e të miturve. Tetovë/Prishtinë.
- Zizak, A. (2010). Mediation in Cases of Juvenile Offenders in Croatia.

KONVENTA, KUSHTETUTA, KODE, LIGJE

- Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës 1989 (Convention on the Rights of the Child-(CRC))
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52 nga 22.11.1992 me Amandamentet plotësuese I-XXXII. Shkup.
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr: 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014.

- Ligji penal i Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave. “Gazeta Zyrtare e F.D.” nr. 44/76, 34/84, 74/84, 57/89, 3/90,38/90, dhe “G.Z. e R.M.” nr. 25/92, 32/93.
- Ligji penal i Republikës Socialiste të Maqedonisë. “ Gazeta Zyrtare e R.S.M.”, nr. 25/77, 23/84, 50/87, 36/89,7/90, 23/91, 24/92, 49/93.
- Ligji për drejtësinë e të miturve i Republikës së Maqedonisë. (2007). ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007, 103/2008, 161/2008 dhe 145/10).
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve i Republikës së Maqedonisë. (2013). “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë.” nr. 148 /2013.
- Ligji mbi Policinë i Republikës së Maqedonisë (Tekst i Spastruar). (Mars, 2015). ("Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 114/04, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 148/08).
- „Lista e masave të ndihmës dhe mbrojtjes - Dokument shtesë me Rregulloren për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit për zbatimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes ndaj fëmijëve dhe të miturve në rrezik të miratuar në vitin 2008 (Gazeta Zyrtare e R.M., nr. 24/2008, f. 24-31.).
- Children and Young Persons Act of England. (1933)
- Crime and Disorder Act. England. (1988).
- Criminal Justice Act of England. (2003).
- Criminal Procedure (Scotland) Act .
- Kodi Evropjan i Etikës Policore, 2001.
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Kosovës. (2010). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë:Viti V/Nr.78/20 Gusht 2010 KODI nr.03/L-193 .
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Shqipërisë. (2017). Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë nr.92 Ligji 37/2017, 30.03.2017 , 5210-5250.
- Kodi penal i Holandës. (1881, me ndyshime 1994). (English version Dutch Penal Code)[7-7-1994].
- Kodi penal i Kroacisë 2015. (n.d.). Kazneni zakon "Narodne novine" NN 125/11, 144/12, 56/15, 61/15 .

- Kodi penal i Norvegjisë. (2005). Lov om straff -Straffeloven LOV-2005-05-20-28. Ministry of Justice and Public Security .
- Ligji mbi familjen i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e R.M.". nr. 80/1992, (Tekst i spastruar) "G.Z. e R.M." nr. 153/2014, 104/2015, 150/2015.
- Ligji mbi gjykatat për të mitur i Kroacisë. (2015). (Zakon o sudovima za mladež) "Narodne novine" nr. 84/11, 143/12, 148/13, 56/15 .
- Ligji për zgjidhjen e konflikteve i Norvegjisë (Ligji mbi Mediacionin). (2014). Lov om konfliktrådsbehandling (konfliktrådsloven) LOV-2014-06-20-49. Ministry of Justice and Public Security Norway .
- Police and Criminal Evidence Act. England. (1984).
- Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act. (2000).
- Swiss Juvenile Criminal Law Act (JCLA) 2007 . (2010). The execution of sentences and measures in Swittzerland. Swittzerland: Federal Department of Justice and Police FDJP.
- Zakon o udomiteljstvu, "Narodne novine" (Official Gazette) No. 90/11, 78/12. (n.d.)

VENDIME GJYQËSORE

- Gjykata Supreme e R.M. (2015). ЗБИРКА на судски одлуки 2004-2014, Кн. 11, 2004-2014. Скопје: Лидија Неделкова, Јово Вангеловски.
- Gjykata Themelore Shkupi I. (2014). Aktvendim KM-210/14. Shkup.

- Gjykata Themelore Shkupi I. (2014). Aktvendim KM-210/14. Shkup.

- Gjykata Themelore Shkupi I. (2016). II.KM.nr. 20/16. Shkup.
- Gjykata Themelore Tetovë. (2017). KM-16/17. Tetovë.
- Gjykata Themelore Tetovë. (2017). KM-27/17. Tetovë.
- Gjykata Themelore Tetovë. (2017). KM-28/17. Tetovë.
- Gjykata Themelore Tetovë. (2017). KM-29/17. Tetovë.

ANKETA DHE INTERVISTA

- Anketë e realizuar më 2017 me fëmijë të gjykuar me masën edukuese të entit-Referimi në Shtëpi edukuese-përmirësese, Tetovë (Ohër).
- Anketë e realizuar më 2017 me fëmijë të dënuar me dënimin burg për fëmijë, Ohër.
- Anketë e realizuar më 2017 me nxënës të shkollave të mesme, Tetovë.
- Intervistë e realizuar më 2017 me të punësuar në shkolla të mesme, Tetovë.
- Intervistë e realizuar më 2017 me Këshilltar të lartë të MPB-së dhe anëtar i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, Shkup.

PUBLIKIME NË SAJTE

- http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/06/Taulant-Bajrami.pdf. (n.d.).
- http://md.rks-gov.net/. (n.d.).
- http://www.ajls.org/doc/5_FSufaj_Takimi_V.pdf. (n.d.).
- http://www.kosovapress.com/sq/lajme/miratohet-ne-parim-projekt-kodi-i-drejtesise-per-te-mitur-105042/. (n.d.).
- http://www.legislation.gov.uk/. (n.d.).
- http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/92-2017.pdf. (n.d.).
- http://www.uisn.hr/index.php?id=publikacije.
- http://www.westminsterlawreview.org/Volume3/Issue2/wlr28.php. (n.d.).
- https://gzk.rks-gov.net/. (n.d.).
- https://lovdata.no/.
- https://lovdata.no/dokument/NL/lov/2005-05-20-28/*#*.
- https://lovdata.no/dokument/NL/lov/2014-06-20-49?q=konfliktr%C3%A5dsloven.
- https://www.justice.gov.uk/offenders/types-of-offender/juveniles. (n.d.).
- https://www.parlament.al/. (n.d.).

- https://www.parlament.al/projektligj/projektligji-kodi-i-drejtesise-per-te-mitur/. (n.d.).
- https://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.html. (n.d.).
- https://www.unicef.org/kosovoprogramme. (n.d.).
- https://www.zeriamerikes.com/a/drejtesia-per-te-mitur/2939399.html. (31.08.2016).
- http://www.slvesnik.com.mk/content/Ustav%20na%20RM%20-%20makedonski%20-%20FINALEN%202011.pdf
- http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=129691. (n.d.).